



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Raporti Vjetor 2013

Nr. 13

31 mars 2014
Prishtinë

Z. Jakup Krasniqi
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Prishtinë

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes Raportin e trembëdhjetë vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, Ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen e këtij Raporti në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe hapjen e diskutimit në lidhje me këtë raport.

Me nderime,
Sami Kurteshi



Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 31 mars 2014

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT

Bashkëjetesa në një shoqëri demokratike, kërkon domosdo një komunikim të hapur, të sinqertë dhe të vazhdueshëm ndërnjerëzor. Në shtetin modern, një komunikim i tillë është i domosdoshëm midis qytetarit dhe shtetit. Shteti, ndër të tjera, është edhe tërësi raportesh njerëzore të shprehura në të gjitha format e mundshme: individ-individ, individ-grup, grup-grup, individ-institucion, grup-institucion, institucion-institucion etj.

Komunikimi i shëndoshë si bazë veprimi, mbështetet në besimin ndërnjerëzor i cili duhet rikrijuar vazhdimisht. Besimi ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, që përfshin të gjitha format e mundshme të komunikimit, bazohet në respektimin e normave të kodifikuara shoqërore - të ligjeve. Ky besim është në përpjesëtim të drejtpërdrejtë me integritetin e zyrtarëve të shtetit – autoriteteve publike. Ai ka të bëjë me respektimin e ligjeve dhe me krijimin e mekanizmave të brendshëm veprues efektiv të autoriteteve publike për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

Pritjet dhe kërkesat e qytetarëve ndaj autoriteteve publike janë që t'i zgjidhin problemet që ata kanë. Problemet janë të shumta, ndërsa kërkesat mund të jenë të arsyeshme dhe të paarsyeshme. Shteti duhet të ballafaqohet me problemet dhe kërkesat e qytetarëve dhe duhet t'i njoftojë ata me mundësitë, mjetet dhe rrugët ligjore që ata kanë për të shtruar kërkesat e tyre dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre bazuar në ligj.

Avokati i Popullit është pjesë përbërëse e këtij komunikimi institucional e ndërnjerëzor. Ai është pjesë e nyjes së komplikuar të marrëdhënieve qytetar – autoritete publike. Në njërin anë, ai duhet të përçojë dhe ankesat e qytetarëve drejt autoriteteve, duke kërkuar zgjidhje për to. Në anën tjetër, duhet të ketë parasysh mjetet dhe mundësitë e kufizuara të autoriteteve për plotësimin dhe zgjidhjen e të gjitha kërkesave. Por, Avokati i Popullit, edhe i mbron autoritetet publike duke refuzuar kritikën, ankesat apo kërkesat e paligjshme ndaj tyre.

Dështimi në cilindo nga këto hallka, do të jetë shumë i rrezikshëm për të gjithë: për autoritetet publike, se do të humbasin besimin e qytetarëve; rrjedhimisht për qytetarët, sepse do të kërkojnë zgjidhje të tjera, jashtë institucioneve shtetërore; domosdo për Avokatin e Popullit, sepse do të shpie në përkeqësimin, marrëdhënieve me autoritetet publike, kur u drejtohet në rast të dështimit për të vepruar sipas ligjit, që rrjedhimisht do të jetë i dëmshëm për qytetarët. Ky është skenari më i rrezikshëm për qytetarin.

Pikërisht mbi këto relacione ndërtohet besimi qytetar – autoritete publike. Angazhimi i autoriteteve publike në ngritjen dhe përmirësimin e standardeve të veprimit, përfshirë edhe ato etike; thjeshtësimi i kompleksitetit të procedurave për qasje të qytetarit tek autoritetet publike; krijimi dhe funksionalizimi i procedurave të thjeshtësuara të brendshme për qasje të qytetarëve me ankesa, shton besimin e qytetarëve në autoritetet publike – në shtetin. Në këtë kuptim, roli dhe synimi i Avokatit të Popullit është promovimi dhe vëzhgimi i standardeve etike në administratën publike. Krijimin, funksionalizimin, thjeshtësimin e procedurave të brendshme për ankesat e qytetarëve nga administrata publike, Avokati i Popullit nuk e konsideron si konkurrencë të rrezikshme për vete, por e përshëndet si veprim etik të domosdoshëm të autoriteteve.

Thjeshtësimi i procedurave, transparenca, përgjegjësia dhe integriteti i administratës shtetërore në raport me qytetarin, përbën gurthemelin e besimit në një shoqëri moderne demokratike. Veprimet dhe mosveprimet, vendimet dhe mungesa e vendimeve të autoriteteve publike, janë pjesë përbërëse e vendimmarrjes publike. Nëse qytetarët besojnë dhe janë të bindur se autoritetet publike sillen ndaj tyre në mënyrë të drejtë, se trajtojnë pasurinë publike në mënyrë të drejtë, se i shërbejnë interesave publike si e mirë e përbashkët dhe jo atyre private, se marrin vendime të drejta, se vendimet e tyre janë të bazuara në ligje dhe rrjedhimisht të parashikueshme, se edhe në rast të ankesave, qytetarëve u vihen në dispozicion mjete dhe mënyra të thjeshta dhe të qarta për të drejtuar pakënaqësitë e tyre, besimi në autoritetet publike është një rrjedhojë e domosdoshme dhe e pa alternativë. Dhe pikërisht, vetëm kjo mënyrë e veprimit të autoriteteve publike, duhet kultivuar për çdo ditë, në çdo kontakt individual me qytetarët.

Autoritetet publike janë vetë shteti. Ato janë të krijuara dhe veprojnë bazuar në ligje. Por, veprimi i autoriteteve publike, përveç përkufizimit normativ, duhet të udhëhiqet edhe nga parimi i veprimit etik. Shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shkelja e parimeve themelore të një administrate publike moderne si mosdiskriminimi dhe proporcionaliteti, përbëjnë shkelje të rënda të veprimit etik. Shkelja e ligjit nga vetë autoritetet publike dhe sidomos veprimi joetik, qoftë edhe në një rast të vetëm individual, i cili mbetet i pasanksionuar, janë dy veprimet që shlyejnë tërësisht çfarëdo besimi në shtetin dhe përbëjnë dëshminë kyçe të keqadministrimit dhe për dështimin e një sistemi të administratës.

Natyrisht, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës çdo person ka në dispozicion një varg mjeteve ligjore për të kërkuar drejtësinë në raste të shkeljeve të tilla. Mirëpo, këto mjete, në radhë të parë duhet të jenë të qarta dhe efektive. Së dyti, mekanizmat për zbatimin e tyre duhet të jenë efikase dhe të përgatitura për t'u ballafaquar me raste të tilla.

Gjendja aktuale e administratës publike, përfshirë edhe gjyqësorin në Republikën e Kosovës, nuk është gjithmonë në gjendje të ballafaqohet me raste të tilla, sidomos brenda një afati të arsyeshëm kohor. Përveç zvarritjeve të pakufishme në trajtimin e rasteve, rastet e tilla jo gjithmonë mund të dëshmojnë dhe argumentohen me lehtësi. Prandaj, kjo e bën edhe më të domosdoshëm ekzistencën dhe veprimin e institucioneve të pavarura jashtëgjyqësore të cilat, brenda një afati të shkurtë mund të merren në mënyrë efektive, të paanshme dhe profesionale, me këto raste. Në rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, diskriminimit dhe keqadministrimit, roli i Avokatit të Popullit është kyç.

Trajtimi dhe zgjidhja e rasteve individuale të shkeljeve të ndryshme, më shumë se punë e Avokatit të Popullit, duhet të jetë punë e vetë autoriteteve publike. Sepse vetë autoritetet publike janë ligji në veprim, domethënë janë ato që në jetën praktike zbatojnë ligjet, të cilat në thelb përbëjnë vullnetin e deklaruar të të gjithëve dhe të secilit veç e veç, përmes votës së tyre.

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, pa fuqi ekzekutive dhe sanksionuese, ka një rol specifik institucional. Përveç monitorimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore, ka për mision edhe forcimin e shtetit ligjor dhe konsolidimin e autoriteteve publike të përgjegjshme ndaj qytetarit. Si ndërmjetës moral midis qytetarit dhe autoriteteve publike, me rekomandimet e tij konstruktive, ai mëton ndryshimet pozitive vetëm përmes autoritetit moral dhe bindjes.

Prandaj, Avokati i Popullit duhet të fokusohet gjithnjë e më shumë në veprimin proaktiv në fushën e përmirësimit të ligjeve dhe të veprimeve të autoriteteve publike, duke u angazhuar së bashku me to për krijimin e një klime në të cilën autoritetet publike, obligimet ligjore i kuptojnë dhe i mishërojnë si parime etike të veprimit, si dhe shndërrimin gradual të këtyre parimeve etike në kategori morale të veprimit të përgjithshëm shoqëror.

PËRMBAJTJA

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT	3
PARATHËNIE	12
KAPITULLI I	20
HYRJE	20
1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit	20
1.2. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit	20
1.3. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit	22
KAPITULLI II	24
TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	24
2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	24
2.2. Dinjiteti i njeriut	26
2.3. Barazia para ligjit	27
2.3.1. Barazia gjinore	28
2.3.2. Pjesëmarrja në tregun e punës dhe në vendimmarrjen politike	28
2.3.3. E drejta e pronës dhe trashëgimisë	29
2.3.4. E drejta për arsim	29
2.3.5. Dhuna në familje	30
2.3.6. Gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës	30
2.3.7. Zbatueshmëria e ligjeve	31
2.3.8. Diskriminimi i bazuar në moshë	32
2.3.9. Ankesat kundër Universitetit të Prishtinës	33
2.3.10. Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me diskriminim në moshë	33
2.3.11. Diskriminimi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	34
2.3.12. Agjencia Kosovare e Privatizimit	35
2.3.13. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuar	35
2.3.14. Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBT	36
2.3.15. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komunitetit LGBT	36
2.3.16. Problemet dhe sfidat kryesore të komunitetit LGBT në Kosovë	37
2.3.17. Diskriminimi në baza sociale	39
2.3.18. Shfrytëzimi i lirë i pronës private dhe publike	39
2.3.19. Agjencia Kosovare e Pronës	40
2.4. E drejta për jetën	42

2.4.1. Vrasjet në Kosovë si dukuri shqetësuese	42
2.4.2. Zvarritja e procedurave hetimore	42
2.5. E drejta e lirisë dhe sigurisë	44
2.6. Ndalimi i torturës	45
2.6.1. Monitorimi dhe vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria	46
2.6.2. Ankesat e personave të privuar nga liria	46
2.6.3. Lirimi me kusht	47
2.6.4. Kujdesi shëndetësor	48
2.6.5. Mbipopullimi	49
2.6.6. Bashkëpunimi i IAP-së me institucionet përgjegjëse	50
2.6.7. Grupi Punues për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës	51
2.7. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	52
2.7.1. Efektet e shkaktuara nga zvarritjet procedurale	53
2.7.2. Sfidat dhe rekomandimet	54
2.8. Të drejtat e të akuzuarit	54
2.9. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	57
2.10. E drejta për mjete juridike	57
2.11. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në raste penale	58
2.12. Liria e lëvizjes	59
2.12.1. Jetësimi i marrëveshjes mbi lirinë e lëvizjes	61
2.12.2. Transporti humanitar	62
2.12.3. Liria e lëvizjes në veri të Mitrovicës	63
2.13. E drejta e privatësisë	65
2.13.1. E drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit	65
2.13.2. Jeta private dhe korrespondenca	66
2.14. E drejta e martesës dhe e familjes	66
2.14.1. Kontakti i prindërve të ndarë me fëmijët	67
2.15. Liria e fesë, besimit dhe ndërgjegjes	69
2.15.1. Bashkësia Islame e Kosovës	69
2.15.2. Kisha Ortodokse në Kosovë	70
2.15.3. Bashkësitë e tjera fetare në Kosovë	71
2.16. Liria e shprehjes	71
2.17. E drejta e qasjes në dokumente publike	72
2.18. Liria e medias	76
2.19. Liria e tubimit	77
2.20. Liria e asociimit	79
2.21. Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	80

2.21.1. Vëzhgimi i zgjedhjeve komunale në Kosovë.....	81
2.21.2. Rastet konkrete të shkeljeve të regjistruara	83
2.21.3. Monitorimi i rivotimit në veriun e Mitrovicës më 17 nëntor 2013	86
2.22. E drejta e pronës	88
2.23. E drejta për arsimin.....	90
2.23.1. Edukimi parashkollor.....	90
2.23.2. Arsimi parauniversitar.....	91
2.23.3. Nxënësit me nevoja të veçanta	92
2.23.4. Zvogëlimi i numrit të nxënësve	92
2.23.5. Parandalimi i dhunës në institucionet shkollore	92
2.23.6. Arsimi i lartë: sfidat dhe problemet	93
2.23.7. Sistemi arsimor për komunitetet	93
2.23.8. Bashkëpunimi i IAP-së me institucionet arsimore	94
2.23.9. Ankesat e pranuar në IAP	94
2.24. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	95
2.24.1. Puna e ndaluar e fëmijëve.....	97
2.24.2. Rastet e shkeljeve të së drejtës së punës	97
2.24.3. Mbrojtja dhe siguria në punë.....	97
2.25. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë	98
2.25.1. E drejta e fëmijëve për shkollim.....	99
2.25.2. Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla	100
2.25.3. Drejtësia për të mitur.....	101
2.25.4. Trafikimi me qenie njerëzore, fëmijët viktime.....	102
2.26. Përgjegjësia për mjedisin jetësor	103
2.26.1. Ndotja e ajrit.....	104
2.26.2. Ndotja e ujit.....	105
2.26.3. Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve	105
2.26.4. Ndërtimet e pa kriter dhe cenimi i të drejtës mjedisore.....	106
2.26.5. Infrastruktura rrugore - trotuaret.....	107
2.26.6. Zhurma.....	108
2.26.7. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë	108
2.27. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale.....	109
2.27.1. Çështja e pensioneve në Kosovë	110
2.27.2. Çështja e strehimit	110
2.27.3. Shërbimet shëndetësore	111
2.27.4. Personat me aftësi të kufizuara.....	112
2.27.5. Kategorizimi i aftësisë së kufizuar	112

2.28. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	114
2.28.1. Ankesat e qytetarëve ndaj gjykatave të rregullta.....	114
2.28.2. Mungesa e veprimt të pushtetit gjyqësor në veri të vendit.....	115
2.28.3. Misioni Evropian për sundim të ligjit në Kosovë - EULEX.....	116
2.28.4. Reformimi i gjyqësorit sipas Ligjit mbi Gjykatat.....	117
2.29. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës	117
2.29.1. Mendimi juridik për lëndët e shpronësimit dhe bartja e kompetencave	117
2.29.2. Ligji për Noterinë në shërbim të qytetarëve	118
2.29.3. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS).....	118
2.29.4. Rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe zvarritjet në gjyqësor	119
2.29.5. Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë.....	120
2.29.6. Konstatimet e Avokatit të Popullit për mbrojtjen gjyqësore të drejtave.....	120
2.30. Raporti i Avokatit të Popullit me Gjykatën Kushtetuese	122
2.31. Përdorimi i gjuhëve	125
2.31.1. Zyra e Komisionarit për gjuhët.....	126
2.31.2. Aktiviteti i IAP-së për mbrojtjen e të drejtës së përdorimit të gjuhës.....	127
2.32. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre	128
2.32.1. Kthimi i personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Kosovë.....	129
2.32.2. Arsimimi i pjesëtarëve të bashkësive pakica.....	130
2.32.3. Këshilli konsultativ dhe Zyra për çështje të bashkësive.....	133
2.32.4. Gjendja e bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase.....	134
2.32.5. Ripranimi dhe riatdhesimi	134
2.32.6. Mediat	136
2.32.7. Përfaqësimi në pushtetin qendror dhe lokal dhe punësimi.....	136
KAPITULLI III.....	139
BASHKËPUNIMI DHE AKTIVITETET E IAP-së.....	139
3.1. Bashkëpunimi me institucionet vendore.....	139
3.2. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile.....	140
3.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar	141
3.3.1. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare	142
3.3.2. Projektet me mbështetje ndërkombëtare	143
3.3.3. Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare.....	144
3.3.4. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare	145
3.3.5. Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar.....	146
3.4. Ngritja e kapaciteteve të IAP-së	147
3.5. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve	148
3.6. Aktivitetet e Departamentit kundër Diskriminimit.....	151

3.7. Komentet dhe rekomandimet në projektligje dhe akte nënligjore.....	152
3.8. Komunikimi me mediat	153
KAPITULLI IV	157
BUXHETI DHE PERSONELI I IAP-së	157
4.1. Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës	157
4.2. Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2013.....	158
4.3. Financimi i IAP-së nga donatorët.....	158
4.4. Personeli i IAP-së për vitin 2013.....	159
KAPITULLI V	160
PËRMBLEDHJA STATISTIKORE	160
5.1. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2013	160
5.2. Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2013 - 31 dhjetor 2013	169
SHKURTESAT	173

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare	146
Tabela 2: Lista e paraqitjeve mediale sipas medimeve	155
Tabela 3: Kërkesa buxhetore, buxheti i aprovuar dhe buxheti final IAP-së	155
Tabela 4: Buxheti i shpenzuar	158
Tabela 5: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP	160
Tabela 6: Ankesat e shpallura të papranueshme	161
Tabela 7: Rastet e hapura për hetim IAP	161
Tabela 8: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë	162
Tabela 9: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP	163
Tabela 10: Autoritetet përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara nga IAP	164
Tabela 11: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së	166
Tabela 12: Vonesat e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së	167
Tabela 13: Raportet dhe rekomandimet e nxjerra nga IAP	168
Tabela 14: Zbatimi i rekomandimeve nga raportet për rastet e hetuara nga IAP	168

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP	169
Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve sipas ankesave të paraqitura në IAP	169
Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP	170
Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP	170
Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim	171
Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP	171
Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë	172
Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP	172

PARATHËNIE

Raporti për vitin 2013 pasqyron punën njëvjeçare të IAP për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2013 dhe ka një renditje të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit: mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Drejtësia ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë individët pa asnjë dallim, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës - përbën bazën e shtetit ligjor.

Ky raport është i ndarë në 5 kapituj të ndryshëm të radhitur në kuptimin funksional dhe përmbajtjesor. Kapitulli i parë paraqet një prezantim të kompetencave, përgjegjësi dhe mandatit të IAP. Në kapitullin e dytë, në mënyrë shteruese dhe të hollësishme është pasqyruar gjendja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës, të radhitura sipas radhitjes në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Bashkëpunimi dhe veprimtaria e IAP gjatë periudhës raportuese është pasqyruar në kapitullin e tretë, ndërsa në kapitullin e katërt është paraqitur gjendja momentale dhe zhvillimet përgjatë vitit raportues të buxhetit dhe të personelit në IAP. Një përmbledhje statistikore e të gjitha rasteve dhe të gjeturave të IAP për këtë periudhë raportimi është dhënë në kapitullin e pestë.

IAP ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe personave të tjerë në nevojë. IAP, ka bërë përpjekje për ofrimin e të gjitha mundësive për paraqitjen e ankesave me të gjitha format e komunikimit në çdo kohë dhe rrethanë: drejtpërdrejt në zyrat e Avokatit të Popullit për çdo ditë pune apo edhe në Ditët e Hapura, në seli apo zyra regjionale të IAP si dhe jashtë tyre, në të gjitha komunat e Kosovës, përmes postës fizike dhe elektronike, përmes familjarëve apo avokatit mbrojtës, me telefon apo edhe forma të tjera.

Megjithëse kjo hapje përcillet me një ngarkesë dukshëm më të madhe për Institucionin, Avokati i Popullit dëgjon hallet e të gjithëve që kanë nevojë dhe paraqiten në institucion, pa asnjë dallim. Çdokush pritët, dëgjohej me kujdes dhe ndihmohet aty ku është e mundur, apo këshillohet aty ku është e nevojshme. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve dhe të gjithë personave, Avokati i Popullit, çdo kërkesë të drejtuar atij, i përgjigjet me shkrim.

Nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2013, në IAP janë paraqitur 2047 raste, ose 23 % më shumë se në vitin 2012, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë. Prej tyre në 377 raste këta persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit, gjatë "Ditëve të hapura" të mbajtura në periudhën raportuese.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka rritur efikasitetin në punën e tij, duke trajtuar të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët për shkeljet e të drejtave të tyre, në kohën më të shkurtë të mundshme. Angazhimi i vazhdueshëm ka rritur besimin në Avokatin e Popullit si një mbështetës dhe mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit. Në saje të punës së vazhdueshme të Avokatit të Popullit, për herë të parë shumica e ankesave të trajtuara janë zgjidhur pozitivisht, që do të thotë në favor të qytetarit, që është edhe njëri prej synimeve kryesore të këtij institucioni.

Shkeljet të cilat janë raportuar, gjatë vitit 2013 tek Avokati i Popullit, kanë të bëjnë edhe me realizimin, përkatësisht mosrealizimin e të drejtave të veçanta, të cilat do t'i paraqes në vijim.

E drejta për jetën. Nga ankesat e trajtuara në Institucionin e Avokatit të Popullit, për vitin 2013, vërehen një varg mangësish në trajtimin e rasteve të vdekjeve nga organet kompetente. Mungesa e hetimeve për rastet e paraqitura, zvarritjet e pajustificueshme të organeve të ndjekjes dhe të drejtësisë, mosprocedimi i rasteve penale dhe mbyllja e tyre e pajustificueshme, përbën një shqetësim të arsyeshëm për qytetarët. Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar Policinë e Kosovës të jetë më efektive për zbulimin e kryerësve të veprave penale, në veçanti vrasjeve, ndërkaq prokurorinë të zhvillojë dhe kryejë me kohë hetimet, me qëllim të procedimit të lëndëve në gjykata brenda afatit ligjor.

Barazia para ligjit. E drejta për të qenë i lirë nga çdo lloj diskriminimi përbën një nga parimet themelore të drejtave të njeriut dhe është parim i garantuar me Kushtetutë dhe me të gjitha instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Ne i gëzohemi faktit se ka një lëvizje të mirë, sado të kufizuar, në këtë fushë dhe inkurajojmë të gjitha institucionet për të shtuar përpjekjet në këtë drejtim. Megjithatë duhet theksuar se ende ka institucione që dallohen me veprimet e tyre diskriminuese, sidomos Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Agjencia Kosovare e Pronës. Po ashtu ka grupe të caktuara shoqërore vazhdojnë të diskriminohen në mënyrë institucionale dhe strukturore si: personat me aftësi të kufizuara, personat nga komuniteti LGBTI, ashkali, egjiptas, rom, femrat etj.

Avokati i Popullit e thekson si veprim pozitiv propozimin dhe veprimet e ndërmarra për ndryshimin e Ligjit kundër diskriminimit dhe ligjit për barazi gjinore, me qëllim që këto ligje të bëhen të zbatueshme në praktikë.

Hapa të rëndësishëm në aspektin normativ për barazinë gjinore janë bërë. Mirëpo, zbatimi në praktikë ende çalon. Andaj, Avokati i Popullit ka bërë rekomandime që kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin bashkëkohor ndërkombëtar; zbatimin e kuotës për pjesëmarrjen e femrës në vendimmarrje në nivelin qendror dhe atë lokal në institucionet publike dhe zbatimin e programit të trajnimit të atyre që merren me barazinë gjinore etj.

Avokati i Popullit konsideron se në fushën e ndalimit të torturës ka përparime të dukshme në Republikën e Kosovës. Por, përmirësime të mëtutjeshme janë të domosdoshme.

Autoritetet publike në Republikën e Kosovës, në përgjithësi, kanë respektuar lirinë e lëvizjes. Policia e Kosovës, siç ka bërë edhe viteve të fundit, vazhdon ta vlerësojë situatën e sigurisë si stabile, por të brishtë. Pjesëtarët e komunitetit serb vazhdojnë të qëndrojnë pjesërisht brenda vendbanimeve ose udhëtojnë në ato pjesë ku grupet e tyre përbëjnë shumicën.

Bllokadat në rrugë të cilat gjatë vitit i kanë vendosur individët dhe grupet e personave të komunitetit serb në pjesën veriore të Kosovës, kanë kufizuar lëvizjen e lirë dhe në disa raste kanë ndërprerë qasjen në një varg të drejtash kryesisht për banorët shqiptarë.

Me gjithë angazhimin e përbashkët të BE, KFOR-it dhe Qeverisë së Kosovës, situata e sigurisë në veri ka qenë e paparashikueshme. Policia e Kosovës ka raportuar për incidente të cilat kanë përfshirë eksplozime, djegie të veturave dhe gjuajtje me armë të zjarra. Lidhur me

këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar institucionet kompetente dhe përgjegjëse, që të ndërmarrin të gjitha veprimet, sipas obligimeve ligjore për garantimin e jetës, pronës, shëndetit dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në pjesën veriore të Mitrovicës. Po kështu Avokati i Popullit ka rekomanduar që të ndërmerren të gjitha veprimet e parapara me ligj për luftimin e kriminalitetit dhe grupeve të organizuara kriminale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa hezitime dhe ngurrime të natyrës politike.

Lidhur me të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, bazuar në vëzhgimet e bëra në terren dhe ankesat e pranuar Avokati i Popullit ka dhënë një varg rekomandimesh konkrete dhe të përgjithshme, duke konsideruar se me gjithë përparimet e bëra, nuk mund të thuhet se duhet të jemi të kënaqur me nivelin e respektimit të Kushtetutës dhe të ligjit. Reforma zgjedhore në Kosovë, e filluar vite më parë, nuk ka përfunduar.

Një shqetësim të madh, jo vetëm për Avokatin e Popullit paraqet dhuna në institucionet shkollore, gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe puna e dëmshme që bëjnë fëmijët, Madje, fëmijë të një shkolle në kryeqytet theksuan se në shkollën e tyre përdoren substanca narkotike.

Dhuna mbetet dukuri shqetësuese në shkollat publike të Kosovës. Gjatë këtij viti nga informatat e siguruar nga nxënës të shkollave të mesme të ulëta, shihet qartë se shumë nga fëmijët janë të pakënaqur me situatën në shkollat e tyre.

Shumë fëmijë mendojnë se shkollat nuk janë më vende të sigurta, sepse nxënësit bartin me vete armë të ndryshme dhe se dhuna është e pranishme si brenda ashtu edhe jashtë hapësirës shkollore.

Lidhur me të drejtën e arsimit, Avokati i Popullit ka paraqitur rekomandime veçanërisht për parandalimin e dhunë në institucionet shkollore. Po kështu avokati i popullit ka dhënë rekomandime edhe për rishikimin e kualitetit mësimor, për largimin e lokaleve të lojërave të fatit nga afërsia e institucioneve shkollore, si dhe rritjen fondit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe përfshirjen e të gjithëve në arsim.

Edhe më tutje në Kosovë, vazhdon të mbetet si çështje sociale më serioze shkalla e lartë e papunësisë me të cilën janë duke u përballur qytetarët e Kosovës. Shkelja e së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, me gjithë angazhimin e mekanizmave ligjorë, vazhdon të jetë shqetësuese.

Avokati i Popullit, konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, vërehen fëmijë të moshës jo madhore, duke bërë punë të ndryshme që dëmtojnë shëndetin dhe dinjitetin e tyre. Ata i gjejmë duke kërkuar lëmshë, duke shitur cigare, duke punuar me karrocë dore apo edhe punë të rënda në ndërtimtari

Edhe pse fëmijët gëzojnë mbrojtje ligjore me legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar të zbatueshëm në Republikën e Kosovës, ashtu edhe me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, kjo dukuri vazhdon pa ndonjë ndryshim. Realizimi praktik i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i tyre, mbeten sfidë e rëndë. Nga Institucionet e Republikës së Kosovës, veçanërisht Fatkeqësisht MPB, MASHT-i, MPMS-ja dhe sidomos Inspektorati i Punës,

kërkohet më shumë përgjegjësi për zbatimin e Ligjit të Punës, si dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e dukurive të punës së fëmijëve.

Institucionet përgjegjëse duhet të shtojnë përpjekjet dhe veprimet për respektimin, mbrojtjen dhe zbatimin përkatës të të drejtave të fëmijëve përfshirë këtu edhe ndarjen e buxhetit të mjaftueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Të drejtat e fëmijëve duhet vënë në ballë të agjendës të punës së qeverisë. Fëmijët duhet t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre. Avokati i Popullit, konsideron se psikologët dhe pedagogët duhet të jenë pjesë e personelit shkollor; duhet të shtohet komunikimi në mes të mësimeve dhe prindërve me qëllim të adresimit më të mirë të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve; të zbatohen dispozitat e Kodit të drejtësisë për të mitur, që kanë të bëjnë me paraburgimin e të miturve; të krijohet një bazë e të dhënave në nivel kombëtar, me qëllim të integritetit të të dhënave të gjitha institucioneve përkatëse që punojnë në fushën e delikuençës së të miturve.

Edhe pse mbrojtja e mjedisit renditet në një ndër vlerat në të cilën bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, mbrojtja dhe sigurimi i një mjedisi cilësor dhe të sigurt për shëndetin e qytetarëve, në vendin tonë ende mbetet larg përcaktimeve ligjore dhe gjendjes objektive. Me gjithë përpjekjet dhe hapat pozitiv të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Republika e Kosovës ende ballafaqohet me ndotjen e tokës, ujit, ajrit, me zhurmën, shkatërrimin e biodiversitetit, ndërtimet e egra, shkatërrimin e rrjedhave të ujit, shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, keqmenaxhimi e mbeturinave etj. Qoftë për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjes në këtë fushë, qoftë për shkak të vetëdijesimit të një numri të madh të qytetarëve për gjendjen e patolerueshme, kemi një reagim gjithnjë e më të shpeshtë të qytetarëve, të ndërgjegjësuar dhe kurajoz.

Kosova vazhdon të ballafaqohet me gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe me varfëri të madhe të qytetarëve. Fatkeqësisht, numri i ankesave të parashtruara në IAP nuk lë hapësirë të mjaftueshme për të konstatuar se ka përmirësime të dukshme mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në Kosovë.

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2013 është përshkuar nga një varg i reformave ligjore dhe riorganizim strukturor, bazuar në ligjet e reja për gjyqësorin. Këto reforma, në disa aspekte kanë sjellë kualitete të reja, sa i përket respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut nga gjyqësori. Por, në disa fusha kanë pasur efektin e kundërt dhe reagimin e qytetarëve. Sidoqoftë, përkundër disa përparimeve në këtë fushë, rezultatet ende janë të pamjaftueshme në mënyrë që të mund të flitet për mbrojtjen e mirëfilltë dhe të plotë gjyqësore të të drejtave.

Edhe në këtë vit raportues, numër i madh i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP, i përkasin gjyqësorit si palë përgjegjëse. Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve.

Me gjithë përpjekjet e sinqerta të shumë gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve të sistemit gjyqësor, përkundër kryerjes së lëndëve të shumta gjyqësore, me gjithë numrin e pamjaftueshëm të bashkëpunëtorëve, me mungesën e kushteve materiale e teknike për punë efikase, Avokati i Popullit nuk gjen arsyetim për zvarritjen e procedurave gjyqësore me vite të

tëra. Pikërisht për shkak të këtyre mangësive, problemeve dhe lëshimeve, tek qytetarët është krijuar perceptimi i dyshimit të përgjithshëm në punën e gjyqësorit. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, dhe në shtetin e së drejtës.

Madje, për shkak të mos funksionimit të sistemit gjyqësor në veri të vendit, qytetarëve që kanë pasur lëndë gjyqësore në Gjykatat në veri të Mitrovicës, u është mohuar e drejta për drejtësi, garantuar me Kushtetutë.

Fatkeqësisht, qytetarët e Kosovës nuk kanë një mekanizëm ligjor për mbrojtjen e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm kohor, kur kjo e drejtë e tyre cenohet nga gjyqësori vendor, ashtu siç është e zakonshme në vendet demokratike me një shtet ligjor të mirëfilltë. Kohëzgjatja e procedurave civile dhe procedurave të tjera pranë gjyqësorit me vite të tëra, rezulton me qasje të vështirësuar në mbrojtje gjyqësore të të drejtave të njeriut nga gjykatat.

Parashkrimi i numrit të madh të lëndëve gjyqësore, që këtë vit ka shënuar rritje të dukshme, paraqet një nga shkeljet më të rënda të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë. Qytetarët nuk kanë në duar asnjë mjet të përshtatshëm ligjor për mbrojtje nga kjo shkelje dhe padrejtësi. Kjo nuk guxon dhe nuk duhet të ndodhë në një shtet ligjor!

Institucioni i Avokatit të Popullit, vazhdimisht ka raportuar për raste të shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në raportet e mëhershme vjetore, Avokati Popullit vazhdimisht ka shprehur shqetësimet tij lidhur cenimit të kësaj të drejte sipas kuptimit të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ: mosrespektim i afateve ligjore për zgjidhjen e rasteve, moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion. Një numër i ankesave ka të bëjë edhe me vendimet e padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet të vënë drejtësinë në vend, qoftë nga administrata shtetërore apo gjyqësore. Me gjithë ndërmarrjen e veprimeve për luftimin e kësaj dukurie nga vetë gjyqësori, bazuar në të dhënat e IAP-së, në përgjithësi, në këtë drejtim, nuk vërehet ndonjë përmirësim i dukshëm.

Një fushë e ankesave që përcillet me pasoja serioze për marrëdhëniet ndërnjerëzore, ku vërehet edhe dështimi më serioz i sistemit të drejtësisë, qoftë për shkak të zvarritjeve të mëdha, qoftë për shkak të moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, apo qoftë edhe të falsifikimeve të dëshmuara, është cenimi i të drejtës së pronës. Në këto raste, kur drejtësia shtetërore i mbështet njerëzit për murin e padrejtësisë, ata marrin drejtësinë në duart e tyre.

Avokati i Popullit ka bërë rekomandimet lidhur me gjendjen në gjyqësor, duke konsideruar se duhet të ndërmerren masat dhe veprimet ligjore urgjente për zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara. Kjo mund të arrihet vetëm përmes miratimit të një programi të reduktimit të lëndëve të pazgjidhura, rritjes së numrit të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë ligjorë, si dhe personelit tjetër administrativ, për të rritur efikasitetin e punës së gjyqtarëve.

Avokati i Popullit ka pranuar ankesa edhe kundër avokatëve mbrojtës. Angazhimi i tyre, qoftë privat apo sipas detyrës zyrtare, është në shumë raste i mangët dhe kundër etikës së avokatisë. Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon që Oda e Avokatëve të Kosovës, të sigurojë kualitet dhe efikasitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) dhe të rregullojë qartë dhe pa mëdyshje sigurimin e respektimit të të drejtave të

akuzuarve, e në raste të dëmtimit lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit, hetimin dhe marrjen e masave disiplinore.

Sa i përket gjyqësorit dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, angazhimi i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti ka konsistuar në tre drejtime: a) identifikimi i shkeljeve dhe i problemeve lidhur me zbatimin e kësaj të drejte; b) parandalimi i shkaqeve që ndikojnë në cenimin e kësaj të drejte dhe c) bashkëpunimi me organet gjyqësore dhe institucionet e tjera përgjegjëse shtetërore kompetente për trajtimin e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese.

Sa u përket të drejtave të komuniteteve, ka përparime pozitive, por mbetet ende shumë për t'u bërë. Sidomos ende shqetësuese mbetet gjendja e komuniteteve ashkali, egjiptas dhe rom. Një shqetësim të veçantë paraqet situata ekonomike dhe papunësia e madhe në mesin e komuniteteve pakicë, me theks të veçantë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas.

Situata e lirisë së lëvizjes është gjithnjë më e mirë, përveç në pjesën veriore të Kosovës. Liria e lëvizjes në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, si dhe në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan vazhdon të mbetet gati tërësisht e kufizuar për qytetarët, sidomos për personat e përkatësisë etnike jo-serbe, për autoritetet publike të Republikës së Kosovës si dhe për institucionet ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për sigurinë fizike.

Në pjesët tjera të Kosovës nuk ka pasur kufizime të lirisë së lëvizjes, por ka pasur incidente të izoluara dhe dëmtim të pronës në komunën e Istogut, dëmtime të mbishkrimeve të varrezave ortodokse serbe në Kllokot dhe në Fushë Kosovë dhe kërcënime individuale. Vlen të theksohet se në të gjitha rastet e incidenteve me karakter të konfliktit etnik, policia e Kosovës ka reaguar me shpejtësi.

Një gjendje shumë e rëndë sa i përket lirisë së lëvizjes vërehet në trafikun rrugor. Vërehet një papërgjegjësi dhe kaos i patolerueshëm në ngasjen e automjeteve si në qendrat urbane ashtu edhe në rrugë të hapura. Në qendrat urbane, për shkak të zënies së trotuareve nga parkimi i pandërgjegjshëm i automjeteve, po ashtu mungesës ose papërshtatshmërisë së shenjave të komunikacionit, shpeshherë kufizohet liria e lëvizjes së këmbësorëve, sidomos e fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Gjendja e sigurisë ka shënuar përmirësime, por një shqetësim për Avokatin e Popullit mbetet numri në rritje i rasteve të vrasjeve me armë si dhe numri i madh i armëve ilegale në duar të individëve.

Avokati i Popullit, po kështu ka bërë një varg rekomandimesh për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut lidhur me privatësinë; lirinë e besimit dhe të fesë; qasjen në dokumente publike, dinjitetin; përdorimi i gjuhëve; pensionet, strehimin e rasteve sociale, shërbimet shëndetësore, personat me aftësi të kufizuara etj.

Avokati i Popullit, bazuar në përgjegjësitë ligjore, ka bërë rekomandime, propozime dhe sugjerime në një varg ligjesh dhe aktesh normative për harmonizimin e tyre me kushtetutën dhe me instrumentet ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe IAP ka zhvilluar një numër jashtëzakonisht të madh të takimeve, trajnimeve, veprimeve të përbashkëta me shoqërinë civile dhe partnerët e ndryshëm ndërkombëtarë. IAP është anëtarësuar në organizatat kryesore ndërkombëtare dhe

ombudsmanëve. Një bashkëpunim shumë të mirë ka sidomos me homologët evropianë dhe regionalë.

Mungesa e ndërgjegjësimit institucional për zbatimin e ligjit po shoqërohet me një tronditje që po prekë të gjitha porët e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës. Si pasojë e humbjes gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë, vërehet edhe një përkeqësim në rritje të raporteve ndërnjerëzore.

Avokati i Popullit, vazhdimisht ka dhënë dhe jep rekomandime për përmirësimin e lëshimeve dhe mangësive të vërejtura. Mirëpo, megjithëse këtë vit janë vërejtur përparime theksuara në këtë drejtim, fatkeqësisht edhe më tutje është evidente mungesa zbatimit dhe rrjedhimisht e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore.

Avokati i Popullit, me të gjeturat e shkeljeve të ndryshme dhe rekomandimet për mënjanimin e tyre, me përpjekjet për komunikimin e pandërprerë me institucionet përkatëse dhe ndërmjetësimet midis tyre dhe qytetarëve, në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Ai do të vazhdojë ta bëjë këtë për të krijuar një klimë më të mirë për drejtat dhe liritë e njeriut.

Gjendja e rëndë ekonomike në vend, prek shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejtë në kualitetin e tyre jetësor. Shqetësuese në këtë drejtim është mungesa e perspektivës për të rinjtë, si dhe gjendja e pensionistëve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit sërish kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor, si dhe Ligjit për sigurimin invalidor e pensional. Po ashtu, ripërsërit kërkesën për përfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si një ndër instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet edhe izolimi strukturor nga jeta publike dhe si pasojë vetizolimi shoqëror i komuniteteve ashkali, egjiptas dhe rom.

Përpjekjet e deritanishme të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, kanë shënuar disa përmirësime modeste në fushën e banimit dhe të arsimit, por mbetet shumë për t'u bërë në integrimin shoqëror, strukturor dhe institucional.

Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjitha rastet e veçanta kur ka konstatuar shkelje të të drejtave, në raportet e tij vjetore dhe të veçanta, ka bërë rekomandime për të gjitha autoritetet publike – ministritë, komunat si dhe agjencitë e tjera publike përgjegjëse.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit për herë të parë ka marrë informata apo njoftime disa institucione, për zbatimin e rekomandimeve të tij sistemore. Dua që shprehimisht të theksoj faktin se në këtë drejtim vërehet një lëvizje pozitive, edhe pse kjo nuk është e mjaftueshme.

Meqenëse zbatimi i ligjit është premisa kryesore për funksionim e shtetit ligjor, në Republikën e Kosovës, përveç disa përpjekjeve modeste, moszbatimi i ligjit është plaga më e rëndë institucionale.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të evidentojë dhe të nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, për të forcuar rolin e tyre që kanë në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin drejtësisë, barazisë.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të jetë ndriçues i rasteve kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, dhe kritik ndaj institucioneve kur ato shprehen mospërfillëse ndaj detyrimeve të tyre ligjore.

Avokati i Popullit, kërkon rritje të përkushtimit dhe përgjegjësisë institucionale dhe ligjore të autoriteteve publike për veprimet apo mosveprimet e tyre. Kërkon edhe rritje të përkushtimit dhe përgjegjësisë individuale e shoqërore.

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qeverisja e mirë janë obligim i autoriteteve publike.

Prandaj, Avokati i Popullit fton të gjithë personat përgjegjës në institucionet publike që të mos injorojnë ankesat e qytetarëve. Po ashtu, fton autoritetet publike që t'i marrin ato seriozisht dhe t'i trajtojnë si kontribut konstruktiv rekomandimet e Avokatit të Popullit, sepse paraqesin një mundësi të mirë për të mësuar nga gabimet dhe lëshimet dhe rrjedhimisht për përmirësimin e administratës shtetërore në përgjithësi.

Meqenëse këtë vit përfundon mandati kushtetues i Avokatit të Popullit, ky është Raporti Vjetor i fundit, të cilin unë e paraqes në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për të gjithë bashkëpunimin, mospajtimet dhe ballafaqimet kritike dhe konstruktive, unë falënderoj të gjithë personat dhe institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile.

KAPITULLI I

HYRJE

1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese.¹ Avokati i Popullit mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike,² por edhe të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.³ Sipas Kushtetutës Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës.⁴

Që nga fillimi i punës, IAP rëndësi të veçantë i ka kushtuar dhe i kushton përbërjes shumetnike dhe strukturës gjinore të punonjësve.

1.2. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit kanë përcaktuar mandatin e Avokatit të Popullit për të marrë dhe për të hetuar ankesa nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Të gjitha organet, institucionet dhe autoritetet tjera që ushtrojnë pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, janë të detyruara t'iu përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në punën e vet IAP udhëhiqet nga parimet e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese⁵ dhe ligjore,⁶ Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe aktet tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventa ndërkombëtare, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkelje të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 132-135. Të gjitha dokumentet zyrtare në këtë raport Kushtetuta, Marrëveshjet ndërkombëtare, kodet, ligjet, udhëzimet administrative, vendimet, mendimet dhe rregulloret janë cituar sipas teksteve zyrtare të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në: <http://gzk.rks-gov.net/>

² Po aty, neni 132.

³ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 1.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 133, paragrafi 2.

⁵ Po aty, neni 132.

⁶ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 15.

ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit.

Avokati i Popullit nuk ndërhyt në rastet që zhvillohen në gjykata, përveç kur ka zvarritje të paarsyeshme apo keqpërdorim të dukshëm të pushtetit. Ai po ashtu nuk merret me hetimin e çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privatë.

Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.⁷

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, por edhe të angazhohet për zgjidhjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përpilojë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.⁸

Krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, që kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike karshi qytetarëve dhe forcim e zhvillim të sundimit të ligjit, janë objektivat kryesorë të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit angazhohet për rritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe në institucionet dhe organet tjera të pushtetit.

Ankesat kundër administratës publike, qytetarët mund t'i parashirojnë sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me dhënien e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Avokati i Popullit po ashtu është edhe një mbrojtës i autoriteteve publike nga kritikrat e pabazuara dhe të papërligjura, nga dezinformimi dhe veprimet e paligjshme, të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë ligjërisht që organi administrativ kompetent të

⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 113, paragrafi 2 dhe 135, paragrafi 4; Ligji për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, neni 15, paragrafi 7; Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nr. 03/L-121, neni 29.

⁸ Ligji për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, neni 16.

ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Në qoftë se letrat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen, Kuvendit të Kosovës dhe organizatave të tjera relevante.

Për të mbuluar fusha të caktuara që përfshijnë çështje të veçanta të disa grupeve të njerëzve, të drejtat e të cilëve konsiderohen më të cenueshme në Kosovë, në IAP tash sa vjet funksionojnë: Njësia për të Drejtat e Fëmijëve, Njësia për Barazi Gjinore dhe Grupi për Mosdiskriminim.

Ndërsa, pas zgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit, në kuadër të departamenteve, të cilat udhëhiqen nga zëvendësit, janë krijuar njësi të tjera të veçanta, sipas fushave të caktuara.

Në kuadër të *Departamentit kundër diskriminimit* funksionojnë njësitë: për të drejtat e fëmijëve; për barazi gjinore; kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër dhunës; për personat me aftësi të kufizuara; për të drejtat e komuniteteve; për çështjet sociale dhe për të drejtat e personave LGBT.

Departamenti i Legjislativit përbëhet nga: Njësia për koordinim e punës, lidhur me Kuvendin e Republikës së Kosovës; Njësia për koordinimin e ngritjes së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës; Njësia për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore, Njësia për hetimin e ankesave për qasjen në dokumente publike dhe Njësia për raportimin vjetor e periodik.

Departamenti i Ekzekutivit përfshinë njësitë: për hetimin e ankesave kundër presidencës dhe kundër qeverisë; për hetimin e ankesave kundër agjencive të pavarura; për hetimin e ankesave kundër ndërmarrjeve publike; për mbrojtjen e mjedisit dhe Mekanizmi Nacional për Parandalimin e Torturës, si dhe njësia për mbrojtje të konsumatorit, biznesit dhe të drejtat e njeriut.

Njësitë në *Departamentin e Gjyqësorit* janë: Njësia për hetimin e ankesave kundër gjyqësorit; për hetimin e ankesave kundër prokurorisë; për hetimin e ankesave kundër Këshillit Gjyqësor; për hetimin e ankesave kundër Këshillit Prokurorial dhe për hetimin e ankesave kundër Institutit Gjyqësor.

Ndërsa, në *Departamentin për Marrëdhënie me Publikun* veprojnë këto njësi: bashkëpunimi me shoqërinë civile, bashkëpunimi me organizatat e huaja në Kosovë, bashkëpunimi me donatorë, materialet dhe publikimet, si dhe konferencat dhe trajnimet.

1.3. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP çdo ditë pune merr ankesa nga qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm.

Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP ka edhe zyrat rajonale në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Graçanicë, kurse nga 1 tetori i vitit 2013 janë themeluar zyra rajonale edhe në Ferizaj dhe Gjakovë. Po ashtu, në kuadër të Zyrës Rajonale të IAP-së në Mitrovicë funksionon edhe nën-zyra e saj në veri të qytetit. Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional për t'i shërbyer qytetarëve, për t'u përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre, si dhe për t'i mbrojtur të drejtat, për të cilat ata pretendojnë se u janë shkelur.

Ankesat e qytetarëve në zyrat e IAP-së pranohen çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:30 - 16.00. Por, për raste urgjente, qytetarët mund të paraqiten edhe jashtë orarit të punës.

Formë tjetër e qasjes më të afërt ndaj qytetarëve është edhe organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë (dy herë në muaj) dhe në komunat e tjera të Kosovës (nga një herë në muaj). Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për ditët e hapura me anë të publikimit të datave nëpër këto komuna, nëpërmjet mediave lokale dhe nëpërmjet faqes zyrtare të IAP-së në internet.

Format e tjera të qasjes janë edhe me postë, telefaks dhe telefon. Ndërsa, një qasje tjetër e lehtë në IAP, që gjithnjë e më shumë po përdoret nga një numër gjithnjë në rritje i personave, është edhe me postë elektronike, e cila të shumtën e rasteve përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Në Zyrën Qendrore të IAP-së ekziston edhe linja telefonike falas për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet e ndalimit të personave në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e IAP.

KAPITULLI II

TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Republika e Kosovës i ka përfshirë në Kushtetutë shumicën e instrumenteve ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë e që, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike të Kosovës.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës shprehimisht garantohej zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare si: *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokolleve të saj; Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës, si dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*⁹

Këto instrumente ndërkombëtare kanë rëndësi të posaçme në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për shkak se ato zbatohen drejtpërdrejt edhe në raste kur ka mangësi apo zbrazëti të shprehura në legjislacionin e brendshëm të Kosovës.

IAP ka vërejtur shkelje serioze të këtyre instrumenteve në disa raste të caktuara. Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2013 dëshmojnë se ato kryesisht kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt gjyqësor.¹⁰ Mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjidhura dhe vonesa në trajtimin e lëndëve të reja si dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë, për vite të tëra po e rëndojnë punën e gjyqësorit në Kosovë, me çka qytetarëve të Kosovës po u cenohet e drejta për proces të drejtë, të rregullt dhe të paanshëm.

Nga 1 janari 2013 ka filluar zbatimi i plotë i Ligjit për Gjykatat, në bazë të të cilit është bërë riorganizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ndikuar në njëfarë mase në punën më efikase dhe efektive të gjyqësorit. Megjithatë, numri i lëndëve të pazgjidhura në gjykata ende është shumë i madh. Prandaj, gjyqësori duhet edhe më tej të konsolidohet, ashtu që zgjidhja e lëndëve të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe standardeve ndërkombëtare. Në këtë drejtim, ndikim pozitiv do të kishte rritja e mëtejme të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe shtimi i bashkëpunëtorëve profesional në këto institucione.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

¹⁰ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), neni 6, p. 1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Avokati i Popullit rithekson se zbatimi i dispozitave të Protokollit Opcional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese do të mundësojë realizimin e monitorimit më të plotë, efektiv dhe efikas të institucioneve ku mbahen personat e ndaluar dhe të dënuar. Në këtë drejtim janë ndërmarrë aktivitete nga Grupi Punues, i cili vepron si pararendës i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës,¹¹ krijimi i të cilit parashihet me këtë protokoll.¹²

Përmes këtij raporti, Avokati i Popullit, ripërsërit shqetësimin e tij për mospërfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Kushtetutën e Kosovës. E drejta për strehim adekuat, e drejta në punë dhe ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, e drejta për sigurim shëndetësor dhe një sërë të drejtash tjera sociale dhe ekonomike, janë vetëm disa nga të drejtat që përmban kjo Konventë, e të cilat ende vazhdojnë të mos kenë mbrojtjen e duhur ligjore në Kosovë. Prandaj, përfshirja e kësaj Konvente në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është e domosdoshme edhe si garancë shtesë për qytetarët e Kosovës, përkatësisht për mbrojtjen e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale.

Duke u bazuar në përvojën e punës së vazhdueshme, në ankesat dhe kërkesat individuale por edhe grupe, Avokati i Popullit konstaton se Republika e Kosovës duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, të përfshihet edhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Megjithëse një pjesë e mirë e normave të kësaj konvente janë të përfshira në instrumentet e tjera ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përfshirja e saj është e domosdoshme për shkak se ky është instrumenti më gjithëpërfshirës ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, i dedikuar për këtë kategori personash, që përfshin rreth 10 % të popullsisë së përgjithshme të vendit, e cila synon integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë ka nevojë për një qasje të tillë bashkëkohore.

Rekomandime:

- *Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.*
- *Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.*
- *Të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës të angazhohen për respektimin dhe zbatimin e plotë të instrumenteve ndërkombëtare, ashtu siç kërkohet shprehimisht me Kushtetutën Republikës së Kosovës.*

¹¹ Si rezultat i bashkëpunimit të IAP-së me disa OJQ vendore (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut - KMDLNI dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT), në maj të vitit 2011 është formuar Grupi Punues i përbashkët, me të cilat është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit.

¹² *Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese*, neni 3 “Çdo shtet palë krijon, projektton ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruës.”

2.2. Dinjiteti i njeriut

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 23 të saj parasheh mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, duke e përcaktuar atë si të *“pacenueshëm dhe bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”*.

Dinjiteti paraqet tërësinë e vlerave morale të një individi dhe të drejtën e tij për t’u nderuar, që buron nga vetë ekzistenca e njeriut dhe si i tillë trajtohet si kategori morale, fetare, sociale, politike dhe juridike.

Dinjiteti i njeriut nuk është vetëm një e drejtë themelore në vetvete, por përbën bazë vërtetë të të drejtave themelore. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ka sanksionuar këtë parim në preambulën e saj se *“Dinjiteti i lindur i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë”*.¹³

Për nga fusha e të drejtave të njeriut, dinjiteti i njeriut konsiderohet se përbën themelin e të gjitha të drejtave dhe është parakusht i domosdoshëm për respektimin dhe për mbrojtjen e të drejtave të tjera nga autoritetet publike të Kosovës. Ky konstatim vihet në pikëpyetje në një shoqëri ku numri i të papunëve çdo ditë rritet, shtohet numri i rasteve sociale, rritet numri i atyre që janë me probleme të ndryshme shëndetësore dhe nuk kanë mundësi të shërohen brenda dhe jashtë vendit për shkak të kushteve të rënda materiale, kur mungojnë sigurimet shëndetësore, ku dhuna ndaj femrës është shumë e shprehur.

Duke u nisur nga praktika e përgjithshme, zakonisht shkelja e të drejtave të njeriut dhe cenimi i dinjitetit të tij ndodh më tepër në situata të pafavorshme për individin, veçanërisht kur ai është i pafuqishëm që t’i mbrojë, t’i kërkojë dhe të luftojë për të drejtat e tij, qoftë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, apo për shkak të moshës së shtyrë.

Avokati i Popullit, me qëllim të parandalimit të shkeljes së dinjitetit dhe të drejtave të njeriut në situata të tilla, është i përkushtuar të ketë një qasje sa më praktike dhe aktive. Prandaj, si pjesë të pandashme të punës së tij janë vizitat e rregullta sistematike, në qendrat e shëndetit mendor dhe vizitat periodike në Shtëpitë e të Moshuarve në Kosovë. Këto vizita shërbejnë për t’u siguruar nëse në ato vende mbrohet dhe respektohet dinjiteti i njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare. Përveç vizitave monitoruese në këto qendra, Avokati i Popullit më 21 shtator 2013, mbajti tryezën e rumbullakët, lidhur me kushtet e jetës së personave të moshuar, personave me probleme në shëndetin mendor, kushtet e punës së punëtorëve nëpër institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), si dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të drejtorisë së Shtëpisë së të moshuarve dhe MPMS-së.

Avokati i Popullit, po ashtu edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me vizitat e rregullta mujore në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria. Trajtimi i tyre në këto institucione, mbrojtja nga keqtrajtimi, është në një vijë të drejtë me mbrojtjen e dinjitetit të njeriut.

IAP gjatë periudhës raportuese ka trajtuar ankesa të ndryshme për shkeljet e pohuara të dinjitetit të njeriut, një ndër këto ankesa është edhe rasti i një të burgosuri në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM).¹⁴ Ankuesi është diagnostifikuar dhe ka lënguar nga

¹³ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Preambula.

¹⁴ IAP, rasti A. nr. 148/2013.

sëmundja e kancerit. Gjendja e tij shëndetësore ka qenë mjaft e rëndë, duke i kufizuar funksionet themelore jetësore, lëvizshmërinë dhe orientimin e tij në hapësirë. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, me anë të kontakteve të vazhdueshme dhe komunikimin përmes letrave, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka kërkuar që në përputhje me ligjin të shikohet mundësia dhe ankuesi të lirohet me kusht, në mënyrë që jashtë hapësirave ku mbahen personat e privuar nga liria të ketë një trajtim të dinjitetshëm shëndetësor. Prej përgjigjes nga KGJK, ka rezultuar se rasti është shqyrtuar dhe ankuesi është liruar me kusht, duke filluar tretmanin shëndetësor në Spitalin Rajonal të Mitrovicës.

Sfidë me të cilën ballafaqohen qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës edhe më tutje është mbrojtja e dinjitetit të njeriut për personat me aftësi të kufizuar. Sikurse edhe në raportet e mëhershme, po ashtu Avokati i Popullit rikujton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese situata e kësaj kategorie në Republikën e Kosovës nuk është aspak e kënaqshme.¹⁵ Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit, paraqet sidomos moszbatimi i infrastrukturës ligjore, që për qëllim primar ka zbutjen e diskriminimit të personave të kësaj kategorie.

Një shqetësim të veçantë paraqet edhe gjendja e pensionistëve të Kosovës. Kompensimi material dhe financiar për kontributin e tyre shoqëror për dekada të tëra, për këtë shoqëri, është jo dinjitoz. Mjetet që pensionistë kosovarë, por edhe përfituesit e ndihmave sociale marrin sot në Kosovë, nuk sigurojnë një jetë të dinjitetshme për këto kategori të shoqërisë kosovare.

2.3. Barazia para ligjit

E drejta për të qenë i lirë nga çdo lloj diskriminimi përbën një nga parimet themelore të drejtave të njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndalon diskriminimin, garanton barazinë para ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ajo garanton të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim.

Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik apo opinionit tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.¹⁶

Sundimi i ligjit është parim bazë i institucioneve vendore. Sundimi i ligjit, në radhë të parë do të thotë ekzistimi i ligjeve, të qarta e të kuptueshme për të gjithë. Megjithatë, në Kosovë një numër i konsiderueshëm i ligjeve të miratuara sot nuk po gjejnë zbatim.

¹⁵ IAP, Raporti vjetor 2010, f. 28.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24.

2.3.1. Barazia gjinore

Arritja e barazisë gjinore është një nga objektivat kryesore dhe është prioritet për zhvillimin e çdo shoqërie moderne demokratike, në të cilën të gjithë anëtarët e saj do të trajtohen në mënyrë të barabartë në të gjitha situatat pa diskriminim.

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë përfshin dallimin në trajtim, përjashtimin apo kufizimin në bazë të gjinisë, që me atë rast rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Çfarëdo dallimi në trajtim është diskriminues atëherë kur nuk ka ndonjë arsytim objektiv.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e thekson drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, pa marrë parasysh gjininë, gjuhën, përkatësinë etnike, politike, religjioze, kulturore, statusin ekonomik, orientimin seksual apo ndonjë status tjetër të qytetarëve.¹⁷

Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW). Mirëpo, bazuar në Kushtetutën kjo Konventë është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. Mbrojtja nga diskriminimi në Kosovë, sidomos nga ai në baza gjinore, është e rregulluar edhe me Ligjin për barazinë gjinore.

2.3.2. Pjesëmarrja në tregun e punës dhe në vendimmarrjen politike

Niveli i lartë i papunësisë në Republikën e Kosovës i vështirëson mundësitë e gjinisë femërore për të konkurruar në tregun e punës. Pozita e femrës në tregun e punës është shumë e rëndësishme për barazinë gjinore. Në tregun e sotëm të punës dhe situatën aktuale, më të mëdha janë gjasat që të punësohen meshkujt, posaçërisht për pozitat e larta, edhe në rastet kur ka kandidatë femra me kualifikime të njëjta.

Diskriminimi shpeshherë fillon që me rastin e shpalljes së konkurseve për vende të punës, duke përmendur gjininë si një nga kriteret për punësim. E tërë kjo flet shumë qartë se sistemi me mekanizmat e ndërtuar mbrojtës nuk është i fuqishëm sa duhet në parandalimin dhe ndaljen e diskriminimit në baza gjinore në fushën e punës dhe punësimit. Gjatë vitit 2013, IAP ka pranuar ankesën të cila referohet shkëputjes së marrëdhënies së punës të një femre të punësuar në një organizatë joqeveritare (OJQ), në periudhën e shtatzënisë.¹⁸

Eliminimi i pabarazisë ndërmjet meshkujve dhe femrave deri diku është arritur me masat e posaçme në legjislacion, më saktësisht me përcaktimin e kuotës për gjininë më pak të përfaqësuar, që ka për qëllim eliminimin e diskriminimit të femrës.

Kuota e përfaqësimit, si masë afirmative, në thelb mundëson krijimin e kulturës së pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, e cila duhet mbajtur për një interval kohor, derisa të zëvendësohet me konkurrencën reale. Kjo masë afirmative për gjysmën e shoqërisë, do të

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3.

¹⁸ IAP, rasti A. nr. 44/2013. Pas përpjekjes për ndërmjetësim nga ana e IAP, ankuesja është udhëzuar të përdorë mjetet ligjore, konkretisht është udhëzuar që t'i drejtohet gjykatës kompetente lidhur me rastin. Rasti është në procedure gjyqësore në gjykatën të cila është kompetente për shqyrtimin e rastit.

duhej të rritej në vazhdimësi deri në momentin e arritjes së barazisë objektive në të gjitha fushat.

Në nivelin lokal janë vërejtur shenja pozitive dhe shpresëdhënëse. Në vitin 2013 është zgjedhur kryetarja e parë grua që do të udhëheqë një komunë në Kosovë, ndërsa në disa komuna partitë politike kanë kandiduar femra për pozitën e të parit të komunës.

2.3.3. E drejta e pronës dhe trashëgimisë

Një fushë tjetër me rëndësi jetike, ku gratë trajtohen në mënyrë jo të barabartë, është fusha e të drejtave pronësore. Ligjet në fuqi u japin femrave dhe meshkujve të drejta të barabarta në lidhje me trashëgiminë e pronës.¹⁹ Mohimi i pronës grave, është një veprim tipik për shoqërinë tradicionale kosovare. Në shumicën e rasteve në Kosovë, për të mos thënë gati në tërësi, prona familjare trashëgohet nga meshkujt. Kjo është më e shprehur në zonat rurale. Mirëpo, kjo nuk ndryshon shumë as në zonat urbane. Në shumë raste kur femrat kanë kërkuar një pjesë të pronës familjare, ato janë kërcënuar nga bashkëshortet apo meshkujt e tjerë të familjes,²⁰ por edhe nga kompanitë private.²¹

Sa i përket rolit të femrës në shoqërinë tonë, ende ka dallime të konsiderueshme mes zonave rurale dhe urbane. Në zonat rurale, për shkak të traditave dhe zakoneve, pozita sociale e femrës është e nënshtruar ndaj asaj të mashkullit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore.

2.3.4. E drejta për arsim

Baza ligjore në Kosovë, sa i përket arsimit dhe edukimit, është e njëjtë për të dy gjinitë. Megjithatë, braktisja e shkollimit nga femrat është shqetësuese, jo vetëm për institucionet e Kosovës por edhe për gjithë shoqërinë kosovare. Kjo dukuri është shumë më e shprehur në zonat rurale, por edhe tek komunitetet pakicë ashkali, rom dhe egjiptas. Ekzistojnë shumë faktorë që vazhdojnë të ndikojnë që femrat ta braktisin shkollimin, por dhe më tutje ndër faktorët më dominues vazhdojnë të jenë ata socio-ekonomikë: varfëria, mungesa e transportit për fëmijët nga zonat e largëta, e cilat përcillet me mungesën e sigurisë për fëmijë të vegjël gjatë rrugës, si dhe martesat e hershme (nën moshën e lejuar me ligj).

Një çështje e cila vazhdon të jetë e pranishme në arsimin parauniversitar, është çështja e bartjes së simboleve fetare (bartja e shamisë), nga një numër i kufizuar i vajzave të besimit

¹⁹ Ligji për trashëgiminë, nr. 2004/26, Neni 3.

²⁰ IAP, rasti A. nr. 316/2011. Ankesa është e ripërsëritur për monitorimin gjyqësor në vitin 2013. Parashtruesja ka përsëritur të njëjtën ankesë, sepse axha i saj e pamundësoi që të bëhet pronare e shtëpisë të cilën baba i saj ka ndërtuar në oborrin e përbashkët familjar. Procedura është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

²¹ IAP, rasti A. nr. 238/2013. Rasti i ankueses të cila pohon se rasti i saj ka të bëjë me çështjen e mosrespektimit të një marrëveshje që lidhet me pronën e saj, e cila nuk është duke u respektuar nga një kompani private. Ankuesja ka parashtruar një padi në gjykatën kompetente dhe rasti është duke u monitoruar nga ana e IAP-së.

islam. Për këtë çështje është i domosdoshëm një dialog i gjerë shoqëror dhe ndërinstytucional.²²

2.3.5. Dhuna në familje

Me gjithë përpjekjet pozitive të institucioneve në nivel qendror dhe lokal në Kosovë, dhuna në familje vazhdon të mbetet një realitet i hidhur në Kosovë. Kjo jo vetëm që paraqet shkeljen e drejtave të njeriut, por përbën edhe bazën e diskriminimit në shumë raste, në radhë të parë e grave, fëmijëve dhe të personave të moshuar. Dhuna në familje gjithashtu vazhdon të prek të gjitha komunitetet në masë gati të njëjtë në Kosovë. Problemin edhe më të madh e bën fakti se, vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës në familje raportohet tek autoritetet kompetente që të trajtojnë rastet e dhunës.

Një ndër arsyt kryesore që vazhdon të jetë burim i dhunës në familje është situata e rëndë socio-ekonomike dhe kulturore. Papunësia dhe varfëria janë faktorët më të shpeshtë që ndikojnë që dhuna në familje të rritet.

Varësia ekonomike e viktimës e vështirëson pozitën e saj. Viktimat e kanë shumë të vështirë që të paraqesin rastin, sepse janë shumë të lidhura ekonomikisht me personin i cili ushtron dhunën. Gjithashtu, pengesa për paraqitjen e rastit janë edhe opinioni i përhapur shoqëror se dhuna në familje është çështje private dhe nuk duhet të dalë jashtë rrethit familjar. Një faktor tjetër që nuk duhet harruar megjithatë është edhe lidhja emocionale, e cila nuk mund të shuhet midis anëtarëve të së njëjtës familje me lehtësi.

IAP shumë herë ka monitoruar proceset gjyqësore, ku viktimat e dhunës kanë kërkuar bashkëpunim dhe monitorim pranë gjykatave.²³ Fatkeqësisht, në disa raste gjykatat kompetente, pas kërkesës së parashtruar nga ana e viktimës për urdhër-mbrojtje, nuk marrin vendim për masën mbrojtëse adekuatë brenda afatit kohor të paraparë me ligj.²⁴

Sipas Raportit të Policisë të Republikës së Kosovës, në Komunën e Prishtinës për vitin 2013 janë regjistruar 251 raste të dhunës në familje, në Komunën e Gjilanit ka pasur 122 raste, në Komunën e Ferizajt janë shënuar 139 raste, në Komunën e Pejës 211, në Komunën e Prizrenit 194 raste dhe në Komunën e Mitrovicës janë regjistruar 170 raste. Në Kosovë gjatë vitit 2013 kanë ndodhur 4 vrasje si pasojë të dhunës në familje.²⁵ Sipas këtij raporti të policisë për vitin 2013, viktimat sipas gjinisë janë: femra 869 dhe meshkuj 220. Gjithashtu, sipas të dhënave të këtij Raporti, gjatë vitit 2013 ka pasur 19 shkelje të urdhrave për-mbrojtje.

2.3.6. Gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës

Kategoria e grave dhe vajzave të cilat janë viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës, janë një kategori të cila nuk ka qenë e trajtuar ligjërisht nga autoritetet përkatëse në vend. Në

²² IAP, rasti A. nr. 152/2013.

²³ IAP, rasti A. nr. 22/2013.

²⁴ Raporti i Policisë së Kosovës për vitin 2013, për rastet të dhunës në familje.

²⁵ Po aty.

Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2013 është diskutuar për këtë kategori të personave dhe ka lëvizje pozitive, por ende të pamjaftueshme.

Në Raportin e IAP-së të vitit 2012, Avokati i Popullit ka kërkuar rregullimin ligjor dhe institucional për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Iniciativa për formimin e grupit ndërministror nga ana e Qeverisë, me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë, i cili do të merret me çështjen e riparimit të dëmeve të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, është një veprim i cili shënon një lëvizje pozitive.²⁶

Grave dhe vajzave, viktimave të luftës në Kosovë, duhet t'u sigurohet përkrahje institucionale dhe infrastrukturë ligjore, me fokus të veçantë në heqjen e paragjytimeve për këtë pjesë të shoqërisë tonë. Gjithashtu shoqëria kosovare duhet të angazhohet më shumë në zhvillimin, edukimin, arsimimin dhe emancipimin e tyre, me qëllim të rikthimit të dinjitetit njerëzor për këtë kategori. IAP mbështet të gjitha nismat dhe veprimet institucionale për rregullimin ligjor të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, që të gëzojnë të drejtat e tyre si viktima civile të luftës.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për harmonizimin e legjislacionit kosovar me legjislacionin e Bashkimit Evropian sa i përket barazisë gjinore.*
- *Të zbatohet kuota e paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore në të gjitha nivelet, me qëllim të avancimit të pozitës së femrës në shoqërinë kosovare, sidomos për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në nivelin qendror dhe lokal.*
- *Të zbatohet programi për trajnim të të punësuarve në institucione të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe me çështjen e barazisë gjinore, në nivelin qendror dhe lokal.*
- *Të aktivizohet çështja e financimit të shtëpive të sigurta për viktimat e dhunës në familje.*
- *Të rregullohet ligjërisht statusi i grave, vajzave dhe personave tjerë të cilët janë viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës.*
- *Të analizohet buxheti i Republikës së Kosovës prej aspektit gjinor, duke integruar statistikën gjinore në organet dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

2.3.7. Zbatueshmëria e ligjeve

Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) është miratuar në vitin 2004, me qëllim që t'u sigurojë subjekteve të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë, barazi të mundësive për të gëzuar dhe ushtruar të drejtat dhe mbrojtje efektive nga çdo sjellje diskriminuese apo që e

²⁶ Ministria e Drejtësisë-Agjencia për Barazi Gjinore, tryeza e rrumbullakët “*Qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë*”, 8 mars 2013, në: www.md-ks.org/?page=1,8,867 (16.12.2013).

nxit atë.²⁷ Megjithatë, ky ligj ka mbetur i pa zbatueshëm për shkak të neneve të paqarta të cilat i përmban në vete.

LKD aktualisht është duke lënë një zbrazëti në zgjidhjen e rasteve diskriminuese sa i përket procedurave dhe mungesës së një organi publik, që ka për obligim trajtimin e rasteve të diskriminimit. Ai nuk i plotëson kërkesat për të siguruar një mjet efektiv për viktimat e mundshme, duke paraqitur një rast të arsytuar në praktikë ose në ligj. Mos zbatimin e LKD, Avokati i Popullit e ka raportuar dhe ka rekomanduar ndryshimet në këtë ligj edhe në raportet vjetore paraprake.²⁸

Në këtë Ligj edhe më tej mbetet i paqartë dhe jofunksional kreu II, ku përfshihen procedurat për iniciimin e rasteve, organi kompetent për shqyrtimin e rasteve të diskriminimit, si dhe sanksionet.

Qeveria e Kosovës, gjatë vitit raportues, ka ndërmarrë veprime për plotësim-ndryshim të LKD. Deri në ndryshimin e tij, ky ligj vazhdon të mbetet i tillë, i pa zbatueshëm për viktimat e diskriminimit, për të kërkuar të drejtën e tyre të garantuar me këtë ligj.

Këshilli Ekonomik Social deri në momentin e raportimit nuk ka arritur të harmonizojë qëndrimet në lidhje me dy dokumente shumë të rëndësishme në fushën e punësimit: Kontratën Kolektive dhe pagën minimale. Avokati i Popullit vlerëson se mos ushtrimi i kompetencave nga KES sipas Ligji mbi Këshillin Ekonomik Social ka implikime negative në realizimin e të drejtave të të punësuarve në sektorin publik dhe privat.

Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë nr. 2003/15, i diskutuar shumë herë në raportet e mëparshme vjetore të IAP-së, për mangësitë e ndryshme, është ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-096, dhe tani ky ligj mund të konsiderohet më gjithëpërfshirës për njerëzit që varen nga ndihmat sociale. Megjithatë, ankesat e parashtruara në IAP për ndërprerje të ndihmës sociale, dëshmojnë të kundërtën në shumë raste. Shumë persona ankohen se u ndalen ndihmat sociale si pasojë e mos-përfshirjes së kategorive të tyre me ligj.

2.3.8. Diskriminimi i bazuar në moshë

Diskriminimi i bazuar në moshë ndodhë kur bazuar në moshën e tij/saj, një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa personi i një grupmoshe tjetër, në rrethana të njëjta ose të ngjashme.

Pavarësisht faktit se Avokati i Popullit ka publikuar raport lidhur me diskriminim në moshë, në rastin e shpalljes së konkurseve për vende pune, ky lloj diskriminimi edhe më tej vazhdon të jetë i pranishëm në çështjet e punësimit. Edhe më brengosës është fakti se një gjë e tillë

²⁷ Ligji kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

²⁸ Shih, Raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, 2010, 2011 pjesa Barazia para ligjit. Avokati i Popullit pretendon se për shkak të mangësive të caktuara, edhe më tutje ky ligj vazhdon të mos jetë i zbatueshëm në praktikë. Amendamenti i Ligjit kundër diskriminimit, do të krijonte një mundësi që ky ligj të mos mbetet edhe më tej i pazbatueshëm në realitet, në: www.ombudspersonkosovo.org (05.03.2014).

praktikohet edhe në marrëveshjet e nënshkruara nga institucionet publike, siç është rasti me MPMS, për punësim të rasteve sociale.²⁹

2.3.9. Ankesat kundër Universitetit të Prishtinës

Gjatë këtij viti raportues, Universiteti i Prishtinës (UP) ka qenë adresë kundër së cilës shumë qytetarë të Republikës së Kosovës janë ankuar për diskriminim. Në mënyrë grupore është parashtruar ankesa e kandidatëve për doktoratë, të cilët janë ankuar në padrejtësitë e supozuara në konkursin publik të shpallur nga senati i UP-së më 26.09.2013, si dhe diskriminim në regjistrimin e studentëve në studimet e doktoratës, për vitin akademik 2013/2014. Rasti është hapur për hetim nga Avokati i Popullit.³⁰

Kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, janë parashtruar edhe një numër i konsiderueshëm i ankesave për diskriminim. Parashtruesit e ankesave pohojnë se Universiteti i Prishtinës nuk i trajton në mënyrë të barabartë kandidatët e diplomuar në universitete private dhe publike, për vazhdimin e studimeve post-diplome dhe master, me gjithë faktin se universitetet private i nënshtrohen procedurave të akreditimit njëjtë si ato publike.³¹

Regjistrimi i studentëve për vazhdimin e studimeve master nga UP në atë privat, nuk ka kritere shtesë, ndërsa anasjelltas UP krijon kritere shtesë për studentët e diplomuar në universitetet private. Nga ta kërkohen kritere shtesë si p.sh. plotësimi i numrit të studentëve me të diplomuarit në UP, dhe nëse mbetet vend i zbrazët mund të plotësohet me student të diplomuar në universitete private, por me kushte tjera, sepse pavarësisht notës mesatare ata duhet t'u nënshtrohen testeve, gjë e cila nuk ndodh për të diplomuarit në UP. Ky lloj diskriminimi rëndon edhe më shumë studentët, sepse në shumë raste kemi të bëjmë me lëndë të njëjta të cilat ligjërohen nga mësimdhënës të njëjtë në të dy universitetet, si atë publik edhe në ato private.

2.3.10. Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me diskriminim në moshë

Avokati i Popullit ka raportuar lidhur me vendimin diskriminues të Senatit të UP-së për mosrekrutimin e mësimdhënësve të cilët kanë arritur moshën mbi 50-vjeçare.³²

Lidhur me këtë rast Avokati i Popullit ka publikuar Raport me rekomandime, dhe këtë vendim të Senatit të UP e ka cilësuar si të paarsyeshëm dhe të kundërligjshëm, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare

²⁹ IAP, rasti A. nr. 566/2013. Memorandumi i Mirëkuptimit nr. 122, i datës 2 prill 2013, i lidhur midis MPMS dhe KEK. Neni V kufizon moshën për punësim në 40 vjet (kopja e memorandumit gjendet në dosjen e rastit).

³⁰ IAP, rasti A. nr. 613/2013. Avokati i Popullit i është drejtuar me letër Rektoratit të UP por nuk ka pranuar përgjigje.

³¹ IAP, rastet A. nr. 523/2013 dhe A. nr. 590/2013. Ankuesit pretendojnë se UP krijon kritere shtesë studentëve të diplomuar në universitete private për studime master.

³² IAP, Raporti Vjetor për vitin 2011, në: www.ombudpersonkosovo.org (05.03 2014).

për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 14 të KEDNJ-së, Ligjin Themelor të Punës, Ligjin kundër Diskriminimit, si dhe me Statutin e UP.³³

Në bazë të kompetencave të IAP, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, Avokati i Popullit e ka ngritur çështjen për konflikt Administrativ pranë gjykatës kompetente për të vendosur në lidhje me rastin.³⁴

2.3.11. Diskriminimi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në sistemin gjyqësor në Kosovë, në periudhën për të cilën po raportojmë, edhe më tej vazhdon të jenë të pranishme probleme si ato me zvarritje procedurale për shqyrtim dhe vendosje të rasteve, si dhe me drejtësinë efektive. Më gjerësisht lidhur me këtë temë mund të gjeni tek pjesa e gjyqësorit.³⁵

Edhe gjatë vitit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS), vazhdon të mos i respektojë të drejtat e qytetarëve të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, respektivisht nenin 5 të Kushtetutës dhe Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.³⁶

Edhe më tej qytetarët e Kosovës janë të obliguar që parashtresat e tyre në DHPGJS t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën angleze dhe për pasojë, në shumë raste, për shkak të shpenzimeve për përkthim të dokumenteve, qytetarët privohen nga e drejta e tyre për të ngritur çështjen e tyre në DHPGJS.

Avokati i Popullit, përmes një raporti me rekomandime, ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që, bazuar në kompetencat e veta kushtetuese, të iniciojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për DHPGJS, pjesën që ka të bëjë me përkthimin e dokumenteve në gjuhën angleze.³⁷

³³ IAP, Raport me rekomandim nr. 170/2010. Avokati i Popullit ka raportuar lidhur me vendimin diskriminues të Senatit të UP-së për mos rekrutimin e mësimdhënësve të cilët kanë arritur moshën mbi 50-vjeçare. Në: www.ombudspersonkosovo.org (05.03 2014).

³⁴ Në bazë të kompetencave të IAP, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, Avokati i Popullit e ka ngritur çështjen për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me ligjshmërinë e vendimit të Senatit të UP, për rekrutimin për herë të parë në pozitën e mësimdhënësve në UP. Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore e Prishtinës, pas reformimit të sistemit gjyqësor në Kosovë, në bazë të kompetencave lëndore ka shqyrtuar kërkesën për konflikt administrativ të ngritur nga IAP. Pas seancës gjyqësore të mbajtur më 20 nëntor 2013 dhe seancës për shqyrtim kryesor të mbajtur më 9 dhjetor 2013, Gjykata ka vendosur dhe me aktgjykim është pranuar kërkesëpadia e IAP-së, si dhe është anuluar vendimi diskriminues i Senatit të Universitetit të Prishtinës me nr. 1/499 i datës 25 maj 2010.

³⁵ IAP, shih Raportet vjetore të IAP 2011, 2012, po ashtu dhe në këtë Raport: Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut. Në: www.ombudspersonkosovo.org (05.03 2014).

³⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5; Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37.

³⁷ IAP, Raport me rekomandim. Rekomandim për ndryshimin e dispozitave të nenit 25 paragrafit 8, paragrafi 9 dhe paragrafi 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, drejtuar Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2.3.12. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Edhe më tej Privatizimi në Kosovë mbetet bazë për ankesë nga shumë qytetarë. Duke pas parasysh faktin se shumë ish të punësuar nëpër ndërmarrje publike kanë mbetur pa punë edhe më tej vazhdojnë të mbesin edhe pa mbështetje ligjore apo institucionale. Gjithashtu, shumica nga ta ankohen edhe kundër mënyrës së privatizimit të ndërmarrjeve të tyre si dhe mospërfshirjen e tyre në kompensim të 20 %. Ankesat e drejtuara në IAP lidhur me këtë çështje janë duke u hetuar sipas kompetencës ligjore që ka Institucioni.³⁸

2.3.13. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuar

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar janë të trajtuara në 26 ligje bazike të fushave të ndryshme dhe 2 akte nënligjore në Kosovë. Disa prej tyre, janë ligje të veçanta që i përkasin veçanërisht kësaj kategorie.³⁹ Edhe përkundër këtij fakti, personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të mbesin kategori e rrezikuar nga çdo lloj diskriminimi, sepse edhe sot nuk vërehet ndonjë përparim lidhur me krijimin të ndonjë infrastrukture për pavarësimin e tyre në përditshmëri.

Ashtu siç është cekur edhe në raportet e mëparshme, vazhdon të mbetet problem infrastrukture rrugore për lëvizje të lirë për personat me mjete ndihmëse. Kjo dukuri nuk është e rregulluar as edhe në vendet më të frekuentuara si: spitale, shkolla, gjykata etj. Madje, edhe nëpër ato vende ku ekzistojnë pjerrinat për lëvizje me mjete ndihmëse, ato janë të ndërtuara pa standarde dhe në këtë mënyrë është e pamundur lëvizja e lirë pa ndihmën e përcjellësve. Kjo ndikon shumë që personat me aftësi të kufizuar, të varur nga mjetet ndihmëse për lëvizje (karroca), të mbesin të izoluar shoqërisht dhe të diskriminohen në aspektin institucional. Përveç tjerash fëmijët mbeten analfabet si pasojë e pa mundësisë për qasje të lirë në objekte.⁴⁰

Me këtë rast, Avokati i Popullit kërkon nga Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe masat e duhura për integrimin në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Po ashtu është i nevojshëm angazhim sipas kërkesave ligjore, për zbatimin e legjislacionit në fuqi si dhe për krijimin e infrastrukturës institucionale, materiale dhe teknike për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën e përditshme pa diskriminim.

³⁸ IAP, rasti A. nr. 133/2013. Ankesë grupore në të cilën ankuesit pohojnë se nuk janë përfshirë në kompensim të 20% nga privatizimi i ndërmarrjes, ata gjithashtu pohojnë se kanë mbetur pa punë dhe në kushte të vështira ekonomike sepse moshë e tyre si dhe shkollimi i tyre nuk është kërkesë e tregut të punës në njërin anë kurse në anën tjetër nuk e plotësojnë kriterin e moshës për pension.

³⁹ Ligje të veçanta që i përkasin aftësisë së Kufizuar në Kosovë janë: *Ligji, për pensionet për personat me Aftësi të Kufizuar nr. 2003/23*, dhe *Ligji, për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme nr. 03/L-022*, *Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nr. 03/L-19*, *Ligji për personat e verbër nr. 04/L – 092*, me të cilën rregullohen të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër.

⁴⁰ Këto informata janë pranuar në IAP gjatë takimeve të rregullta gjatë vitit 2013, me OJQ të cilat i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë:- OJQ Hendikos, OJQ Hendikep Kosova, OJQ Down Syndrome Kosova.

2.3.14. Mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBT

Në Kosovë ekziston baza solide normative e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, por pavarësisht ekzistencës së garancive kushtetuese dhe ligjore ky komunitet bie në komunitete pakicë/grupe të drejtat e të cilëve shkelen. Jo vetëm te ne por në shumë vende të botës pjesëtarët e komunitetit LGBT shpesh janë viktima të dhunës e cila bëhet jashtëzakonisht e rëndë, veçanërisht në raport me llojet tjera të krimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të motivuara nga paragjykimet, pasi që këto krime shpesh përcillen me shkallë të lartë të mizorisë dhe brutalitetit.⁴¹

Kushtetua e Republikës së Kosovës siguron garanci të barabarta dhe bazë solide për respektim të barabartë të të drejtave të njeriut të gjithë personave. Në fakt, në Kushtetutë parashihet *barazia para ligjit*⁴² e të gjithëve dhe ndalohet diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, po ashtu garantohet edhe *liria e shprehjes, liria e mediave*, si dhe *liria e tubimit*. Kufizimet e këtyre lirive mund të lejohen vetëm nëse një gjë e tillë është paraparë me ligj dhe nëse ky kufizim është në interes publik.

Përveç kushtetutës, bazën për respektim të barabartë të të drejtave të gjithë qytetarëve sigurojnë edhe një mori ligjesh, në rend të parë Ligji kundër Diskriminimit,⁴³ i cili ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual. Ndalimi i nxitjes së urrejtjes, trazirave dhe mostolerancës ndërmjet grupeve në Kosovë është e paraparë me Kodin Penal të Kosovës. Ligji për Punën po ashtu ndalon të gjitha format e diskriminimit. Ndalimi i çdo lloj paraqitje dhe shfaqje publike të çdo individi në mënyrë fyese, nënçmuese dhe përlulëse në raport me gjininë apo orientimin seksual, është e paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore.⁴⁴

2.3.15. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komunitetit LGBT

Gjatë vitit 2013, pati lëvizje drejt promovimit të të drejtave të komunitetit LGBT në Kosovë, të cilat nëse kemi parasysh kontekstin shoqëror, nuk janë të papërfillshme. Me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare të luftës kundër homofobisë, më 17 maj 2013 u mbajt konferenca e parë për të drejtat e komunitetit LGBT në Kosovë.⁴⁵

41 Raporti vjetor i Komisionarit të lartë të OKB për të drejtat e njeriut dhe raportet e Zyrës së komisionarit të lartë dhe sekretarit të përgjithshëm, 17.11.2011, në: http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/19session/A.HRC.19.41_English.pdf (12.12.2013).

42 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24 paragrafi 2: "Askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë[...]orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar apo të ndonjë statusi tjetër personal".

43 Ligji kundër Diskriminimit, neni 2 "a) Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë ndaj asnjë personi në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paftësisë mentale apo fizike, prirjes seksuale".

⁴⁴ Ligji për Barazinë Gjinore, neni 15, paragrafi 3.

⁴⁵ Konferenca e parë për komunitetin LGBT në Kosovë: Të promovohen dhe mbrohen të drejtat 17. 5. 2013. Në konferencë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, sektorit të OJQ-ve, dhe Avokatit të Popullit. Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësuesit e misionëve diplomatike në Kosovë.

Po ashtu, është i rëndësishëm fakti që Qeveria e Kosovës ka lëvizur drejt krijimit të Grupit Koordinues Këshillëdhënës në nivel kombëtar në Republikën e Kosovës, për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT. Qëllimi i krijimit të këtij grupi është që të krijohet bashkimi, partneriteti dhe bashkëpunimi i rregullt ndërmjet institucioneve dhe OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, si dhe që të iniciohen dhe ndërmerren veprime të përbashkëta në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual.

Gjatë këtij viti, përfaqësuesit e sektorit të OJQ-ve në Kosovë, të Komisionit Evropian dhe përfaqësuesi i Avokatit të Popullit morën pjesë në punëtorinë regjionale “People 2 People”, program i Komisionit Evropian, dhe në bashkëpunim me Zyrën për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në Serbi, si dhe organizatën ndërkombëtare “ILGA-Europe”.⁴⁶ Gjatë kësaj punëtorie, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit prezantoi qëndrimet lidhur me temën e mekanizmave monitorues si dhe masat legjislative dhe jo legjislative, dhe qëndrimet lidhur me gjendjen e tanishme të komunitetit LGBT në Kosovë dhe lidhur me aktivitetet e Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje.⁴⁷ Gjatë kësaj punëtorie, me theks të veçantë u diskutuan tema si në vijim: diskriminimi, krimet nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes, si dhe liria e asociimit, tubimit dhe shprehjes.

Një ngjarje shumë e rëndësishme është hulumtimi në temën Liria dhe Mbrojtja për pjesëtarët e komunitetit LGBT në Kosovë, të cilin e ka zhvilluar organizata Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), kurse rezultatet deri të cilat kanë arritur gjatë hulumtimit i kanë prezantuar për publikun më 14 nëntor 2013.⁴⁸ Sipas të dhënave të raportit, mund të fitohet një pasqyrë e përafërt e gjendjes në të cilën jeton komuniteti LGBT në Kosovë, si dhe për perceptimet e përfaqësuesve të organeve të ndryshme dhe institucioneve, por gjithashtu mund të vërehet se megjithatë ka lëvizje pozitive në pranimin dhe të kuptuarit e problemeve me të cilat ballafaqohet komuniteti LGBT.

2.3.16. Problemet dhe sfidat kryesore të komunitetit LGBT në Kosovë

Megjithatë, pavarësisht garancive kushtetuese, një baze relativisht të mirë ligjore dhe përpjekjeve të institucioneve shtetërore, këto të drejta në praktikë nuk respektohen. Shkelja e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe lirisë së tubimit, janë problemet me të cilat më së shpeshti ballafaqohet komuniteti LGBT në Kosovë. Ato përcillen edhe me sulme fizike dhe verbale ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti. Avokati i Popullit edhe më parë ka tërhequr vërejtjen

⁴⁶ ILGA-Europe është degë e asociacionit ndërkombëtar të LGBT për regjionin e Evropës (European Region of the International LGBTI Association)

⁴⁷ Komisioni Evropian, TAIEX, “p2p events”, prezantimi i përfaqësueses së Avokatit të Popullit të Kosovës, në: http://ec.europa.eu/enlargement/taieX/dyn/taieX-events/library/detail_en.jsp?EventID=53050 (11.12.2013).

⁴⁸ Raporti i YIHR për lirinë dhe mbrojtjen e pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë, 14. 11. 2013, në: <http://ks.yihr.org/rs/article/159/YIHR-KS-publishes-the-report-on-Freedom-and-Protection-for-Lesbians-Gays-Bisexuals-and-Transgender-in-Kosovo> (12.12.2013).

lidhur me ekzistimin e këtij problemi, si dhe nevojën për t'ua zgjidhur nga organet kompetente.⁴⁹

Në IAP ekziston njëسيا për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT. Megjithatë, bazuar në statistikat e IAP, deri më tani nuk ka ankesa të parashtruara lidhur me shkeljen e të drejtave në bazë të orientimit të ndryshëm seksual, kështu që nga aspekti i statistikave ne nuk mund të flasim në mënyrë precize për këtë problem.

Moslajmërimi i rasteve të shkeljeve të të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, shkakton mungesë të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, gjë që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në nivel të ultë të mbrojtjes së pjesëtarëve të komunitetit LGBT. Vetë paraqitja e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut të pjesëtarëve të komunitetit LGBT është veçanërisht e vështirë, sepse në të shumtën e rasteve këto shkelje janë të motivuara nga paragjykimet, dhe përcillen me gjuhë të urrejtjes dhe në përgjithësi janë të mbuluara mirë dhe në mënyra të ndryshme.

Pikërisht për këtë arsye, nëse pas një shkelje të të drejtave apo edhe kryerjes eventuale të veprës penale, si motiv qëndron paragjykimi apo urrejtja ndaj grupit të caktuar shoqëror, në rastin e tanishëm kundër komunitetit LGBT, është e domosdoshme që organet e ndjekjes t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dhe të zbulojnë se bëhet fjalë për një lloj të motivimit të tillë për të kryer shkelje të të drejtave të njeriut. Është e domosdoshme që kjo të njihet dhe shënohet nga ana e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, se paragjykimi ndaj orientimit të ndryshëm seksual ka qenë motiv për dikë për të shkelur të drejtën e ndokujt.

Problemi i moslajmërimit tregon për shkallën e ultë të besimit të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në punën e institucioneve shtetërore. IAP ka ndërmarrë hapat adekuat për të inkurajuar pjesëtarët e komunitetit LGBT që lirshëm të drejtohen në IAP, të parashtrorjnë ankesë, të paraqesin shkeljet e drejtave të tyre.

Fitimi i besimit në sistem gjithashtu shtron parakushte të caktuara, ndërsa njëra nga parakushtet është që lëndët gjyqësore, të cilat në prapavijë kanë diskriminimin në bazë të orientimit seksual si motiv për shkeljen të drejtave, të procedohen në mënyrë efektive dhe efikase.

Po ashtu, një moment i rëndësishëm është edhe mbrojtja e viktimave nga viktimizimi sekondar (i dytë), frikësimi dhe hakmarrja gjatë procedimit të rastit nga ana e organeve të ndjekjes. Të shpeshta janë rastet kur viktimat nuk kanë guxim të paraqesin rastet pasi që kanë frikë nga pasojat, hakmarrja etj. Nëse organet gjyqësore dhe organet tjera kompetente nuk i inkurajojnë viktimat dhe dëshmitarët që të raportojnë veprën, ata nuk do ta bëjnë këtë ose do ta bëjnë shumë rrallë. Po ashtu, është e nevojshme që të përkrahen OJQ-të dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, të cilat merren me hulumtimin e shkeljeve të të drejtave të komunitetit LGBT.

Me qëllim të përmirësimit të pozitës së komunitetit LGBT, është i nevojshëm zbatimi i një procesi gjithëpërfshirës, i cili do të ndikonte në zhvillimin e tolerancës dhe tejkalimin e paragjyqimeve në të gjitha sferat e shoqërisë.

⁴⁹ IAP, Arkivi. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) shpreh shqetësimin e tij lidhur me ngjarjet e ditëve të fundit përkitazi me sulmin fizik gjatë prezantimit të "Kosova 2.0" në pallatin e rinisë në Prishtinë nën organizim të "Libertas".19.12.2012. Në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,s,670> (7.12.2013).

2.3.17. Diskriminimi në baza sociale

Shumë familje në Kosovë, në pamundësi për të bërë zgjidhje vetanake për strehim, edhe më tej vazhdojnë t'u drejtohen Kuvendeve Komunale për të kërkuar ndihmë për strehim humanitar.

Në shumicën e komunave të Kosovës, mungesa e strehimoreve për rastet sociale është një dëshmi e dhembshme. Një numër i konsiderueshëm i familjeve ende jetojnë në kushte banimi krejtësisht të padinjitetshme që nga përfundimit i Luftës në Kosovë më 1999, pa ndonjë shpresë për një zgjidhje të afërme.

Kontejnerët tek lagjja "Fusha e Pajtit" në Prishtinë edhe më tej janë të mbushura me banorë, të cilët jetojnë në kushte të cilat nuk përkojnë me jetë dinjitoze. Këto raste Avokati i Popullit gjithashtu i ka raportuar edhe në Raportet paraprake dhe përmes mediave.

2.3.18. Shfrytëzimi i lirë i pronës private dhe publike

Një problem evident vazhdon të paraqesë edhe uzurpimi i paligjshëm i pronës shoqërore apo private edhe pengimi i shfrytëzimit të lirë të pronës private, nga persona dhe grupe të ndryshme personash.

Pas një numri të shumtë ankesash dhe peticionesh të drejtuara në Kuvendin Komunal të Prishtinës për të cilat nuk kanë marrë përgjigje, qytetarët e një lagjeje në Prishtinë (afër tregut të gjelbër) i janë drejtuar IAP me ankesë nëpërmjet së cilës pohojnë se e kanë të pamundur zhvillimin normal të jetës sepse po ju vështirësohet edhe liria e lëvizjes si dhe shfrytëzimi i lirë i pronave të tyre, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga shitësit ambulantë në hapësirat publike, konkretisht në rrugë, në hyrje-dalje të lagjes. Ata gjithashtu pohojnë se shpeshherë edhe personat e sëmurë nuk mund të dërgohen për ndihmë urgjente mjekësore, si pasojë e mbylljes së rrugës nga shitësit ambulantë. Sipas tyre, edhe shëndeti i banorëve të kësaj lagje është i rrezikuar, sepse tregtarët ilegalë i hedhin mbeturinat në rrugë, nga të cilat kundërmon erë e rëndë dhe mblidhen shumë qen endacakë.⁵⁰

Avokati i Popullit e ka ngritur këtë çështje përmes letrës drejtuar Komunës së Prishtinës, mirëpo ajo është deklaruar si jo kompetente për këtë çështje, sepse sipas saj, tregu i qytetit bie nën kompetencë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare i Privatizimit ka pohuar se pas transferimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të gjitha ndërmarrjet publike kanë mbetur në kompetenca të nivelit lokal dhe atij qendror.

Avokati i Popullit është duke vazhduar me procedura për këtë rast, sepse nga hetimet e zhvilluara për këtë çështje shihet qartë mosgatishmëria për të menaxhuar me pronat publike,

⁵⁰ IAP, Rasti A. 494/2013. Ankuesit pretendojnë se nuk mund ta shfrytëzojnë lirshëm pronën e tyre private në lagjen tek tregu i gjelbër, në qendrën e qytetit të Prishtinës, si pasojë e mos mbështetjes së organeve kompetente në nivelin lokal. Lidhur me pohimet e ankuesve Avokati i Popullit i është drejtuar komunës së Prishtinës me letër dhe ankesa është në procedurë.

si dhe për t'u garantuar qytetarëve, që pa diskriminim, në mënyrë të lirë dhe pa pengesa, të mund t'i shfrytëzojnë të drejtat dhe pronat e tyre.

2.3.19. Agjencia Kosovare e Pronës

Ashtu siç është raportuar edhe në raportet paraprake të IAP-së, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), edhe më tej vazhdon me standarde të dyfishta në trajtimin dhe shqyrtimin e lëndëve për të cilat vendosin në bazë të kompetencës së tyre.

Edhe më tej, pronat në pjesën veriore të Mitrovicës nuk janë liruar nga uzurpuesit e paligjshëm dhe nuk janë të përfshira në skemën e qirasë nga kjo agjenci, ashtu siç është e përcaktuar me ligj. Këtu vërehet një dështim i punës së kësaj agjencie për të realizuar mandatin e vet. Këtë e rëndon edhe më shumë fakti se nga neglizhenca në punën e tyre ata vjelin qira nga shfrytëzuesit individualë duke ua ndarë këto mjete personave jolegjitimë. Në këtë rast kemi të bëjmë me pronat e banorëve shqiptarë të uzurpuara në pjesën veriore të Mitrovicës, për të cilat AKP nuk mbledh qira, por të cilëve u merren mjetet e qerasë për banesat e shfrytëzuara në pjesën jugore të Mitrovicës për pronarët serbë edhe nëse pronat e tyre nuk janë duke u shfrytëzuar. Ky paraqet një diskriminim të palejueshëm me prapavijë politike.

Në IAP janë regjistruar raste ku qiramarrësi i paguan AKP-së për pronën të cilën ai e shfrytëzon, kurse AKP mjetet e grumbulluara nga qiraja e tij i deponon tek pronari i një prone tjetër, e cila gjithashtu është nën administrim të AKP. Në këtë rast, i gjithë procesi i ankesës nga qiramarrësi, drejtuar kësaj agjenci ka përfunduar me kërkim-falje për gabim, dhe atë pa u udhëzuar në shfrytëzim të mjeteve juridike për kompensim të dëmit. Ky rast është duke u hetuar në IAP.⁵¹

Diskriminimi nga AKP dëshmohet edhe në faktin se ata edhe më tej i obligojnë pronarët shqiptarë që pronat e tyre që i kanë të uzurpuara në pjesën veriore të Mitrovicës dhe nën administrim të AKP, të paguajnë qira për shfrytëzimin e pronave të pronarëve serb në pjesët tjera të Kosovës, por një gjë të tillë nuk e bëjnë me pjesëtarë nga komuniteti serb që kanë uzurpuar pronat e shqiptarëve në veri të Mitrovicës, duke mos i detyruar të njëjtit të paguajnë qira për pronat e shqiptarëve të cilat i kanë uzurpuar dhe ende i shfrytëzojnë.⁵²

Arsyetimi i vazhdueshëm i AKP për shkeljet e lartpërmendura, të cilat i bazon në shkaqe politike dhe mos mbështetje nga Policia e Kosovës (PK) për të realizuar mandatin. Sidoqoftë, kjo gjendje përbën shkelje të Kushtetutës së Kosovës, instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të inkorporuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin Kundër

⁵¹ IAP, *rasti A. nr. 506/2013*. Ankuesi pretendon se i paguan qira Agjencia Kosovare e Pronës për pronën të cilën ai e shfrytëzon, kurse AKP mjetet e grumbulluara nga qiraja e tij i deponon tek pronari i një prone tjetër, e cila gjithashtu është e përfshirë në skemë të qirasë në AKP.

⁵² IAP, *rastet A. nr. 4 84/2008* dhe *A. nr. 475/2008*. Ankuesit pretendojnë se banesat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës i kanë nën administrim të AKP, por ata edhe sot nuk vjelin qira nga pronat e tyre të cilat i kanë të uzurpuara nga banorët serbë, identitetin e të cilëve e kanë dorëzuar në AKP dhe në Polici.

Diskriminimit, të cilat garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.⁵³

Rekomandime:

- *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të angazhohen seriozisht për plotësim-ndryshimin e ligjit kundër diskriminimit, në mënyrë që ligji të jetë i qartë dhe i zbatueshëm.*
- *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të rishqyrtojë memorandumit me nr. 122 të datës 2 prill 2013, të lidhur në mes të MPMS dhe KEK, duke hequr masat kufizuese për grup-moshën për punësim deri në 40 vjeç.*
- *Universiteti i Prishtinës të eliminojë përdorimin e standardeve të dyfishta për studentët e diplomuar në universitetet private dhe publike për studime master dhe doktoratë.*
- *Kuvendi i Kosovës dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës të zbatojnë rekomandimet e raportit të Avokatit të Popullit, datë 1 nëntor 2012, për ligjin 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.*
- *Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, të shqyrtojnë me kujdes punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, respektivisht formën dhe mënyrën e Privatizimit të ndërmarrjeve si dhe gjithë-përfshirjen e punëtorëve të legjitimuar për kompensimin e 20 % nga privatizimi.*
- *Qeveria e Kosovës, seriozisht të trajtojë problemet të cilat dalin nga mos zbatimi i ligjeve të cilat kanë hyrë në fuqi, me theks të veçantë në zbatimin e Ligjit nr. 04/L-092 për persona të verbër.*
- *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të përshpejtojë procedurën që Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik të shkojë sa më parë për miratim në Kuvendin e Kosovës.*
- *Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Arsimit, të krijojë kushte për qasje të lirë personave me aftësi të kufizuar, të cilët varen nga mjetet ndihmëse nëpër hapësira shkollore dhe institucionet tjera publike.*
- *Komuna e Prishtinës të ndërmerr të gjitha veprimet për lirimin e pronës publike për shfrytëzim të lirë të qytetarëve, për qasje të lirë edhe në prona private të tyre, duke e liruar hapësirën publike të uzurpuar kundërligjshëm te Tregu i Gjelbër në Prishtinë.*
- *Agjencia Kosovare e Pronës duhet t'i trajtojë bazuar në ligje pronat të cilat i ka nën administrim, ndërsa pronarët e atyre pronave në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.*

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës nenet 3, 24, 22 dhe 46; Ligji i Kundër Diskriminimit, nr. 2004/3; KEDNJ, neni 14 dhe neni 1 i Protokollit të KEDNJ.

2.4. E drejta për jetën

Jeta e njeriut mbrohet me ligj dhe është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁵⁴ Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht. Dënimi me vdekje është i ndaluar.

2.4.1. Vrasjet në Kosovë si dukuri shqetësuese

Sipas Zyrës për informim dhe marrëdhënie me publikun nga Policia e Kosovës, gjatë periudhës 1 janar 2013 deri më 30 nëntor 2013, në Kosovë janë kryer gjithsej 43 vrasje, ndërsa në tentativë kanë mbetur 151 vrasje.⁵⁵

Këta numra dëshmojnë se kohët e fundit është në rritje numri i vrasjeve dhe krimeve. Rastet e shpeshta të vrasjeve bëjnë që kjo dukuri të reflektojë në rritjen e brishtësisë të sigurisë publike në vend. Vrasjet vijnë si rezultat i shumë faktorëve: qërimi i hesapeve me qëllime kriminale, prania e numrit të madh armëve në popullatë, gjakmarrja etj.

2.4.2. Zvarritja e procedurave hetimore

Nga ankesat e trajtuara në IAP, për vitin 2013, vërehen një varg mangësish në trajtimin e rasteve të vdekjeve nga organet kompetente. Mungesa e hetimeve për rastet e paraqitura, zvarritjet e pajustificueshme të organeve të ndjekjes dhe të drejtësisë,⁵⁶ mosprocedimi i rasteve penale të mbyllja e tyre e pajustificueshme, përbën një shqetësim të arsyeshëm për qytetarët.⁵⁷

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 25.

⁵⁵ Informata të pranuar nga zyra për informim e Policisë së Kosovës, më 3 dhjetor 2013.

⁵⁶ IAP, rasti A. nr. 529/2009. Raport me Rekomandime. Pala nga Lipjani është ankuar për zvarritje të pajustificuar në hetimin e procedimit penal PP.nr. 712-1/2007, nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, për veprë penale të fatkeqësisë së komunikacionit me fatalitet/vdekjen e djalit të tij në vitin 2007. IAP ka komunikuar me drejtuesit e prokurorisë, me qëllim të përsheptimit dhe kryerjes së veprimeve hetimore dhe përfundimit të hetimeve, mirëpo pa sukses. Për këtë rast është hartuar edhe raport me rekomandim për Prokurorinë e Shtetit. IAP nuk ka pranuar përgjigje për moszbatimin e rekomandimeve në lidhje me rastin nga Prokuroria.

⁵⁷ IAP, rasti A. nr. 597/2012. Raport me Rekomandime. Pala nga Theranda ankohet për mosfillimin, pushimin apo mbylljen e procedurës së ndjekjes nga Prokuroria Themelore në Prizren. Avokati i Popullit, nga hetimet e zhvilluara në lidhje me këtë rast ka konstatuar se organi i prokurorisë së qarkut në Prizren, ka vendosur në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar, mos fillimin apo pushimin e procedimit penal për veprë penale "Fatkeqësisë së komunikacionit me fatalitet" me pasojë vdekjen, me shifrën PP. nr. 60/2005. Për këtë rast Avokati i Popullit ka hartuar raport me rekomandime për Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore në Prizren, për mosfillim të procedimit penal për veprë penale fatkeqësisë në komunikacion me pasojë vdekjen e një të mituri. Hetimet për këtë rast janë hapur nga Prokuroria e Qarkut në Prizren. Rekomandimi i Avokatit të Popullit ende nuk është zbatuar nga organet përgjegjëse.

Palët e dëmtuara, familjarët dhe të afërmit e viktimave, shpeshherë janë të zhgënjyer për neglizhencën, zvarritjen e procedurave, mosfrimin e informatave për rastin.⁵⁸ Anëtarët e familjes apo të afërmit e viktimës nuk përfshihen fare në procedurë dhe interesat e tyre në tërë procesin nuk merren parasysh fare. Kjo bie në ndesh drejtpërdrejtë me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sipas të cilave bëhet edhe interpretimi i të drejtave dhe lirive themelore në Republikën e Kosovës.⁵⁹ GJEDNJ shprehimisht kërkon që “*Megjithatë, në të gjitha çështjet i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë, deri në atë masë sa të sigurojë në proces interesat e tij apo të saj legjitime.*”⁶⁰

Sipas GJEDNJ, në mënyrë që të ketë përfitim sa më të efektshëm të drejtave të garantuara nga neni 2 i KEDNJ,⁶¹ autoritetet shtetërore duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura, me mjetet që kanë në dispozicion, për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë midis të tjerash, dëshmitarët okularë dhe provat e mjekësisë ligjore. Nëse është e nevojshme, duhet bërë autopsinë për të marrë të dhëna të plota, e cila do të mundësojë përshkrimin e dëmtimeve të shkaktuara, për të përcaktuar në mënyrë të besueshme shkaqet e vdekjes.⁶² Natyrisht, duhet pranuar fakti se mund të ketë pengesa dhe vështirësi që ndalojnë progresin në hetimin e një shtate të caktuar. Megjithatë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet ndaj hetimit në përgjithësi mund të konsiderohet thelbësore në ruajtjen e sigurisë publike.

Përveç detyrimit për të respektuar normat procedurale, autoritetet kompetente pas hetimit mbi shkaqet e vdekjes së dhunshme, kanë si qëllim fillimin e ndjekjes gjyqësore ose vënien në lëvizje të procedurave gjyqësore të detyrueshme në rastin e shkeljes së Konventës.

Qytetarëve duhet t’u sigurohen mjete të përshtatshme juridike për realizimin e kompensimit për dëmet e shkaktuara në rastet e dështimit të institucioneve publike kompetente për hetimin dhe ndriçimin e rasteve dhe zbulimin e kryerësve të veprave penale. Prandaj, deri në krijimin e mekanizmave të tillë ligjorë, sistemi juridik në Republikën e Kosovës, vazhdon të mos jetë në përputhshmëri me standarde të pranuar ndërkombëtare.

Rrjedhim i gjithë kësaj mbetet forcimi i kontrollit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mbikëqyrja dinamike e veprimtarisë së organeve të ndjekjes penale. Rritja e nivelit të përgjegjësisë disiplinore dhe penale e personave që shkelin ligjet në këtë fushë, do të ndikojë

⁵⁸ IAP, *rasti A. nr. 349/2013*. Pala ankohet lidhur me procedurat e hetimit të policisë rajonale në Mitrovicë, për rastin e vdekjes së djalit, në rrethana të panjohura. Për rastin që ka ndodhur në mars 2013, hetimet ende janë duke u zhvilluar nga policia rajonale në Mitrovicë. Rasti është duke u monitoruar nga IAP.

⁵⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 53: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

⁶⁰ Shih Manualin e të drejtave të njeriut, nr. 8. Një udhëzues për zbatimin e nenit 2 të KEDNJ, Douwe Korff E drejta për jetën., f. 44. *Guleç v. Turkey*, vendimi i 27 korrikut 1998, paragrafi 82, ku i ati i viktimës nuk u njoftua për vendimet për të mos proceduar ligjërisht; *Ogur v. Turkey*, Applicationno. 21594/93, 20.05.1999, , ku familja e viktimës nuk kishte qasje në hetimet dhe dokumentet e gjykatës; *Gal kundër Turqisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2000, par. 93. Në:<http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/public/materials/1057> (12.03.2014).

⁶¹ *KEDNJ*, neni 2, paragrafi 1: “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.” në:<http://www.echr.coe.int/Documents/Convention> (12.03.2014).

⁶² Sipas Manualit të drejtave të njeriut, nr. 8. Udhëzues për zbatimin e nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih në lidhje me autopsinë, për shembull *Salman kundër Turqisë*, vendimi i 27 qershorit 2000, paragrafi 106; në lidhje me dëshmitarët për shembull, *Tanrikulu v. Turqisë*, vendimi i dhomës së madhe i 8 korrikut 1999, paragrafi 109; në lidhje me provat e mjekësisë ligjore, për shembull, *Gul kundër Turqisë*, vendimi i 4 dhjetorit 2000, paragrafi. 89.

ndjeshëm në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe në rritjen e besimit të shoqërisë në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Rekomandime:

- *Policia e Kosovës të jetë më efektive për zbulimin e kryerësve të veprave penale-vrasjeve.*
- *Prokuroria të zhvillojë dhe përfundojë me kohë hetimet, të bëjë procedimin e tyre në gjykata brenda afatit të paraparë ligjor.*
- *Instituti Gjyqësor i Kosovës, të vazhdojë dhe intensifikojë mbajtjen e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, në lëmin penal.*

2.5. E drejta e lirisë dhe sigurisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29 thekson se “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj [...]*”.⁶³ Kjo e drejtë është në harmoni të plotë me instrumentet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, si KEDNJ⁶⁴ dhe Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike.⁶⁵

Aktet ndërkombëtare dhe ato vendore përcaktojnë se kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në rastet e parapara me ligj. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton se gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer ndonjë veprë penale dhe nëse përmbushet njëri prej këtyre kushteve: ekziston rreziku i ikjes së personit, rrezikut se personi mund të ndryshojë provat e veprës penale dhe rreziku se personi mund ta përsëris veprën penale.⁶⁶

IAP gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar 8 (tetë) ankesa, lidhur me shkeljen e kësaj të drejte.⁶⁷

Sado e shkurtër të jetë periudha kohore e paraburgimit, paraburgimi mund të caktohet vetëm në rastet kur një gjë e tillë është e domosdoshme. Vendimi për shqiptimin e një masë të tillë duhet të jetë i arsyetuar mirë, pasi kjo shërben për mbrojtje të lirisë individuale dhe mbrojtje të individit nga privimet arbitrare të lirisë nga autoritetet. Caktimi i paraburgimit me një vendim të arsyetuar ligjërish, është i nevojshëm dhe i rëndësishëm për të pandehurin për ushtrimin e të drejtës së tij për të kundërshtuar atë vendim.

Në disa prej vendimeve të veta GJEDNJ ka theksuar rëndësinë e së drejtës për liri dhe siguri, duke kërkuar që çdo privim nga liria të jetë në pajtim me qëllimin e nenit 5, që do të thotë në mbrojtjen e individit nga rreziku i arbitraritetit.⁶⁸

⁶³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

⁶⁴ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 5.

⁶⁵ Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, neni 9.

⁶⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 187.

⁶⁷ IAP, rastet: A. nr. 614/2013, A. nr.601/2013, A. nr.589/2013, A. nr.537/2013, A. nr.288/2013, A. nr.15/2013, A. nr.11/2013, A. nr.10/2013, A. nr.197/2013.

Ndërsa, sa i përket periudhës kohore të paraburgimit, GJEDNJ ka theksuar po ashtu se, pa marrë parasysh për çfarë periudhe kohore të paraburgimit bëhet fjalë, ajo duhet të arsyetohet bindshëm nga autoritetet.⁶⁹ Sipas GJEDNJ-së kjo duhet të ndodhë për faktin se vendimet e arsyetuara mirë shërbejnë për t'i treguar palës së është dëgjuar, i japin palës mundësinë që të parashtrijë ankesë dhe përfundimisht garantojnë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë.⁷⁰

Gjatë kësaj periudhe raportuese zyrtarët e IAP-së kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të vizitave në burgje, qendrat e paraburgimit dhe qendra të ndalimit në stacionet policore në Kosovë. Nga intervistat e realizuara me personat e ndaluar, në disa raste ka pasur pohime të shkeljes së të drejtës së lirisë, duke iu referuar vendimeve për paraburgim dhe zvarritjes jashtëligjore të procedurave gjyqësore deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.⁷¹

Nisur nga përvoja dhe ankesat e parashtruara në IAP, Avokati i Popullit, me gjithë ndjeshmërinë dhe specifikat e secilit rast veç e veç, ka dhënë rekomandimet e veta.

Rekomandime:

- *Institucionet kompetente në Republikën e Kosovës, bazuar në kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore, të mbrojnë të drejtën e çdo qytetari për liri dhe siguri, të garantuar me kushtetutë dhe ligjet në fuqi.*
- *Autoritetet përgjegjëse, respektivisht prokuroria dhe gjyqësori, të shqiptojnë masën e paraburgimit vetëm në ato raste kur kjo është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*

2.6. Ndalimi i torturës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se “Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar”.⁷² Ndalimi i torturës ose i veprimeve jo-njerëzore dhe degraduese është i mishëruar në të gjitha aktet vendore dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të zbatueshme në Republikën e Kosovës.⁷³

⁶⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Fedotov v. Russia”, Applicationno. 5140/02, 25.01.2006, në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"fulltext":\["fedotov v. russia"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-70756"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{) (12.12.2013).

⁶⁹ Po aty, “Belchev v. Bulgaria”, Applicationno. 39270/98, 08.07.2004, në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"fulltext":\["belchev v. bulgaria"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-61699"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{) (15.12.2013).

⁷⁰ Po aty, “Suominen v. Finland”, Applicationno. 37801/97, 24.07.2003, në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"fulltext":\["suominen v. finland"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-61178"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{) (16.12.2013).

⁷¹ IAP, A. nr. 197/2013, A. nr. 331/2013, Raport i brendshëm i IAP për vizitën në Qendrën Korrektuese në Lipjan, më 17.01.2013; Raport i brendshëm i IAP për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, më 19.04.2013.

⁷² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 27.

⁷³ Po aty, neni 22.

Termi torturë nënkupton çdo akt me anë të cilit ndaj një personi, me qëllim i shkaktohet dhimbje e madhe ose vuajtje fizike apo mendore. Respekti për integritetin fizik dhe mental përbën thelbin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

2.6.1. Monitorimi dhe vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria⁷⁴

Me qëllim të parandalimit të shkeljes së të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka vazhduar të bëjë monitorimin pa paralajmërim të vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria.

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka realizuar edhe vizita të rregullta dhe sistematike, një herë në muaj, në të gjitha vendet ku mbahen personat e ndaluar, për mbledhjen e informacioneve dhe vlerësimin sa më objektiv të gjendjes së përgjithshme të të drejtave të njeriut të personave të ndaluar dhe të privuar nga liria.

IAP ka vendosur kutitë e ankesave në të gjitha burgjet, qendrat e paraburgimit, qendrat e ndalimit, Institutin Special në Shtime, Qendrën Integruese të Shëndetit Mendor, Shtëpinë e fëmijëve në Shtime, si dhe Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore, po ashtu në Shtime.

2.6.2. Ankesat e personave të privuar nga liria

Gjatë vitit 2013 IAP ka realizuar 94 vizita monitoruese në këto qendra dhe ka intervistuar 172 persona, në qendrat e lartpërmendura.⁷⁵

Të gjithë personat në institucionet e lartshënuara mund të parashtrojnë ankesa nëpërmjet kutive të ankesave në të cilat kanë qasje vetëm përfaqësuesit e IAP. Por ankesat gjithashtu pranohen edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë intervistimit, duke i përcjellë drejtpërdrejt në adresë të IAP nëpërmjet postës, nëpërmjet thirrjeve telefonike, familjarëve, avokatëve apo edhe punëtorëve social të institucioneve.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, 49 ankesa janë regjistruar si raste për hetim, ndërsa të tjerat janë cilësuar të papranueshme. Avokati i Popullit, lidhur me pohimet për shkeljen e kësaj të drejte ka hapur një rast *ex-officio* kundër PK për përdorim të tepruar të

⁷⁴ Me termin “*vendet ku mbahen personat e privuar nga liria*” përfshihen të gjitha hapësirat në institucionet shtetërore si: burgjet, qendrat e paraburgimit, qendrat e ndalimit, stacionet policore, institucionet e shëndetit mendor, ku mbahen personat e privuar nga liria me vendim të një organi kompetent shtetëror.

⁷⁵ Vizitat realizohen, duke filluar me një takim me drejtuesin e institucionit apo zëvendësin e tij. Ky takim zhvillohet me qëllim të prezantimit të përfaqësuesve të IAP, qëllimit të vizitës, si dhe marrjes së informacioneve nga ana e tyre. Nën përcjelljen e një oficeri vazhdon vizita nëpër pavijone dhe hapja e kutive, të cilat janë të vendosura nga IAP dhe ku kanë qasje vetëm përfaqësuesit e IAP. Vizitat ndër të tjera, koncentrohen në të kuptuarit e problemeve që lidhen me shërbimet mjekësore, higjienën, ushqimin, arsimimin, masat disiplinore, sjelljen e stafit, etj. Përfaqësuesve të IAP, u sigurohet një ambient i veçantë për realizimin e intervistave pa prezencën e stafit të institucionit, si moment shumë i rëndësishëm gjatë realizimit të vizitës. Gjatë këtyre vizitave zhvillohen intervista edhe me punonjësit e institucionit të cilët janë përgjegjës për shërbime të ndryshme, si: punëtorët social, mjekët, kuzhinierët, etj. Vizita përmbyllet duke u takuar përsëri me drejtuesin e institucionit, duke bërë një përmbledhje nga vizita si dhe duke bërë rekomandime nëse janë të natyrës urgjente.

forcës.⁷⁶ Lidhur me rastin në fjalë, Avokati i Popullit ka pranuar një raport të detajuar nga Departamenti i Hetimeve i Policisë së Kosovës, përmes të cilit është njoftuar se më 23 tetor 2013, është bërë rekomandim për suspendimin e tre zyrtarëve policorë të përfshirë në këtë rast. Gjithashtu, Avokati i Popullit është njoftuar edhe nga Inspektorati Policor se ndaj tre zyrtarëve policorë është ngritur kallëzim penal, nën dyshimin e bazuar se kanë kryer veprën penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare” nga neni 198 i KPK dhe i njëjti është dërguar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Natyra e ankesave vazhdon të jetë pothuajse njëjtë nga viti në vit. Ato vazhdojnë të drejtohen kundër vendimeve të gjykatave, qoftë për zvarritje procedurale apo ankesa për “vendime të padrejta”, pasi konsiderojnë se nuk janë marrë parasysh provat nga gjykatat.

Ankesa janë drejtuar, po ashtu edhe kundër vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht (PLK) si dhe kundër administratës së burgut, pasi që të burgosurit nuk kanë qasje në dosjet e tyre. Në të gjitha këto raste, përfaqësuesit e IAP i njoftojnë të ndaluarit për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe i udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmarrin, në drejtim të realizimit të drejtës së tyre.

2.6.3. Lirimi me kusht

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), PLK ka kaluar në kompetencë të Këshillit Gjyqësor dhe është paraparë të ketë përbërje të re.⁷⁷ Pas një ndërprerje të punës për disa muaj, PLK ka mbajtur seancën e parë në nëntor 2013. Bazuar në praktikën e deritashme të punës së PLK, Avokati i Popullit ka bindjen se përbërja e PLK, me një anëtar të katërt zëvendësues mund të krijojë probleme, kjo pasi është vërejtur se mund të ketë nevojë për dy përfaqësues zëvendësues, në rast konflikti.

Gjatë periudhës raportuese, nga PLK janë liruar 46 persona, ndërsa nën mbikëqyrjen e Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK), kanë qenë 123 persona të liruar me kusht nga burgu, që kanë qenë raste të bartura nga vitet e kaluara.⁷⁸ Nga numri i përgjithshëm, gjatë vitit 2013, mbikëqyrjen e kanë mbaruar me sukses 96 persona, ndërsa 27 raste vazhdojnë të jenë nën mbikëqyrje të SHSK. SHSK ka pasur nën mbikëqyrje 24 persona të mitur, të cilët kanë qenë në Programin e Përkujdesjes pas Lirimit.

⁷⁶ IAP, rasti A. nr. 537/2013. Rasti është hapur bazuar në informatat e siguruar nga portali elektronik i lajmeve në “Telegraf”, 21 tetor 2013.

⁷⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nr.04/L-149, neni 122, paragrafi.2: ”Paneli për Lirim me Kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) prokuror i shtetit i deleguar nga Kryeprokurori i Shtetit; një (1) përfaqësues i MPB/ Policia e Kosovës, me njohuri dhe përvojë në fushat relevante profesionale (juridik, pedagogji, sociologji, psikologji) i deleguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. KGJK gjithashtu emëron edhe një (1) përfaqësues të deleguar nga Rektorati/ Fakulteti Juridik, si anëtar të katërt me njohuri dhe përvojë nga fusha përkatëse profesionale, i cili përzgjidhet për të qenë në gatishmëri për të vendosur në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit në një çështje të caktuar apo zëvendësimi në mungesë të ndonjë anëtari tjetër.”

⁷⁸ Po aty, neni 121, paragrafi 2: “Personi i dënuar ka të drejtë t’i paraqes lutje për lirim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin.”

2.6.4. Kujdesi shëndetësor

Iniciativa për themelimin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), e filluar qysh në vitin 2002, është në finalizim e sipër. Me përkrahjen e Bashkimit Evropian (BE), ka filluar ndërtimi i objektit për IPFK, i cili pritet të përfundojë në mars 2014 dhe pastaj do të bëhet edhe bartja e stafit, i cili tani më është përzgjedhur. IPFK ka kapacitet të vendosë 36 pacientë. Ky kapacitet pritet të rritet edhe për dymbëdhjetë (12), në një të ardhme të afërt. Për mbarëvajtje të punës së Institutit, Ministria e Drejtësisë (MD) ka caktuar njëzet (20) oficerë korrektues, të cilët do të kujdesen dhe janë përgjegjës për sigurinë.

Avokati i Popullit në vazhdimësi ka rekomanduar që shërbimi shëndetësor i burgjeve të transferohet nga MD në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), në mënyrë që të ofrohet një shërbim më efikas, prandaj edhe e përshëndet nismën në këtë drejtim. Në qershor të vitit 2013, MD dhe MSH kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe pritet fillimi i funksionimit të saj.⁷⁹

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Shëndetësi,⁸⁰ si dhe bazuar në marrëveshjen e lartpërmendur, në periudhën raportuese, ka filluar hartimi i një Udhëzimi Administrativ për shëndetësinë në burgje, i cili do të përcaktojë mënyrën e funksionimit, organizimit dhe ofrimit të kujdesit shëndetësor për të burgosurit, bazuar në Ligjin për Shëndetësi, Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Kosovës, Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe Rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.⁸¹

Një shqetësim për t'u theksuar përbën situata e repartit apo dhomës në spitalet civile të dedikuara për të burgosurit, siç është ajo në Gjilan e cila është jashtë funksionit dhe nuk i plotëson as kushtet elementare për trajtim dhe as qëndrim të stafit kujdestar. Po ashtu, edhe në Prishtinë edhe pse është identifikuar hapësira, për shkak të procedurave të prokurimit, ende nuk është përzgjedhur kompania që do të kryejë punimet.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë epidemi në burgjet apo vendet e ndalimit, por janë evidentuar dhe trajtuar 5 raste me *tuberkulozë* dhe 4 raste me *hepatit*. Pajisja e burgjeve me barna ka qenë e mirë, ndërsa lista esenciale përfshin 118 artikuj.⁸²

Gjatë kësaj periudhe raportuese, ka pasur 3 vdekje (që kanë ndodhur në spitalet civile, Pejë, Gjilan, Prishtinë), 15 vetëlëndime, 62 lëndime trupore, 4 tentim-vetëvrasje dhe 45 greva urie, duke përfshirë grevën masive, që kishte për qëllim shtyrjen e procesit për nxjerrjen e Ligjit mbi Amnistinë.

⁷⁹ Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MD dhe MSH, Nr. 05-3527, e datës 13.06.2013.

⁸⁰ *Ligji për Shëndetësi, nr. 04/L-125.*

⁸¹ IAP është përfshirë në grupin e punës për hartimin e aktit nënligjor – Rregullores për funksionimin e Departamentit për shërbime shëndetësore të burgjeve të Kosovës.

⁸² Intervistë me z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Sistemit Shëndetësor të Burgjeve, dhjetor 2013.

2.6.5. Mbipopullimi

Mbipopullimi ka vazhduar të jetë shqetësim edhe gjatë vitit 2013, sidomos në sezonin e dimrit. Në periudhën raportuese, gjendja e popullimit të këtyre vendeve ka qenë si në vijim:

- Qendra Korrektuese në Dubravë (QKD), që ka kapacitet 1151 vende, ndërsa në të ka pasur të vendosur 971 person;
- Qendra Korrektuese në Lipjan (QKL), në pavijonin ku janë të vendosur të dënuarit për vepra kundërvajtjeje, kanë qenë të vendosur 69 persona, përderisa kjo pjesë ka kapacitet vetëm për 60 persona. Në pavijonin e femrave me kapacitet prej 60 vendeve, kanë qenë të vendosura 58 të burgosura;
- Qendra Korrektuese në Smrekovicë (QKS) ka dy pavijone. Njëri pavijon, është ku janë të vendosur të burgosurit me privilegje të caktuara, ka kapacitet prej 200 vendesh, sa edhe janë të vendosur, ndërsa pavijoni i dhomës së pranimit ka kapacitet prej 16 vendesh, ndërsa janë të vendosur 12 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Lipjan (QPL), ka kapacitet prej 170 vendeve, ndërsa ka të vendosur 179 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë, me kapacitet prej 55 vendesh, ka të vendosur 26 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Prizren ka kapacitet prej 92 vendesh, ndërsa ka të vendosur 100 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Pejë ka kapacitet prej 80 vendesh, plus 6 në vetmi, ndërsa ka të vendosur 87 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Gjilan ka kapacitet prej 88 vendesh, ndërsa ka të vendosur 82 persona;
- Qendra e Paraburgimit në Prishtinë ka kapacitet prej 65 vendesh, ndërsa në të janë vendosur 68 persona.⁸³

Lëshimi në punë i Burgut të Sigurisë së Lartë në Gërdoc (Podujevë),⁸⁴ fillimi i ndërtimit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, si dhe ndërtimit të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, dukshëm do të zbutë mbipopullimin dhe njëkohësisht do të mundësojë një sistemim të të burgosurve, ashtu si e parasheh ligji. Gjithashtu, renovime janë duke u kryer edhe në Dubravë.

Në Institutin Special në Shtime, ka pasur progres në drejtim të renovimit të objektit dhe të infrastrukturës fizike në përgjithësi si dhe furnizimit me shtrojë e mbulojë, sigurimit të veshmbathjes, etj. por vazhdon të mbetet sfidë, mungesa e stafit profesional dhe mos trajnimi i vazhdueshëm i stafit.⁸⁵

⁸³ Statistikat e siguruar nga udhëheqësit e institucioneve, gjendja 20 dhjetor 2013.

⁸⁴ Hapja e Burgut të Sigurisë së Lartë është bërë më 18 dhjetor 2013 dhe ka kapacitet për vendosjen e mbi treqind (300) të burgosurve, që janë të dënuar me mbi pesëmbëdhjetë (15) vite burg.

⁸⁵ IAP ka realizuar vizitën e fundit në dhjetor 2013.

2.6.6. Bashkëpunimi i IAP-së me institucionet përgjegjëse

Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar bashkëpunimi i rregullt i IAP edhe me Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), udhëheqjet e institucioneve të lartcekura dhe institucioneve relevante të lëmisë, të cilat në vazhdimësi janë njoftuar me natyrën e ankesave të burgosurve si dhe të gjetjeve nga monitorimet e kryera, si: mbipopullimi, zgjatja e tepërt e paraburgimeve nga ana e gjykatave, ushqimi, shëndetësia, shfrytëzimi i beneficioneve, lirimi me kusht, transferet nga njëra qendër në tjetrën, si dhe ekstradimet e të burgosurve nga një shtet në tjetrin.⁸⁶

Në përgjithësi, bashkëpunimi me këto institucione ka qenë korrekt dhe i kënaqshëm, pasi që edhe qëllimi i monitorimit është vlerësimi i respektimit të drejtave të njeriut, si dhe parandalimi i cenimit të drejtave të njeriut, përmirësimi i shërbimeve dhe rritja e transparencës së institucioneve.

Nisur nga informacionet dhe të gjeturat gjatë vizitave të shumta në të gjitha këto institucione, Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në këto institucione, e konsideron të nevojshme që për Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të japë rekomandime.

Rekomandime:

- ***Të ofrohen trajnime për stafin e institucioneve ku mbahen personat e ndaluar (për punëtorët socialë edhe stafin tjetër), me qëllim të zgjerimit të njohurive të tyre për të drejtat e njeriut;***
- ***Të forcohet bashkëpunimi i PLK me stafin e SHKK dhe SHSK, për të ofruar shërbime më të mira, përmes organizimit të takimeve të ndryshme punuese, tryezave dhe seminare të përbashkëta;***
- ***Të bëhet kategorizimi i të ndaluarve, sipas natyrës së veprës, rrezikshmërisë dhe moshës.***
- ***Të njoftohen të ndaluarit për të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe për mënyrën e parashtrimit të ankesave;***
- ***Stafit mjekësor dhe pjesës tjetër të stafit, t'u paguhen shtesat për rrezikshmëri, si dhe të krijohen kushte më të mira për punë;***
- ***Të rritet numri i punëtorëve social si dhe të ofrohen trajnime të nevojshme për ta;***
- ***Të rritet numri i stafit profesional për Institutin Special në Shtime;***

⁸⁶ Intervistë me z. Arbër Gegaj, Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, në Ministrinë e Drejtësisë, dhjetor 2013. Marrëveshje për ekstradim deri në këtë moment janë të lidhura midis Republikës së Kosovës dhe: Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë, Turqisë, Kroacisë, Italisë, Belgjikës, Zvicrës, dhe është duke u punuar edhe për nënshkrim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Hungarinë, Malin e Zi dhe Republikën Federale të Gjermanisë.

- *Të lejohet paraaja e xhepit për rezidentët, siç është e paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2007.*

2.6.7. Grupi Punues për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës⁸⁷

Grupi Punues ka vazhduar bashkëpunimin edhe në këtë vit raportues, duke realizuar monitorime të përbashkëta, tryeza për promovimin e punës si dhe ka mbajtur takime të shumta me qëllim të koordinimit të punës, të cilat janë realizuar në mbështetje të OSBE, Zyrës së Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe Këshillit të Evropës (KE). Takimet janë zhvilluar me qëllim të përcaktimit të punëve, gjetjes së fondeve, zhvillimit të aktiviteteve, mbajtjes së trajnimeve, seminareve e konferencave, lobimit, avokimit, etj.

Me mbështetjen e Qendrës për Kërkime dhe Rehabilitim të Viktimave të Torturës (RCT) nga Danimarka dhe Institutit të Shoqërisë së Hapur, *Grupi Punues*, ka hartuar Manualin e monitorimit të institucioneve korrektuese dhe qendrave të ndalimit, i cili i është përshtatur kontekstit dhe praktikave Kosovare.⁸⁸

Më 26 prill dhe 31 maj 2013, në kuadër të mandatit të *Grupit Punues*, janë realizuar vizitat në QKD, QKL dhe QPL. Vizitat kishin për qëllim vlerësimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave të privuar nga liria, duke ngritur transparencën dhe përgjegjësinë e vendeve të privimit të lirisë, duke rritur kështu besueshmërinë publike në këto institucione.⁸⁹

Për punën dhe aktivitetet e QKD dhe QKL e QPL, *Grupi Punues* është informuar nga drejtorët e Qendrave që janë monitoruar. Përveç kushteve të përgjithshme në të cilat mbahen personat e ndaluar, *Grupi Punues* ka realizuar intervista individuale dhe grupe me të ndaluarit, për të kuptuar trajtimin e tyre nga ana e stafit.

Të gjeturat e monitorimeve të zhvilluara u janë përcjellë për komente drejtorëve të burgjeve dhe MD. Gjithashtu, të njëjtat janë prezantuar në konferencën e organizuar në javën kundër torturës.

Grupi Punues ka vazhduar dhe do të vazhdojë bashkëpunimin me OSBE, e cila ka mbështetur publikimin e një fletëpalosje për NPM, si dhe janë duke zhvilluar një projekt me Komitetin e Helsinkit të Holandës, për një periudhë dyvjeçare, për monitorimin e vendeve ku mbahen të miturit.

⁸⁷ Më 10 maj 2011, IAP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me dy organizata të shoqërisë civile vendore QKRMT dhe KMDLNI, të cilat përveç të tjerash merren edhe me monitorimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria, për krijimin e NPM.

⁸⁸ Shih në: www.krct.org

⁸⁹ Vizitat realizohen duke filluar me një takim me drejtuesin e institucionit apo zëvendësin e tij. Ky takim zhvillohet me qëllim të prezantimit të *Grupit Punues*, qëllimit të vizitës, si dhe marrjes së informacioneve nga ana e tyre. Nën përcjelljen e një oficeri vazhdon vizita nëpër pavijone, spital, kuzhinë, shkollë, depo, banja dhe në të gjithë hapësirën që monitorohet. Vizitat ndër të tjera, koncentrohen në të kuptuarit e problemeve që kanë të bëjnë me shërbimet mjekësore, higjienën, ushqimin, arsimimin, masat disiplinore, sjelljen e stafit etj. Vizita përmbyllet duke u takuar përsëri me drejtuesin e institucionit, duke bërë një përmbledhje të të gjeturave nga monitorimi si dhe duke bërë rekomandime për ndonjë rast që mund të jetë i natyrës urgjente.

Më 17 dhjetor 2013, janë publikuar të gjeturat preliminare të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara mendore, të cilat u prezantuan nga QKRMT, ku gjithashtu ishin të përfshira edhe të gjeturat e *Grupit Punues*.

2.7. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, IAP ka për obligim që ta përcjellë gjendjen dhe t'i mbrojë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave fizikë a juridikë, kur ato kufizohen, cenohen apo shkelen nga institucionet e tjera në Republikën e Kosovës.

IAP, vazhdimisht ka raportuar për raste të shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në raportet e mëhershme vjetore, Avokati Popullit vazhdimisht ka shprehur shqetësimet tij lidhur me dështimin e sistemit gjyqësor për t'i trajtuar pa zvarritje rastet e paraqitura.

Angazhimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, përkitazi me këtë temë, gjatë këtij viti ka konsistuar në tre drejtime: a) identifikimi i shkeljeve dhe i problemeve, lidhur me zbatimin e kësaj të drejte; b) parandalimi i shkaqeve që ndikojnë në cenimin e kësaj të drejte dhe c) bashkëpunimi me organet gjyqësore dhe institucionet e tjera përgjegjëse shtetërore kompetente për trajtimin e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese.

Rastet e shqyrtuara për shkelje të së drejtës për gjykim të paanshëm, kanë nxjerrë në pah problemin e zbatimit të ligjit, respektivisht të cenimit të kësaj të drejte sipas kuptimit të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ: mosrespektim i afateve ligjore për zgjidhjen e rasteve, moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion dhe parashtresave të tjera.

Kjo sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të gjyqësorit, në marrëdhëniet e kësaj të fundit me qytetarët. Këto vështirësi dhe pengesa rriten edhe më shumë kur kihet parasysh edhe fakti se qytetarët, nga ana tjetër, nuk ka njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtat e tyre për procedurat që zhvillohen nëpër gjykata.

Në sferën e gjyqësorit, gjatë këtij viti, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, numri më i madh i ankesave të paraqitura ka të bëjë me shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht të zvarritjeve të procedurave. *Zvarritja procedurale* i referohet periudhës kohore nga momenti i fillimit deri në momentin e përfundimit të procedurave gjyqësore në një rast të caktuar, e cila i tejkalon përcaktimet ligjore të afatizimit, pa ndonjë arsytim racional.

Edhe pse në këtë drejtim janë ndërmarrë nisma të panumërta legjislative dhe administrative për mënjanimin e këtyre problemeve gjatë viteve, ato vazhdojnë të mbeten të njëjtat, madje edhe me tendencë përkeqësimi.

Shkaqet e zvarritjeve procedurale janë të natyrave të ndryshme, si: numri i madh lëndëve të grumbulluara që presin për zgjidhje, burime të pamjaftueshme njerëzore në gjykata, problemet me menaxhimin e burimeve brenda gjykatave, procedura ligjore joefikase,

përgatitja e pamjaftueshme ose joadekuate të rasteve, marrja e deklaratave të dëshmitarëve me vonesë, mungesa e ekspertizës,⁹⁰ mungesa e përfaqësimit ligjor etj.

Njëkohësisht, ka shumë mënyra në të cilat vetë palët mund të kontribuojnë në vonesa. Kjo ndodhë kryesisht në fazën përgatitore, por mund të ndodhë edhe gjatë shqyrtimit të rastit, kryesisht për shkak të mosinformimit përkatës nga vetë gjykatat apo institucionet përgjegjëse, mosnjohjes së procedurave etj.

Megjithëse të gjithë protagonistët në sistemin gjyqësor e kanë pranuar me kohë rëndësinë e reduktimit të vonesave, IAP vazhdimisht është i detyruar që me anë të shkresave t'u drejtohet institucioneve gjyqësore, duke kërkuar informata mbi procedurat për rastin në fjalë, dhe në shumë raste fatkeqësisht është i detyruar të konstatojë zvarritje të paarsyeshme.⁹¹

Jo rrallë herë ndodhë që, edhe përkundër njoftimeve, rekomandimeve, kërkesave urgjente (letrave përkujtuese) shtesë, etj., institucionet nuk i përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit, duke mos i dërguar informatat e kërkuara, ndonjëherë madje as të dhëna të pjesshme, të cilat janë relevante për përpunimin dhe analizën e rastit.⁹² Në këtë mënyrë, me mospërgjigjen, jo vetëm që pengohet puna dhe funksionimi i IAP-së, por përfundimisht humbet besimi dhe shpresa tek qytetarët për një shtet ligjor.

2.7.1. Efektet e shkaktuara nga zvarritjet procedurale

Efektet e shkaktuara për shkak të zvarritjeve procedurale në gjyqësor përcillen me stres dhe ankth për viktimat e krimin, të akuzuarit dhe për familjen e tyre. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit, jo vetëm të gjyqësorit, por edhe të shtetit në përgjithësi, për të ofruar drejtësi.

Një humbje e tillë e besimit për pasojë logjike dhe të natyrshme ka përpjekjen e individëve dhe grupeve të prekura për të marrë drejtësinë në duar të veta, gjë e cila fatkeqësisht është duke ndodhur, sado që rastet janë të rralla. Mirëpo, edhe kjo pjesë e besimit të mbetur në drejtësinë shoqërore e institucionale, që përfaqësohet dhe është obligim thelbor i gjyqësorit do të shuhet me kalimin e kohës. Prandaj, në këtë situatë, ndërmarrja e masave të menjëhershme, pa hezitime dhe pa vonesa, është një domosdoshmëri e shkallës më të lartë. Kjo është përgjegjësia dhe obligimi parësor i një shteti, që nuk duron arsytetime. Edhe sipas kuptimit të vendimeve të GJEDNJ-së, në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,

⁹⁰ IAP, rasti A. nr. 259/2013. Gjatë monitorimit të një prej seancave gjyqësore për këtë rast, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, IAP vërejtë se mungesa e ekspertit ligjor të propozuar nga pala paditëse (pasojë e neglizhencës), bëri që të pamundësohet zhvillimi i mëtutjeshëm i seancës gjyqësore, me ç'rast gjykata që e detyruar të shtyjë seancën për një ditë tjetër.

⁹¹ IAP, rasti A. nr. 229/2013. Ankesa është paraqitur në IAP për 'zvarritje procedurale' ndaj Dhomën së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

⁹² IAP, rasti A. nr. 400/2013. Ankesa është paraqitur për zvarritje procedurale ndaj Gjykatës Themelore të Prishtinës. IAP, pas konstatimit të shkeljes, megjithëse, ka dërguar dy shkresa të njëpasnjëshme, nuk ka marrë përgjigje deri më tani.

përgjegjësia për procedurat e zhvilluara në mënyrë të ngadaltë bie, kryekëput mbi organet gjyqësore.”⁹³

2.7.2. Sfidat dhe rekomandimet

Numri i ankesave të hetuara në IAP për shkelje të kësaj të drejte, gjatë vitit 2013, është 143. Nga ky numër, shihet se zbatimi i kësaj të drejte mbetet problem shqetësues dhe, përbën një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Edhe më shqetësues mbetet fakti se për shkeljet e tilla, madje edhe kur ato janë objektive dhe të pamohueshme, dhe përcillen me pasoja të rënda për qytetarët, nuk ka denoncime dhe marrje në përgjegjësi të personave përgjegjës nga institucionet përgjegjëse dhe kompetente. Çështja e zvarritjes procedurale për vet gjyqësorin ngre çështje të performancës, llogaridhënies dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme, si dhe informatat, dëshmitë e siguruara, kahen e zhvillimeve aktuale, sidomos në gjyqësor, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandime si në vijim.

Rekomandime:

- *Të ndërmerren të gjitha masat dhe veprimet ligjore për zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara, përmes miratimit të një programi të reduktimit të lëndëve të pazgjidhura, i cili duhet të jetë i zbatueshëm dhe lehtë i menaxhueshëm.*
- *Rritja e numrit të gjyqtarëve si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë ligjorë, si dhe personelit tjetër administrativ, për të rritur efikasitetin dhe eficiencën e punës së përditshme të gjyqtarëve.*

2.8. Të drejtat e të akuzuarit

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale të përcaktuara me Kushtetutë,⁹⁴ Kodin e Procedurës Penale,⁹⁵ si dhe instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.⁹⁶

IAP ka vazhduar të pranojë ankesa të natyrave të ndryshme të drejtuara kundër vendimeve të gjykatave, qoftë për zvarritje procedurale, për “vendime të padrejta”, për shkak të pakënaqësisë me mbrojtjen e ofruar, qoftë nga avokatet e caktuar sipas detyrës zyrtare apo

⁹³Rasti, *Tomasi k. Francës*, -241-A 27.8.1992, “Një rend publik evropian: Vendime të zgjedhura të Gjykatë Evropiane të të drejtave të njeriut”. Vëllimi I, (Tiranë, 2001), f. 189. Rasti kundër gjykatës së Kasacionit në Francë.

⁹⁴ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 30.

⁹⁵ *Kodi i Procedurës Penale*, nr. 04/L-123.

⁹⁶ *Po aty*, neni 22.

edhe ata që i kanë zgjedhur vet,⁹⁷ pamundësisë së realizimit të vizitave në familje, trajtimit shëndetësor, etj.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar nëntëdhjetë e nëntë (99) ankesa, me pretendimin se është shkelur e drejta e të akuzuarit, duke mos përfshirë këtu shkeljen për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që shpesh ndërliidhen në mes vete. Njëzet e tetë (28) prej tyre janë hapur për hetime në IAP, ndërsa të tjerat janë cilësuar si të papranueshme.

Për shkak të zvarritjeve të procedurave për vendosje në raste penale nga ana e gjykatave shumë personave të privuar nga liria iu vazhdohet paraburgimi pa dhënë ndonjë arsye të bazuar ligjore dhe gjatë monitorimeve të kryera në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfaqësuesit e AP kanë vërejtur se qendrat e lartpërmendura janë evidentuar raste kur akuzuarit mbahen në paraburgim jashtë afateve ligjore dhe në kushte jo shumë përshtatshme.⁹⁸

Për evitimin e kësaj shtate, sipas informacioneve të marra nga u.d. i Komisarit të SHKK, kanë filluar punimet për ndërtimin e hapësirave të reja apo renovimin e hapësirave ekzistuese për mbajtjen e personave të privuar nga liria.⁹⁹ Kjo do të mundësojë zvogëlimin e numrit të vendosurve në qendrat e mbipopulluara, por edhe kategorizimin e tyre sipas natyrës së veprës, moshës etj.

Avokati i Popullit në këto raste ka publikuar raport dhe rekomandime, rastet e tilla që përsëriten vazhdimisht, paraqesin jo vetëm shqetësim për Avokatin e Popullit, por para së gjithash cenim të rëndë të të drejtave të njeriut.¹⁰⁰

Për shkak të zvarritjeve të procedurave për vendosje në raste penale nga ana e gjykatave shumë personave të privuar nga liria u vazhdohet paraburgimi pa dhënë ndonjë arsye të bazuar ligjore dhe gjatë monitorimeve të kryera në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfaqësuesit e AP kanë vërejtur se qendrat e lartpërmendura janë evidentuar raste kur

⁹⁷ IAP përmes postës elektronike, është njoftuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës se gjatë vitit 2013, Komisioni Disiplinor i Hetimeve ka pranuar 94 ankesa, prej tyre, 1 është hedhë poshtë si e pasafatshme; 4 kanë qenë jashtë kompetence; për 11 ka pushuar procedura; 54 janë refuzuar dhe për 24 ankesa janë duke u zhvilluar procedura disiplinore, dhjetor 2013.

⁹⁸ IAP gjatë periudhës raportuese ka realizuar vizita mujore pa paralajmërim në qendrat e ndalimit, paraburgimit dhe burgjeve duke kryer nëntëdhjetë e katër (94) vizita monitoruese dhe intervistuar njëqind e shtatëdhjetë e dy (172) të ndaluar. AP në këto qendra ka të vendosura kutit e ankesave në të cilat ka qasje vetëm AP në të cilat kuti është i shënuar numri i telefonit, falas.

⁹⁹ Intervistë me u.d. së Komisarit të SHKK, z. Shemsi Hajrizi, dhjetor 2013. QP Gjilan, si dhe për QP në Prishtinë. Gjithashtu, ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë, ku pritet të transferohen mbi treqind (300) të dënuar me rrezikshmëri të lartë, që janë të dënuar me mbi pesëmbëdhjetë (15) vite heqje lirie. Burgu i Sigurisë së Lartë është bërë më 18 dhjetor 2013.

¹⁰⁰ IAP, *rasti A. nr. 305/2013*. Pala ankohet për vazhdimin e pandërprerë të paraburgimit dhe zvarritjes së procedurës nga ana e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe kohëzgjatjen e paraburgimit. Rasti ka filluar të procedohet për veprën penale më 12 maj 2009 dhe, në bazë të obligimit të gjykatës për të vendosur në lidhje me vazhdimin apo ndërprerjen e paraburgimit, nga maji 2009 e deri në nëntor të vitit 2013, janë nxjerrë njëzet e nëntë 29 aktvendime për vazhdimin e paraburgimit. Avokati i Popullit, më 30 tetor 2013, ka publikuar raport me rekomandime, duke i rekomanduar Gjykatës Themelore të Prishtinës, marrjen e masave të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritore, pa zvarritje të mëtejshme; dhe dorëzimin e aktgjykimit për të gjitha palët brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim me KPPK dhe kërkesës sipas kuptimit të nenit 6 të KEDNJ-së.

akuzuarit mbahen në paraburgim jashtë afateve ligjore dhe në kushte jo shumë përshtatshme.¹⁰¹

Në njërin nga rastet e paraqitura në IAP gjatë periudhës raportuese, palët ankohen për cenimin dhe kufizimin e të drejtës për mbrojtje efektive ligjore. Ata konsiderojnë se në procesin gjyqësor që po zhvillohet kundër tyre, Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), përmes Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, respektivisht neni 3, paragrafi 3.2, pika (a), cenon të drejtat e tyre si të akuzuar. Ata pohojnë se norma e lartcekur e Rregullores në fjalë, është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit mbi Avokatinë dhe shkel rëndë nenin 30 – Të Drejtat e Akuzuarit dhe nenin 31 – E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që garantojnë të drejtën e përzgjedhjes së avokatit, për të pasur një gjykim të drejtë dhe të barabartë. Ankuesit pretendojnë që janë të privuar nga e drejta e zgjedhjes së avokatit mbrojtës vendor ose ndërkombëtar, sipas përzgjedhjes së tyre, të cilën e kanë të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.¹⁰²

Avokati i Popullit, më 12.4.2012, lidhur me çështjen e ankuesve paraqiti deklaratën në mediat publike, me konstatimin se masa e reciprocitetit, e vendosur nga OAK, për licencimin e avokatëve të huaj që angazhohen në Republikën e Kosovës, përbën shkelje kushtetuese dhe ligjore.¹⁰³ Kjo për arsye se Ligji për Avokatinë Nr. 03/L-117, në nenin 6, për regjistrimin e avokatëve mbrojtës të huaj në regjistrin e avokatëve në Republikën e Kosovës, nuk parasheh kurrfarë kufizimi. Avokati i Popullit, bazuar në analizën ligjore pas konstatimit për shkelje të të drejtave të njeriut në dëm të ankuesve nga OAK, bazuar në kompetencat ligjore dhe kushtetuese, më 11 shkurt 2013, i paraqiti një Raport Special Qeverisë së Republikës së Kosovës, me rekomandim për ndryshimin e dispozitave të Rregullores për licencimin e avokatëve të huaj. Me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të ardhmen, Avokati i Popullit bëri kërkesën shprehimisht që Qeveria e Republikës së Kosovës të pezullojë, për afat të pacaktuar, më së voni deri në momentin e angazhimit të prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë në gjyqësorin e Republikës së Kosovës, ekzekutimin e nenit 3, paragrafi 3.2, pika (a) të Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj, si të papajftueshëm me nenin 6 të Ligjit për Avokatinë, nenin 30 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 paragrafi 3, pika c, të KEDNJ.¹⁰⁴

Rekomandime:

- *Gjykatat të shqiptojnë masa tjera alternative, e vetëm në raste të domosdoshme dhe ligjërish të bazuara paraburgimin, si mjet për sigurimin e të akuzuarit.*
- *Oda e Avokatëve të Kosovës, të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare (exofficio) dhe të rregullojë qartë*

¹⁰¹ IAP gjatë periudhës raportuese ka realizuar vizita mujore pa paralajmërim në qendrat e ndalimit, paraburgimit dhe burgjeve duke kryer nëntëdhjetë e katër (94) vizita monitoruese dhe intervistuar njëqind e shtatëdhjetë e dy (172) të ndaluar. AP në këto qendra ka të vendosura kutit e ankesave në të cilat ka qasje vetëm AP në të cilat kuti është i shënuar numri i telefonit, falas.

¹⁰² IAP, rasti A. nr. 12/2013. Ankuesit pretendonin se nuk janë të barabartë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se kishte shkelje të nenit 6 të Ligjit për Avokatinë.

¹⁰³ Kosova sot, 12 prill 2012, f. 5.

¹⁰⁴ IAP, rasti A. nr. 12/2013, Raport Special nr.1. Rekomandim drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me rastin.

dhe pa mëdyshje sigurimin e respektimit të të drejtave të klientëve të avokatit, e në raste të dëmtimit lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit, hetimin dhe marrjen e masave disiplinore.

2.9. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër

Parimi *ne bis in idem*, përkatësisht parimi se asnjë person nuk duhet të gjykohet dy herë për të njëjtën vepër, është parim i përgjithshëm dhe themelor në një shtet ligjor. Ky parim është mishëruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹⁰⁵ si dhe në instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.¹⁰⁶

Qëllimi i parimit *ne bis in idem* është që të mbrojë personin nga pushteti arbitrar i shtetit dhe për të parandaluar shtetin që të dënojë personat dy herë për të njëjtën vepër. Kriteri “*e njëjta vepër*” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar një herë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, IAP nuk ka konstatuar ndonjë shkelje të këtij parimi. Prandaj, Avokati i Popullit është i inkurajuar me faktin se parimi *ne bis in idem* është trajtuar në mënyrë të drejtë në sistemin ligjor dhe në zbatimin e tij në praktikë.

2.10. E drejta për mjete juridike

Të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative e ka çdo subjekt i së drejtës. Secili person, nëse cenohen të drejtat dhe interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj, e shfrytëzon këtë të drejtë.

E drejta për mjete juridike, qytetarëve u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁰⁷ në frymën e nenit 6 të KEDNJ, si dhe me legjislacionin penal, civil dhe administrativ vendor.

Gjatë vitit 2013, përkitazi me vendimet gjyqësore dhe administrative lidhur me të drejtën për mjete juridike, IAP ka hetuar 66 raste. Në bazë të analizës së ankesave të paraqitura, kundër gjyqësorit dhe prokurorisë janë të paraqitura 28 raste, ministrive 12 raste, komunave 10 raste, Universitetit të Prishtinës 4 raste, Agjencisë Kosovare të Pronave 3 raste, Agjencisë Kosovare të Privatizimit 3 raste, KEK-ut 3 raste, Qendrës për Punë Sociale 2 raste dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) 1 rast. Përkitazi me këto raste, IAP u është drejtuar

¹⁰⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 34.

¹⁰⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, neni 4.1 i Protokollit nr. 7: “Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit shtet, për një vepër për të cilën ai është deklaruar më parë i pafajshëm ose dënuar, me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të po atij shteti”. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14.7, “Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet për një vepër për të cilën ai është dënuar ose liruar njëherë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi”.

¹⁰⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32: “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

autoriteteve përkatëse, nga të cilat ka kërkuar marrjen e veprimeve të duhura, të parapara me ligj.

Ankesat lidhur me mjetet juridike, kryesisht janë të paraqitura kundër gjykatave të të gjitha niveleve, si dhe DHPGJS, lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë me zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore deri në marrjen e vendimit gjyqësor pas ushtrimit të mjeteve juridike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuara me dispozita ligjore. Ankesat e qytetarëve drejtuar ministrive, gjykatave, komunave për mjete juridike përfshijnë çështje të fushave të ndryshme: marrëdhënia e punës, çështjet pronësore, strehimi, mosrespektimi i vendimeve të nxjerra nga vet organi etj.

Ankesa të konsiderueshme të qytetarëve, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre, me pretendimin se u janë shkelur të drejtat, janë kërkesa që IAP të hartojë si ankesa, kërkesa dhe padi. Gjithashtu, ka pasur kërkesa edhe për përfaqësimin e tyre në kontestet pranë institucioneve kompetente. Kjo është si rezultat i mosnjohjes së kompetencave të Avokatit të Popullit, por edhe rezultat i besimit të qytetarëve ndaj këtij institucioni.

Shqetësues për Avokatin e Popullit është mosbesimi i qytetarëve në punën dhe drejtësinë e ofruar nga institucionet kompetente e sidomos të gjykatave në të gjitha nivelet. Avokati i Popullit konstaton se, për të evituar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe për të qenë mjetet juridike efikase dhe efektive, duhet patjetër të respektohen afatet ligjore nga institucionet kompetente, lidhur me lëndën.

Rekomandim:

- *Të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës në të gjitha nivelet, organet administrative dhe gjykatat, të zbatojnë me konsekuencë ligjet vendore dhe instrumentet ndërkombëtare për ushtrimin e mjeteve juridike nga autoritetet publike.*

2.11. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në raste penale

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, në raste penale, është i garantuar me nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës.¹⁰⁸ Në këtë mënyrë të gjithë personave në territorin e Republikës së Kosovës u garantohet siguria ligjore dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.

Parimi i ligjshmërisë *Nullum crimen sine lege, nulla poene sine lege* kërkon që krimi të jetë i përshkruar sipas ligjit, garanton drejtësi dhe paanshmëri. Asnjë i pandehur nuk mund të ndëshkohet në mënyrë arbitrare ose retroaktive, për veprimin i cili nuk ka qenë i përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat në kohën e kryerjes së tyre, sipas të drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. KEDNJ

¹⁰⁸Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082, neni 2: “Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.”

në nenin 7.1 ka përcaktuar qartë se “*Nuk ka dënim pa ligj*”.¹⁰⁹ Në përputhje të plotë me frymën e KEDNJ-së, edhe legjislacioni kosovar garanton të njëjtën gjë.

Ky parim, po ashtu mbron kryesin e veprës nga marrja e dënimit më të rëndë se ajo që është paraparë me ligj. Në këtë aspekt, legjislacioni kosovar në fuqi është i favorshëm për të akuzuarit, sepse në rast të ndryshimit të legjislacionit, në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, ndaj kryesit të veprës penale, do të zbatohet ligji i cili është më i favorshëm.¹¹⁰

Avokati i Popullit, ka konstatuar se edhe në këtë vit është vazhduar me cenimin e parimit të proporcionalitetit me rastin e dënimeve të shqiptuara nga gjyqësori ndaj abuzuesve me votat e qytetarëve në zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Gjykatat themelore kanë vazhduar me shqiptime të dënimeve me gjobë dhe me kusht, ndërsa dënimi me burg efektiv ishte shqiptuar në raste shumë të rralla. Avokati i Popullit konstaton se dënimet e shqiptuara nga gjykatat komunale për manipuluesit e zgjedhjeve në Kosovë ishin të ulëta, të pamjaftueshme dhe jo proporcionale në krahasim me peshën dhe natyrën e veprës së kryer.

Gjatë monitorimit të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, edhe pse është shënuar përparim në tërë procesin zgjedhor, Avokati i Popullit ka gjetur shkelje të rregullave të procesit zgjedhor. Në raportin për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës nr. 510/2013, datë 21 nëntor 2013, Avokati i Popullit ka kërkuar të iniciohen procedura penale dhe të vihen para organeve të drejtësisë të gjithë ata që kanë shkaktuar incidente dhe kanë penguar procesin e votimit, për të marrë dënim të merituar në raport me veprën penale,¹¹¹ ashtu siç parashihet me normat ligjore në fuqi.¹¹²

Rekomandim:

- *Për të gjitha gjykatat në Republikën e Kosovës që, në të gjitha rastet e gjykimit të rasteve të trajtuara, të zbatohet parimi i proporcionalitetit gjatë marrjes së vendimeve.*

2.12. Liria e lëvizjes

Kushtetuta¹¹³ dhe ligjet e Republikës së Kosovës, parashohin lëvizjen e lirë brenda shtetit, udhëtimin jashtë vendit, emigracionin dhe riatdhesimin.¹¹⁴ Këtë të drejtë shteti i garanton të

¹⁰⁹KEDNJ, neni 7.1: “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”

¹¹⁰Kodi Penal i Republikës Kosovës, nr.04/L-082, neni 3: “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm.”

¹¹¹IAP, Raporti, ex officio nr. 510/2013, për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës me 3 nëntor 2013.

¹¹²Kodi Penal i Republikës Kosovës, nr. 04/L-082, Kapitulli XVIII, veprat penale kundër të drejtave të votimit.

¹¹³Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 35.1. “Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.”

gjithë personave në përgjegjësinë e vet, në tërë territorin e shtetit pa kufizime dhe ndërhyrje të paligjshme. Institucionet përgjegjëse kanë obligim, që pa asnjë diskriminim dhe kufizime të paligjshme, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që lëvizja e lirë në përgjithësi të sigurohet për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Qeveria në përgjithësi, në periudhën raportuese ka respektuar këtë të drejtë. Mirëpo, tensionet ndëretnike, barrikatadat në rrugët të cilat i kanë vendosur grupe të caktuara kriminaleserbe në pjesën veriore të Kosovës, rreziku evident, incidentet e dhunës sporadik, si dhe frikësimi kanë vazhduar që në disa pjesë të caktuara të vendit ta kufizojnë lëvizjen e lirë të serbëve dhe shqiptarëve në pjesën veriore të Kosovës. Policia e Kosovës, siç ka bërë edhe viteve të fundit, vazhdon ta vlerësojë situatën e sigurisë si stabile por të brishtë. Pjesëtarët e grupeve etnike vazhdojnë të qëndrojnë kryesisht brenda ose udhëtojnë në ato pjesë ku grupacionet e tyre përbëjnë shumicën.

Bllokadat në rrugë të cilat gjatë vitit i kanë vendosur serbët në pjesën veriore të Kosovës, në shumëçka kanë kufizuar lëvizjen e lirë në atë pjesë dhe në disa raste kanë ndërprerë qasjen në të gjitha fushat, gjë ka rezultuar me një angazhim të përbashkët të BE, KFOR-it dhe Qeverisë së Kosovës me vendosjen e kalimit kufitar kosovar të kontrolluar në mënyrë ligjore në kufirin verior të vendit. Gjatë periudhës raportuese situata e sigurisë në veri ka qenë e paparashikueshme dhe Policia e Kosovëska raportuar për incidente të cilat kanë përfshirë eksplozime, djegie të veturave dhe gjuajtje me armë të zjarra.

Gjithashtu, gjatë kohës për të cilën raportohet ka pasur tentativa të vjedhjes së pronës së të kthyerve në komunat Istog dhe Klinë dhe sulme me armë të motivuara në baza etnike ndaj të kthyerve në komunën e Istogut,¹¹⁵ ka pasur edhe kërcënime dhe frikësime verbale të murgut të Manastirit të Zoçishtës,¹¹⁶ i cili gjendet në afërsi të Rahovecit.

Në këto situata dhe të ngjashme ka intervenuar policia e cila është kyçur në hetime. Ka pasur edhe dhunë të motivuar në aspektin etnik për sa i përket trashëgimisë kulturore të komunitetit serb në Kosovë, dëmtimin dhe prishjen e mbishkrimeve të varrezave në Kilokot dhe Fushë Kosovë.¹¹⁷ Kur flasim për sigurinë e qytetarëve të komuniteteve jo shumicë, Policia e Kosovës duhet të bëjë më shumë në parandalimin dhe pengimin e veprave të tilla, gjetjen e personave dhe sjelljen e tyre para drejtësisë.

Një aspekt shumë i rëndësishëm për procesin e kthimit dhe stabilizimit të komunitetit në tërësi është siguri i një mjedisi të sigurt dhe të qetë. Edhe pse liria e lëvizjes për pjesëtarëte

2. Secili ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte mund të përcaktohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.

3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohej hyrja në Kosovë.

4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, përveç në rastet kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është parashikuar ndryshe.

5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, do të rregullohet me ligj.¹¹⁴

¹¹⁴Ligji për shtetësinë nr.03/L-034, Ligji për vendqëndrimin dhe banimin nr. 02/L-121, Ligji për të huajtnr.03/L-126, Ligji për dokumentet e udhëtimit nr. 03/L-037, prej 19 qershorit 2008 në versionin e ndryshuar të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit mbi dokumentet e udhëtimit nr. 03/L-217, të 11 dhjetorit 2010.

¹¹⁵ Informatat e marra nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, rubrika Lajme, me 16.12.2013. f. 1-5; f. 11-15.

¹¹⁶Po aty, f. 86-90.

¹¹⁷Po aty, f. 111-115.

komuniteteve jo shumicë është gjithnjë e më e mirë, gjithsesi mbetet shumë punë për t'u bërë që siguria dhe liria e lëvizjes të jenë të plota në tërë territorin e Kosovës.

2.12.1. Jetësimi i marrëveshjes mbi lirinë e lëvizjes

Marrëveshja mbi lirinë e lëvizjes e arritur në qershor të vitit 2011 në mes të Serbisë dhe Kosovës i mundëson qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë të udhëtojnë lirshëm brenda dhe jashtë territorit të Kosovës dhe Serbisë. Me këtë marrëveshje është vendosur lëvizja e lirë e njerëzve nga Kosova në Serbi dhe tani qytetarët e Kosovës mund të hyjnë në Serbi duke prezantuar letërnjoftimet e lëshuara nga qeveria kosovare, por jo edhe me pasaporta të Republikës së Kosovës

Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit mbetet sfiduese vendimi i përkohshëm i lëshimit të sigurimit të automjeteve në kufirin Kosovë- Serbi. Pagesa e sigurimit për automjete mbetet shumë e lartë, pasi që Kosova ende nuk është anëtare e Byrosë për Karton të Gjelbër. Kosova dhe Serbia në mënyrë reciproke aplikojnë tarifa të ndryshme të sigurimit të automjeteve në kufi. Taksat shumë të larta kufizojnë lëvizjen e lirë pasi që shumë qytetarë nuk mund të paguajnë taksa aq të larta të sigurimit të automjeteve, gjë që orienton në domosdoshmërinë e marrjes së një vendimi sa më të shpejtë në mes të shoqatave të sigurimit nga Kosova dhe Serbia, me qëllim të shmangies së pagesave të dyfishta të sigurimit, me të cilën gjë përballen personat të cilët drejtojnë automjetet me tabela të Kosovës.

Si masë të përkohshme, Qeveria e Kosovës, në kuadër të marrëveshjes ka pranuar vazhdimin e regjistrimeve të tabelave me KS fillimisht për një periudhë 5 vjeçare, por me mundësinë e diskutimit lidhur me të, pas kësaj periudhe. Të gjithë pronarët e automjeteve me vendqëndrim në Kosovë do të përdorin regjistrimet e tabelave të Kosovës RKS ose KS të automjeteve të tyre. Tabelat e automjeteve KS dhe letërnjoftimet ende nuk aplikohen në pjesën veriore të Kosovës. Atje përdoren tabelat e automjeteve të Serbisë dhe nuk paguhet siguri për ato automjete. Një situatë e tillë është shkelje e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, e cila në mënyrë eksplicite thekson që marrëveshja e tabelave për automjete do të aplikohet prej 11 nëntorit 2011.

Zyrtarët e EULEX-it janë prezent në të gjitha pikat kufitare dhe misioni ka rol aktiv në punën e Grupit për aplikim të marrëveshjes për MIK. Të gjitha vendkalimet tani janë të hapura dhe zyrtarët doganor të EULEX-it si dhe policët kufitar të EULEX-it qëndrojnë vazhdimin në të gjitha pikat kufitare.

Për sa i përket lirisë së lëvizjes, qeveritë e të dyja vendeve gjithsesi do të duhej që në të ardhmen të punojnë në vendosjen e qarkullimit efikas ajror dhe hekurudhor dhe të heqin të gjitha pengesat reciproke për lirinë e lëvizjes së njerëzve, ideve dhe të mallrave për qytetarët e të dy vendeve.

Për sa i përket udhëtimit jashtë Kosovës, qytetarët e Kosovës po përballen me vështirësi të mëdha, të izolimit dhe veçimit, lidhur me lirinë e lëvizjes. Kosova është shteti i vetëm i Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilit presin në rend për viza, për të lëvizur lirshëm nëpër shtetet e BE.

Çështje të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimin në BE, paraqesin edhe politikën e sajë në lëmin e migracionit dhe reintegrimit të personave të riatdhesuar. Shtetet anëtare të BE kanë qenë synim i shumë emigrantëve nga Kosova. Qeveria e Kosovës në këtë drejtim, në vitin 2013 ka hartuar Strategjinë nacionale për reintegrimin e personave të riatdhesuar.¹¹⁸ Gjithashtu ka ndërmarrë edhe një sërë nismash me qëllim të hartimit të kornizës ligjore për menaxhim të migracionit, në pajtueshmëri me legjislacionin e BE. Kosova ka bazë të gjerë ligjore dhe nënligjore në lëmin e reintegrimit dhe ka vendosur mekanizmat institucional ligjor për menaxhim, kthimin e suksesshëm dhe procesin e riatdhesimit, duke respektuar dinjitetin e qytetarëve, me prejardhje nga Republika e Kosovës.¹¹⁹

2.12.2. Transporti humanitar

Me nxjerrjen e Ligjit mbi transportin rrugor nr.04/L-179, Ministria e Infrastrukturës (MI), ka paralajmëruar ndërprerjen e transportit humanitar dhe kalimin në një lloj të transportit të subvencionuar.¹²⁰ Në lidhje me këtë, në fazën e përpilimit është Draft Udhëzimi Administrativ për bartjen e subvencionuar të udhëtarëve,¹²¹ i cili nuk është kryer deri në fund të periudhës raportuese. Për këtë mbetet e paqartë vetë procedura e MI rreth funksionimit dhe qëndrueshmërisë së mëtejshme të transportit humanitar.

Avokati i Popullit është i mendimit se duhet bërë paraprakisht vlerësimin e detajuar të gjendjes lidhur me nevojat e komuniteteve si dhe vlerësimin e situatës së sigurisë në pjesët e caktuara të vendit, në të cilat do të duhej të mbështetet edhe më tej ky lloj i transportit, për arsye se disa vija të transportit humanitar paraqesin mundësinë e vetme të transportit për kategoritë e caktuara të banorëve ku nuk ka transport publik dhe me ndërprerjenë saj, liria e lëvizjes kufizohet.

Rekomandime:

- ***Qeveria e Kosovës të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të sigurohet lëvizja e lirë dhe e pakushtëzuar e njerëzve dhe mallit, pa kufizime, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.***

¹¹⁸ *Strategjia kombëtare për reintegrimin e personave të riatdhesuar*, tetor 2013. Në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia_kombetare_për_reintegrimin_e_personave_të_riatdhesuar.pdf (12.12.2013).

¹¹⁹ *Po aty.*

¹²⁰ Pas themelimit nga ana e UNHCR-it në vitin 1999, shërbimi humanitar i transportit me autobus, është marrë nga Njësia për administrim civil të Misionit për Administrim të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) prej korrikut të vitit 2001. Me 31 gusht 2006, UNMIK-u dhe Institucionet e përkohshme vetëqeverisëse kanë nënshkruar një marrëveshje të bartjes së përgjegjësisë për transport humanitar të komuniteteve pakicë në Kosovë (Marrëveshje), përmes së cilës përgjegjësia e plotë bie mbi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim që ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2007.

¹²¹ Përfaqësuesi i Ministrisë për infrastrukturë e ka njoftuar për këtë përfaqësuesin e Avokatit të popullit, i cili në cilësinë e vëzhguesit ka përcjellë punën e Komisionit për këshillim për çështje të transportit humanitar dhe me 29.10.2013 ka dërguar draft UA i cili ka qenë i pjesshëm. Përpunimi i draftit të ri është në proces e sipër.

- *Qeveria e Kosovës, në afatin më të shkurtër kohor, të ndërmerr masat e duhura në drejtim të arritjes së marrëveshjes në mes të shoqatave të kompanive të sigurimeve në Kosovë dhe Serbi, e me këtë do të shmangej pagesa e sigurimit të përgjegjësive mbi automjetin në pikat kufitare dhe pagesës së dyfishtë të sigurimeve për automjetet motorike.*
- *Ministria e Punëve të Brendshme t'i ndërmerr të gjitha masat e duhura që në afatin sa më të shkurtër kohor t'i zgjidh të gjitha kërkesat e parashtruara për para-regjistrimin e automjeteve dhe lëshojë shenjat e përhershme të regjistrimit.*
- *Qeveria e Kosovës, pas vlerësimit të përgjithshëm të situatës mbi arsyeshmërinë, të vendos në interesin më të mirë të qytetarëve të Kosovës, për zhvillim të mëtejshëm të transportit humanitar.*

2.12.3. Liria e lëvizjes në veri të Mitrovicës

Edhe në vitin 2013, liria e lëvizjes dhe siguria e qytetarëve në veri të Mitrovicës për banorët shqiptarë, e pjesërisht edhe për personat e përkatësive të tjera etnike, paraqet problemin më të madh në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2013, në pjesën veriore të Mitrovicës kanë ngjarë 30 shpërthime. Këto shpërthime janë pasuar me dëme materiale, nga to edhe vetura e biznese. Po ashtu ka pasur të shtëna të shumta me armë zjarri nga persona të panjohur, zakonisht nga pjesëtarë të grupeve të organizuara kriminale në pjesën veriore, pjesërisht të njohur edhe për institucionet publike të Kosovës dhe ato ndërkombëtare, që kanë për obligim përcjelljen e gjendjes së sigurisë në këtë pjesë të vendit.¹²²

Grupe ekstremiste serbe, të pakënaqur, të nxitur nga qarqet qeveritare të Republikës së Serbisë, në krye me kryetarët e organeve ilegale serbe, kanë organizuar protesta, në shumë raste të përcjella edhe me përdorimin e armëve të zjarra. Protesta janë organizuar edhe për shkak të organizimit të zgjedhjeve lokale të Republikës së Kosovës në pjesën veriore, me tendencë për ta tensionuar situatën në këtë pjesë të vendit, duke shpërndarë afishe për bojkotimin e zgjedhjeve në pjesën veriore të Mitrovicës.¹²³

Në vitin 2013, në veri kanë vazhduar provokimet dhe pengimi i punëve nga ana e individëve dhe grupeve të organizuara të personave me përkatësi etnike serbe, për rindërtimin e objekteve për banim të shqiptarëve në pronat e tyre private në lagjet e veriut të Mitrovicës.

Sa i përket lirisë së lëvizjes, gjendja e sigurisë nuk ka ndryshuar fare për të mirë në krahasim me vitet e kaluara. Nënurat që lidhin pjesën jugore dhe veriore të qytetit të Mitrovicës, ende gjenden të vendosura dy barrikada nga grupet kriminale, njëra tek ura kryesore e lumit Ibër dhe tjera në Lagjen e Boshnjakëve, në drejtim të shkollës teknike në veri të Mitrovicës. Barikadat që kanë mbetur në rrugët e veriut, paraqesin problem për lëvizjen e lirë të

¹²² Intervistë me z. Behxhet Bala, drejtor i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim në komunë të Mitrovicës më 16 dhjetor 2013.

¹²³ IAP, Raporti vjetor 2013. Shih pjesën mbi zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, pjesa veriore e Mitrovicës, më 3 nëntor dhe 1 dhjetor 2013.

qytetarëve dhe e vështirësojnë jetën e të gjithë banorëve të pjesës veriore të Kosovës, sidomos të banorëve shqiptarë.

Edhe pas disa viteve, ende mbahen të bllokuara fshatrat e komunës së Leposaviqit të banuara me popullatë shqiptare. Atyre u mohohet e drejta për lëvizje të lirë, e me këtë edhe e drejta për punë, shërbime shëndetësore, për shërbime administrative dhe për sigurimin e jetesës së tyre. Këta banorë vazhdojnë të lëvizin me vështirësi të mëdha, në të shumtën e rasteve vetëm me përcjellje nga Policia e Kosovës. Thjeshtë, lëvizja e lirë për këta njerëz nuk ekziston, edhe pse situata ndryshon nga momenti në moment.

Grupe të caktuara kriminale në pjesën veriore, të prira dhe të nxitura edhe qeveria e Serbisë, për shkaqe krejtësisht politike, nën petkun e mosnjohjes së Republikës së Kosovës, në mënyrë sistematike sulmojnë dhe rrezikojnë jetën dhe pasurinë e çdo personi që udhëton me automjetin e tij me tabela të rregullta të automjeteve në Republikën e Kosovës. Në po këtë mënyrë veprojnë edhe me automjetet zyrtare të Policisë së Kosovës apo edhe të institucioneve të tjera të Kosovës. Në situata të caktuara këtë e bëjnë edhe me çdo automjet tjetër që nuk bartë numra të automjeteve nga Serbia, apo, për të qenë paradoksi edhe më i madh, edhe çfarëdo numri përveç atyre serbe. Më e preferueshme është të drejtohen automjete pa numra fare, të pidentifikuara. Kjo domosdoshmërisht lë të dyshohet se kemi të bëjmë me një përzierje të krimit të organizuar me petkun politik, që rrezikon jetën, pasurinë e njerëzve dhe e kufizon në masën më të madhe lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit, pa dallim, përveç individëve dhe grupeve të organizuara kriminale.

Më 19 shtator 2013, në veri të Mitrovicës është vrarë doganieri lituanëz.¹²⁴ Rasti ka ndodhur kur dy vetura të EULEX-it, që i bartnin gjashtë pjesëtarë të tij, për të bërë ndërrimin e rregullt në Portën kufitare nr. 1, janë qëlluar me armë zjarri nga persona të panjohur, në afërsi të Komunës së Zveçanit. Megjithë përpjekjet e shumta, kryesit e vrasjes nuk janë zbuluar ende.

Bazuar në informata dhe të dhënat e ofruara, fatkeqësisht situata në veri të Mitrovicës vazhdon të jetë e rëndë, sidomos përkitazi me lirinë e lëvizjes për banorët në atë pjesë të vendit, me theks të veçantë, për banorët shqiptar.

Rekomandime:

- *Institucionet kompetente dhe përgjegjëse, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Policia e Kosovës, të ndërmarrin të gjitha veprimet, sipas obligimit ligjor për garantimin e jetës, pronës, shëndetit dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në pjesën veriore të Mitrovicës.*
- *Të largohen të gjitha barrikatat e vendosura dhe të lirohen rrugët në pjesën veriore të Kosovës, për të garantuar lirinë e plotë të lëvizjes për të gjithë njerëzit që jetojnë në atë pjesë, vendosjen e rendit dhe ligjit, duke krijuar siguri, dhe zhvillim ekonomik në pjesën veriore të Kosovës.*

¹²⁴ Audrius Senavicius, doganieri 35-vjeçar lituanëz, i cili u vra në veri të Mitrovicës.

- *Të ndërmerren të gjitha veprimet e parapara me ligj për luftimin e kriminalitetit dhe grupeve të organizuara kriminale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa hezitime dhe ngurrime të natyrës politike.*

2.13. E drejta e privatësisë

E drejta për jetën private, jetën familjare, banesa dhe korrespondenca, janë të drejta që përfshihen në të drejtën e privatësisë, të cilat mbrohen me nenin 8 të KEDNJ-së dhe me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Çdokush ka të drejtë që t'i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij. Megjithatë, në praktikë janë identifikuar shkelje të së drejtës së privatësisë në Kosovë. Në periudhën raportuese, IAP ka pranuar një numër ankesash të qytetarëve, për shkeljen e të drejtës së privatësisë.¹²⁵

2.13.1. E drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit

KEDNJ dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, garantojnë të drejtën e gëzimit të papenguar të posedimit.¹²⁶ Midis objekteve të cilave duhet t'u kushtohet respekt i veçantë, sipas nenit 8 është shtëpia, që është vendi ku personi jeton në mënyrë të përhershme apo me të cilin personi ka lidhje të mjaftueshme e të vazhdueshme. Problemet më të rënda në këtë drejtim janë paraqitur për shkak të afërsisë së madhe të ndërtesave të larta tek shtëpitë private, me gërmimet e thella që rrezikojnë shtëpitë fqinje, hapja e dritareve përballë shtëpive, dëmtimi i pronës. Të gjitha këto veprime vështirësojnë shfrytëzimin e qetë të shtëpisë.¹²⁷

Po ashtu, në periudhën raportuese për vitin 2013, është cenuar e drejta e privatësisë nga zhurma dhe shqetësimet që u shkaktohen qytetarëve në banesat e tyre nga zhurma jashtë banesave, e shkaktuar nga bizneset në afërsi, nga kafiteritë dhe restorantet, nga makineritë e zhurmshme që përdoren edhe në orët e vona të natës, gjatë vikendeve, etj. Shqetësimi i qytetarëve shkaktohet për shkak të aktiviteteve që ushtrohen jashtë standardeve të sigurisë.

¹²⁵ IAP, rastet: *ex officio* 551/2013, *ex officio* 345/2013, A. nr. 83/2013, A. nr. 43/2013.

¹²⁶ Protokollin 1 neni 1 paragrafi 1, i KEDNJ dhe neni 46 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹²⁷ IAP, A.nr. 123/2012. Ankuesi ankohet lidhur me pengimin e posedimit, lidhur me pronën tij, ku nuk është ekzekutuar urdhëresa nr. 09-356-11048 të datës 1 tetor 2012, e drejtorisë së inspektoratit - sektorit të ndërtimit të komunës së Prishtinës. Ankuesi ka paraqitur ankesën se, fqinji me rastin e ndërtimit të objektit që gjendet në lagjen "Mati I," në Prishtinë, ngjitur për pronën e tij, ka bërë hapjen e dritareve nga ana e pronës së tij, duke mos respektuar projektin kryesor, i cili është vërtetuar në drejtorinë e urbanizmit, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Nga kontaktet e përfaqësueses së IAP-së me kryeinspektorin e inspektoratit të ndërtimit, jemi informuar se është lëshuar urdhëresë për mbylljen e dritareve. Po ashtu, edhe drejtori i drejtorisë së urbanizmit informon se hapja e dritareve është në kundërshtim me lejen. Ndërtuesi nuk i ka mbyllur dritaret e lartpërmendura, në anën e kufirit me pronën e ankuesit, që është jashtë kushteve të parapara me lejen e ndërtimit. Në këtë rast janë konstatuar shkeljet ligjore dhe më 29 korrik 2013, Avokati i Popullit ka publikuar raport të veçantë me rekomandime, drejtuar kryetarit të komunës së Prishtinës, duke kërkuar nga ai ndërprerjen e punimeve. Mirëpo, Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje nga komuna e Prishtinës, për fillimin e procedurave të zbatimit të rekomandimeve.

Në periudhën raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash të qytetarëve, për shkeljen e të drejtës së privatësisë, lidhur me shkaktimin e zhurmës, dhe ka ndërmarrë veprime në raste të ndryshme kundër zhurmës.¹²⁸

2.13.2. Jeta private dhe korrespondenca

Kontrolli i komunikimeve në formën e përgjimeve telefonike ose i korrespondencës me shkrim, përgjithësisht konsiderohet se përbën një ndërhyrje në mënyrë shumë se një nga të drejtat e garantuara me nenin 8 paragrafi 1, të KEDNJ. Megjithatë ndërhyrja e shtetit në këtë të drejtë është e lejuar deri në masën me të cilën arrihet qëllimi i ligjit. Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pranuar ndonjë ankesë që lidhet me cenimin e kësaj të drejte. Jeta private dhe korrespondenca është e rregulluar me dispozitat e Kodit Penal, por Avokati i Popullit vëren se kjo fushë nuk është e mbuluar sa duhet dhe është më se e nevojshme që të finalizohet sa më shpejtë ligji për përgjimet e telekomunikimeve.

Rekomandime:

- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ta procedojnë për miratim Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve në Republikën e Kosovës, pa zvarritje të mëtutjeshme.*
- *Inspeksionet komunale të urbanizmit dhe të tregut të ndërmarrin të gjitha masat ligjore për respektimin e largësisë së ndërtimit të objekteve nga objektet ekzistuese.*
- *Inspeksionet komunale të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për respektimin dhe zbatimin e ligjit mbi zhurmën, sidomos në raport me veprimtarinë e kafiterive dhe restoranteve që shkaktojnë zhurmë të palejueshme në orët e natës.*

2.14. E drejta e martesës dhe e familjes

Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush ka të drejtën të martohet dhe të krijojë familje në pajtim me ligjin.¹²⁹ Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.

Martesa nënkupton bashkësi midis dy personave, të regjistruar sipas ligjit, të cilët me vullnet të lirë vendosin të jetojnë bashkë dhe të krijojnë familje.¹³⁰ Ligji, rregullon një fushë mjaftë të gjerë të marrëdhënieve shoqërore, me fokus marrëdhëniet që lindin në familje, martesë ose të lidhura me familjen dhe martesën.

¹²⁸ IAP, rastet: A.nr. 530/2013, A.nr. 583/2013, A.nr. 216/2013.

¹²⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 37 paragrafi 1.

¹³⁰ Ligji për Familjen i Kosovës nr. 32/2004, neni 14.

Përveç me Ligjin për Familjen, disa çështje në lidhje me marrëdhëniet familjare rregullohen edhe me ligje të tjera që rregullojnë fushën e të drejtës familjare, si: Ligji për Barazi Gjinore,¹³¹ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare¹³² dhe Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.¹³³ Gjithashtu, si bazë për rregullimin e marrëdhënieve familjare, në Kosovë janë të zbatueshme drejtpërdrejtë edhe standardet ndërkombëtare, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.¹³⁴

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të KEDNJ “çdo njeri ka të drejtën për respekt për jetën familjare, vendbanimin dhe korrespondencën e tij. Në bazë të këtij neni jeta e familjes është pozicionuar drejtpërdrejtë në sferën e jetës private, pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.”¹³⁵

Sipas nenit 2 paragrafi 1, të Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK), “familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini”. Familja, sipas mënyrës së themelimit, është familje martesore, jashtëmartesore dhe familje e birësimit (adoptimit).

Bashkësia martesore, përbën familjen e cila themelohet nga martesë, respektivisht nga një burrë dhe një grua që kanë lidhur martesë të ligjshme dhe nga ajo martesë kanë lindur fëmijë. *Bashkësia jashtëmartesore*, themelohet nga personat që bashkëjetojnë, por që nuk kanë lidhur martesë të ligjshme, dhe nga ajo bashkëjetesë lindin fëmijët nga prindërit e pamartuar, duke themeluar familje jashtëmartesore. Mirëpo fëmijët e lindur në familjen jashtëmartesore janë të barabartë në bazë të ligjit në realizimin e të drejtave të tyre. *Familja e adoptimit*, është bashkësi jetese e adoptuesit me të adoptuarin dhe pasardhësit e tij, e cila themelohet me aktin e adoptimit me vendim të gjykatës.¹³⁶

2.14.1. Kontakti i prindërve të ndarë me fëmijët

Bazuar në analizën e rasteve të paraqitura në IAP, ankesat më të shumta në këtë fushë kanë të bëjnë me zvarritjet procedurale nëpër gjykata, përkritazi me pagesën e alimentacionit, në të shumtën e rasteve nga bashkëshortët, për bashkëshortet e ndara dhe fëmijët e përbashkët,¹³⁷

¹³¹ Ligji për barazi Gjinore nr. 2004/2. Sipas nenit 1, me këtë ligj mbrohet, trajtohet dhe vendoset barazia gjinore për meshkujt dhe femrat, në të gjitha sferat e jetës.

¹³² Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare nr. 02/17. Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 04/1-081 për ndryshimet dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare. Me këtë ligj përcaktohen rregullat për ofrimin e shërbimeve sociale për personat dhe familjet me nevojë në Kosovë.

¹³³ Ligji për mbrojtjen nga dhuna në Familje nr. 03/L-182.

¹³⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

¹³⁵ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 8 paragrafi 2.

¹³⁶ Ligji për Familjen i Kosovës nr. 32/2004, neni 180 paragrafi 1.

¹³⁷ IAP, rasti A. nr. 512/2013. Pala është ankuar kundër zvarritjes së procedurës gjyqësore dhe për përsëritjen e procedurës nga Gjykata Themelore në Prizren, dega në Suharekë. Ajo pretendon se është mashtruar nga ish bashkëshorti për prishjen e kurorës, për shkak të rregullimit të dokumenteve në Itali. Mirëpo, ka ndodhur diçka tjetër. Pas shkurorëzimit, ajo së bashku me katër fëmijët e përbashkët, pas 17 vite martesë, është detyruar të braktisë shtëpinë e përbashkët dhe të largohet pa kurrfarë ndihme ekonomike (alimentacion), nga ish bashkëshorti. Pala e kishte çështjen për rivendosje në gjykatën kompetente, e cila ende nuk ka vendosur. Rasti është duke u përcjell nga IAP deri në përfundimin e tij.

apo përkitazi me të drejtën e realizimit të kontakteve të njërit prind të ndarë me fëmijët e mitur.¹³⁸ Një rast i tillë është duke u përcjellë nga IAP, deri në realizimin e kontakteve të rregullta me fëmijët ashtu siç parashihet me ligj.¹³⁹

Çështja e pengimit të kontakteve të fëmijëve nën përkujdesjen e njërit prind, me prindin i cili është ndarë nga bashkësia familjare, në Kosovë vazhdon të jetë një problem shumë i rëndë. Në të shumtën e rasteve, për shkak të prishjes dhe të acarimit të skajshëm të raporteve ndër-njerëzore midis ish-bashkëshortëve, ku në të shumtën e rasteve janë të përfshira edhe familjet e tyre, njërit prind, i mohohet kontakti me fëmijët nga prindi tjetër. Rastet kur edhe nënat e pengojnë dhe ndalojnë kontaktin e fëmijëve me babain, nuk janë të pazakonshme.¹⁴⁰

Nga informatat e pranuar nga Departamenti i Mirëqenies Sociale, rezulton se këtë vit, në shumicën e rasteve kujdestarinë e kanë fituar prindërit e gjinisë femërore- nënat, derisa statistikat e vitit të kaluar tregojnë se kanë qenë gjinia mashkullore-baballarët, ata të cilët e kanë fituar kujdestarinë pas zgjidhjes së martesës.¹⁴¹

Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Departamenti i Mirëqenies Sociale i cili vepron në kuadër të MPMS, kanë rëndësi të veçantë gjatë proceduarve të shkurorezimit, adoptimit dhe takimeve të rregullta të prindërve me fëmijë të mitur me të cilët nuk jetojnë në bashkësi familjare. Mendimi i tyre profesional luan rol të rëndësishëm në marrjen e vendimit nga gjykatat kur gjykohen çështjet familjare. Mirëpo, rolin vendimtar për vendosje në çështjet familjare (shkurorezim, kujdestari, besimin e fëmijëve dhe adoptimin), e kanë gjykatat. Prandaj, duhet përkushtim më i madh dhe serioz në punën e tyre, që të mos këtë zvarritje të pajustificuara procedurale.

Rekomandime:

- *Gjykatat kompetente që vendosin për rastet e konflikteve familjare, sidomos gjykatat themelore në Kosovë, të mos lejojnë zvarritje procedurale të pajustificueshme.*

¹³⁸ IAP, rasti A. nr. 401/2013. Pala ka shprehur shqetësime për zvarritje të procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren, dega në Suharekë dhe Qendrën për Punë Sociale në Suharekë, për realizimin e kontakteve me fëmijët e mitur. Ankuesja, pas vdekjes së bashkëshortit të saj, është detyruar të ndahet prej fëmijëve të mitur nga prindërit e ish bashkëshortit, të cilët i kanë pamundësuar takimin me fëmijët e saj. Ndërkohë, me ndihmën dhe ndërmjetësimin e IAP, është arritur një marrëveshje që të caktohet një kujdestar I përkohshëm I fëmijëve, sepse ankuesja në këtë fazë nuk ka mundësi të jetë kujdestare e tyre, për shkak të situatës ekonomike dhe krijimit të bashkësisë tjetër martesore. Mirëpo, ajo vetëm kërkon kontaktet-takimet e rregullta me fëmijë.

¹³⁹ Ligji për Familjen i Kosovës nr. 32/2004, neni 25, paragrafi 2, “Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët të cilët nuk jetojnë bashkë me prindërit kanë të drejtë t’i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë”.

¹⁴⁰ IAP, rasti A. nr. 395/2013. Pala është ankuar lidhur me pengesat për realizimin e kontakteve me fëmijët e mitur pas prishjes së bashkësisë jashtëmartesore nga ish-bashkëshortja, në Komunën e Ferizajit. Pas këshillimeve me IAP dhe kontakteve me QPS në Ferizaj, pala ka arritur të kontaktojë fëmijët e mitur. Me ndërmjetësimin e IAP tek institucionet kompetente dhe bashkëpunimit korrekt të palës, rasti është zgjedhur pozitivisht.

¹⁴¹ Informata nga Departamenti i Mirëqenies Sociale të MPMS, 2 dhjetor 2013. Statistikat për periudhën, janar-shtator 2013. Numri i shkurorezimeve 125, numri i fëmijëve, nga rastet e shkurorezuara 208, besuar babait 72, nënës 130 dhe përziera 6.

- *Gjykatat të cilat vendosin për çështjet familjare, sidomos për rastet ku fëmijët janë të përfshirë, të vendosin një bashkëpunim më të mirë me QPS-të, dhe të kenë parasysh mendimin e tyre profesional.*
- *MPMS-departamenti për mirëqenie sociale, të mbikëqyrë punën e QPS-ve, që të arrihet një efektivitet më i madh në rastet kur gjykatat dhe institucionet e tjera kompetente kërkojnë ndihmën profesionale në çështjet familjare nga QPS-të.*

2.15. Liria e fesë, besimit dhe ndërgjegjes

Një nga problemet më të mëdha në respektimin e të drejtave kushtetuese të fesë, besimit dhe ndërgjegjes në Kosovë është mungesa e ligjit me të cilin do të rregullohej pozita e bashkësive fetare.¹⁴² Për zgjidhjen e këtij problemi është e domosdoshëm miratimi i projekt ligjit për ndryshimin e Ligjit për Bashkësitë Fetare të cilin në vitin 2011 Qeveria e Kosovës ia dërgoi Kuvendit të Kosovës, për të cilin ka rekomanduar edhe Avokati i Popullit që nga viti 2011.¹⁴³

Fatkeqësisht, ky ligj edhe më tej nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Miratimi i ligjit është nevojë e të gjitha bashkësive fetare në Kosovë.

Bashkësitë fetare në Kosovë, ashtu si edhe viteve të mëparshme patën të njëjtat kërkesa dhe probleme.

Këtë vit e karakterizuan një numër i ngjarjeve dhe tubimeve publike të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimit ndërfeetar.

Periudha kohore prej 20 deri më 27 maj 2013 në Kosovë është shënuar si java e tolerancës e cila ka përfshirë aktivitete të shumta të cilat ishin drejtuar drejt përmirësimit të bashkëpunimit ndërfeetar.¹⁴⁴

2.15.1. Bashkësia Islame e Kosovës

Është shumë e rëndësishme që bashkësitë fetare nuk kanë probleme sa i përket bashkëpunimit dhe që i kontribuojnë bashkëjetesës fetare, tolerancës fetare dhe që kjo përbën një faktor të rëndësishëm në stabilitetin e vendit.

Bashkësia Islame ka theksuar nevojën që organet shtetërore me ligj të rregullojnë kthimin e pronës kësaj bashkësie fetare, pronë e cila iu mor gjatë periudhave të mëhershme. Financimi i kësaj bashkësie po ashtu bëhet nga mjetet vetanake, nuk ka mjete të dedikuara nga buxheti

¹⁴² *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 38: “2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ndërthhen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.”

¹⁴³ *IAP, Raporti vjetor për vitin 2012*, f. 41.

¹⁴⁴ *Ministria e Punëve të Jashtme*, Konferenca ndërfeetare në Kosovë mbledh përfaqësuesit kyç fetar regjional dhe ndërkombëtar për dialog vital dhe pajtim, 25.5.2013, në: <http://www.mfa-ks.net/?page=3,4,1708&offset=13> (24.12.2013).

shtetëror për financim të 200 zyrtarëve fetar, ndërsa 60% e këtyre zyrtarëve janë me përgatitje të lartë shkollore.

Lidhur me problemin e bartjes së shamisë në institucionet e arsimit parauniversitar, IAP në raportet e mëhershme ka tërhequr vëmendjen, ndërsa këtë e bënë edhe në rastin e tanishëm, dhe apelon tek të gjithë faktorët relevant se duhet të respektohen të gjitha obligimet dhe përcaktimet kushtetuese dhe ligjore. Duhet të gjendet mënyra që në kuadër të respektimit të Kushtetutës dhe Ligjit, të respektohet parimi i mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, e kjo sigurisht në këtë rast është e drejta për arsimim. Dialogu ndërinstitucional dhe bashkëpunimi mund të shërbejnë për të gjetur një zgjidhje të moderuar dhe të pranueshme për të gjithë faktorët lidhur me këtë çështje.

2.15.2. Kisha Ortodokse në Kosovë

Një nga kërkesat e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë është ruajtja e identitetit, ekzistencës dhe trashëgimisë kulturore.

Problemi i dëmtimit të kishave dhe manastireve gjatë këtij viti nuk ka ndodhur si viteve të mëparshme, përveç disa incidenteve të vogla. Në muajin gusht, ruajtja e manastirit të Patriarkales së Pejës dhe 24 objekteve të tjera të Kishës Ortodokse Serbe, kanë kaluar në kompetencë të Policisë së Kosovës, ndërsa vetëm manastiri i Deçanit ka mbetur nën mbrojtjen e KFOR-it. Përbërja e njësisë e cila e ruan manastirin është e karakterit multietnik. Përveç manastirit të Deçanit, për mbrojtjen e të cilit edhe më tej janë të angazhuar pjesëtarët e forcave ndërkombëtare ushtarake, të gjitha objektet tjera fetare dhe monumentet kulturore janë nën mbrojtje të Policisë së Kosovës.

Gjatë periudhës kohore qershor-shtator ka filluar restaurimi i varrezave "serbe" (në fakt kjo është një varrezë ortodokse dhe katolike, ndërsa në po të njëjtën varrezë ka edhe varre hebreje) në pjesën jugore të Mitrovicës, e cila pas vitit 1999 pothuajse tërësisht është shkatërruar. Në fakt, ky aktivitet është ndërmarrë nga ana e Zyrës së Qeverisë së Kosovës në pjesën Veriore të Mitrovicës (ZQKM).

Nevojën për rindërtim dhe mbrojtje të objekteve sakrale të bashkësisë serbe përveç ZQKM-së e ka njohur edhe Ambasada e Norvegjisë në Kosovë e cila përmes një donacioni ka mundësuar rehabilitimin e pjesshëm dhe rindërtim e varrezës. Në ZQKM janë pranuar 639 kërkesa dhe secila kërkesë e cila është pranuar në zyre është protokolluar në mënyrën e duhur në librin e protokollit, kurse çdo parashtrues i kërkesës ka marrë një kopje të kërkesës së protokolluar.¹⁴⁵ Po ashtu, në kuadër të punëve të parapara është realizuar edhe vendosja e shtyllave për ndriçim dhe vendosjen e kamerave për mbikëqyrje dhe kjo është bërë sipas standardeve. Një pjesë e këtij rindërtim të monumenteve kërkon mjete financiare shtesë sigurimi i të cilave do të varet nga donatorët, por kjo pritet të ndodh gjatë vitit 2014.

Në fund të shtatorit, në mënyrë solemne u lëshua në përdorim ura në Deçan, e cila u ndërtua si projekt i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), me kërkesë të komunës së Deçanit, Manastirit

¹⁴⁵ Të gjitha informatat lidhur me restaurimin e varrezave të cilat përmenden në tekst janë informata zyrtare të cilat janë marrë më 13.12.2013 nga zyrtari i Zyrës Administrative në veri të Mitrovicës i cili është i ngarkuar me këtë çështje.

të Deçanit, për shkak të vështirësive dhe pamundësisë së lëvizjes së lirshme përmes urës së dëmtuar në Drinin e Bardhë.

2.15.3. Bashkësitë e tjera fetare në Kosovë

Përfaqësuesit e Kishës Katolike po ashtu theksojnë se ligji për bashkësitë fetare, përveç rregullimit të statusit të bashkësive fetare, do të mundësonte përputhshmërinë e rregullimit të tyre me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përfaqësuesit e Kishës Protestante kanë shprehë shqetësimin e tyre në lidhje me kërkesën e tyre drejtuar Komunës së Prishtinës për ndërtimin e kishës së tyre, si dhe për rregullimin e statusit të tyre përmes ligjit për bashkësitë fetare.

Gjatë këtij viti është mbajtur edhe Java e Hebrenjve në Kosovë, e cila është përcjellë me një varg ngjarjesh, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte organizimi i panelit për trashëgiminë hebreje në Kosovë, si dhe për rëndësinë e dialogut ndërfaqetar të organizuar më 12 dhjetor 2013.

Nisur nga të gjitha kërkesat e bashkësive fetare në Kosovës, Avokati i Popullit ka dhënë një rekomandim.

Rekomandim:

- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të ndërmarrin të gjitha veprimet për procedimin e ligjit për bashkësitë fetare në Kosovë.*

2.16. Liria e shprehjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 40 të saj, garanton lirinë e shprehjes, e cila gjithashtu është e mbrojtur me nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut¹⁴⁶ dhe nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.¹⁴⁷

Liria e shprehjes në thelb ka mendimin e lirë e pa ndërhyrje, si dhe marrjen e dhënien e informacionit dhe ideve pa marrë parasysh kufijtë.

Përcaktimi i saktë i shtrirjes së lirisë së shprehjes, shpeshherë në vetvete është kundërthënës, duke i shndërruar rastet e cenimit të saj në çështje të debatuar. Pa lirinë e shprehjes nuk mund të mendohen proceset shoqërore dhe politike në një shtet të lirë dhe demokratik. Parë nga ky këndvështrim, është e mjaftueshme që shteti të mos ndërhyj dhe mos ta pengojë në çfarëdo forme.

Megjithatë ushtrimi i lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar. Shteti ka të drejtën legjitime për të ndërmarrë veprime që kufizojnë lirinë e shprehjes, kur të njëjtat janë “[...] në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e shëndetit ose

¹⁴⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në: [http://www.un.org/en/documents/udhr/\(30.01.2104\)](http://www.un.org/en/documents/udhr/(30.01.2104)).

¹⁴⁷ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, në: [http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf\(30.01.2104\)](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf(30.01.2104)).

*të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të parandaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.*¹⁴⁸

Edhe Kushtetuta e Kosovës, i legjitimon shtetit të drejtën në kufizimin e ushtrimit të lirisë së shprehjes kur një gjë e tillë është e domosdoshme “[...] për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”¹⁴⁹

Pikëtakimi i të drejtës së lirisë së shprehjes me të drejta të tjera shpeshherë bëhet objekt debatesh, por gjithashtu e bën më komplekse ndarjen e drejtësisë. Tendenca e favorizimit të të drejtave të tjera (siç është ajo e privatësisë) në raport me lirinë e shprehjes, apo prirja e autoriteteve që lirinë e shprehjes ta shohin si çështje të kompetencës së tyre dhe jo si një të drejtë themelore, kërkon vëmendje të shtuar dhe saktësi e kujdes të veçantë në trajtimin e cenimit të pohuar, duke i vlerësuar rastet veç e veç, me tërësinë e specifikave që kanë.

Liria e shprehjes nënkupton jo vetëm mendimet dhe informacionet të cilat pranohen qetësisht, por edhe ato që mund të jenë shqetësuese dhe ofenduese, por që janë në funksion të një vlere demokratike, përfshirë këtu jo vetëm fjalën e folur ose të shkruar, por edhe imazhet, veprimet, apo edhe veshjet, nëse qëllimi është informacioni, dhe po ashtu, jo vetëm aspektin përmbajtjesor të informacionit, por edhe formën përmes së cilës shprehen ato.

Avancimi teknologjik po e sfidon gjithnjë e më shumë lirinë e shprehjes. Përderisa platformat e ndryshme elektronike ofrojnë një univers të tërë mundësish për ta realizuar këtë të drejtë, ato gjithashtu lënë shtigje të shumta për keqpërdorim dhe abuzim me lirinë e shprehjes. Kjo i bën të domosdoshme përkufizimet ligjore në këtë aspekt, për të identifikuar qartë kufijtë e lirisë së shprehjes dhe dispozitat ndëshkuese në rast mosrespektimi të të drejtave në fushën e lirisë së shprehjes.

Në IAP gjatë vitit 2013, ka pasur 4 ankesa për cenim të lirisë së shprehjes. Dy prej këtyre rasteve janë mbyllur, njëri pozitivisht¹⁵⁰ dhe tjetri rast, në pajtim me nenin 20, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, është shpallur i papranueshëm për mosinteresim të palës.¹⁵¹ Rasti i tretë është shpallur i papranueshëm, meqë është konstatuar se është në shfrytëzim të mjeteve juridike.

I papranueshëm për IAP-në ka qenë dhe rasti i katërt meqenëse nga dëshmitë e paraqitura dhe rrethanat e përshkruara në ankesë, nuk ka rezultuar se janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.

2.17. E drejta e qasjes në dokumente publike

E drejta e qasjes në dokumente publike përfshinë të drejtën që ka çdo person për të njohur përmbajtjen e dokumenteve që mbahen nga autoritetet publike, përcakton dhe vendosë

¹⁴⁸ *Po aty*, neni 10, paragrafi 2.

¹⁴⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 40, paragrafi 2.

¹⁵⁰ *IAP, rasti A. nr. 418/2013.*

¹⁵¹ *IAP, rasti A. nr. 340/2013.*

rregulla për mirëfunktionimin dhe transparencën e administratës publike në raport me publikun në lidhje me veprimtarinë e saj.

Qarkullimi i lirë i informacionit është mjet i rëndësishëm për ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve, për të krijuar transparencë të veprimeve, efikasitet dhe efektivitet të administratës publike, për ndërgjegjësim reciprok, të qytetarëve për shërbimet që i pret nga administrata dhe, i administratës për detyrimet e saj për ofrimin e shërbimeve qytetarit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e qasjes në informacione publike me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj,¹⁵² ndërsa Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQPD) qartë i definon të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente publike.¹⁵³

LQPD në dukje, parimisht është një ligj zemërgjerë në raport me qytetarin. Ai ngarkon me përgjegjësi institucionin që e ka në dispozicion dokumentin dhe jo kërkuesin e dokumentit, ngase kërkuesi i dokumentit nuk është i obliguar doemos për të dhënë arsye të lidhje me atë se për çfarë arsye është duke e parashtruar kërkesën, ndërsa në anën tjetër institucionet janë të obliguara të japin shpjegime për arsyen e refuzimit të kërkesës.

Mirëpo, LQPD përmban mangësi! Ligji nuk e specifikon qartë se cila është Gjykata kompetente për trajtimin rasteve që lidhen me mohimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Neni 10 i Ligjit në të cilin flitet për rastet e mos përgjigjes së institucionit publik theksohet vetëm se: *“Refuzimi i kërkesës së kërkuesit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuesit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.”*

Përveç se i njuh të drejtën kërkuesit që *“[...] të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi”*, ligji nuk përcakton shprehimisht institucionet tjera publike me fuqi ekzekutive që mund të obligojnë përgjegjësit në kuadër të këtyre institucioneve për të respektuar dhe zbatuar të drejtën e garantuar për qasje në dokumentet publike. Orientimi i palës në drejtimin e papërcaktuar të *“[...] institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, [...]”* nuk i ndihmon në asnjë mënyrë kërkuesit për të realizuar të drejtën e tij të garantuar. Përkundrazi, ky orientim është konfuz dhe në të vërtetë paraqet një ikje nga përgjegjësia e konkretizuar institucionale.

Në raste të tilla, kërkuesit, në rast refuzimi të kërkesës për qasje, përveç *Institucionit të Avokatit të Popullit*, i cili në rastin më të mirë *“[...] ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar”*,¹⁵⁴ pa fuqi ekzekutive, nuk i mbetet tjetër përveç se *“[...] ti drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike”*,¹⁵⁵ mirëpo pa i treguar atij se cilat janë ato *“[...] institucione të tjera publike”*. Dhe, për ta komplikuar edhe më shumë qasjen në dokumente publike, në rast paqartësie apo

¹⁵² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41.

¹⁵³ Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215, neni 4.

¹⁵⁴ Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215, Neni 17, paragrafi 1: “1. Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar.”

¹⁵⁵ Po aty, neni 17, paragrafi 4: “Pala e pakënaqur në procedurën e realizimit të së drejtës në qasje në dokumente publike, mund ti drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike.”

pakënaqësie “[...] për procedurën për qasje në dokumente publike, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”,¹⁵⁶ e drejton palën në një ligj edhe më të komplikuar. Kjo paraqet një komplikim të mëtejshëm të vetë LQDP-së si dhe të procedurës për realizimin e së drejtës nga palët dhe përbën një ikje nga konkretizimi i përgjegjësive institucionale në rastet e cenimit të kësaj të drejte.

Mangësia më e madhe e LQPD-së, janë vetë kufizimet për realizimin e kësaj të drejte në përgjithësi. Lista e Përjashtimeve të së drejtës së qasjes në dokumente në nenin 12 të LQPD, përbën një kufizim jashtëzakonisht elastik, që i lë fushë jashtëzakonisht të madhe për interpretim arbitrar personit përgjegjës në institucionin përkatës.¹⁵⁷ Në këtë rast, mundësia e interpretimit arbitrar është aq e madhe, sa që çdo kërkesë për dokumente publike mund t’i vishet një kufizim.

Për palët jo shumë të familjarizuara me ligjin, paraqiten një varg problemesh, duke filluar nga identifikimi i institucioneve publike dhe i gjykatës kompetente. Në anën tjetër duket mjaft dekurajuese për qytetarët që t’i drejtohen gjykatës në lidhje me këtë çështje. Bazuar në të dhënat dhe informatat që posedon Avokati i Popullit, ende asnjë gjykatë në Republikën e Kosovës nuk ka nxjerrë ndonjë vendim në lidhje me ndonjë rast që ka të bëjë me refuzimin e qasjes në dokumente publike.

LQPD gjatë zbatimit të tij duhet të harmonizohet edhe me ligjet tjera, sidomos me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Klasifikimi i dokumenteve mbetet një nga çështjet më komplekse në gjithë këtë proces.

Me klasifikimin e dokumenteve do të krijohet një ndarje e qartë mes dokumenteve të qasshme dhe jo të qasshme për publikun, si dhe nuk do të lejohej shumë hapësirë për interpretime subjektive dhe arbitrare të asaj se çka është dokument i klasifikuar. Po ashtu, edhe më tej vazhdon të ketë dilema në lidhje me atë se çka konsiderohet si dokument i cili nuk mund të publikohet. Me rastin e paraqitjes së rasteve të tilla, diskutimet në lidhje me këtë duket se nuk kanë fund.

¹⁵⁶ *Po aty*, neni 25: “Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, për procedurën për qasje në dokumente publike, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.”

¹⁵⁷ *Po aty*, “1. Çdo kërkuar ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:

- 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
 - 1.2. sigurisë publike;
 - 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;
 - 1.4. hulumtimeve disiplinore;
 - 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;
 - 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;
 - 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;
 - 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
 - 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
 - 1.10. mjedisit, apo,
 - 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.
2. Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin.”

Ndonëse shumica e institucioneve publike kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, përgjegjësia për vendimmarrje nuk iu takon atyre, dhe shpesh ka paqartësi edhe në këtë drejtim.

Nisur nga përvoja e deritashme, qytetarët kanë njohuri të pakta ose aspak, në lidhje me të drejtën e tyre për qasje në dokumente publike. Kjo dëshmohet edhe me numrin shumë të vogël të ankesave që paraqiten në IAP.

Numri i rasteve të paraqitura në IAP, përkitazi me mohimin e qasjes në dokumente publike, për vitin 2013 është 31. Nga ky numër, 14 raste janë hapur për hetim, për një (1) rast është hartuar raport me rekomandime, ndërsa 17 ankesa janë hedhur poshtë si të pa bazuara mbi njëri nga bazat ligjore të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit. Bazuar në numrin e ankesave drejtuar IAP në vitin 2013, vërehet një rritje krahasuar me numrin e ankesave parashtruara në vitin paraprak.

Në fund të vitit 2013, IAP ka botuar një Buletin,¹⁵⁸ përmes të cilit mëton të ndërgjegjësojë dhe inkurajojë qytetarët dhe secilin individ, që nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike, të bëhet pjesë e jetës publike në vend. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët, shoqëria civile dhe mediat do të mund të bëhen pjesë e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme e forcimit të demokracisë, transparencës, llogaridhënies dhe ndërtimit të shtetit ligjor.

Nisur nga nevoja e madhe që ka shoqëria kosovare për një administratë të përgjegjshme dhe transparente, Avokati i Popullit e konsideron më se të nevojshme që për institucionet kompetente, në radhë të parë për Qeverinë dhe Kuvendit e Republikës së Kosovës të nxjerrë rekomandime të veçanta.

Rekomandime:

- *Qeveria e Kosovës të shtojë aktivitetet për rritjen e vetëdijes për të drejtën e qasjes në dokumente publike nëpërmjet fushatave informuese, që për synim do të kishin në rend të parë zyrtarët përgjegjës të institucioneve por edhe qytetarët në lidhje me këtë të drejtë.*
- *Të gjitha institucionet publike të shtojnë dhe intensifikojnë trajnimet e vazhdueshme të zyrtarëve, për të krijuar dhe trajtuar në mënyrë profesionale regjistrat e dokumenteve publike dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve me korrektësi dhe duke respektuar ligjin.*
- *Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të filluar me amendamentimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, për ta bërë këtë ligj të qartë, të thjeshtë dhe të zbatueshëm.*

¹⁵⁸IAP, Buletin "E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike", Prishtinë, 2013.

2.18. Liria e medias

Respektimi i plotë i lirisë së mediave është thelbësor për funksionimin e demokracisë, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Liria e mediave është gjithashtu çështje kyçe për të siguruar që qytetarët të kenë rol aktiv në jetën publike dhe në proceset demokratike.

Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Kosovë garanton Lirinë e Mediave. Ky nen ndalon censurën dhe përcakton se kur është i domosdoshëm pengimi i shpërndarjes së informacionit, pohohet e drejta e korrigjimit të informacionit jo të plotë ose të pasaktë.

Liria e medias është pashmangshmërisht e lidhur me lirinë e shprehjes. Në këtë hallkë, mediat bartin dy role: ato përçojnë informacionin saktë e me profesionalizëm dhe të jenë në këtë mënyrë avokuese të së drejtës për liri të informimit, por në anën tjetër, mediat mund të shndërrohen në instrumente që cenojnë thelbin e lirisë së shprehjes, apo në raste të tjera mund të bëhen edhe shkelëse të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Varësia ekonomike e mediave, si dhe rastet e vakumeve ligjore apo të mosrespektimit të ligjeve përkatëse, e vënë në dilemë lirinë dhe besueshmërinë e mediave, si burim kyç i informacionit. Për IAP-në, mbetet shqetësues respektimi i Ligjit të Punës, në mënyrë të veçantë sa i përket kontratave të punës së gazetarëve të të gjitha profileve. Kjo çështje kërkon vëmendjen e institucioneve kompetente, për të krijuar një ambient më të favorshëm për gazetari cilësore dhe në funksion të informimit të drejtë e të saktë

Fakti se IAP nuk ka pasur asnjë ankesë të drejtpërdrejtë nga ana e medimeve apo individëve që punojnë në gazetarinë e shkruar dhe elektronike, e bën të vështirë për IAP-në identifikimin dhe hetimin e rasteve që kanë të bëjnë me lirinë e mediave në Kosovë.

Duke e vlerësuar si fushë të ndjeshme dhe të rëndësishme dhe me qëllim të perceptimit sa më të saktë lidhur me lirinë e mediave në vend, IAP ka përpiluar një pyetësor, i cili është drejtuar në E-mail adresa të gazetarëve, kameramanëve, foto/reporterëve dhe redaksive të mediave në Kosovë.¹⁵⁹ Nga përgjigjet e pranuar, janë identifikuar së paku dy raste të cenimit të lirisë së mediave, përfshirë këtu kërcënimin fizik dhe verbal ndaj gazetarëve.¹⁶⁰

Megjithatë, bazuar në shqetësimet e ngritura publikisht, vërehen një varg shkeljesh që e cenojnë rëndë lirinë e medias. Shpërthimi në shtëpinë e z. Mufail Limani, kryeredaktor në RTK, ka ngjallur reagim në vend por edhe tek organizatat ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Rasti i gazetares së “Zërit”, znj. Besiana Xharra, e cila është kërcënuar nga drejtuesit e kompanisë “BelleAir”, ashtu si edhe sulmi në Prishtinë, në dhjetor 2013, ndaj gazetares dhe kameramanit të Koha Vizionit nga një person privat, derisa ata po kryenin detyrën e tyre, rikujton ndjeshmërinë dhe rrezikun e punës së gazetarëve.

Në anën tjetër, reagime publike, po ashtu, kanë ngjallur edhe rastet kur mediat kanë qenë në pozitën e shpërdoruesit me lirinë e garantuar, duke cenuar në këtë mënyrë nenin 17 të

¹⁵⁹ I hartuar nga IAP, një pyetësor me 10 pyetje dhe 3 nën pyetje, është përcjellë më 30 dhjetor 2013 në 260 E-mail adresa të gazetarëve, kameramanëve, (foto) reporterëve dhe redaksive lidhur me lirinë e medias.

¹⁶⁰ Përkundër afatit kohor prej më se 10 ditësh, në IAP kanë arritur vetëm 1% e pyetësorëve me përgjigje.

KEDNJ,¹⁶¹ që ka të bëjë me ndalimin e shpërdorimit të së drejtës. Rast i tillë ka qenë plasimi dhe afishimi nga mediat i videos së sulmit fizik e verbal të një nxënëseje të mitur kundrejt një bashkëmoshatareje të saj në tetor, në Mitrovicë. Gjithashtu, në shtator 2013, një foto denigruese e presidentes së vendit, e nxjerrë fillimisht nga një portal elektronik në Kosovë dhe e afishuar me pas nga portalet e tjera, televizionet dhe mediat e shkruara, shënon shpërdorim të lirisë së medias dhe cenon kategori të tjera të të drejtave të individit.

Në përfundim të vitit 2013, IAP është njoftuar përmes një letre drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK), lidhur me shqetësimin e tyre për shkak të përpjekjeve për emërim dhe emërimet e personave të involvuar në politikë në KPM. Përkundër faktit se IAP ka ndjekur rrjedhën e debatit lidhur me këtë çështje, në respektim të pavarësisë dhe kompetencave specifike të KPM-së, konsideron se kjo është një fazë kur IAP mund të luajë rolin e vëzhguesit, por nuk mund të ndërhyjë.

2.19. Liria e tubimit

Liria e tubimit është e drejtë themelore në një shoqërie demokratike, e cila u garanton qytetarëve të drejtën e tubimit. Kjo e drejtë në Republikën e Kosovës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁶² dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme në Kosovë.

Kjo e drejtë po ashtu është e rregulluar me Ligjin mbi Tubime Publike (LPT) në bazë të së cilit qytetarët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë, ndërsa shteti (organet kompetente) marrë masa për mbrojtjen e kësaj të drejte.

LTP përmban kushtet e përgjithshme për një tubim publik. Megjithatë, ky ligj ka mangësi, për të cilat Avokati i Popullit ka ngritur shqetësimet në raportet vjetore të mëparshme. Këto shqetësime kanë të bëjnë me nenin 12 të LTP (pika 2 dhe 3), i cili është në kundërshtim me parimet e nenit 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁶³

Kjo ka të bëjë me rolin e caktuar për “*kujdestarët*” e caktuar nga organizatorët e protestave. Atyre në asnjë mënyrë nuk mund tu delegohet e drejta apo edhe detyrimi që në rast eskalimi të situatës nga ndonjë pjesëmarrës në tubimin publik, të kujdeset që “*ta kapë dhe ta dorëzojë te policët pjesëmarrësin apo personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik, nëse i prish rendin, qetësinë, nëse mban armë ose objekte të rrezikshme ose shenja të ndaluara*”. Kjo është detyrë ekskluzive e autoriteteve shtetërore, të ndërmarrin masa të nevojshme në situatë të caktuar.

¹⁶¹ KEDNJ, neni 17: “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.”

¹⁶² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 43: “Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to”.

¹⁶³ Ligji për Tubimet Publike nr. 03/L-118, neni 12, paragrafi 3: “Kujdestari menjëherë duhet që të kap dhe dorëzoi tek policët pjesëmarrësin apo personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik nëse prish rendin, qetësinë, mban armë apo objekte të rrezikshme apo shenja të ndaluara.”

Avokati i Popullit, sikurse edhe në Raportet vjetore të vitit të kaluar rekomandon që neni 12, paragrafi 3 i LPT, të ndryshohet dhe të plotësohet në mënyrë që të harmonizohet me standardet evropiane.

Sa i përket ankesave gjatë kësaj periudhe të raportimit IAP ka pranuar vetëm një (1) ankesë lidhur me cenimin e lirisë së tubimit.¹⁶⁴ Sikurse viteve të kaluara IAP edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit ka vazhduar bashkëpunimin me Policinë e Republikës së Kosovës, si dhe ka monitoruar dy protesta për të cilat janë publikuar raporte. Nga informacionet e pranuar nga Policia e Kosovës, numri i tubimeve publike, përmes të cilave qytetarët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, është tregind e dyzet e pesë (345).¹⁶⁵

Avokati i Popullit, me qëllim të mbikëqyrjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka monitoruar zhvillimin e ngjarjeve të 30 marsit 2013, protestë kjo e organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje, në Mitrovicë.

Në kuadër të këtij monitorimi nga IAP u vëzhguan edhe hyrjet e qytetit për të shikuar se a u lejohet protestuesve të cilët më parë kanë paralajmëruar këtë protestë, që të hyjnë dhe të mblidhen pa ndonjë incident.¹⁶⁶ Nuk është raportuar për ndonjë incident të mundshëm, prandaj edhe nuk ka pasur elemente të shkeljes apo veprimeve nga ana e Policisë së Kosovës. Autoritetet po ashtu janë kujdesur që edhe kur protestuesit nuk përfshihen në aktet e dhunës: *“të tregojnë shkallë të lartë të tolerancës kundrejt tubimeve paqësore nëse liria e tubimit, e garantuar nga neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, nuk është për t’u privuar nga substanca e saj.”*¹⁶⁷

Avokati i Popullit ka hapur hetime *ex officio*, në lidhje me ngjarjet në protestën e organizuar nga një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve të energjisë elektrike të cilët ankoheshin përmes rrjetit social facebook, se faturat e shpenzimit të energjisë elektrike të shpërndara nga KEK-u, për muajin janar 2013, janë shumë të larta. Për këtë arsye IAP ka monitoruar nga afër rrjedhën e protestës së organizuar.

Rekomandim:

- ***Për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës që të ndërmarrin veprime për plotësim ndryshimin e Ligjit për Tubime Publike, respektivisht të nenit 12, paragrafi 3, në mënyrë që ai të jetë në përputhje të plotë me Nenin 11 të KEDNJ për lirinë e tubimit dhe të organizimit.***

¹⁶⁴ IAP, rasti i regjistruar A.nr.604/2013.

¹⁶⁵ IAP përmes postes elektronike, ka pranuar informacionin nga Policia e Kosovës, dhjetor 2013.

¹⁶⁶ IAP, Raporti i datës 30 mars 2013, nga monitorimi i protestës së organizuar më 7.3.2013, në Prishtinë.

¹⁶⁷ KEDNJ, neni 11.

2.20. Liria e asociimit

Liria e asociimit është një e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (KRRK),¹⁶⁸ KEDNJ¹⁶⁹ dhe Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, për qytetarët për t'u bashkuar me të tjerët në sindikata, shoqata, organizata joqeveritare, parti politike dhe në asociacione të ndryshme.

Gjatë këtij viti janë vërejtur përparime në drejtim të krijimit të kushteve për ndërtimin e një marrëdhënie konstruktive ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Këtu vlen të përmendet hartimi i Strategjisë Qeveritare dhe Planit të Veprimit për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 nga ana e Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë dhe iniciativës së organizatave të shoqërisë civile Platforma CiviKos.¹⁷⁰

Më 5 korrik 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi strategjinë dhe planin e veprimit e cila është strategjia e parë e bashkëpunimit të Qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë.¹⁷¹ Kjo strategji ka për objektive kryesore fuqizimin e shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e politikave të legjislacionit, ngritjen e sistemit për kontraktimin e shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile, ngritjen e sistemit të mbështetjes financiare të shoqërisë civile dhe zhvillimin e vullnetarizmit.

Një nismë e ngjashme është ndërmarrë edhe nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku është krijuar një grup punues i përbashkët i Kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile, për hartimin e një deklaratë përmes së cilës shprehet zotimi i Kuvendit për ta njohur rolin e shoqërisë civile dhe ngritjen e bashkëpunimit në nivel partneriteti. Fillimisht, gjatë këtyre muajve pritet të miratohet deklarata e lartpërmendur në Kuvend, si fazë e parë e formalizimit dhe strukturimit të bashkëpunimit, kurse në hapat më tutjeshëm pritet të hartohet strategjia dhe plani i veprimit për bashkëpunim midis Kuvendit dhe shoqërisë civile.¹⁷²

Po ashtu, edhe sa i përket mbështetjes financiare të shoqërisë civile, IAP gjatë këtij viti ka vërejtur se janë ndërmarrë hapa pozitivë në drejtim të financimit dhe mbështetjes së OJQ-ve nga ana e institucioneve shtetërore, për realizimin e projekteve dhe nismave të tyre.¹⁷³

¹⁶⁸ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 44: "1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente."

¹⁶⁹ *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, neni 11.

¹⁷⁰ *Iniciativa e Organizatave të shoqërisë civile në Kosovë*, Platforma Civikos, në: <http://www.civikos.net/> (18.02.2014).

¹⁷¹ *Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës*, nr. 03/138 datë 5 korrik 2013, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/vendimet_e_mbl_138.pdf (18.02.2014).

¹⁷² Intervistë me z. Driton Selmanaj Menaxher i Programit në Institutin demokratik i Kosovës, anëtar i grupit punues midis Kuvendit dhe Shoqërisë civile.

¹⁷³ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, *Komunikatë për mjetet e informimit* "MKRS ndanë mbi 150 mijë euro subvencione për projektet e organizatave rinore", 29 mars 2013, në: <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,528> (18.02.2014).

Avokati i Popullit konsideron se me gjithë hapat e ndërmarrë gjatë viteve të fundit për krijimin e hapësirës që shoqëria civile të jetë pjesë e proceseve të politik-bërjes, është i domosdoshëm një angazhim edhe më i madh i institucioneve shtetërore për t'i krijuar hapësirë reale shoqërisë civile, që edhe objektivisht të jetë pjesë e proceseve të rëndësishme që lidhen me zhvillimin demokratik dhe ekonomik të vendit.

Në Raportin e Progresit për vitin 2013 për Kosovën, Komisioni Evropian ndër të tjera ka cekur se, autoritetet qendrore dhe lokale kanë nevojë të përmirësojnë bashkëpunimin me shoqërinë civile, sidomos sa i përket përshkrimit dhe ekzekutimit të shërbimeve publike.¹⁷⁴

Sa i përket lirisë së asociimit, një çështje që duhet përmendur është edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e neneve: 90; 95, pika 1.6; 110; 111 dhe 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹⁷⁵

Nisur nga përparimet e bëra në aspektin e fuqizimit të shoqërisë civile dhe të veprimeve të ndërmarra për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile, Avokati Popullit përshëndet të gjitha këto veprime dhe inkurajon për intensifikimin e përpjekjeve të bashkëpunimit dhe të fuqizimit të mëtutjeshëm të shoqërisë civile në Republikën e Kosovës edhe në sferën e pavarësimit dhe forcimin e bazës së saj shoqërore.

2.21. Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes

E drejta për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur është një nga të drejtat themelore të njeriut, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹⁷⁶ si dhe me aktet juridike ndërkombëtare më të rëndësishme.¹⁷⁷

Edhe pse në Kosovë ka filluar procesi i reformës zgjedhore që para gati tri vitesh, ajo as ka përfunduar në mënyrë të rregullt dhe as përbën një reformë. Për shkak të papajtueshmërisë midis subjekteve politike më të mëdha, reforma zgjedhore në Kosovë ka rënë në një ngërç.

¹⁷⁴ Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit 2013 për Kosovën*, 16 tetor 2013, në: http://www.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_%28alb%29_%282%29.pdf (18.02.2014).

¹⁷⁵ Aktgjykimi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, për rastin KO 97/12, publikuar më 12 prill 2013. Gjykata Kushtetuese fillimisht në dhjetor 2012 miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit dhe vendosi të lejojë masën e përkohshme për pezullimin e zbatimit të neneve të lartpërmendura të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare deri në një vendim meritator të kësaj gjykate. Po ashtu Gjykata Kushtetuese në janar 2013 vazhdoi masën e përkohshme të pezullimit të ligjit, ndërsa më 5 mars 2013 ftoi në seancë publike IAP dhe disa institucione tjera për të paraqitur fjalën e tyre lidhur me çështjen e lartpërmendur. Pas këtyre veprime të lartpërmendura Gjykata Kushtetuese me 14 mars 2013, nxori aktgjykim përmes së cilit miratoi kërkesën e IAP dhe shfuqizoi si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenin 90; nenin 95, pika 1.6; nenin 110; nenin 111 dhe nenin 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. në:http://www.gjkk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_97_12_shq_.pdf(18.02.2014).

¹⁷⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45.

¹⁷⁷ *Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut*, neni 21.3; *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 25 (b); *Protokollin nr. 1i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)*, neni 3.

Zgjedhjet lokale për vitin 2013 janë mbajtur pa përfunduar kjo reformë, ndërsa është krejt e pasigurt nëse zgjedhjet nacionale do të mbahen pas një reforme dhe ndryshimi të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme nacionale.

2.21.1. Vëzhgimi i zgjedhjeve komunale në Kosovë

Në muajin nëntor të vitit 2013, në Republikën e Kosovës janë organizuar zgjedhjet komunale për të gjitha komunat e Kosovës. Për herë të parë pas përfundimit të luftës në Kosovës, zgjedhje për institucionet e Republikës së Kosovës sipas ligjeve në fuqi të Kosovës, janë organizuar edhe në komunat e banuara me popullsi shumicë serbe. Këto zgjedhje janë organizuar edhe në komunat e pjesës veriore të Kosovës: Mitrovicë, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Raundi i parë i zgjedhjeve lokale është mbajtur më 3 nëntor 2013, ndërsa raundi i dytë më 1 dhjetor 2013. Përveç përsëritjes së zgjedhjeve më 17 nëntor në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në raundin e dytë në Partesh më 15 dhjetor, për shkak të sulmeve nga grupe të caktuara me qëllime politike për dëmtimin e procesit zgjedhor në Kosovë, në vendet tjera nuk janë regjistruar parregullsi të tilla që do të detyronin Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të përsërisë zgjedhjet. Sipas Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës,¹⁷⁸ mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve lokale në Kosovë dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga disa parime, siç janë:

- Zgjedhjet Komunale mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe rregullave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ-së.
- Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë për të votuar dhe të zgjidhet pa diskriminim.
- Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, ta detyrojë atë të votojë në mënyrë të veçantë, ta mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë, kundër dëshirës së tij/saj, që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mosvotim.
- Të gjitha subjektet politike janë të lira të bëjnë fushatë dhe kanë mundësi të barabartë për emisione në radio dhe televizion, fonde publike dhe forma tjera të përkrahjes.
- Përdorimi i posteve publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion me qëllim të përkrahjes subjektivit politik në zgjedhje është rreptësisht i ndaluar.
- Subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civil dhe të përdorin burimet ose personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve.
- Të gjitha subjektet politike, përkrahësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera, janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë ligj dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta

¹⁷⁸ Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nr. 03/L-072, neni 3.

dhe të mirë-informuara brenda klimës së tolerancës demokratike dhe respektit për sundimin e ligjit.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës,¹⁷⁹ raundi i parë i zgjedhjeve lokale për kryetar të komunave dhe për kuvende komunale, është zhvilluar më 3 nëntor 2013.

Fushata zgjedhore e subjekte politike u zhvillua në periudhën 3 tetor - 1 nëntor 2013. Përgjithësisht, fushata zgjedhore ka kaluar në atmosferë të qetë dhe pa incidente, përveç në pjesën veriore të Kosovës ku kundërshtitë për dhe kundër mbajtjes së zgjedhjeve kanë kulmuar me kërcënime, sulme verbale e fizike dhe akte tjera të dhunës.

Gjatë fushatës ka pasur raste të shfrytëzimit të lokaleve shkollore për tubime elektorale të subjekte politike gjatë orarit mësimor si dhe të përfshirjes së fëmijëve në fushatë, gjë që paraqet shkelje të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së për fushatën zgjedhore dhe njoftimin për ngjarjet politike.¹⁸⁰ Shkollat mund të përdoren për tubime publike vetëm nëse KQZ dhe Qeveria e Kosovës me marrëveshje vendosin për këtë dhe atë vetëm pas orarit të punës.¹⁸¹

IAP ka monitoruar procesin e Zgjedhjeve me 12 ekipe vëzhguese mobile në tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë pjesërisht edhe veriun e Mitrovicës dhe fshatin Çabër të Zubin Potokut, me përjashtim të komunave Leposaviq e Zveçan, si dhe Zubin Potok.¹⁸² *Ekipe vëzhguese të IAP-së kanë vizituar 131 Qendra të Votimit (QV) dhe 407 Vendvotime (VV) nga gjithsej 798 QV me 2366 Vendvotime në 38 komuna të Republikës së Kosovës.*

Zgjedhjet lokale të 3 nëntorit 2013 në përgjithësi kanë qenë të organizuara mirë, përkundër disa lëshimeve, kryesisht të natyrës teknike, por të cilat nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të votimit. Në përgjithësi dita e votimit ka kaluar qetë dhe pa incidente të theksuara, pos në veriun e Mitrovicës ku gjatë tërë ditës grupe të njerëzve të cilët ishin kundër organizimit të zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes së qytetarëve serbë në to kanë provokuar, fyer dhe kërcënuar qytetarët që kanë shkuar në QV për të votuar.

Edhe këtë herë u dëshmuua se me vullnetin e mirë, vendosmërinë e të gjithë faktorëve relevantë të rendit, sigurisë dhe drejtësisë si dhe informimin e drejtë, është i mundur ofrimi i sigurisë për të gjithë qytetarët që të gëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të shprehur lirshëm vullnetin e tyre zgjedhor përmes votës.

¹⁷⁹ *Po aty*, neni 4.

¹⁸⁰ *Rregulla Zgjedhore nr. 13/2013*. Fushata zgjedhore dhe njoftimi për ngjarjet politike, neni 4.1 dhe neni 5.2.

¹⁸¹ *Po aty*, neni 4.1.

¹⁸² Për shkak të rrezikut për jetën dhe sigurinë, më 3 nëntor 2013, Policia e Kosovës ka udhëzuar Avokatin e Popullit që të mos udhëtojë në pjesën veriore të Kosovës me bashkëpunëtorët e tij. Pas kërkesës që megjithatë të dërgohen 1 ose 2 ekipe mobile në atë pjesë të Kosovës, Policia e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të garantojë për sigurinë e njerëzve dhe të automjeteve, prandaj edhe nuk ka pranuar të përcjellë asnjërin nga ekipet mobile të IAP. Dalja e një ekipi mobil të IAP është bërë pa kurrfarë sigurimi dhe në mënyrë të pavarur dhe individuale.

2.21.2. Rastet konkrete të shkeljeve të regjistruara

Para disa QV në pjesën veriore të Mitrovicës, numri i policëve ka qenë i vogël dhe gradualisht në orët e pasdites është zvogëluar edhe më shumë, kështu që rreth orës 15:30, para QV 3805B (me 16 vendvotime) në Shkollën Filllore “Sveti Sava” nuk vërehej fare prania e policisë. Pas orës 16:00 është ndërprerë votimi në dy QV më të mëdha 3805B dhe 3805X, kur disa dhjetëra persona kanë hyrë nëpër vendvotime, kanë sulmuar personat e pranishëm në QV si votues apo menaxhues të QV dhe kanë shkatërruar materialin zgjedhor.

Incidente ka pasur edhe në QV 3401E në Graçanicë. Policia i ka ndaluar 4 anëtarë të subjektit politik “Savez Kosovskih Srba” (Lidhja e Serbëve të Kosovës) me dyshim se para kësaj QV u kanë ofruar të holla qytetarëve që të votojnë për këtë subjekt politik. Të gjithë të arrestuarve u është caktuar paraburgimi prej 48 orëve.

Ndërsa, në vendvotimin QV 3401E/02R, po ashtu në Graçanicë, me kërkesë të anëtarëve të KVV-së, policia ka larguar nga vendvotimi një vëzhgues, i cili ka penguar procesin e votimit duke fyer votuesit dhe duke iu bërë presion atyre që të tregojnë se për kënd kanë votuar, ndërkohë ka tentuar që fizikisht t’i pengojë disa votues të shkojnë te paravanet dhe të votojnë.

Rast evident i diskriminimit ishte ai në QV 1315E/01D në Lipjan me mbishkrimin ASHKALIT, duke u veçuar kështu në mënyrë diskriminuese si vendvotim vetëm për këtë komunitet, edhe pse vërehej që ata votonin edhe në vendvotimet tjera dhe nuk kishte ndonjë arsye të veçantë për një dallim të tillë.

Mangësitë e identifikuara gjatë monitorimit:

- *Llambat verifikuese ultravjollce* në përgjithësi kanë qenë funksionale, por në disa raste të rralla ato nuk kanë funksionuar si duhet për shkak të baterive të dobëta apo ka pasur mungesë të llambave rezervë, pas vërejtjeve të kryesuesve të Këshillit të Vendvotimit (KVV) dhe të menaxherëve të QV-ve janë mënjeluar.
- Në një mori rastesh *dhënësve e fletëvotimit* (anëtar të KVV-së), të cilët njëherit kanë bërë edhe spërkatjen e gishtit të votuesit me ngjyrën e padukshme, në mungesë të dorëzave u janë lagur gishtat me këtë ngjyrë dhe pastaj kanë hasur në probleme për të votuar, nëse kanë votuar në një vendvotim tjetër nga ai ku kanë qenë me detyrë si anëtar të KVV-ve. Të përkujtojmë se anëtarët e KVV-ve kanë pasur mundësi të votojnë të parët, para fillimit të procesit të votimit, në bazë të dispozitave të Rregullës Zgjedhore përkatëse të KQZ-së,¹⁸³ por jo çdo herë ata caktohen në vendvotimet ku edhe votojnë.
- Te një numër i anëtarëve të KVV-ve ka pasur *paqartësi se kush ka të drejtë të ndihmojë votuesit me aftësi të kufizuar dhe/ose analfabet*, duke ua mohuar anëtarëve të familjes t’iu ndihmojnë familjarëve të tyre në këtë gjendje. Rregulla Zgjedhore përkatëse e KQZ-së thekson qartë se anëtarët e KVV-ve dhe vëzhguesit e akredituar nuk mund t’iu ofrojnë ndihmë asnjë votuesi, por këtë mund ta bëjnë familjarët ose njëri nga votuesit që presin në rresht për të votuar, dhe atë vetëm për një votues.¹⁸⁴ Personi që pranon të asistojë votuesin do të shënojë me shkronja

¹⁸³ Rregulla Zgjedhore nr. 09/2013. Votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i QV-së, neni 19.1.

¹⁸⁴ Po aty, neni 15.5.

të shtypit emrin e tij/saj dhe do të shënohet në Listën Votuese përkatëse, pranë emrit ose hapësirës së votuesit që është asistuar.¹⁸⁵ Ekipet vëzhguese të IAP-së në disa raste kanë vërejtur se i njëjti person u ka asistuar gjatë votimit dy anëtarëve të familjes (prindërve të tij).

- Edhe në Ditën e Votimit, *posterët dhe bilbordet e subjekteve politike, me fotografi të kandidatëve për kryetar komune dhe të kandidatëve për kuvende komunale kanë qenë të vendosura në distancë më të shkurtë se 100 metra nga QV-të*. Kjo është e ndaluar me Rregullën Zgjedhore përkatëse të KQZ-së, ku theksohet se ato duhet të mënjanohen që në ditën e heshtjes zgjedhore, pra së paku 24 orë para fillimit të procesit të votimit. Përgjegjës për heqjen e tyre janë menaxheri i QV-së së bashku me stafin teknik për materialet në rreze prej 100 metrave nga QV si dhe KVV-të për materialet brenda vendvotimit.¹⁸⁶
- *Në Listat Përfundimtare të Votuesve ende figurojnë një numër i konsiderueshëm emrave të personave që kanë vdekur*. Raste të këtilla ka në të gjitha komunat.
- *Personat me aftësi të kufizuara (në karroca) në shumë raste nuk kanë mundur të kenë qasje të papenguar në vendvotime, për shkak të mungesës së pjerrinave përkatëse në objektet që kanë qenë të caktuara si QV, ndër to edhe objekti ku gjendet Zyra Administrative e Qeverisë së Kosovës në Lagjen e Boshnjakëve në veriun e Mitrovicës*.
- *Ka pasur raste kur kabinat e votimit kanë qenë në aso pozita që nuk kanë garantuar fshehtësinë e votës*.
- *Në QV në Shtëpinë e Kulturës në Lipjan, shënimi në Librin e Votimit fillimisht është bërë me laps të thjeshtë, por pas dhënies së këshillës nga ekipi vëzhgues i IAP-së, shënimi ka vazhduar të bëhej me laps kimik*.
- *Gjatë vëzhgimit në fshatin Ratkoc, komuna e Rahovecit, menaxheri i kësaj qendre e ka njoftuar ekipin vëzhgues mobil të IAP-së se një numër i konsiderueshëm i votuesve janë ankuar për shkak se *vendvotimi u është caktuar në largësi deri në 15 km. nga vendbanimi i tyre*. Rregulla Zgjedhore përkatëse e KQZ-së e specifikon shumë qartë se “Asnjë votues mundësisht, nuk duhet të udhëtojë më shumë se 3 km deri në vendvotimin e tij apo të saj”.¹⁸⁷*
- *Disa policë nga Vushtrria të cilët në Ditën e Votimit janë sjellë për të shërbyer në Mitrovicë prej orës 7:00 - 19:00 nuk kanë pasur mundësi të ushtrrojnë të drejtën e tyre të votës*. Ata janë ankuar për këtë çështje dhe kanë kërkuar që të gjendet mundësia e realizimit të kësaj të drejte edhe nga policët që në Ditën e Votimit kanë qenë në detyrë, pikërisht në periudhën e procesit të votimit. IAP, ka kërkuar informacion nga KQZ për t’u njoftuar se si është rregulluar çështja e votimit të policëve në detyrë jashtë komunës së tyre gjatë kohës së votimit. Përgjigja nga KQZ ka qenë: “Policët që janë në detyrë në vendin e njëjtë ku jetojnë, mund të votojnë në çdo kohë, por KQZ nuk ka paraparë zgjidhje për policët në detyrë që janë dërguar në një vend apo komunë tjetër nga atje ku jetojnë, për realizimin e të

¹⁸⁵ Po aty, neni 15.6.

¹⁸⁶ Po aty, neni 12.

¹⁸⁷ Po aty, neni 3.2.

drejtës së tyre për të votuar”. Ky nuk ka qenë rasti i vetëm, kur policët në detyrë, apo edhe personeli shëndetësor në kujdestari (siç ishte rasti në Spitalin Rajonal në Gjakovë) nuk kanë mundur të realizojnë të drejtën e votimit. Ç’është e vërteta, as Rregullat Zgjedhore të KQZ-së nuk kanë paraparë kurrfarë zgjidhje për raste të tilla.

Vëzhgimi i votimit nëpër qendrat korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, shtëpinë e përkujdesjes së pleqve në Prishtinë dhe spitale:

- Në *Qendrën Korrektuese në Dubravë*, kanë votuar 85 të burgosur (të gjithë me kusht). Ky vendvotim është mbyllur në orën 14.00 me arsyetim se nuk ka pasur të interesuar tjerë për votim dhe nuk kanë qenë të pajisur me dokumente identifikimi.
- Në *Qendrën Korrektuese në Smrekonicë*, kanë qenë të regjistruar 184 votues. Në kohën kur ekipi vëzhgues mobil i IAP-së ishte në këtë qendër (ora 11:00) votimi nuk kishte filluar. Sipas koordinatorit për votim pritej arritja e materialit zgjedhor nga KQZ. Më vonë ai ka konfirmuar se procesi i votimit kishte filluar në orën 11:30.
- Në *Qendrën Korrektuese në Lipjan* është votuar me kusht dhe kanë munguar listat e kandidatëve të subjekteve politike për kuvende komunale. Po ashtu, në këtë qendër nuk janë dërguar fare fletëvotimet për votuesit nga komuna e Deçanit dhe Mamushës, ndërsa fletëvotimet nga komuna e Fushë Kosovës kanë qenë në numër jo të mjaftueshëm.
- Në *Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë* të burgosurit kanë votuar me kusht. Prej 65 të burgosurve, kanë votuar 39 prej tyre. Pos listës së kandidatëve për këshilltarë të kuvendit komunal të Prishtinës, ka munguar lista me kandidatë për komunat tjera, prandaj të burgosurit nga komunat tjera kanë mundur të votojnë vetëm për kandidatët për kryetarë të komunës dhe subjektin politik për kuvend komunal.
- Në *Qendrën e Paraburgimit në Pejë* ka pasur vonesë në hapjen e QV-së për shkak të mungesës së një anëtari të KVV-së. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të identifikimit kanë votuar vetëm 35 nga gjithsej 87 të burgosur. Vendi i ndarë për votim nuk i ka plotësuar kushtet e nevojshme për fshehtësinë e votimit, pasi që KQZ nuk i ka pajisur me kabina për votim.
- Në *Qendrën e Paraburgimit në Prizren* procesi i votimit ka filluar në orën 9:00 dhe ka përfunduar në orën 13.00. Nga 89 të burgosur kanë votuar vetëm 8 prej tyre.
- Në *Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë* të drejtën e votimit e kanë realizuar vetëm 4 të paraburgosur (3 nga Graçanica dhe 1 nga Fushë Kosova). Rreth 20 të paraburgosur të tjerë nuk kanë mundur të votojnë. Zëvendësdrejtori i Qendrës së Paraburgimit ka deklaruar se ata i kanë dërguar me kohë Shërbimit Korrektues të Kosovës listën me kërkesën e të paraburgosurve dhe të dënuarve për t’iu mundësuar votimi dhe kjo listë është nënshkruar nga vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit.

- Në *Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare* (Shtëpia e Pleqve) në *Prishtinë* procesi i votimit ka filluar në orën 10:00.
- Në *Qendrën Klinike e Universitare të Kosovës (QKUK)* në *Prishtinë* nuk ka pasur votim. Ekipi vëzhgues mobil i IAP-së ka vizituar QKUK-në dy herë gjatë ditës së votimit. Në bisedën telefonike me drejtorin e Departamentit të Operacioneve Zgjedhore të KQZ-së u informuam se QKUK nuk ka dorëzuar në KQZ listën e votuesve, prandaj nuk është organizuar procesi i votimit.
- As në *Spitalin Rajonal në Ferizaj* nuk ka pasur vendvotim. Sipas drejtorit të spitalit, arsye për këtë është fakti se në spital nuk ka pasur pacientë të palëvizshëm, ndërsa ata që kanë dëshiruar të votojnë, janë liruar nga spitali.
- Procesi i votimit nuk është zhvilluar as në *Spitalin Rajonal në Gjakovë*. Në mungesë të ekipit mobil të KQZ-së, të drejtën e votimit nuk kanë mundur ta shfrytëzojnë disa dhjetëra pacientë, por as personeli shëndetësor në kujdestari.
- Në *Institutin e Shëndetit Mendor (ISHM)* në *Shtime* procesi i votimit kishte përfunduar në orën 11:00. Në kohën kur ekipi vëzhgues mobil i IAP-së ishte në këtë institut, aty nuk gjendej asnjë person kompetent për të dhënë ndonjë informatë zyrtare. Më vonë, drejtori i ISHM-së informoi ekipin vëzhgues se kutitë e votimit janë dërguar në Institut pa kurrfarë paralajmërimi. Ai theksoi se kanë votuar 26 pacientë dhe pothuajse gjysma e tyre nuk kanë pasur aftësi gjykimimi.

2.21.3. Monitorimi i rivotimit në veriun e Mitrovicës më 17 nëntor 2013

Më 17 nëntor 2013, është zhvilluar procesi i rivotimit në 3 QV (me 29 vendvotime) në pjesën veriore të Mitrovicës. Ekipi vëzhgues i IAP-së ka monitoruar procesin e rivotimit në 20 vendvotime në këto QV.

Në të gjitha QV, përreth tyre vërehej numër shumë i madh i forcave të rendit dhe sigurisë. Në afërsi të drejtpërdrejtë të QV-ve gjendeshin policët e EULEX-it dhe policë të Policisë së Kosovës, ndërsa në distancën prej 50-100 metra prej tyre qëndronin pjesëtarë të uniformuar me mbishkrimin "Civilna Zaštita". Nuk janë vërejtur incidente apo konflikte që do të prishnin rendin dhe do të rrezikonin sigurinë e votuesve, por megjithatë vërehej gjendje e tensionuar.

Avokati i Popullit falënderon ekipet e Policisë së Kosovës, nën udhëheqjen e z. Besim Hoti, zëvendës-drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në pjesën veriore, për përcjelljen e vazhdueshme dhe sigurinë e ekipeve vëzhguese të IAP-së gjatë tërë procesit të monitorimit.

Gjatë monitorimit janë evidentuar këto shkelje dhe lëshime të dëshmuara:

- *Parimi i dygjuhësisë*, përkatësisht barazia e gjuhëve dhe shkrimeve nuk është respektuar në asnjë QV dhe në asnjë vendvotim. Materialet sqaruese dhe orientuese kanë qenë vetëm në gjuhën serbe me alfabetin cirilik, përkundër faktit se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

- Ka pasur vështirësi për të votuar *personat me aftësi të kufizuara dhe ata të moshës së shtyrë* (pleqtë) për shkak se shumë vendvotime kanë qenë në katin e dytë dhe nuk ka pasur pjerrina.
- Janë vërejtur vështirësi të theksuara në *gjetjen e emrave të votuesve në Listat e votuesve*, si rrjedhojë numri i votuesve me kusht ishte më i madh dhe janë paraqitur radhë të gjata të votuesve te vendvotimet me kusht.
- Në shumicën e vendvotimeve në paravanet e votimit ka qenë vetëm Lista me emrat e kandidatëve për kuvendin komunal, por *ka munguar Lista me emrat e kandidatëve për kryetarin e komunës*.
- Në paravanet e votimit në disa vendvotime janë hequr ose *mbuluar apo dëmtuar logot e KQZ-së*.

Duke u bazuar në lëshimet e vërejtura gjatë monitorimit të zgjedhjeve lokale nga ekipet vëzhguese mobile të IAP-së, Avokati i Popullit, ka lëshuar disa rekomandime.

Rekomandime:

- *Të bëhet pajisja me kohë e KVV-ve me tërë materialin e duhur për mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjes në Ditën e Votimit.*
- *Të bëhet përzgjedhja adekuate e anëtarëve të KVV-ve dhe trajnimi e testimi i tyre adekuat.*
- *Të rishikohet mundësia e caktimit të anëtarëve të KVV-ve në vendvotimet apo QV ku ata votojnë ose sa më afër QV-ve ku e kanë vendvotimin.*
- *Anëtarët e KVV-ve që kryejnë rolin e Dhënësit të Fletëvotimeve dhe njëherit bëjnë edhe spërkatjen e gishtit të votuesve me ngjyrë të padukshme, të pajisen me dorëza, ashtu që të mënjanohet spërkatja e gishtave të tyre me këtë ngjyrë dhe të votojnë pa problem.*
- *Të korrigjohen Listat Përfundimtare të Votuesve duke i hequr nga to të gjithë emrat e personave të vdekur.*
- *Të gjithë, posterët dhe bilbordet e subjekteve politike, me fotografi të kandidatëve për kryetar komune dhe të kandidatëve për kuvende komunale duhet të largohen para fillimit të heshtjes zgjedhore, së paku 24 orë para fillimit të procesit të votimit.*
- *Të krijohen kushte përkatëse që të gjithë personat me aftësi të kufizuara (veçanërisht ata në karroca) të kenë qasje të papenguar në të gjitha QV-të dhe vendvotimet ku ata votojnë. Në rastet kur kjo nuk është e mundur apo kërkon më shumë kohë për t'u realizuar, këtyre personave t'iu mundësohet votimi në shtëpitë dhe banesat e tyre nga ekipet mobile përkatëse të KQZ-së dhe të KKZ-ve, në pajtim me Rregullën Zgjedhore përkatëse të KQZ-së.¹⁸⁸*

¹⁸⁸ Rregulla Zgjedhore nr. 04/2013. Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, neni 3.

- *Të respektohet parimi i dygjuhësisë në të gjitha QV-të dhe vendvotimet duke përfshirë edhe materialet zgjedhore në tërë territorin e Republikës së Kosovës.*
- *Të rregullohet me dispozita përkatëse ligjore realizimi i të drejtës së votimit për persona të cilët në ditën e votimit, përkatësisht gjatë kohëzgjatjes së procesit të votimit janë në detyrë, përkatësisht kujdestari.*
- *Të përmirësohet komunikimi me votuesit jashtë Kosovës, ashtu që ata të pajisen me kohë me fletëvotime dhe të mund të realizojnë të drejtën e tyre për të votuar, në pajtim me Rregullën Zgjedhore përkatëse të KQZ-së.¹⁸⁹*
- *Të iniciohet procedura penale dhe të vihen para organeve të drejtësisë të gjithë ata që kanë shkaktuar incidente dhe kanë penguar procesin e votimit dhe posaçërisht ata që kanë shkatërruar materialin zgjedhor në QV-të veri të Mitrovicës, ku për pasojë është ndërprerë procesi i votimit dhe janë mbyllur QV-të të sulmuara. Këto raste të gjykohen me urgjencë.*

2.22. E drejta e pronës

E drejta e pronës garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me Protokollin nr. 1 të KENDJ, ndërsa rregullohet me Ligjin për pronën.

E drejta e pronësisë është e drejtë sendore, e cila bartësit të saj (titullarit) i mundëson posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e sendit të caktuar brenda kufijve të paraparë me ligj. Kjo e drejtë prek drejtpërdrejtë interesat ekonomike të subjektit të së drejtës. Titullarit të së drejtës në Republikën e Kosovës, i garantohet që sendin ta posedoj dhe ta përdorë qetësisht, pa u penguar nga askush me Kushtetutë, Konventa Ndërkombëtare dhe me Ligj.

Titullari i së drejtës së caktuar mund të autorizojë persona të tjerë që ta përdorin pasurinë e tij, por këto autorizime (që konsiderohen përdorimi, shfrytëzimi dhe disponimi i sendit), nuk e përjashtojnë titullarin nga posedimi i sendit të tij.

Në raste të caktuara hasim edhe kufizimet në të drejtën e pronës dhe si kufizim të përgjithshëm e hasim ndalimin e keqpërdorimit të të drejtës së pronësisë, sepse nuk lejohet që të përdoret e drejta në dëm të të tjerëve. Bartësit e të drejtës së pronësisë dhe shfrytëzuesit e tjerë janë të obliguar t'i kontribuojnë të mirës së përgjithshme. Në kufizimet e veçanta bën pjesë mundësia e shpronësimit të pronës private, për interes të përgjithshëm. Kjo bëhet me kompensim sipas çmimit të tregut. Shpronësimi bëhet në çdo rast bazuar në ligj.

IAP gjatë vitit 2013 ka pranuar ankesa për privim apo pengim në shfrytëzimin e pronës së tyre.

Rreth 23 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të hetuara në IAP gjatë vitit 2013 ndërlidhen me të drejtën e pronës. Në bazë të statistikave të IAP-së, mund të konkludojmë se krahasuar

¹⁸⁹ Rregulla Zgjedhore nr. 03/2013. Votimi jashtë Kosovës, nenet 3-5.

me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi rritje shqetësuese të ankesave të hetuara të kësaj natyre për 11 %.

Objekt i ankesave të pranuar dhe të trajtuara në IAP, gjatë kësaj periudhe janë si për pronën e luajtshme po ashtu edhe të paluajtshme, si ndaj personave fizik poashtu edhe atyre juridik. Në shumicën e rasteve, për shkak të mosveprimit apo neglizhencës së organeve kompetente për zgjidhjen e problemeve të kësaj natyre, por edhe për shkak të shqetësimeve nga personat e tretë, detyrohen t'i drejtohen gjykatës.

Gjatë periudhës raportuese më së shumti ankesa janë paraqitur kundër Kuvendeve Komunale, Agjencisë Kosovare të Pronës, gjykatave (për shkak të zvarritjeve procedurale), Korporatës Energjetike të Kosovës (tash KEDS), Prokurorive, Policisë së Kosovës, disa Ministrive etj. Por, nisur nga numri i ankuesve, dominojnë ankesat kundër Kuvendeve Komunale, Gjykatave në të gjitha nivelet (përfshirë edhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme), dhe Agjencisë Kosovare të Pronës.

Ankesat janë të natyrave të ndryshme si uzurpime, shpronësime, dëmtim i pasurisë, vjedhje e pasurisë, mosekzekutim i vendimit gjyqësor, mosregjistrim i pronës në regjistrat kadastral, pengim posedimi, zvarritje procedurale, trashëgimi etj.

Ngarkesa me lëndë e gjykatave që kanë të bëjnë me pronën, është mjaft e madhe. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për 3 mujorin e parë të vitit 2013 shihet se vetëm në Gjykatën e Apelit janë duke u zhvilluar procedura për 6.149 lëndë civile, ndërsa në Gjykatat Themelore në Republikën së Kosovës, janë duke u zhvilluar procedura për 48.609 lëndë civile, pa llogaritur këtu edhe 4.682 lëndë trashëgimore të cilat ndërliidhen drejtpërdrejt me të drejtën e pronës.

Në raportet policore shpesh publikohen fakte të cilat dëshmojnë se si pasojë e mosmarrëveshjeve të ndryshme për kontestet pronësore-juridike, kemi raste kur qytetarët provojnë ta marrin drejtësinë në duart e veta. E kjo nuk do të duhej të tolerohej kurrsesi nga shteti.

Shteti me gjithë përpjekjet për t'i aktivizuar mënyrat alternative për zgjidhjen e kontesteve civile-juridike (ndërmjetësimin), akoma nuk ia ka dalë të shkarkojë gjykatat e stërngarkuara më lëndë.

Po ashtu janë të pranishme rastet e vënies në lajthim të pronarëve të caktuar me rastin e transaksioneve të pronave, si dhe shkaktimit të shqetësimeve pronarëve, lidhur me posedimin e qetë dhe të pa penguar të pronave të tyre, nga ana e organeve të administratës, qofshin ato lokale apo qendrore.

Por rastet më të rënda të shkeljes së drejtës së pronës, janë ato kur institucionet publike lokale apo qendrore (komuna apo Qeveria), me rastin e shpronësimit të pronarëve, nuk e përfillin në masën e duhur, apo fare Kushtetutën dhe Ligjin.

Çështja e shpronësimit në Kosovë është e rregulluar me Ligjin mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Ky ligj më tutje përcakton procedurat e shpronësimit ose kufizimit të pronësisë, procedurat për përcaktimin e shumës së pagesës, si dhe afatet e pagesës ndaj titullarit të pronës lidhur me kryerjen e shpronësimit. Ligji në fjalë sqaron, se shpronësimi apo privimi nga e drejta pronësore i kryer nga ana e institucioneve publike (lokale apo qendrore), duhet të jetë i bazuar vetëm në ligj. Përndryshe shpronësimi është i kundërligjshëm dhe arbitrar, dhe se

një trajtim i tillë i pronës, me rastin e shpronësimit konsiderojmë se në esencë e atakon sistemin kushtetues dhe demokratik të një shoqërie.

Sa i përket pjesës veriore të Mitrovicës, gjendja mbetet e pandryshuar në krahasim me raportet e viteve të kaluara, që do të thotë se shumë qytetarë të Republikës së Kosovës janë të privuar nga shfrytëzimi i lirë dhe i papenguar i pronës së tyre në atë pjesë.

Një çështje që kërkon vëmendje dhe trajtim serioz është çështja e zbatimit të vendimeve të formës së prerë të nxjerra nga Agjencia Kosovare e Pronës. Në bazë të informacioneve që posedon Institucioni i Avokatit të Popullit, janë gjithsej 143 persona që u është njohur e drejta e kompensimit lidhur me pronën. Dhe kjo çështje është bartur që nga Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore ndërsa shuma e nevojshme për kompensim është 3.2 milion euro (sipas AKP). Deri në tani nuk është gjetur ndonjë zgjidhje ligjore e financiare dhe kjo paraqet një nga shkeljet me të rënda të të drejtave të njeriut lidhur me pronën, për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë administrative.

Këto dhe shumë raste tjera të regjistruar në IAP, janë dëshmi se ka mjaft shkelje të të drejtave të njeriut për të drejtën e pronës, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventa Ndërkombëtare.

Rekomandime:

- *Qeverisë së Kosovës dhe komunave që të gjitha shpronësimet dhe kompensimin e pronës së shpronësuar t'i bëjnë bazuar në ligjin për shpronësimin.*
- *Gjykatave që të ndërmarrin të gjitha masat e parapara me ligj për përshpejtimin e procedurave për rastet e pengim-posedimit.*

2.23. E drejta për arsimin

E drejta për arsimim, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRRK) parasheh që “*secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi financohet me ligj nga fondet publike.*”¹⁹⁰ Kushtetuta përcakton detyrimin që institucionet publike t’i sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.¹⁹¹ Po këtë e garanton edhe KEDNJ dhe Protokollat e saj.¹⁹²

2.23.1. Edukimi parashkollor

Avokati i Popullit në raportet e vjetore për vitin 2011 dhe 2012, ka rekomanduar që, nëpërmjet rritjes së kapacitetit të infrastrukturës fizike, të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët. Megjithëse ky është një obligim me implikime më të mëdha

¹⁹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47 paragrafi 1.

¹⁹¹ Po aty, neni 47 paragrafi 2.

¹⁹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 paragrafi 2.

financiare dhe kërkon kohë, edhe përkundër këtyre rekomandimeve, në disa komuna kemi numër të vogël të institucioneve parashkollore dhe nuk përmbushen nevojat e qytetarëve, ndërsa në disa komuna nuk kemi fare institucione parashkollore. Në të vërtetë, në ndërkohë nuk është vërejtur ndonjë lëvizje e dukshme në këtë drejtim. Në vitin shkollor 2012/2013, në 42 institucione parashkollore janë përfshirë gjithsej 5'389 fëmijë.¹⁹³

2.23.2. Arsimi parauniversitar

IAP, me qëllim të mbikëqyrjes, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të këtij viti shkollor ka vizituar 27 shkolla fillore të mesme të ulëta në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës, përfaqësues të IAP mbajtën ligjërata lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe bashkëbiseduan me nxënës, psikologë, mësime dhe drejtorë të shkollave.

Nga këto takime, Avokati i Popullit konstaton se shumica e shkollave ballafaqohen me probleme të natyrave të ndryshme. Në disa shkolla mungojnë kushtet themelore sanitare dhe është vështirë të flitet për një mjedis të shëndetshëm fizik. Disa shkollave ju mungon infrastruktura e mirëfilltë dhe nuk mirëmbahen si duhet, në disa shkolla mungojnë kutitë për ankesa,¹⁹⁴ disa komuna kanë dështuar që me kohë të sigurojnë derivatet për ngrohje të objekteve shkollore,¹⁹⁵ ndërsa objektet e lojërave të fatit në shumë qytete gjenden në afërsi të shkollave.¹⁹⁶ Drejtorët e disa shkollave janë të shqetësuar për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve, kurse nxënësit për të cilët sigurohet transporti ankohen se gjatë transportit ata detyrohen të ulen nga dy e më shumë nxënës në një karrige.

Një mangësi tjetër me që vlen të veçohet është përmbajtja e teksteve mësimore që u ofrohen nxënësve. Për shembull, në tekstin shkollor nga lënda edukata qytetare për klasën e VIII, sipas plan programit, mësimi i parë për nxënës është Liritë dhe të drejtat e njeriut. Po të analizohet ky tekst, shihet se nuk i përmbushë objektivat e një mësimi cilësor, sepse nxënësve nuk ju shpjegohen të drejtat e njeriut në mënyrë të saktë dhe ka disa informata të pasakta.¹⁹⁷

Të gjitha këto dukuri janë si rezultat i dështimit të institucioneve kompetente të arsimit parauniversitar, respektivisht i drejtorive të shkollave, drejtorive komunale të arsimit por edhe i inspektorateve të arsimit si institucione mbikëqyrëse të deleguara nga MASHT-i. Këto dukuri ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit, rrezikojnë dhe dëmtojnë shëndetin e nxënësve. Prandaj, institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për eliminimin e këtyre dukurive, sipas obligimeve ligjore, pa filluar arsyetimet burokratike të zakonshme.

¹⁹³ MASHT, *Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2012/2013*, në: www.masht-gov.net/ (24.01.2014).

¹⁹⁴ Komuna e Kamenicës, Komuna e Dragashit dhe Komuna e Vitisë.

¹⁹⁵ Komuna e Gjakovës.

¹⁹⁶ *Ligji për lojërat e fatit, nr.04/L-080*, neni 66 paragrafi 2.4.

¹⁹⁷ Sheribane Bahtiri, Shemi Krasniqi dhe Habib Aliu, *Edukata qytetare, për klasën e VIII, shtëpia botuese "Dukagjini"*.

2.23.3. Nxënësit me nevoja të veçanta

Avokati i Popullit, në raportet e mëparshme vjetore, po ashtu ka rekomanduar që të sigurohen kushte sa më të mira për nxënësit me nevoja të veçanta, sidomos për ata me aftësi të kufizuara. Në të gjithë, pa përjashtime, jemi dëshmitarë të përditshëm se kjo kategori e nxënësve me vështirësi i realizon këto të drejta. Sidomos ka probleme me sigurimin e transportimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Përkrahja dhe përmirësimi i kushteve për këta nxënës duhet të jetë prioriteti i MASHT-it dhe komunave.¹⁹⁸

IAP, ka pranuar një ankesë në emër të një familje të komunitetit boshnjak, e cila për dy fëmijë me nevoja të veçanta ka kërkuar hapjen e një paraleleje në gjuhën boshnjake në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë. Ankesa është duke u proceduar dhe sipas MASHT-it, kjo çështje pritet të zgjidhet në gjysmë vjetorin e dytë shkollor.¹⁹⁹

2.23.4. Zvogëlimi i numrit të nxënësve

Pas krahasimit të shënimeve statistikore të MASHT-it, konstatohet se në vitin shkollor 2011/2012, numri i nxënësve është zvogëluar për 6418 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2012/2013, numri i nxënësve është zvogëluar për 9146 nxënës. Në total numri i nxënësve për dy vite shkollore është zvogëluar për 15.564.²⁰⁰ Dukuria e zvogëlimit të numrit të nxënësve në institucionet shkollore është mjaft shqetësuese. Sipas drejtorëve të shkollave, kjo ndodhë për shumë shkaqe, si: rënia e natalitetit për shkaqe ekonomike, braktisja e shkollimit të obligueshëm për shkak të migrimin, dyndja e popullatës nga viset rurale në ato urbane, etj.

Edhe përkundër kësaj dukurie, në viset urbane ende vazhdon të jetë numri i madh i nxënësve në një klasë. Në shumicën e qyteteve të Kosovës ende kemi shkolla të cilat punojnë në tri ndërrime, ndërsa në viset rurale shumë shkolla vazhdojnë të ballafaqohen me mungesën e nxënësve dhe ekziston rreziku i mbylljes së disa shkollave. Natyrisht, kjo dukuri do të vazhdojë derisa të arrihet një baraspeshë e përafërt e mundësive, pra derisa të mos të krijojnë një infrastrukturë më e mirë të jetesës në viset rurale.

2.23.5. Parandalimi i dhunës në institucionet shkollore

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar (LAP), ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe edukative, qofshin ato publike ose private.²⁰¹

Megjithatë dukuria e paraqitjes së dhunës në institucione shkollore ende nuk zgjidhet në mënyrë thelbësore. Shpeshherë, në raste të konflikteve të këtilla, veprimet janë formale dhe mendohet se me një bisedë me nxënësin, prindin apo mësimdhënësin rasti është “zgjidhur”.

¹⁹⁸ IAP, rasti A. nr. 515/2013.

¹⁹⁹ IAP, rasti A.nr. 483/2013.

²⁰⁰ MASHT, Statistikat e Arsimin në Kosovë, 2011/12 dhe 2012/13, në: www.masht-gov.net/ (24.01.2014).

²⁰¹ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 042/L-032, neni 4 paragrafi 2.

Për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, vërehet mungesa e veprimeve parandaluese, koordinimi jo i mjaftueshëm ndërinstytucional, hezitimi i përgjegjësve për raportimin dhe trajtimin e viktimës, por edhe të ushtruesit të dhunës, mungesa e personelit profesional, respektivisht të psikologëve në shumicën e shkollave ndikon negativisht në parandalimin e kësaj dukurie.²⁰²

Për krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të përshtatshëm në institucionet arsimore, si dhe për parandalimin e kësaj dukurie, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Rregulloren e cila përcakton procedurat e zgjidhjes së rasteve të dhunës në shkollë dhe referimin tek institucionet tjera përgjegjëse.²⁰³

2.23.6. Arsimi i lartë: sfidat dhe problemet

Me hapjen e Universiteteve publike në Gjilan, Mitrovicë dhe në Gjakovë, krahas zgjerimit të ambienteve publike për arsimimin e lartë është ofruar mundësi e studimeve më afër shtëpisë dhe janë zvogëluar shpenzimet financiare të familjeve që duan të arsimojnë fëmijët e tyre.

Në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, disa profesorë dhe asistentë kanë pasur të krijuara nga dy e më shumë marrëdhënie të punës. Rektorati i universitetit ka kërkuar plotësimin e një pyetësori për të verifikuar mësimdhënësit e angazhuar edhe në vende tjera të punës, respektivisht në dy a më shumë vende të punës. Pas verifikimit, profesorët dhe asistentët është dashtë të përcaktohen se në cilin vend të punës do të angazhohen, dhe një numër i tyre kanë dhënë dorëheqje nga njëri vend i punës.²⁰⁴ Ky veprim është ndërmarrë për ruajtjen dhe ngritjen e kualitetit të mësimdhënies në UP.

Parlamenti Studentor, e ka monitoruar procesin e mbajtjes së ligjëratave dhe provimeve nga profesorët dhe pohojnë se orari i punës tani është duke u respektuar më mirë se në të kaluarën, por megjithatë ka ende probleme të kësaj natyre.²⁰⁵

2.23.7. Sistemi arsimor për komunitetet

Duke u mbështetur në zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë së Integritimit të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Qeverisë së Kosovës 2009 -2015 dhe në përkrahje të zhvillimit dhe arsimimit të këtyre komuniteteve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), këtë vit shkollor ka ndarë bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta dhe studentët e fakulteteve publike për studentë të këtyre komuniteteve. Sigurisht, edhe pse nuk do të mund të kompensojë kohën e gjatë të lënies anash të këtyre komuniteteve, sigurisht do të ndihmojë sadopak për integrimin e këtyre komuniteteve në arsim.

²⁰² *Udhëzimi Administrativ, nr.26/2013*, neni 2. Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare.

²⁰³ *Rregullore, QRK nr. 21/2013* për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, Qeveria e Republikës së Kosovës.

²⁰⁴ Intervistë me z. Esat Kelmendi, Sekretar i Përgjithshëm, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

²⁰⁵ Intervistë me z. Minir Begaj, kryetar i Parlamentit Studentor.

Shkollat të cilat zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe ende vazhdojnë të punojnë sipas plan-programeve të Republikës së Serbisë pa ndonjë kontakt me MASHT-in. Këto shkolla nuk i dorëzojnë të dhënat statistikore në MASHT, prandaj në publikimet statistikore të MASHT-it mungesa e të dhënave nga shkollat serbe ndikon në paraqitjen complete të të dhënave për arsimin parauniversitar në Kosovë.²⁰⁶

2.23.8. Bashkëpunimi i IAP-së me institucionet arsimore

Gjatë vitit 2013, IAP ka pasur një bashkëpunim intensiv me institucionet arsimore. Të gjitha institucionet arsimore të vizituara ishin të gatshëm për bashkëpunim. Në kuadër të bashkëpunimit me MASHT-in, më 17 dhe 18 shtator 2013, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga MASHT-i me temën “*Ecim tutje – Arsimimi për Zhvillim Ekonomik*”. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe vendeve të rajonit, përfaqësues të institucioneve të ndryshme të vendit, udhëheqës të institucioneve të arsimit publik dhe privat, përfaqësues të shoqërisë civile, afaristë, ekspertë të arsimit nga vende të ndryshme të botës, studentë, etj. Në konferencë u debatua për konceptet relevante akademike të ekonomisë së arsimit, me theks të veçantë u debatua për nevojat e investimeve në nivelet e ulëta të arsimit (Arsimi parashkollor dhe fillor), u trajtuan sfidat në sektorin e arsimit dhe tregun e punës, dhe në fund dolën shumë rekomandime të cilat mbetet të zbatohen nga institucionet publike.²⁰⁷

2.23.9. Ankesat e pranuar në IAP

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar gjithsej 21 ankesa për shkeljen e të drejtës për arsimim. Pas shqyrtimit të ankesave të pranuar, 13 janë shpallë të papranueshme, prej tyre 8 janë refuzuar për shkak të mos shfrytëzimit të mjeteve juridike,²⁰⁸ 2 për shkak se janë në shfrytëzim të mjeteve juridike,²⁰⁹ 2 për shkak se nuk ka shkelje të të drejtave të njeriut apo keqadministrim²¹⁰ dhe 1 për shkak se është jashtë juridiksionit të IAP.²¹¹

Prej 8 rasteve të hapura, pas përfundimit të hetimeve, 3 raste janë mbyllur,²¹² dhe 5 të tjera janë duke u shqyrtuar ende.²¹³

²⁰⁶ MASHT, *Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2010/11, 2011/12 dhe 2012/13*, në: www.masht-gov.net/ (24.01.2014).

²⁰⁷ *Ecim tutje - arsimimi për zhvillim ekonomik*, Dokumentim i konferencës, 18.12.2013, f 294 dhe 295, në: www.education-economics-kosovo.org (24.01.2014).

²⁰⁸ *Ligji për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195*, neni 20.1.4, “kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shteruar.”

²⁰⁹ *Po aty*, neni 20.1.3 “kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuar me këtë ligj.”

²¹⁰ *Po aty*, neni 20.1.1 “kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi ”

²¹¹ *Po aty*, neni 19.1.3.1 “nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji ”

²¹² *IAP, rasti A. nr. 523/2013*, pala ankuuese është këshilluar që të shfrytëzoj mjetet juridike, ai ka refuzuar të ushtroj ankesë dhe ka kërkuar nga IAP të mos ndërmarr veprime lidhur me ankesën e tij, rasti është mbyllur

Prej ankesave të pranuar gjatë këtij viti raportues, 9 ankesa ishin kundër Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 6 ankesa ishin kundër Drejtorive Komunale të Arsimit(DKA), 2 ankesa kundër komunave, 2 ankesa kundër MASHT-it, 1 ankesë kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe 1 ankesë kundër autoriteteve të huaja.

Rekomandime:

- *Me qëllim të parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës në institucionet shkollore, MASHT-i, DKA-të dhe të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, të zbatojnë detyrimet e përcaktuara sipas Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.*
- *Komunat dhe DKA-të, të punësojnë shërbyesit profesional psiko-pedagogjik në institucionet edukative-arsimore parauniversitare.*
- *MASHT-i në bashkëpunim me partnerët dhe autorët, të rishikojë kualitetin mësimor të tekstit shkollor për edukatën qytetare për klasën e VIII.*
- *MASHT-i dhe DKA-të, në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës të zbatojnë Ligjin për lojërat e fatit dhe lokalet e tilla të largohen sipas kërkesës ligjore nga institucionet edukativo-arsimore.*
- *MASHT-i, të rrisë fondet për fëmijët me nevoja të veçanta dhe të sigurohet përfshirja e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim.*
- *Komunat dhe DKA-të, të vendosin kutitë për ankesa në të gjitha institucionet shkollore.*
- *Komunat dhe DKA-të, të sigurojnë me kohë derivatet për ngrohje gjatë sezonit dimëror.*

2.24. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës²¹⁴ dhe është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të

sipas nenit 20.1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195. IAP, rasti A. nr. 136/2013, pala ankuese është ankuar përmes postës elektronike, është kërkuar nga ai që të paraqitet në IAP, por ai ka refuzuar të paraqitet dhe ka kërkuar që ankesa e tij të mbetet anonime, rasti është mbyllur sipas nenit 20.1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195. IAP, rasti A. nr.228/2013, pala ankuese ka përfunduar studimet jashtë vendit dhe ka kërkuar nga MASHT-i njohjen e diplomës, rasti është zgjidhur pozitivisht sipas kërkesës së palës ankuese, rasti është mbyllur sipas nenit 19.1.5, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195.

²¹³ IAP, rasti A. nr. 379/2013. Ankesë kundër kriterëve të shpallura për pranim të fëmijëve në institucionin parashkollor, IAP, rasti A. nr. 483/2013, kërkesë për hapjen e paraleles për mësim në gjuhën boshnjake në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë. IAP, rasti A. nr. 515/2013, ankesë për shkak të mos sigurimit të transportit për nxënës me nevoja të veçanta. IAP, rasti A. nr. 525/2013, ankesë për shkak të mos sigurimit të transportit të nxënësve për shkak të rrezikut nga automjetet gjatë udhëtimit të nxënësve deri në shkollë dhe anasjelltas. IAP, rasti A. nr. 590/2013, ankesë për shkak të refuzimit për tu pranuar në universitet për studime në nivelin master.

²¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.²¹⁵ Gjithashtu kjo e drejtë, është e rregulluar dhe mbrohet edhe me ligje bazike, të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.²¹⁶

Avokati i Popullit, vëren se realizimi i të drejtave të qytetarëve nga fusha e marrëdhënies së punës ka një rëndësi të posaçme për statusin e çdo qytetari dhe njëkohësisht është një indikator se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve të vetë.

Edhe më tutje në Kosovë, vazhdon të mbetet si çështje sociale më serioze shkalla e lartë e papunësisë me të cilën janë duke u përballur qytetarët e Kosovës.

Edhe në këtë periudhë raportuese, numri i të papunëve në Kosovë vazhdon të jetë shumë i lartë. Bazuar në të dhënat e MPMS, në vitin 2013, numri i përgjithshëm i punëkërkuësve të regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit është 266.569 persona nga ata 123.462 femra dhe 143.107 meshkuj.²¹⁷ Fatkeqësisht vërehet një rritje e dukshme e numrit të personave që kërkojnë punë në Kosovë.

Në realitetin kosovar ndodhin shkelje të mëdha në tregun e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Avokati i Popullit vlerëson se Inspektorati i Punës si mekanizëm parandalues dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, duhet të kontrollojë në mënyrë unike dhe të vazhdueshme, të gjitha vendet e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Duhet të kontrollojë kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve në përgjithësi, sidomos të veprorëve në mënyrë aktive për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit. Një kujdes i veçantë duhet kushtuar kushteve të punës në tregun privat, me fokus të shtuar në moshën e të punësuarve, sidomos për shkak të punësimit të personave të moshës së mitur.

Bazuar në hetimet e zhvilluara, Avokati i Popullit, konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese vazhdon shkelja e së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit. Sikurse në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, ka shkelje të drejtës nga marrëdhënia e punës – shkelje të procedurave të punësimit,²¹⁸ të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, kohëzgjatjen dhe kompensimin jashtë orarit,²¹⁹ mos shfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor, mos realizimi i të drejtës në pagë, diskriminimi në moshë.²²⁰

²¹⁵ *Po aty*, neni 22.

²¹⁶ *Ligji i Punës nr. 03/L-212; Ligji për Shërbimin Civil nr.03/L-145; Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil nr.03/L-147; Ligji për Këshillin Ekonomiko Social nr.04/L-008.*

²¹⁷ Departamenti i Punës dhe Punësimit i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/0913%20Informatat%20ne%20tregun%20e%20Punes.pdf> (18.09.2013).

²¹⁸ *IAP, rasti A. nr.566/2013.* Pala ankohet se ka konkurruar në Spitalin Rajonal në Mitrovicë, për vendin e punës Infermiere - Mami dhe me sukses e ka kaluar procesin e testimin dhe intervistimit, por nuk është pranuar në punë. Parashtruesja e ankesës është ankuar dhe nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Spitali Rajonal në Mitrovicë.

²¹⁹ *IAP, rasti A. nr.371/2013.*

²²⁰ *IAP, rasti A. nr.5661/2013.*

2.24.1. Puna e ndaluar e fëmijëve

Në bazë të Ligjit të Punës, marrëdhënie pune mund të themelojë çdo person prej moshës 18 vjeçare. Ndërsa, në punë të lehta, të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin e tyre, mund të punësohen edhe personat në mes të moshës 15-18 vjeç.²²¹

Avokati i Popullit, konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, vërehen fëmijë të moshës jo madhore, duke bërë punë të ndryshme që dëmtojnë shëndetin dhe dinjitetin e tyre. Ata i gjejmë duke kërkuar lëmoshë në rrugë, restorante, udhëkryqe të rrugëve, duke shitur cigare rrugëve, duke punuar me karrocë dore apo edhe punë të rënda në ndërtimtari.²²²

Edhe pse kjo është e ndaluar dhe fëmijët gëzojnë mbrojtje ligjor si me legjislacionin vendor, ashtu edhe me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës,²²³ kjo dukuri vazhdon pa ndonjë ndryshim. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit kërkon nga institucionet përgjegjëse që t'i respektojnë instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në lidhje me çështjen e punës së fëmijëve, Avokati i Popullit, përkujton se është i domosdoshëm një bashkëpunim midis Inspektoratit të Punës, MPMS dhe MPB, për parandalimin dhe eliminimin e formave të dëmshme të punës së fëmijëve. Ndërsa një rol me rëndësi në këtë bashkëpunim duhet të luaj MASHT-i së bashku me drejtoritë komunale të arsimit, përmes përcjelljes së vazhdueshme dhe të disiplinuar të vijimit të mësimin nga nxënësit dhe nxënëset në arsimin para universitar.

2.24.2. Rastet e shkeljeve të së drejtës së punës

Në këtë periudhë IAP ka pranuar gjithsej 287 ankesa të qytetarëve për cenimin e së drejtës së marrëdhënies së punës. Prej tyre 221 ankesa janë vendosur si të papranueshme,²²⁴ ndërsa për 61 ankesa janë hapur hetime, kurse 5 ankesa janë në pritje për shqyrtim.

2.24.3. Mbrojtja dhe siguria në punë

Edhe pse mbrojtja dhe siguria në punë sa i përket legjislacionit në Kosovë, janë të rregulluara me dy ligje në fuqi: Ligjin e punës dhe me Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë,²²⁵ vdekja e punëtorëve dhe lëndimi i tyre në vende të punës, për Avokatin e Popullit paraqet

²²¹ Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 7, paragrafi 2.

²²² Raporti i ILO-IPEC, "Hapat e ILO-IPEC për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve në Kosovë, Në: <http://www.ilo.org/budapest/what-we-do/publications/albanian/lang--en/index.htm> (17.11.2011).

²²³ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 32: " Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror."

²²⁴ Ligji për Avokatin e Popullit, nr.03/L-195, neni 19, paragrafi 1.3.: "Ankesa nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, ankesa është e parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa nuk paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit."

²²⁵ Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 42, paragrafi 1 dhe 2; Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në punë nr.04/L-161.

shqetësim tejet serioz. Sidomos mos-hetimi i këtyre rasteve nga Inspektorati i Punës dhe organet hetuese, si dhe mosndëshkimi i punëdhënësve për shkak të mospunësimit të punëtorëve dhe të vendeve të punës, si dhe mospunësimi i kompensimit të viktimave apo i familjeve të tyre pas fatkeqësisë.

Gjatë periudhës së raportimit në Kosovë, në sektorin privat-në ndërtimtari kanë ndodhur raste të shumta të vdekjes së punëtorëve dhe lëndimi i tyre në vendet e punës.²²⁶ Në vitin 2013, 17 persona kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës, ndërsa numri i të lënduarve mund të jetë më i madh.

Rekomandime:

- *Qeveria e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë Inspektorati i Punës, të kërkojë përgjegjësi konkrete nga institucionet dhe personat përgjegjës lidhur me mos zbatimin e Ligjit të punës, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.*
- *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, së bashku me Inspektoratin e Punës, të ndërmarrin masa që të parandalojnë dukurinë e punës së fëmijëve, duke hartuar programe konkrete për identifikimin e punëdhënësve që shkelin ligjin në këtë fushë dhe ndjekjen e tyre sipas ligjeve në fuqi.*
- *Inspektorati i Punës, të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe shëndetin në Punë dhe të merr masa të duhura ligjore për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, në rast të shkeljes së ligjit nga punëdhënësit, duke i sanksionuar ata sipas ligjeve në fuqi.*
- *Të rritet numri i inspektorëve në Inspektoratin e Punës, në të gjitha nivelet, sipas nevojave objektive, ashtu si është kërkuar nga Avokati i Popullit, edhe në raportet e kaluara vjetore.*

2.25. Të drejtat e fëmijëve në Kosovë

Qeveria e Republikës së Kosovës më 26 dhjetor 2012, kishte miratuar programin legjislativ për vitin 2013, me të cilën kishte përcaktuar listën e ligjeve që do të nxirreshin dhe të atyre që do të ndryshoheshin dhe plotësoheshin për të rregulluar fusha të caktuara shoqërore.

Në kuadër të këtij programi ishte paraparë edhe hartimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili do të përfundonte më 30 nëntor 2013. Edhe pse ky projektligj, tani i emërtuar *Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve*, tashmë ka kaluar disa faza në procesin e hartimit, një analizë paraprake gjithëpërfshirëse e legjislacionit që rregullon këtë fushë nuk ishte kryer nga institucionet përkatëse.

Në lidhje me këtë, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), pas një pune vlerësuese disamuajshe, më 20 dhjetor 2013, në një tryezë të rrumbullakët kishte prezantuar draft raportin "*Ligji dhe të drejtat e fëmijëve në Kosovë: Pajtueshmëria e legjislacionit në fuqi*

²²⁶ Intervistë me z. Basri Ibrahim, Kryeinspektor në MMPS të Republikës së Kosovës, më 11 dhjetor 2013.

me Konventën mbi të drejtat e Fëmijës”, gjegjësisht të gjeturat preliminare dhe rekomandimet nga vlerësimi dhe rishikimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës për të drejtat e fëmijëve. Fatkeqësisht, në këtë tryezë nuk morën pjesë përfaqësues të grupit i cili kishte qenë pjesë e procesit të hartimit të projektligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Nuk ka dyshim se nxjerrja e ligjeve është e domosdoshme për të rregulluar marrëdhënie të caktuara në çdo shoqëri mirëpo ajo duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vlerësuar situata dhe nevojat reale për rregullimin e tyre. Aq më tepër një vlerësim paraprak është i rëndësishëm të bëhet dhe duhet të kihet parasysh kur nxjerrja e ligjeve i referohet mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Mirëpo hartimi dhe miratimi i ligjeve, përfshirë këtu edhe atë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nuk është i mjaftueshëm nëse ligjet nuk zbatohen në mënyrë adekuate, zbatohen pjesërisht apo nuk zbatohen fare.

Realizimi praktik i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i tyre, mbeten sfida për institucionet e Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të bashkërendisin dhe shtojnë përpjekjet dhe veprimet në drejtim të respektimit, mbrojtjes dhe zbatimit përkatës të të drejtave të fëmijëve përfshirë këtu edhe ndarjene buxhetit të mjaftueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t’i vë ato në ballë të agjendës së saj të punës. Fëmijët duhet t’i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

2.25.1. E drejta e fëmijëve për shkollim

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim cilësor, sigurimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, si dhe parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla, mbeten disa nga objektivat më të rëndësishme nga fusha e arsimit, realizimi i të cilave kërkon angazhim të vazhdueshëm të institucioneve të Kosovës.

Nga ankesat e pranuar në IAP, lidhur me të drejtën për arsimim, 4 kanë të bëjnë me fëmijët.²²⁷ Dy nga to i referohen çështjes së sigurimit të transportit për të vijuar mësimet në shkollë, ndërsa dy të tjera kanë të bëjnë me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare për dy fëmijë me aftësi të kufizuar, përkatësisht, për të drejtën për përfshirje në edukim parashkollor. IAP ka ndërmarrë veprimet e nevojshme, përkatësisht është duke bërë përpjekje që të ndërmjetësojë dhe ndihmojë në zgjidhjen e tyre. Me qëllim të përmirësimit të situatës, sa i përket të drejtës për arsimim, përkatësisht sigurimit të gjithëpërfshirës në arsim për të gjithë fëmijët, Avokati i Popullit rekomandon që institucionet e Republikës së Kosovës, përveç të tjerash:

Rekomandime:

- ***Të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatim përkatës të legjislacionit që rregullon fushën e arsimit edhe sa i përket shtimit numerik dhe ngritjes profesionale të kuadrit në arsimin gjithëpërfshirës;***

²²⁷ IAP, rastet: A.nr.515/2013, A.nr.525/2013, A.nr. 483/2013, A.nr.379/2013.

- *Të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës fizike, si dhe për ndarjen e një buxheti të veçantë për sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuar.*

2.25.2. Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Dhuna mbetet dukuri shqetësuese në shkollat publike të Kosovës. Gjatë këtij viti nga informatat e siguruar nga nxënës të shkollave të mesme të ulëta, shihet qartë se shumë nga fëmijët janë të pakënaqur me situatën në shkollat e tyre.

Përveç mangësive të shumta në shkolla për shkak të mungesës së kushteve elementare higjienike, mësimit në shumë ndërrime, mungesës së hapësirës përkatëse për ushtrime dhe lojë, problem më vete është se nuk merren seriozisht shqetësimet dhe ankesat e fëmijëve, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me dhunën dhe gjendjen e sigurisë.

Shumë fëmijë mendojnë se shkollat nuk janë më vende të sigurta, sepse nxënësit bartin me vete thika e madje edhe armë dhe se dhuna është e pranishme si brenda ashtu edhe jashtë hapësirës shkollore. Madje, fëmijë të një shkolle në kryeqytet theksuan se në shkollën e tyre përdoren substanca narkotike.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka zhvilluar hetime lidhur me çështjen e mosndërmarrjes së veprimeve përkatëse nga autoritete komunale arsimore në dy raste të përdorimit të dhunës ndaj disa fëmijëve, nga arsimtarë në dy shkolla publike të Kosovës.²²⁸ Në njërin rast, pas ndërmjetësimit të IAP-së, situata është përmirësuar, ndërsa në rastin e dytë, pas hetimit rezultoi se, autoritetet përkatëse, arsimtarit që kishte përdor dhunë ndaj nxënësit, i kishin shqiptuar vërejtje me shkrim.

Në kuadër të detyrimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 6 shtator 2013, ka miratuar Rregulloren QRK - nr. 21/20013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar. Me këtë protokoll janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve edukativo-arsimore dhe institucioneve të tjera në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet parauniversitare. Gjithashtu, protokollin përcakton edhe procedurat për adresimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit para-universitar.

Protokollin ka shënuar një hap përpara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna. Zbatimi përkatës i tij do të përmirësonte gjendjen në shkollat e Kosovës. Në këtë drejtim, IAP edhe këtë vit rithekson dhe jep rekomandime.

Rekomandime:

- *Psikologë dhe pedagogë të jenë pjesë e personelit shkollor.*
- *Ora e kujdestarisë të përfshihet detyrimisht në programet shkollore.*

²²⁸ IAP, rastet: A. nr.17/2013 dhe A.nr. 490/2013.

- *Të shtohet komunikimi në mes të mësimeve dhe prindërve me qëllim të adresimit më të mirë të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve.*
- *Të ndërmerren veprimet përkatëse për rritjen e sigurisë në ambientet shkollore (p.sh. vendosja e kamerave).*
- *Nxënësit të informohen për pasojat dhe rreziqet që sjell përdorimi i substancave narkotike.*

2.25.3. Drejtësia për të mitur

Në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra për reformimin e sistemit të drejtësisë për të mitur, institucionet e Kosovës kanë vazhduar punën në ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të angazhuar në fushën e drejtësisë për fëmijë, me qëllim që të miturit që bien në konflikt me ligjin të trajtohen në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).²²⁹ Gjithashtu, edhe në pajtim me KDF, pas reformimit të gjyqësorit në Kosovë, autoritetet përkatëse kanë themeluar edhe departamente për të mitur në 7 Gjykata Themelore, në Gjykatën e Apelit si dhe në kuadër të Prokurorive Themelore në tërë territorin e Kosovës, kanë caktuar gjyqtarë dhe prokurorë që ekskluzivisht do të punojnë me lëndët e të miturve. Nga ankesat e pranuar,²³⁰ informatat e siguruar nga monitorimi i Qendrës Korrektuese në Lipjan,²³¹ nga përfaqësues të institucioneve që punojnë me të mitur që kanë rënë në konflikt me ligjin,²³² del se mbetet ende shumë për t'u bërë në këtë fushë.

Me qëllim të përmirësimit të sistemit të drejtësisë për të mitur në Republikën e Kosovës, IAP e konsideron të nevojshme, të japë rekomandime.

Rekomandime:

- *Të respektohen përkatësisht të zbatohen me përpikëri edhe dispozitat e Kodit të drejtësisë për të mitur, që kanë të bëjnë me paraburgimin e të miturve, përkatësisht me kohëzgjatjen e paraburgimit.*
- *Të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të institucioneve të përfshira në sistemin e drejtësisë për të mitur (Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues, gjykatat, prokuroritë, avokatët, qendrat për punë sociale etj.), përfshirë këtu edhe shoqërinë civile.*

²²⁹ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), është instrumenti më i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, i cili zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Kosovës sipas nenit 22 të kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²³⁰ IAP, rastet: A.nr.325/2013, A. nr. 330/2013.

²³¹ Në maj të vitit 2011, IAP-së me disa OJQ vendore (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut - KMDLNJ dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT) kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me të cilën kanë krijuar Grupin Punues të përbashkët. Ky Grup për herë të fundit më 31 maj 2013 ka monitoruar edhe Qendrën Korrektuese për të mitur dhe femra në Lipjan.

²³² Informatat e marra nga përfaqësues të Shërbimit Sprovues të Kosovës, më 10 qershor 2013.

- *Të zbatohen në masë më të madhe masat e diversitetit dhe ato edukuese në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës, duke pasur parasysh rrethanat e çdo rasti veç e veç.*
- *Të krijohen fonde për mbështetjen e të miturve pas lirit të tyre nga masat riedukuese të shqiptuara dhe të ekzekutuara, me qëllim të ri-integrimit të tyre.*
- *Të krijohet një bazë e të dhënave në nivel kombëtar, me qëllim të integrimit të të dhënave të gjitha institucioneve përkatëse që punojnë në fushën e delikuencës së të miturve.*

2.25.4. Trafikimi me qenie njerëzore, fëmijët viktimë

Me gjithë përparimet evidente, parandalimi i trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja përkatëse e të drejtave të fëmijëve - viktimë të trafikimit me qenie njerëzore - mbetet sfidë për institucionet e Kosovës. Pjesën dërmuese të viktimave të trafikuar gjatë vitit 2013 e përbëjnë vajzat e mitura, të trafikuar për qëllim të shfrytëzimit seksual.²³³

IAP ka filluar hetimet *ex-officio* lidhur me mosndërmarrjen e veprimeve përkatëse nga ana institucioneve që punojnë në identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave në rastet e trafikimit me qenie njerëzore për hetimin, identifikimin dhe mbrojtjen e një fëmije,²³⁴ ish viktimë e trafikimit, tani viktimë në rrezik apo viktimë e mundshme e trafikimit me qenie njerëzore. Duke u nisur nga informatat e siguruara dhe rrethanat e rastit, IAP ka kërkuar nga institucionet e përfshira në rast, që rasti të rishqyrtohet dhe, të ndërmerren veprimet e nevojshme në mënyrë që fëmijës t'i ofrohet mbrojtje dhe ndihmë adekuate.

Gati po në këtë kontekst, IAP në bashkëpunim me Save the Children International, gjatë vitit të kaluar ka publikuar raportin mbi të gjeturat nga hulumtimi i kryer përkitazi me çështjen e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Kosovë, përfshirë këtu edhe trafikimin me qenie njerëzore.²³⁵

Me qëllim të përmirësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandime për institucionet kompetente.

Rekomandime:

- *Të fuqizojnë kapacitetet e punonjësve të institucioneve përkatëse për identifikim efikas të viktimave të mitura, trajtimin dhe ofrimin e ndihmës adekuate atyre duke u nisur nga nevojat dhe rrethanat e çdo rasti.*
- *Të ndërmarrin veprime përkatëse për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e punonjësve që punojnë me rastet e trafikimi me qenie njerëzore.*

²³³ Informatat e siguruara nga përfaqësues të Divizionit për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore në takimin e datës 20 dhjetor 2013.

²³⁴ IAP, rasti A.nr. 589/2013.

²³⁵ IAP, Raport "Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në Kosovë", i publikuar në dhjetor të vitit 2012, në Prishtinë.

- *Të vazhdojnë fushatat informuese, sidomos për fëmijët, në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore, për rreziqet e mundshme dhe mënyrat e njohjes së tij, si dhe për të drejtat e fëmijëve për mbrojtje dhe ndihmë.*
- *Të krijojnë fonde të veçanta për të financuar nevojat urgjente të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe riintegrimin të plotë të tyre në shoqëri.*

2.26. Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Edhe pse mbrojtja e mjedisit renditet në një ndër vlerat në të cilën bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës,²³⁶ mbrojtja e mjedisit, dhe sigurimi i një mjedisi cilësor dhe të sigurt për shëndetin e qytetarëve, në vendin tonë ende mbetet sfida.

Gjatë vitit raportues IAP ka zhvilluar hetime sipas ankesave të qytetarëve, por edhe ka iniciuar hetime *ex officio*, lidhur me cenimin e të drejtës për mjedis, për shkak të cenimit të së drejtës për jetë, të drejtës së privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë, të drejtës familjare, të drejtës së pronës, shëndetin publik, etj.

Edhe pse Kosova vazhdon të mos jetë palë e shumë konventave, protokolleve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore, për arsye të statusit të saj, megjithatë legjislacioni duhet të vazhdojë përshtatjen me standardet mjedisore dhe klimatike të BE-së. Këtë vit është nënshkruar rregullorja e punës, në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të (MMPH) dhe ministrisë homologe të Maqedonisë, për komisionin e përbashkët në sferën e mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, me çka ka vazhduar rrugën drejt përmbushjes së përgjegjësisë të shtetit, për mbrojtjen ndërkufitare të mjedisit.²³⁷

Edhe pse sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e të gjithëve²³⁸, Avokati i Popullit ka vërejtur vazhdimin e veprimeve degraduese dhe në kundërshtim me ligjin, si nga individët po ashtu edhe nga institucionet. Aq më tepër, për Kosovën, problem në vete mbetet bashkëpunimi ndërinstitutional në mbrojtjen e mjedisit.²³⁹

Ndotja e vazhdueshme e mjedisit, zgjerimi i pakontrolluar urban, ndërhyrjet abuzuese, ndërtimet e pa kriter, mosrespektimi i planeve rregulluese dhe normave të ndërtimit, humbja e tokave bujqësore, ndotja e ajrit, ujërave, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, dëmtimi dhe zhdukja e biodiversitetit, mungesa e sistemeve të mjaftueshme monitoruese dhe sistemit të

²³⁶ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 7: “1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”

²³⁷ Në: <http://mmp-h-rks.org/sq/Lajmet/Kosova-e-Maqedonia-me-komision-te-perbashket-per-mbrojtjen-e-mjedisit-80> (11.12.2013).

²³⁸ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 52: “1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.”

²³⁹ *IAP, Raport me Rekomandim për rastin A. nr.394/2011*. Konstatim i Avokatit të Popullit për mosinteresimin e organeve kompetente për bashkërendimin e aktiviteteve, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore. Shih po ashtu në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package_brochures/kosovo_2013.pdf (11.12.2013).

informimit, problemet në trajtimin e mbeturinave, zhurmës e cila tejkalon kufijtë e lejuar ligjore karakterizuan vendin edhe këtë vit.

Respektimi i parimeve kyçe të së drejtës dhe legjislacionit mjedisor: parimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, i qasjes në informata mjedisore, i integritit, i parandalimit, i realizimit i të drejtave përmes gjykatave për arsye të vonesave si e drejtë themelore, parimi ndotësi paguan, shfrytëzuesi paguan, ende mbeten në fazën fillestare.

2.26.1. Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit në mjediset urbane dhe ato industriale vazhdon të jetë problem i rëndë. Edhe pse janë regjistruar përmirësime nga instalimet e filtrave në *Sharcem* dhe *Feronikel*, KEK-u dhe sistemet e ngrohjes qendrore (Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjakovë), kanë vazhduar të jenë një ndër ndotësit më të mëdhenj.

Sipas të dhënave nga raporti për gjendjen në mjedis të publikuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, nga të dhënat e 9 stacioneve të monitorimit automatik dhe një stacion mobil të cilësisë së ajrit, të instaluar në Kosovë, janë regjistruar tejkallime, sidomos me ndotësit PM10 dhe PM25.²⁴⁰

E drejta e qytetarëve për mjedis të shëndetshëm ka vazhduar të cenohet nga ndotja e ajrit nga mjetet e vjetra të transportit, përdorimi i karburanteve të cilësisë së ulët, ndotja e pakontrolluar nga ndërtimi i rrugëve dhe objekteve në ndërtim, ushtrime të veprimtarive në gurthyes dhe gurore, si dhe nga mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave urbane dhe industriale.

Sipas një hulumtimi të bankës botërore, koncentrimi i PM në ajër, ka ndikuar në ngritjen e numrit të vdekjeve të parakohshme në 852 raste, kryesisht nga sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe të kancerit të mushkërive, ndërsa janë regjistruar 318 raste të reja të bronkitit kronik.²⁴¹

Avokati i Popullit, më 5 qershor 2013, pas ankesës së qytetarëve të Prishtinës, banorë të lagjes pranë shkollës fillore “Nazmi Gafurri” në Prishtinë, konstatoi cenim të së drejtës për mjedis të pastër dhe të shëndoshë, si dhe të së drejtës së privatësisë, nga ndotja e ajrit, e shkaktuar nga lirimi i gazrave dhe mbeturinave gjatë ushtrimit të veprimtarisë të përpunimit të drurit. Përmes raportit, i është rekomanduar kryetarit të komunës së Prishtinës, përcaktimi një lokacionit të përshtatshëm për tregun e druve, jashtë zonave të banimit ngaseshteti ka detyrim pozitiv, që të ndërmarrë masa të arsyeshme, për të siguruar respektimin e të drejtave të qytetarëve, që burojnë në bazë të nenit 8 të KEDNJ dhe për të mbajtur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave konkurrenente të individit dhe komunitetit në tërësi. Sipas KEDNJ, apelimi dhe thirrja në mirëqenien ekonomike, nuk është e mjaftueshme për të zhvleftësuar të drejtat e tjerëve, posaçërisht të drejtën për mjedis, si e drejtë e ndjeshme.

²⁴⁰ *Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit, Raport për gjendjen e mjedisit 2011-2012, f. 43.*

²⁴¹ *Kosovo Country Environmental Analysis Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review, and Public Environmental Expenditure Review, World Bank, January 2013, f. 19.*

2.26.2. Ndotja e ujit

Mosmenaxhimi i mirë, shfrytëzimi jo i mirë dhe i pabarabartë i ujërave, aq më tepër rritja e kërkesës për ujë për arsye të rritjes së nevojave urbane, industriale dhe bujqësore, shkarkimi i ujërave të ndotura nga amvisëria, industria dhe ndotja nga bujqësia, pa asnjë trajtim paraprak, në masë të madhe janë shkaktarë të gjendjes së vështirë me ujëra me të cilën u ballafaqua Kosova këtë vit. E drejta e qytetarëve për ujë të pijshëm të pastër, është duke u cenuar nga pamundësia e qasjes së popullatës në sistemet e ujit të pijshëm, si dhe nga mos trajtimi paraprak i ujërave të ndotura / të zeza, dhe shkarkimit të tyre pa kontroll në lumenj.

Ndërkaq, vendbanimet e mëdha në Republikën e Kosovës, vazhduan të ballafaqohen me mungesë të ujit të pijshëm, si rezultat i reduktimeve shumë të gjata dhe të mëdha sidomos gjatë muajve të verës. Kjo gjendje është rënduar edhe më shumë në komunat e Prishtinës dhe të Gjilanit, pas mungesës së të reshurave për një periudhë të gjatë kohore. Kjo gjendje kërkon angazhim të Qeverisë dhe të komunave për gjetjen zgjidhjes dhe sigurimin e ujit të pijshëm për këto dy qytete.

2.26.3. Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve

Fragmentimi i tokës bujqësore dhe ndikimi aktivitetëve të njeriut në degradim të sipërfaqeve tokësore, ka vazhduar me intensitet të njëjtë në Kosovë. Ndërtimet e paplanifikuara, ndërrimi i pakontrolluar i destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore, ka vazhduar. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, llogaritet që në Kosovë gjatë një viti 400 ha të tokës bujqësore u ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore.

Mbetjet inerte industriale, mbetjet e amvisërisë, erozioni dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i zhavorrit, janë disa nga veprimet me efekte shkatërruese të tokës. Në Kosovë, ekzistojnë 28 pika të nxehta me potencial të madh të ndotjes, të cilat janë pasojë e veprimtarisë industriale të së kaluarës.²⁴²

Edhe pse këtë vit nuk janë shënuar zjarre të mëdha në pyje si në vitet e mëhershme, dhe ndërhyrjet e njeriut në pyje kanë qenë më të vogla, prerja e tyre ilegale ka vazhduar. Dëme të konsiderueshme të masës drunore ka pasur në pjesën e territorit të parkut kombëtar Sharr, pjesë e menaxhuar nga institucionet paralele në Shtërpcë. Edhe pse Policia e Kosovës, ka ndihmuar në mbrojtjen e pyjeve, vonesa rreth shqyrtimit të fletëpadive, paraqet problem në vete.²⁴³

²⁴² *Raport, pikat problematike mjedisore në Kosovë 2011*. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit fq. 13

²⁴³ *Po aty*, f. 79.

2.26.4. Ndërtimet e pa kriter dhe cenimi i të drejtës mjedisore

Mosrespektimi i planit hapësinor dhe planeve zhvillimore të komunave, mungesa e sistemit të monitorimit të tokës, mungesa dhe pasiguria e të dhënave kadastrale, e kanë përcjellë Kosovën gjatë vitit raportues. Miratimi i vonshëm i Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe parashikimi i afateve të gjata për me legjislacion sekondar,²⁴⁴ kur kemi parasysh zhvillimet urbanistike mosndërmarrja e veprimeve për ngritjen e kapaciteteve për zbatim të ligjit, mos kompletimi i Ligjit për Ndërtim me legjislacion sekondar, e sidomos me kodin e ndërtimit, ka bërë që ndërtimet pa kriter të shkaktojnë kaos të vërtet mjedisor, duke vështirësuar jetën e qytetarëve.

Shkeljet e të drejtave të qytetarëve nga ndërtimet e larta, mos respektimi i hapësirave në mes të objekteve, tejkalimet në lartësi dhe kate, ndriçimi dhe ventilimi joadekuat, mungesa e shkallëve emergjente, dhe masave të sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri, mos përfundimi dhe mos kompletimi me hapësira përcjellëse, si dhe rreziqe të tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor, jo vetëm që kanë vazhduar, por madje kanë arritur fazën kritike duke e vështirësuar jetën e qytetarëve.

Shqetësim më vete për Avokatin e Popullit, janë gërmimet jashtë normave, për fillimin e ndërtimeve të objekteve të larta, pa ndërmarrjen e masave për parandalim të rrezikut, duke shkaktuar cenimin e të drejtës për jetë, mjedis të sigurt dhe shëndetshëm, të drejtën e pronës, si dhe rrezikimin e sigurisë publike.

Avokati i Popullit, ka reaguar dy herë gjatë vitit 2013, përmes deklaratave publike, lidhur me dy rastet e shembjes së dheut në lagjen Arbëria dhe ato në lagjet e Muhaxhirëve dhe Kalabria.²⁴⁵ Në të dy rastet, institucionet kompetente komunale kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve pozitive ndaj qytetarëve të vet, për ndërmarrjen e masave parandaluese, mbrojtjen e qytetarëve nga veprimet e personave të tretë. Pas shembjes së dheut në lagjen Arbëria, është vërejtur informim kundërtshënës nga dy drejtori të komunës së Prishtinës, përkitazi me rregullsinë ligjore të ndërtimit. Dëmet e shkaktuara në pronë publike dhe private deri në momentin e raportimit nuk janë sanuar.

Numër i paktë i objekteve në ndërtim, kanë të vendosur tabelën informuese, gjë që lë mundësi për dyshime si në ligjshmërinë e ndërtimit, ashtu edhe përputhjen me lejen e ndërtimit.

Në një numër rastesh ndërtuesit e objekteve nuk respektojnë dispozitat e Ligjit për Ndërtim, dhe Udhëzimit Administrativ 60/2005 të MMPH-së, për mbylljen e vend-ndërtimit dhe mënyrën e rrethimit të tij.

Bazuar në ankesën e një qytetari të komunës së Prishtinës, lidhur me mos ndërmarrjen e veprimeve konkrete të inspektoratit, për ndërprerjen e ndërtimit të objektit nga fqinji, jashtë kushteve të parapara me leje, konstatim ky edhe i inspektoratit të Komunës, për mos përputhshmëri në mes gjendjes në objekt dhe lejes, pas hetimeve dhe analizës së rastit, Avokati i Popullit, konstatoi që në rastin konkret ishte cenuar e drejta e privatësisë dhe

²⁴⁴ Ligji për Planifikimin Hapësinor, nr. 04/L-174, neni 2: "Qeveria dhe Ministria nxjerrin akte nënligjore që kërkohen me këtë ligj dhe i harmonizon aktet nënligjore ekzistuese brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

²⁴⁵ Shih në: <http://www.ombudpersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,777> dhe <http://www.ombudpersonkosovo.org/?id=5,0,0,0,a,804> (10. 12. 2013).

gëzimit të shtëpisë, e drejta e mjedisit me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën e pronës. Po ashtu, në këtë rast, Avokati i Popullit konsideroi që adresimi i çështjes në gjykatë nga Inspektorati, në vend të ndërprerjes së menjëhershme të punimeve, ashtu si parashihet në Ligjin për Ndërtim, nuk ishte masë proporcionale në raport me dëmin që pësonte qytetari. Në këtë rast, Komuna e Prishtinës kishte dështuar në përmbushjen e obligimeve të saj, për mbrojtjen e qytetarit nga personat e tretë.²⁴⁶

Mos planifikimi dhe mungesa e hapësirave të gjelbra, këndeve për lodra të fëmijëve, mungesa e parkingjeve, pjesëve të pasiguruar pranë shkollave, nënkalimeve dhe mbikalimeve, probleme me ndikim në shëndetin mendor dhe fizik, jo vetëm që kanë vazhduar, por nuk është vërejtur asnjë hap drejt përmirësimit. Po ashtu, në shumicën e ndërtimeve të tilla, private apo publike, nuk ndërmerren veprime për qasje të personave me aftësi të kufizuara në këto objekte. Me gjithë obligimin ligjor të inspektorateve komunale të ndërtimit që të mos lëshojnë lejen e përdorimit të objektit, duke e mohuar vlerësimin teknik, për shkak të këtyre mangësive, nuk vërehet ndonjë përparim i dukshëm në këtë drejtim.

2.26.5. Infrastruktura rrugore - trotuaret

Zgjerimi i paplanifikuar urban me hapa të përshpejtuar, ka bërë që qytetarët të ballafaqohen me probleme të shumta me infrastrukturën rrugore. Mos parashikimi i gjerësisë dhe lartësisë së trotuareve në proporcion me numër të banorëve dhe norma urbanistike, mos planifikimi i tyre sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ligjit për Ndërtim, jo vetëm që ka vazhduar por, si problem mjedisor, madje është thelluar. Avokati i Popullit konsideron që gjendja e tillë është duke e cenuar të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt me cenim të drejtpërdrejtë të lirisë së lëvizjes.

Pengimi i lëvizjes së qytetarëve, përveç nga hapësirat e ngushta të lëvizjes së këmbësorëve - trotuareve, në disa raste edhe mungesa e tërësishme e tyre, pamundësohet edhe nga zënia e tyre nga veturat e parkuara në mungesë të parkingjeve, nga zënia me materialit ndërtimor, shpërndarja e mbeturinave ndërtimore në trotuare dhe rrugë, vendosjen e mallit, uzurpimeve arbitrare të pronës publike, etj.

Një problem tjetër serioz dhe mos përmbushje e obligimeve nga organet kompetente, që nuk duhet neglizhuar, madje që kërkon ndërmarrjen e masave të përshpejtuara për sanim, është mungesa e krijimit të kushteve në trotuare për persona me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit, pas pranimit të informatës lidhur me mungesën e një nënkalimi/mbikalimi, pas ndërtimit të autostradës në fshatin Llapushnik, e cila ka vështirësuar jetën e banorëve të fshatit të ndarë në dysh, ka iniciuar procedurat sipas detyrës zyrtare, *ex officio*. Pas ngritjes së çështjes dhe komunikimit ndër institucional në mes IAP dhe Ministrisë së Infrastrukturës, ministria kishte njoftuar Avokatin e Popullit lidhur me ndërmarrjen e masave për ndërtimin e nënkalimit, dhe që procedurat për ndërtimin e nënkalimit kishin përfunduar.²⁴⁷

²⁴⁶ IAP, Raport me Rekomandim, rasti A. nr. 123/2013, drejtuar Komunës së Prishtinës.

²⁴⁷ IAP, Raport me Rekomandime *ex officio*, 11/2013, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës.

2.26.6. Zhurma

Mos përgjegjësia e organeve kompetente për mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma ka vazhduar. Është vërejtur që qytetarët në Kosovë, posaçërisht ata të Prishtinës, janë duke u ballafaquar me probleme nga zhurma e liruar nga veprimtarit hoteliere, por edhe nga puna e zhvilluar në objektet në ndërtim, në lagjet e banuara atë në orët e vona të natës, posaçërisht në periudhën e verës dhe në ditët e fundjavës.

Cenimi i të drejtave të qytetarëve për mjedis të qetë dhe të sigurt dhe të drejtën e tyre për gëzimin e pronës, është rënduar jashtëzakonisht shumë edhe nga zhurma dhe dridhjetë shkaktuara nga transporti me mjete të rënda i materialit ndërtimor, si dhe shkarkimi i tyre, sidomos orët e vona të natës, vazhdon me intensitet të madh.

Edhe pse ligji për Mbrojtje nga Zhurma përcakton shprehimisht që inspektorati mjedisor është organ kompetent për zbatimin e ligjit, Avokati i Popullit ka vërejtur një mosgatishmëri të inspektorateve qendrore dhe lokale për gjetjen e një zgjidhje të të përshtatshme të çështjes, në bazë të kriterëve profesionale dhe të përcaktuara me ligj, për planifikimin e veprimeve, dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në bashkëveprim, deri në miratimin e ligjit të ri për Mbrojtjen nga Zhurma.

Avokati i Popullit, pas hetimit të ankesës së pranuar nga banorë të rrugës “Presheva”, “Bajram Bahtiri” dhe hapësirave përreth shkollës fillore “Nazim Gafuri”, të cilët pohonin se jeta e qetë e tyre është cenuar nga efektet e dëmshme dhe bezdisëse të zhurmës së liruar nga veprimtaria e drushitësve në ato hapësira e zhvilluar për 10 vite me radhë, duke mos përjashtuar, as orët e vona të natës, vlerësoi që komuna e Prishtinës, në çështjen konkrete, nuk ka respektuar të drejtat e qytetarëve, për mbrojtje nga zhurma, ashtu si parashihet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Për këtë arsye rekomandoi Kuvendin Komunal të Prishtinës që të caktojë lokacion të përshtatshëm për tregun e druve, jashtë zonave të banimit si dhe bashkërendimin e aktiviteteve të organeve kompetente komunale, për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit.

Duke i kushtuar vëmendje si çështje me ndikim në të drejtat e njeriut, IAP, më 18 tetor 2013, organizoi tryezën “*Zhurma dhe Ndikimi i saj në të Drejtat e Njeriut*”. Tryeza ofroi mundësinë e diskutimit të përbashkët, të problemeve me zbatimin e ligjit për mbrojtje nga zhurma, midis të gjitha institucioneve shtetërore të nivelit qendror dhe lokal, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

2.26.7. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë

E drejta e qytetarëve për mjedis të shëndetshëm, të pastër, dhe të sigurt, si dhe e drejta e pronës ka vazhduar të cenohet nga keqmenaxhimi i deponive të mbeturinave. Deponitë e mbeturinave dhe ato sanitare në Pejë, Gjilan, Prizren, Mirash, Podujevë dhe Mitrovicë, edhe pse të ndërtuara sipas standardeve, kanë vazhduar funksionimin me probleme serioze. Mos menaxhimi i duhur i deponive mund të paraqet probleme të cilat mund të përcillen me pasoja të rënda mjedisore dhe shëndetësore për shkak të mosshlyesjes dhe mbulimit të mbeturinave, djegies së vazhdueshme të tyre.

Rekomandime:

- *Qeveria e Republikës së Kosovës të rritë buxhetin dhe investimet për mbrojtjen e mjedisit.*
- *Qeveria e Kosovës si dhe qeveritë komunale të ndërmarrin hapa konkret për ngritjen e kapaciteteve administrative dhe të inspektorateve për implementim sa më të mirë të ligjeve mjedisore.*
- *Të ndërmerren fushata sensibilizuese për ngritjen e vetëdijes së publikut, për të drejtën e tyre për mjedis të shëndetshëm, mënyrat për realizimin e të drejtave të tyre si dhe ruajtjen e mjedisit.*
- *Të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstytucional në nivel qendror dhe lokal si dhe midis dy niveleve si dhe me shoqërinë civile, në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.*
- *Qeveritë komunale të përmirësojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje për çështje mjedisore.*
- *Të ndërmerren masa sanksionuese për mosveprim në detyrë zyrtare, për zyrtarët kompetent për zbatim të ligjeve mjedisore.*

2.27. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Kosova edhe sot sfidohet me gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe me varfëri të madhe të qytetarëve. Fatkeqësisht, numri i ankesave të parashtruara në IAP nuk lë hapësirë të mjaftueshme për të konstatuar se ka përmirësime të dukshme sa i përket gjendjes socio-ekonomike në Kosovë. Gjendja ekonomike dhe sociale e qytetarëve të Republikës së Kosovës vazhdon të mbetet e rëndë.

Edhe përkundër përpjekjeve të MPMS gjatë këtij viti, për ngritjen e shkallës së punësimit dhe aftësimin profesional të punëkërkuësve, përmes marrëveshjeve me kompani të ndryshme për punësim, zbatimin e plotë të legjislacionit ekzistues nga fusha e shërbimeve dhe e ndihmës sociale për familjet në nevojë, mbikëqyrjen e dispozitave ligjore, si dhe përpjekjet për plotësim ndryshimin e Ligjit të punës, nxjerrjen e udhëzimeve administrative, situata vazhdon të mbetet pothuaj e njëjtë si në vitet paraprake.

Një përparim modest është vërejtur në krijimin e një infrastrukture ligjore të kënaqshme, duke pas parasysh edhe një numër të konsiderueshëm të projektligjeve, të cilat janë në diskutim, përfshirë këtu projektligjin për sigurime shëndetësore dhe projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë 2003/15, i diskutuar shumë herë në raportet mëparshme vjetore të IAP dhe në takimet me MPMS për mangësitë, është ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-096, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Por me gjithë faktin se tani konsiderohet më gjithëpërfshirës për personat

që varen nga ndihma sociale, edhe më tej mbetet i mangët. Këtë e vërtetojnë ankesa e parashtruara në IAP për ndërprerje të ndihmës sociale.²⁴⁸

Për Avokatin e Popullit është shqetësues fakti se edhe më tutje disa dispozitat të këtij ligji mbeten të pafavorshme për shtresën e popullatës së Kosovës me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale. Konkretisht neni 4 i këtij ligji, bazuar në kriteret jo financiare për ndihmë sociale, veçohen dy kategori përfituesish të ndihmave sociale.²⁴⁹

2.27.1. Çështja e pensioneve në Kosovë

Sistemi pensional në Kosovë mbetet pa ndryshime, si në vitet paraprake. Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, që nga viti i kaluar ka ngecur në procedurë të shqyrtimit në Kuvendin e Kosovës. Çështja e Pensioneve në Kosovë, sipas ankesave të parashtruara në IAP mbetet jo e kënaqshme. Këto pensione, të cilat pensionistët e Kosovës i marrin nga shteti, edhe më tej ngjasojnë si një ndihmë sociale dhe jo e drejtë e realizuar nga puna dhe e rregulluar me ligj, që do t'u mundësonte pensionistëve një jetë të dinjitetshme.²⁵⁰

Gjatë vitit raportues IAP ka pranuar një numër ankesash nga shoqatat e pensionistëve dhe qytetarë – pensionistë në lidhje me mosfrimin e mundësisë për realizimin e pensionit kontribut dhënës për periudhën para vitit 1999 nga shteti serb. Edhe pse në lidhje me këtë çështje Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerr një vendim me të cilin obligon shtetin e Serbisë për pagesën e pensioneve,²⁵¹ deri në tani nuk shihet ndonjë zhvillim pozitiv dhe shumica e kërkesave të qytetarëve të Kosovës janë refuzuar, andaj kjo çështje duhet shtruar për zgjidhje në dialogun ndërshtetëror.

2.27.2. Çështja e strehimit

Edhe më tej çështja e strehimit të familjeve me asistencë sociale, bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, vazhdon të mbetet si problem evident dhe shqetësues në Kosovë. Gjatë këtij viti nuk është vërejtur ndonjë përpjekje e nivelit lokal për sigurimin e strehimit të familjeve me asistencë sociale.

²⁴⁸ IAP, *rastet A.nr. 9/2013 dhe A.nr. 581/2013*. Ankuesit kanë parashtruar ankesë kundër vendimit për ndërprerjen e ndihmës sociale në Qendrën për Punës Sociale, por nuk kanë pranuar përgjigje.

²⁴⁹ *Ligji nr. 04/L-096, për ndryshim - plotësimin e ligjit nr. 2003/15*, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, neni 4.

²⁵⁰ IAP, Raporti i takimit të Avokatit të Popullit me federatën e Pensionistëve të Kosovës, të mbajtur më 17 dhjetor 2013. Përfaqësuesit e pensionistëve të Kosovës i kanë ngritur shqetësimet e tyre lidhur me çështjet të cilat e vështirësojnë jetën e tyre. Çështje të ngritura në këtë takim ishin: Situata e pensionistëve në Kosovë pas vitit 1999, *Ligji për sigurimin invalidor dhe pensional*, i cili akoma nuk është miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës, çështja e invalidëve të përhershëm nën moshën 65, Pensionet familjare, Kategorizimi i pensioneve sipas kontributeve dhe kërkesa për lartësinë e vlerës së pensioneve të pranueshme sipas tyre, 60% e pagës mesatare në vend.

²⁵¹ *Rasti Grudić v. Serbia*, (Applicationno. 31925/08), në:

<http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-110378#%7B%22itemid%22%3A%22001-110378%22%7D> (21.02.2104).

Riatdhesimi i shtetasve kosovarë nga shtetet e tjera, paraqet një problem gjithnjë në rritje në Kosovë, duke filluar nga strehimi e deri tek problemet tjera të përgjithshme ekonomiko-sociale, papunësinë e madhe, varfërinë etj. Në të shumtën e rasteve, këta qytetarë shndërrohen në kategori sociale që sigurojnë mbijetesën vetëm në saje të ndihmave sociale.

Riatdhesimi i detyrueshëm i qytetarëve të Kosovës pas qëndrimit të tyre shumëvjeçar në shtetet perëndimore, shkakton trauma të kthyerit si pasojë e ndërrimit të mjedisit. Ata kanë jetuar me një standard relativisht të mirë dhe kanë ardhur në ambient të ri për ta dhe integrimi i tyre nuk është i lehtë, përkundër ekzistimit të programit Qeveritar për reintegrim. Kjo shihet të jetë pengesa e parë për integrimin e tyre apo është shkëputje e hallkës së parë të zinxhirit të procesit të integrimit që është proces shumë i ndërlikuar.²⁵²

Në tërë këtë gjendje, viktimë mbi viktimat të të gjithë procesit të riatdhesimit vazhdojnë të mbeten fëmijët, të cilët, jo vetëm që nuk bartin asnjë faj për të gjitha veprimet, qofshin ato të prindërve apo autoriteteve publike që vendosin për fatin e tyre pa i pyetur ata, por veç kësaj ata as e njohin ndonjërin nga gjuhët që përdoren në Kosovë, përfshirë shpeshherë edhe gjuhën e tyre amtare.

2.27.3. Shërbimet shëndetësore

Gjendja e sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës edhe më tej vazhdon të mbetet pothuaj e njëjtë. Gjatë këtij viti janë vërejtur përpjekje pozitive të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për finalizimin e projektligjit për sigurimet shëndetësore. Megjithatë, çështja e sigurimeve shëndetësore edhe këtë vit mbetet si në vitet paraprake, e pa përfunduar. Në mungesë të këtij ligji, gjendja edhe më tej mbetet e rëndë për një pjesë të mirë të shoqërisë, sidomos për ata që jetojnë në varfëri dhe në kushte të rënda ekonomike.

Problemet me furnizim të dobët me barna nga lista esenciale, problemet me ngrohje dhe me mosfunksionim i aparateve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), janë probleme me të cilat vazhdon të ballafaqohet shëndetësia në Kosovë edhe sot.

Përveç kushteve të vështira me të cilat po përballen pacientët në klinikat e QKUK-së, për sigurimin e medikamenteve si dhe për shfrytëzimin e aparaturave për kontrolle të detajuara, ata edhe më tej, ashtu sikurse gjatë dimrit të kaluar, janë duke u ballafaquar me të ftohtin, për shkak të mungesës së furnizimit të QKUK-së me ngrohje nga ana e “Termokosit”.

Avokati i Popullit ripërsërit se një gjendje e tillë në QKUK është vazhdim i një dështimi të pafalshëm të institucioneve qendrore, për sigurimin e kushteve elementare për popullin e Kosovës për trajtim efektiv shëndetësor.

Tregu i ilaçeve në Kosovë mbetet edhe më tej pakënaqshëm, e herë – herë edhe me rrezik për qytetarët. Edhe më tej, në barnatore shiten barna pa receta nga mjeku, pa udhëzime për përdorim të përkthyer në gjuhën e qytetarëve të Kosovës. Këtë çështje Avokati i Popullit e ka ngritur edhe në Raportin paraprakintegrimi i tyre duket të mos jetë edhe aq i lehtë, përkundër ekzistimit të programit qeveritar, por edhe sot vazhdon që situata të mbetet e njëjtë

²⁵² IAP, *rasti A.nr. 527/2013*. Ankuesi pretendon se është dëbuar me dhunë nga shteti francez dhe se nga shteti i Kosovës nuk i janë plotësuar kushtet elementare për jetë.

dhe të mos vërehet përkushtim i institucioneve kompetente, në rend të parë i MSH, për të rregulluar këtë çështje, e cila paraqet rrezik për popullatën e Kosovës.

2.27.4. Personat me aftësi të kufizuara

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk është e inkorporuar Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila do të ishte një mbështetje për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Edhe pse infrastruktura ligjore lidhur me të drejtat të caktuara për personat me aftësi të kufizuara është plotësuar pjesërisht, në mungesë të akteve nënligjore, ajo edhe më tej vazhdon të mos zbatohet plotësisht në praktikë.²⁵³

Këtë vit, Qeveria e Kosovës është duke punuar edhe në Projektligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili pritet që në të ardhmen të përmirësojë së paku gjendjen e rëndë të këtyre personave.

Edhe më tutje vazhdon të mbetet shqetësuese, infrastruktura rrugore dhe ndërtimet larta për lëvizje të lirë për personat me mjete ndihmëse. Pavarësisht faktit se ekziston udhëzimi administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore, për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, kjo dukuri vazhdon të mos jetë e rregulluar as edhe në vendet më frekuentuese, si spitale, shkolla, gjykata e institucione të tjera publike.

2.27.5. Kategorizimi i aftësisë së kufizuar

Më 22 Gusht 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015. Mirëpo, deri më tani Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për nxjerrjen e një ligji i cili do të caktonte kategorizimin e aftësisë së kufizuar tek llojet tjera të aftësisë së kufizuar, e cila do të përcillej me kompensim material përkatës, me shkallën objektive të aftësisë së kufizuar.

Përveç rregullimit të beneficioneve, si dhe mbështetjes financiare, sepse varësisht nga diagnoza të cilën e ka një person me aftësi të kufizuar, ndryshojnë edhe nevojat elementare për jetesë, mungesa e një norme ligjore apo edhe e një udhëzimi administrativ për kategorizimin e aftësisë së kufizuar, ka shkaktuar konfuzion të përgjithshëm, sepse ka shumë individë që me plotë të drejtë pretendojnë se janë persona me aftësi të kufizuar, përderisa komisioni vlerëson të kundërtën.

Në pozitë më të mirë në këtë aspekt, sa i përket rregullimit të pozitës me ligj, janë personat me aftësi të kufizuar në të parë, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë periudhës

²⁵³ Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar janë të caktuara në 26 ligje bazike të fushave të ndryshme dhe 2 akte nënligjore, ndërsa prej tyre, tri ligje janë te veçanta që i përkasin veçanërisht kësaj kategorie: *Ligji nr. 2003/23 për pensionet për personat me Aftësi të Kufizuar*, *Ligji nr. 03/L-022, për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme*, *Ligji nr.03/L-19, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara*.

raportuese ka miratuar Ligjin Nr. 04/L – 092, për Personat e Verbër, me të cilin rregullohen të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër. Miratimi i këtij ligji shihet si një hap i drejtë për përmirësimin e kushteve jetësore për personat e verbër në Kosovë.

Përfshirja në arsimin fillor, sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, është i obligueshëm për të gjithë fëmijët. Përmirësimet të dukshme ka në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, d.m.th. përfshirja në sistemin arsimor të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Rekomandime:

- *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, të miratojnë infrastrukturën ligjore të nevojshme për personat me aftësi të kufizuar në Kosovë, në mënyrë që të gjithë të përfitojnë nga pensionet e aftësisë së kufizuar, sipas vlerësimit profesional për kategorizim dhe pa diskriminim.*
- *Qeveria duhet të vazhdojë të monitorojë në mënyrë të përpiktë kualitetin e procedurave mjekësore, kualifikimet e personelit shëndetësor dhe në këtë mënyrë të minimizojë mundësinë e keqpërdorimit të ushtrimit të profesionit në sektorin e shëndetësisë.*
- *Qeveria e Kosovës, përmes akteve normative të qarta dhe veprimeve konkrete, shtetasve të Kosovës pas riatdhesimit t'u krijë kushte për jetë të dinjitetshme.*
- *Qeveria e Kosovës, që të ndërmerr veprime për nxjerrjen e akteve normative për kategorizimin e aftësisë së kufizuar.*
- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të angazhohen për inkorporimin e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të angazhohen për inkorporimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- *Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës në mënyrë urgjente të angazhohen për sigurimin e barnave nga lista esenciale.*
- *Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në mënyrë urgjente të angazhohen për zgjidhjen e problemit të ngrohjes në QKUK.*
- *Ministria e Shëndetësisë seriozisht angazhohet për rregullimin e tregut të produkteve farmaceutike, si dhe udhëzimit për dhënien dhe përdorimin e tyre.*
- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të ndërmarrë veprimet të menjëhershme për miratimin e ligji për pensionet.*
- *Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të ndërmarrë veprimet për shpejtimin e procedurave për miratimin e ligjit për sigurimin shëndetësor.*

2.28. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe lirive të njeriut, përbën themelin e sundimit të ligjit dhe të shtetit ligjor. Në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të përcaktuar me Kushtetutë,²⁵⁴ apo me ligj për mbrojtjen gjyqësore të drejtave ligjore, qytetarët kërkojnë nga gjykatat drejtësi ligjore lidhur me kontestet e ndryshme të ngritura pranë gjykatave në Republikën e Kosovës.

Për realizimin kësaj të drejte ligjore në praktikë, qytetarët vazhdojnë të përballen me vështirësi të natyrave të ndryshme.

2.28.1. Ankesat e qytetarëve ndaj gjykatave të rregullta

Edhe në këtë vit raportues, numri më i madh i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP, i përkasin gjyqësorit si palë përgjegjëse. Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

Kundër gjykatave si palë përgjegjëse, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 577 ankesa, ndërsa në vitin paraprak 2012 kemi pasur 532 ankesa. Vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të ankuesve ndaj gjyqësorit në raport me vitin paraprak. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar 382 ankesa janë vendosur si të papranueshme, sipas nenit 19.1.3 të Ligjit për Avokatin, ndërsa për 195 ankesa janë hapur hetime.

Numri më i madh i ankesave është paraqitur kundër gjykatave themelore, Gjykatës Apelit, si dhe kundër DHPGJSK, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në të gjitha rastet, kur kërkesat apo ankesat e qytetarëve në lidhje me gjyqësorin nuk kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, ata janë udhëzuar dhe drejtuar tek institucionet kompetente profesionale, për ofrimin e shërbimeve juridike, si në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe shoqatat joqeveritare, të cilat kryejnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Nga analiza e natyrës së ankesave të hetuara të qytetarëve, konstatohet se shumica e ankesave ka të bëjë me: zvarritje, herë-herë disavjeçare, të procedurave gjyqësore; parashkrimin e lëndëve gjyqësore; mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme; dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në vendosjen e lëndës si dhe përfaqësimit jo të mirë nga avokatët mbrojtës. Të gjitha ankesat e paraqitura në IAP ndaj pushtetit gjyqësor të Kosovës, janë trajtuar sipas nenit 15.6 të Ligjit për Avokatin e Popullit.²⁵⁵

²⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

²⁵⁵ Ligji për Avokatin e Popullit, nr.03/L-195, neni 15, paragrafi 6: “Avokati nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2013 është përshkruar nga një varg i reformave ligjore dhe ri-organizim strukturor, bazuar në ligjet e reja për gjyqësorin. Këto reforma, në disa aspekte kanë sjellë kualitete të reja, sa i përket respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut nga gjyqësori. Por, në disa fusha kanë pasur efektin e kundërt dhe reagimin e qytetarëve. Sidoqoftë, përkundër disa përparimeve në këtë fushë, rezultatet ende janë të pamjaftueshme në mënyrë që të mund të flitet për mbrojtjen e mirëfilltë dhe të plotë gjyqësore të të drejtave.

2.28.2. Mungesa e veprimit të pushtetit gjyqësor në veri të vendit

Edhe pse Kushtetuta garanton pushtetin gjyqësor në tërë territorin e vendit, institucionet e Republikës së Kosovës,²⁵⁶ respektivisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Misioni Unionit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), edhe gjatë këtij viti nuk kanë arritur shtrirjen pushtetit gjyqësor në pjesën veriore të vendit, me çka është dëshmuar mungesa e shtetit ligjor në atë pjesë të vendit dhe mungesa e vullnetit politik për të siguruar drejtësinë.

Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësim i jashtëzakonshëm dhe plagë e hapur për Republikën e Kosovës, mungesa e zbatimit të ligjit, për të siguruar drejtësi dhe respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, gjykatat nuk funksionojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.

Për qytetarët e këtyre lokaliteteve, të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, përfshirë të drejtën për mbrojtje gjyqësore, janë të nëpërkëmbura rëndë. Kjo vlen posaçërisht për të gjithë ata persona që kanë pasur lëndë gjyqësore në gjykatat në pjesën veriore të Mitrovicës, të cilat tani e shumë vite nuk funksionojnë fare, pasi janë shkatërruar nga ekstremistët serbë.. Me atë rast, shumë dokumente dhe lëndë gjyqësore kanë mbetur në objektin e gjykatës.

Në konferencën vjetore të Gjykatës së Apelit, të mbajtur më 26 dhjetor 2013, lidhur me punën e Gjykatës për vitin 2013, njoftohet se, nga ish-Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, gjatë këtij viti ka pranuar mbi 400 lëndë gjyqësore të cilat janë të parashkruara. Për Avokatin e Popullit, kjo shifër e lartë e parashkrimit të lëndëve gjyqësore, nga një gjykatë, është një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Fatkeqësisht, kjo thjeshtë do të thotë se për këta persona, nuk ka të drejta, nuk ka sundim të ligjit dhe as drejtësi shoqërore.

Shumë qytetarë të komunës së Mitrovicës, edhe këtë vit kanë paraqitur ankesa tek Avokati i Popullit, lidhur me lëndë gjyqësore të pa shqyrtuara dhe të parashkruara nga gjykatat. Avokati i Popullit, në të gjitha takimet me autoritetet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, por dhe në media, vazhdimisht e ka shprehur këtë shqetësim të qytetarëve/ankuesve, me qëllim të funksionalizimit të gjyqësorit në këtë komunë. Pa asnjë përjashtim, të gjitha institucionet dhe autoritetet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, kanë dështuar plotësisht në vendosjen e shtetit ligjor në këto komuna të Kosovës. Ky është shembulli më drastik i mohimit të

²⁵⁶ *Po aty*, neni 102, paragrafi 2. "Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata."

drejtësisë, për shkak të mungesës së vullnetit politik. Ky është shembulli më i keq i shprehjes së vullnetit politik në dëm të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

2.28.3. Misioni Evropian për sundim të ligjit në Kosovë - EULEX

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës ka vazhduar të mbështetet nga EULEX-i, në fushën e sundimit të ligjit. 'Sektori ekzekutiv' me gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, që kanë për detyrë të ndihmojnë autoritetet gjyqësore drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë, të lirë nga ndërhyrjet politike dhe për respektimin e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht.

Gjyqtarët veprojnë në panele të përziera gjyqësore me gjyqtarë vendor, për fusha të rezervuara të hetimit dhe gjykimit, si: krimet e luftës, gjenocidit, terrorizmit, krimet të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, vrasjeve të rënda, krimet ekonomike dhe të krimeve të tjera të rënda, por edhe për gjykimin e lëndëve civile të të gjitha natyrave, sipas ligjit mbi kompetencat.²⁵⁷ KGJK nuk ka kurrfarë kompetenca mbi gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, por ata i përgjigjen organeve të Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it.

Gjatë viti IAP ka pranuar ankesën e paraqitur nga ankuesit për shkak të refuzimit të kërkesës së tyre nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) për angazhimin dhe licencimin e avokatit ndërkombëtar.²⁵⁸ Për këtë rast, Avokati i Popullit i ka paraqitur një Raport special Qeverisë së Republikës së Kosovës, me rekomandim të pezullimit të Rregullores për licencimin e avokatëve të huaj, përkatësisht të përmirësimit të legjislacionit. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 2 maj 2013 e ka miratuar Ligjin për Avokatinë, me ndryshimet e rekomanduara nga Avokati i Popullit në lidhje me këtë çështje.²⁵⁹

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar po ashtu edhe ankesa të qytetarëve kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, për zvarritje të procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve. Po ashtu, në adresë të Avokatit të Popullit ka pasur edhe kërkesa për monitorim të procesit gjyqësor, apo edhe kërkesë për marrjen e njoftimeve lidhur me kallëzimet penale për krime lufte. Në disa raste, palët e njoftojnë IAP lidhur me parashtesat e paraqitura tek gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it.

Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve, u është drejtuar me shkresa gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, duke kërkuar informata lidhur me kërkesat dhe ankesat e pranueshme të qytetarëve dhe në të gjitha rastet Avokati i Popullit ka marrë përgjigje me shkrim. Avokati i Popullit ka hasur në mirëkuptim dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me gjyqtarët dhe prokurorët e misionit ndërkombëtar të EULEX-it, gjatë punës

²⁵⁷ *Ligji për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nr. 03L/053, neni 5. paragrafi 1.*

²⁵⁸ *IAP, rasti A.nr. 12/2013. Raport me Rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ankuesi ka kërkuar angazhimin e avokatit ndërkombëtar për mbrojtës të tij procesin gjyqësor penal për krime lufte, i udhëhequr nga prokurori i EULEX-it. Ankuesit kanë pohuar se kjo paraqet shkelje të të drejtave të tyre, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pasi që paneli i gjyqtarëve ishte i përzier ndërkombëtar dhe vendor.*

²⁵⁹ *Ligji për Avokatinë nr. 06/L-193.*

së tij. Prandaj, me këtë rast, Avokati i Popullit shfrytëzon momentin për të falënderuar komponentin e drejtësisë të EULEX-it për bashkëpunim të ndërsjellë dhe korrekt.

2.28.4. Reformimi i gjyqësorit sipas Ligjit mbi Gjykatat

Pas miratimit të Ligji mbi Gjykatat,²⁶⁰ KGJK ka reformuar sistemin gjyqësor bazuar në ligj. Nga 1 janari 2013 Kosova ka një strukturë të re organizative të gjykatave dhe të administratës gjyqësore. Tani sistemi gjyqësor i vendit përbëhet nga Gjykatat Themelore dhe Degëve të tyre, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Përkundër përgatitjeve të bëra nga KGJK për reformën gjyqësore, e cila ka pasur ndikime në lëvizje të gjyqtarëve, të personelit administrativ, sigurimit të objekteve, bartjes së lëndëve gjyqësore sipas kompetencave të reja, këtë proces e kanë përcjellë edhe vështirësi të natyrave të ndryshme, vonesat në transferimin e lëndëve nga disa gjykata të qarkut në Gjykatën e Apelit, ndarja e lëndëve në departamentet përkatëse/gjyqtarëve. Të gjitha këto vështirësi kanë ndikuar negativisht, sidomos në zvarritje për vendosjen e lëndëve gjyqësore, por edhe të paqartësive të shkaktuara tek palët për lëndët e tyre gjyqësore.

IAP ka pranuar disa ankesa dhe kërkesa për ndihmë, të qytetarëve të cilët janë ankuar për mungesë informacionesh për lëndë të tyre, respektivisht se në cilat departamente të gjykatave janë transferuar ato për shqyrtim. Në të gjitha këto raste, Avokati i Popullit ka kontaktuar gjykatat për të marrë informata zyrtare lidhur lëndët gjyqësore dhe i ka njoftuar ankuesit.

2.29. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

2.29.1. Mendimi juridik për lëndët e shpronësimit dhe bartja e kompetencave

Gjykata Supreme e Kosovës, mbështetur në reformën e gjyqësorit dhe të kompetencave të gjykatave themelore, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 15.01 2013 miratoi “*mendimin juridik*”, që të gjitha lëndët, të cilat bazuar në nenin 36 të Ligjit për Shpronësimin i janë adresuar Gjykatës Supreme dhe ish-in regjistruar në gjykatë si konflikte administrative, t’u barten në kompetencë të mëtutjeshme gjykatave themelore – departamentit të përgjithshëm, në territorin e të cilave ndodhet paluajtshmëria që është objekt shpronësimi, me qëllim të caktimit të kompensimit të drejtë, sipas kuptimit të nenit 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Lidhur me bartjen e lëndëve për vendosje në gjykata themelore dhe mosprocedimit sipas paragrafit 2 të nenit 36 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme,²⁶¹ në IAP janë ankuar mbi 120 qytetarë, për shkak të cenimit të drejtave të tyre pronësore dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre gjyqësore, sipas ligjit. Avokati i Popullit vëren se me këtë rast ka pasur

²⁶⁰ Ligji për Gjykatat nr. 04/L-199.

²⁶¹ Ligji Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139, neni 36, paragrafi 2: “Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës”.

zvarritje të paarsyeshme dhe joligjore të procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëvetë shpronësimit. Meqenëse prona është një ndër të drejtat themelore të njeriut, gjykatat duhet trajtuar me prioritet rastet për vendosjen e tyre.

2.29.2. Ligji për Noterinë në shërbim të qytetarëve

Funksionalizimi i shërbimeve të noterisë, bazuar në ligjin për noterinë, ka ngritur kualitetin e shërbimeve juridike në të mirë të qytetarëve. Kjo ka pasur efekte të drejtpërdrejta pozitive edhe për gjykatat themelore dhe komunat, të cilat janë liruar nga lëndëtjokontestimore dhe administrative. Sistemi gjyqësor për një kohë të gjatë është cilësuar si jo adekuat dhe jo efikas për kryerjen e disa shërbimeve juridike që tani kryhen nga noterët, të cilët janë të specializuar në këtë fushë.²⁶² Tani qytetarët shumë më lehtë dhe më shpejtë marrin të gjitha shërbimet noteriale. Ky është një përparim i dukshëm në sistemin e përgjithshëm të ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të shpejta për qytetarët.

2.29.3. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS)

DHPGJS për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), si pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas ligjit vendos lidhur për ankesat ndaj vendimeve të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)-së, si paraardhëse e AKP-së, si dhe kërkesave ndaj ndërmarrjeve shoqërore, me panelet përziera të gjyqtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë.²⁶³

DHPGJS-ja, sipas shënimeve zyrtare të KGJK,²⁶⁴ ka në punë një numër të madh të lëndëve gjyqësore të parashtruara nga qytetarët. Sipas Raportit vjetor 2013, Statistikat mbi punën e gjykatave tregojnë se, DHPGJS në punë ka pasur gjithsej 16'424 lëndë, i ka zgjidhur 3'819 lëndë, ndërsa si lëndë të pazgjidhura në fund të vitit i kanë mbetur 12'605 lëndë gjyqësore. Ndërsa, DHPGJS në raportin vjetor vitin 2012,²⁶⁵ sipas statistikave mbi punën e gjykatave, ka pasur në punë 10'422 lëndë, i ka zgjidhur 1'109 lëndë, ndërsa si lëndë të pazgjidhura në fund të vitit i kanë mbetur 9'313 lëndë gjyqësore.

Nga analiza krahasuese e raporteve statistikore mbi punën e gjykatave, vërehet se kemi një rritje të numrit të lëndëve për 6'002 si të pazgjidhura në vitin 2013. Ky fakt është mjaft

²⁶² *Noteri* është jurist profesional, zyrtar publik, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë, për ta ushtruar veprimtarinë e përcaktuar me ligj. Ata kryejnë shërbimet si në vijim:

- Shërbime juridike për çështje familjare dhe trashëgimore;
- Shërbime juridike për çështje pronësore;
- Shërbime juridike për çështje ekonomike dhe të punës;
- Shërbime juridike nga ruajtja e gjërave dhe dokumenteve tjera;
- Shërbime juridike lidhur me vërtetimet, legalizimet dhe certifikatat tjera.

²⁶³ *Ligji, Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L-033.*

²⁶⁴ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor 2013, Statistikat për punën e gjykatave, f. 3, në: <http://www.kgjk-ks.org/> (18.3.2014).*

²⁶⁵ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti i vjetor 2012, Statistikat mbi punën e gjykatave të rregullta, f. 3, në: <http://www.kgjk-ks.org/> (18.3.2014).*

shqetësues për Avokatin e Popullit, duke pasur parasysh numrin aktual të lëndëve të pazgjidhura prej 16'424 në DHPGJS. Kjo do të duhej të konsiderohej si dëshmi alarmuese për të gjitha institucionet kompetente, veçanërisht për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për KGJK, se është koha e fundit për veprime të menjëhershme në këtë drejtim, për të garantuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut.

Fatkeqësisht, duke pasur parasysh faktin e rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe ankesave të paraqitura të qytetarëve, për mos fillimin dhe shtyrjen e procedurës gjyqësore pas parashtrimit të padive,²⁶⁶ për një periudhë të gjatë kohore, Avokati i Popullit konkludon që as institucionet gjyqësore vendore, e as misioni kompetent i EULEX-it në Kosovë, nuk kanë ndërmarrë veprime të duhura që të sigurojnë proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, sipas kërkesës së nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ.

Prandaj, më 2 gusht 2013, Avokati i Popullit i dërgoi Raport me Rekomandime Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe EULEX-it, me rekomandimin për ndërmarrjen e masave të nevojshme për emërimin e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve apo/dhe ndërmarrjen e masave të tjera të domosdoshme, që garantojnë shqyrtimin e rasteve të paraqitura në DHPGJS, si dhe dërgimin e vendimeve të gjitha palëve brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në këtë raport po ashtu u kërkuar ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për zvogëlimin e numrit të lëndëve, si dhe të përsheptimi i punës në lëndët e mbetura si të pazgjidhura në DHPGJS.²⁶⁷

2.29.4. Rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe zvarritjet në gjyqësor

Avokati i Popullit ka pranuar shumë ankesa të qytetarëve lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore për rastet e tyre, për shkak se gjykatat nuk kanë arritur që lëndët gjyqësore t'i trajtojnë brenda afateve të arsyeshme kohore.

Për shkak të numrit të madh të lëndëve të mbetura të pazgjidhura nga vitet paraprake, rritjes së vazhdueshme të numrit të lëndëve të reja gjyqësore, numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, numrit të pamjaftueshëm të kuadrit ndihmës në gjyqësor, sidomos mungesës së bashkëpunëtorëve profesionalë ligjorë, në gjyqësorin kosovar nuk vërehet ndonjë përparimi konsiderueshëm, i gjendjes në gjyqësor. Natyrisht, edhe pse nuk duhet përgjithësuar në asnjë rast, nuk duhet neglizhuar edhe mosefiçencën dhe mosefikasitetin e vetë gjykatësve dhe të prokurorëve në këtë drejtim, pastaj sjelljet korruptive, jotransparente të njerëzve të punësuar në këto institucione.

Raporti vjetor 2013 dhe statistikat mbi punën e gjykatave, tregojnë se gjykatat në punë kanë pasur gjithsej 885.677 lëndë, i kanë zgjidhur 419'422 lëndë, ndërsa si lëndë të pazgjidhura në fund të vitit i kanë mbetur 466.255 lëndë gjyqësore.²⁶⁸ Derisa në vitin 2012, gjykatat kanë pasur në punë 312.903 lëndë, ndërsa të pazgjidhura 218.748 lëndë.²⁶⁹

²⁶⁶ Në IAP gjatë vitit 2013 janë paraqitur 26 ankesa kundër DHPGJS, kryesisht për çështje të pronës.

²⁶⁷ IAP, *rasti, ex officio, nr. 362/2013*. Raport me Rekomandime, 2 gusht 2013, dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

²⁶⁸ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor 2013*, Statistikat mbi punën e gjykatave, f. 3.

²⁶⁹ *Po aty*.

Nga analiza e të dhënave statistikore të publikuara në këtë Raport vjetor 2013, vërehet se gjykatat kanë zgjidhur 419.422 lëndë gjyqësore, ndërsa qytetarët i kanë parashtruar 522.171 parashtrës të reja nëpër gjykata. Gjyqësori ende pranon shumë më shumë lëndë se sa kapacitete për trajtimin e tyre. Mungesa e burimeve njerëzore profesionale për të mbajtur hapin dhe për t'i zgjidhur të gjitha lëndët e pranuar, është një fakt shumë shqetësues për Avokatin e Popullit. Prandaj Avokati i Popullit kërkon nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që, urgjentisht të angazhohet për gjetjen zgjidhjeve ligjore në këtë drejtim.

Me gjithë gjendjen e këtyre në gjyqësor, Avokati i Popullit nuk gjen arsyetim për zvarritjen e procedurave në vendosjen e parashtrësve të qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, kur qytetarët janë të detyruar që vendimet gjyqësore t'i presin me vite të tëra.

2.29.5. Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë

IAP, pas pranimit të një numri të ankesave të qytetarëve të komunës së Graçanicës, për zvarritjen e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve të tyre gjyqësore, në degën e gjykatës në Graçanicë, hapi rastin *ex officio*, ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të hetimit të ankesave.

Më 25 mars 2013, bashkëpunëtorja e IAP-së është takuar me administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë dhe ka kërkuar informata lidhur me shkaqet e zvarritjeve dhe për mundësitë e përshpejtimin të procedurës së vendosjes së lëndëve. Me atë rast, ajo u informua se nga 31 dhjetori i vitit 2012, nuk ka asnjë gjyqtar në këtë degë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe se dega në Graçanicë ka mbi 1000 lëndë, konteste gjyqësore civile në pritje për vendosje, përkundër që sipas riorganizimit të gjyqësorit në Kosovë, në këtë degë janë paraparë dy gjyqtarë.

Pas shqyrtimit të këtij rasti, Avokati i Popullit ka ardhur në përfundim se është bërë shkelje e të drejtës së qytetarëve për procedurë adekuate gjyqësore, brenda një afati të arsyeshëm kohor. Më 15 maj 2013, Avokati i Popullit i dërgoi Raport me rekomandim KGJK, që të ndërmerren masa të menjëhershme për dërgimin e gjyqtarëve në degën e Gjykatës Themelore në Graçanicë, në mënyrë që të fillohet me procedimin e padive të qytetarëve.

KGJK, me shkresën e datës 23.5.2013, brenda afatit ligjor, e njofton Avokatin e Popullit për zbatimin e rekomandimit, përkatesisht të emërimit të një gjyqtari në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë.

Ky është një rast i bashkëpunimit korrekt, bazuar në ligj, i një institucioni publik përgjegjës me Avokatin e Popullit, i cili meriton të theksohet dhe të përshëndetet.

2.29.6. Konstatimet e Avokatit të Popullit për mbrojtjen gjyqësore të drejtave

Avokati i Popullit pas hetimit të ankesave të qytetarëve të parashtruar ndaj gjyqësorit, në shumë raste ka konstatuar se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut nga gjyqësori. Prandaj, me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave dhe të rikthimit të të drejtave të tyre, por edhe

të përmirësimit të legjislacionit në fushën e drejtave të njeriut, Avokati i Popullit i ka dërguar gjyqësorit raporte me rekomandime, për eliminimin e këtyre shkeljeve.

Me gjithë përpjekjet e singerta të shumë gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve të sistemit gjyqësor, përkundër kryerjes së lëndëve të shumta gjyqësore, pikërisht për shkak të mangësive, problemeve dhe lëshimeve të lartcekura, tek qytetarët është krijuar perceptimi i dyshimit të përgjithshëm në punën e gjyqësorit. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, dhe në shtetin e së drejtës.

Për shkak të mos funksionimit të sistemit gjyqësor në veri të vendit, qytetarëve që kanë pasur lëndë gjyqësore në Gjykatat në veri të Mitrovicës, u është mohuar e drejta për gjykim të drejtë, të garantuara me Kushtetutë.

Qytetarët e vendit nuk kanë një mekanizëm ligjor për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm kohor, kur kjo e drejtë e tyre cenohet nga gjyqësori vendor, përkatësisht ekziston mekanizmi ligjor i kompensimit material, për shkak të dëmit të shkaktuar material, për zvarritje të procedurave gjyqësore, parashkrimit të lëndëve gjyqësore ashtu siç është e zakonshme në vendet demokratike me një shtet ligjor të mirëfilltë.

Kohëzgjatja e procedurave civile dhe procedurave të tjera pranë gjyqësorit me vite të tëra, rezulton me qasje të vështirësuar në mbrojtje gjyqësore të të drejtave të njeriut nga gjykatat.

Gjykatat veprojnë me numër të pamjaftueshëm të resurseve njerëzore, me mungesë të kushteve materiale e teknike për punë efikase. Kjo është e shprehur sidomos në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe DHPGJSK.

Parashkrimi i numrit të madh të lëndëve gjyqësore këtë vit paraqet një nga shkeljet më të rënda të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë, për mbrojtje gjyqësore të. Qytetarët nuk kanë në duar asnjë mjet të përshtatshëm ligjor për mbrojtje nga këto shkelje dhe padrejtësi.

Po ashtu vërehet një rritje të numrit të parashtrësive në të cilat qytetarët nuk janë të kënaqur nga vendimet gjyqësore, për shkak të dyshimit në objektivitetin e ndarjes së drejtësisë. Ata kërkojnë ndërmarrjen e masave nga Avokati i Popullit, prandaj janë në rritje kërkesat për monitorimin e seancave gjyqësore si në proceset penale edhe civile.

Rekomandimet:

- Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- *Shtrirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë
- *Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat*

për parashkrimin e lëndëve gjyqësore dhe për zvarritje të tepruar të procedurës gjyqësore.

- *Të iniciohet nxjerrja e një vendimi të përkohshëm, për ndalimin e parashkrimit të lëndëve gjyqësore në Republikën e Kosovës, për shkak të rrezikut të shkatërrimit të sistemit gjyqësor si pasojë e mohimit të qytetarëve për t'u drejtuar tek gjyqësori për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme.*

- Këshillin Gjyqësor të Kosovës
 - *Që të rritë numrin e gjyqtarëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë në gjykata, ashtu që të gjitha lëndët gjyqësore të trajtohen brenda afateve të arsyeshme kohore dhe pa zvarritje të paarsyeshme në vendosjen e tyre.*
 - *Ngritjen e efikasitetit për zbatimin e Strategjisë Shtetërore “Reduktimi i lëndëve të vjetra” për zvogëlimin e numrit të rasteve të papërfunduara gjyqësore.*

- Gjykatat
 - *Përmbartimin dhe zbatimin konsekuent të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore në afatin e paraparë me ligj.*
 - *Rritjen e transparencës dhe njoftimin e të gjitha palëve, në rastin e kërkesës së tyre për t'u njoftuar për lëndët e tyre, pas reformimit të gjykatave sipas ligjit dhe transferimit të lëndëve gjyqësore në kompetencë ligjore.*

2.30. Raporti i Avokatit të Popullit me Gjykatën Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Këtë supremaci ia siguron Kushtetua.²⁷⁰

Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese janë dy institucione komplementare njëra me tjetrën. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e legjitimon Avokatin e Popullit që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur ai vlerëson se të drejtat dhe liritë e njeriut janë pakësuar, apo në rastin më të keq janë shkelur me rastin e nxjerrjes së një norme ligjore me karakter të përgjithshëm.

Gjykata, duke mbrojtur kushtetutshmërinë e veprimeve të organeve shtetërore, njëkohësisht mbron edhe të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit në vazhdimësi e përcjell punën e gjykatës, si dhe praktikën e GJEDNJ-së dhe në rekomandimet, mendimet dhe sugjerimet e tij iu referohet vendimeve të këtyre dy gjykatave.

Avokati i Popullit është palë e autorizuar për të ngritur raste para Gjykatës Kushtetuese vetëm mbi bazën e nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës, për çështje që kanë të bëjnë me

²⁷⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 124 [Parimet e përgjithshme] dhe 116 [Efekti juridik i vendimeve].

përputhshmërinë e ligjeve, të dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, si dhe përputhshmërinë e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Avokati i Popullit, në të gjitha rastet, pas pranimit të ankesës, e shqyrton atë nga disa aspekte: Së pari çështja e ngritur a është çështje që bie në kompetencat e Avokati i Popullit të përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Avokatin e Popullit apo edhe ligjet e tjera. Nëse përgjigja është pozitive, atëherë rasti i nënshtrohet një analize të brendshme gjithëpërfshirëse, duke ndjekur rrugën analizës së rastit në tërësinë e tij dhe balancimit të të gjitha fakteve, duke u bazuar në parimin proporcionalitetit. Vetëm pas një analize e tillë rezulton vendimi i Avokatit të Popullit.

Edhe pse vendimet e gjykatës janë të obligueshme për zbatim për të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës, në praktikë jo gjithëherë vendimet e saj gjejnë zbatim.

Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2013 është përballur me ankesën e sindikatës së pavarur të ish-punonjësve të Fabrikës së Çelikut - IMK Ferizaj, për mos zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 7 dhjetor 2010, Nr. REF.: AGJ 75/10. Duke e konsideruar si të drejtë shqetësimin e tyre dhe njëkohësisht si shkelje e të drejtave të njeriut, respektivisht shkelje të së drejtës për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Avokati i Popullit, nëpërmjet një raporti me rekomandime, kërkoi nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit që të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Edhe pse raporti përmbante një pasqyrim të qartë të gjithë ecurisë dhe po ashtu rekomandimet ishin të qarta, Avokati i Popullit nuk pranoi asnjëherë përgjigje në lidhje me këto rekomandime nga Qeveria dhe agjencia e përmendur, megjithëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe të zbatojnë rekomandimet e tij.

Në fund të vitit 2012, Avokati i Popullit pranoi aktvendimin nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, më të cilin hidhej poshtë kërkesa e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit, si kërkesë të jashtë-afatshme. Gjykata me këtë rast nuk u lëshua në shqyrtimin e meritës së kërkesës, me arsyetimin se kërkesa ishte paraqitur pas afatit 6 mujor të përcaktuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, ndonëse shkeljet ligjore vazhdonin.

Çështja e kufizimit të afatit të ngritjes së çështjeve nga Avokati i Popullit në Gjykatën Kushtetuese, është një çështje që do të duhej të hapet për diskutim, ngase afati 6 mujor duket të jetë mjaft i shkurtër për të përcjellë numrin aq të madh të akteve ligjore që miratohen dhe duke pasur parasysh kapacitetet e institucionit të Avokatit të Popullit për të përcjellë të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu, në këtë drejtim, për ndryshimin e afatit prej 6 muajsh flet edhe përvoja e moszbatimit të ligjeve në praktikë. Janë të rralla ligjet zbatimi i të cilave fillon që me datën e hyrjes në fuqi. Në anën tjetër, vetëm ligjet që zbatohen në praktikë, dhe ballafaqohen me realitetin, mund të shfaqin mangësitë e tyre, të cilat do të duhej të mënjanohehin në praktikë.

Avokati e Popullit e ka të qartë se kufizimi prej 6 muajsh ka për qëllim që t'i shërbejë sigurisë juridike dhe të kujdeset që çështjet që shtrohen për vlerësim pranë Gjykatës Kushtetuese edhe të shqyrtohen në një afat të arsyeshëm, duke evituar kështu ndjenjën e pasigurisë tek autoritetet. Mirëpo, përvoja ka dëshmuar se është e nevojshme dhe e domosdoshme që ky afat të zgjatet, ngase jo gjithë herë efektet negative të një akti ligjor kundër-kushtetues vërehen

menjëherë. Për këtë, po ashtu flet edhe përvoja e gati të gjitha vendeve ku Gjykata Kushtetuese ka po të njëjtin rol.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar gjithsej 18 ankesa të qytetarëve që lidhen me Gjykatën Kushtetuese dhe me pretendimet se ka shkelje të Kushtetutës.

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e dy ligjeve: Ligji për Kontrollin e Duhanit dhe Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Kërkesa e parë ishte adresuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, me pretendimet se Ligji për Kontrollin e duhanit dëmtonte biznesin dhe tregtinë e lirë. Kërkesa ishte që të shfuqizohet neni 9.2 të Ligji i cili përcakton se: *“Produktet e duhanit nuk lejohen të vendosen apo të jenë të dukshme në asnjë vend të shitjes, përveçse në momentin e transaksionit të shitjes, dhe nuk duhet të jenë të shfaqur[a] për qëllime komerciale në asnjë vend tjetër.”*

Avokati i Popullit, pas analizimi të ligjit dhe pretendimeve për kundër-kushtetutshmëri të tij, erdhi në përfundim se Kuvendi i Kosovës, respektivisht deputetët kanë marrë në konsideratë me kujdes kufizime më të vogla, si alternativa të mundshme për arritjen e qëllimit të Ligjit. Me rastin e hartimit të këtij ligji, Kuvendi i Kosovës me të drejtë është mbështetë edhe në udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të cilat theksojnë se *“efekti i një ndalimi jo të plotë të reklamimit për konsumimin e duhanit është i kufizuar.”*²⁷¹ Këto konsiderata tregojnë se vendimi i Kuvendit për ndalimin e plotë, jo të pjesshëm, të ekspozimit të duhanit ishte plotësisht brenda kufijve të diskrecionit legjislativ të tij dhe se vet ligji, për vlerësimin e Avokatit të Popullit, nuk përmbante shkelje Kushtetuese.

Në rastin e dytë, një grup i banorëve të zonës së Rugovës, janë ankuar tek Avokati i Popullit me pretendimin se Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, cenonte të drejtat e tyre pronësore. Ata kërkuan nga Avokati i Popullit që të kërkonte nga Gjykata Kushtetuese që të njëjtin ta shfuqizonte dhe ta shpallte kundër kushtetues. Pas zhvillimit të takimeve me përfaqësues të banorëve të zonës, por edhe pas konsultimeve edhe me Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe, pas analizimit të Ligjit në fjalë, Avokati i Popullit nuk arriti të krijojë bindjen se ky ligj cenonte të drejtat pronësore të ankuesve dhe si të tillë refuzoi kërkesën si të papranueshme.

Rekomandime

- *Të hiqet afati 6 mujor i parashtrimt të kërkesave nga Avokati i Popullit në Gjykatën Kushtetuese, apo në rastin më të mirë të mos kufizohet me afate e drejta e Avokatit të Popullit për parashtrimin e kërkesave në Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me ligjet.*

²⁷¹Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Nenin 13 të Konventës Kornizë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e duhanit. Në: http://apps.who.int/iris/bitstream/_10665/80510/1/9789241505185_eng.pdf?ua=1 (18.1.2014).

2.31. Përdorimi i gjuhëve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës,²⁷² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve,²⁷³ Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre²⁷⁴ si dhe Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale,²⁷⁵ i detyrojnë të gjitha institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve që të sigurojnë përdorimin e barabartë e të dy gjuhëve zyrtare, gjuhës shqipe dhe asaj serbe, si dhe të gjuhëve zyrtare në komuna. Gjuhët e komuniteteve tjera, si ajo turke, boshnjake dhe rome, janë në përdorim zyrtar në nivel komunal, në bazë të përmbushjes së konditave të parapara me ligj.

Avokati i Popullit ka trajtuar problemin e përdorimit të gjuhëve edhe në raporte tjera vjetore dhe me rekomandimet e veta, të cilat i ka adresuar tek organet përgjegjëse të pushtetit, ka potencuar shkeljen e dispozitave ligjore për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Shkaktarët e problemeve të cekura nuk janë mënjanuar as në vitin 2013. Ligji mbi Gjuhët ende nuk jetësohet në tërësi ashtu siç e parasheh ligji, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal. Edhe më tutje mungojnë burimet njerëzore dhe financiare gjë që paraqet pengesë dhe rrezikon qasjen në shërbime publike shumë-gjuhësore dhe pjesëmarrje të komuniteteve pakicë në jetën publike.

Çështja e përkthimit, për komunitetet pakicë nëpër komuna, ende paraqet problem për shkak të vëllimit të madh të punës me të cilën përballet njësia e përkthimit, numrit të vogël të përkthyesve, mungesës së kualifikimeve adekuate të përkthyesve, mjeteve financiare etj. Mbishkrimet në gjuhët zyrtare ose në gjuhët në përdorim zyrtar nëpër ndërtesat publike dhe brenda tyre ende të mangëta ose me gabime. Ekzistojnë ende probleme dhe të dhëna të shënuara gabimisht në dokumentet personale të qytetarëve si dhe emërtimet e vendeve në mbishkrimet rrugore në tërë Kosovën.

Në komunat në veriun e Kosovës fare nuk respektohet përdorimi i gjuhëve zyrtare. Megjithatë duhet theksuar se, me vendim të Ministrisë së punëve të brendshme, në fund të dhjetorit 2013, ka filluar dhënia e letërnjoftimeve biometrike në gjuhën turke.

Ende nuk është bërë standardizimi i termeve në gjuhët zyrtare dhe udhëzimet për përkthim. Për shkak të lëshimeve shumëvjeçare dhe abuzimit të aplikimit të Ligjit mbi gjuhët, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve pranë Kuvendit të Kosovës ka themeluar grupin punues për mbikëqyrje dhe jetësim të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve.²⁷⁶

Gjatë kohës për të cilën raportohet nuk ka pasur ndonjë lëvizje dhe veprim të dukshëm të qeverisë në lidhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit, të dhëna në Raportin vjetor të vitit të shkuar, që ka të bëjë me ngritjen e vetëdijes dhe rëndësinë e krijimit të kushteve dhe klimës së përshtatshme të mësimit të gjuhëve zyrtare dhe përfshirjes së tyre në sistemin arsimor të Kosovës. Kjo tani më paraqet problem, që në të ardhmen e afërt do të krijojë problem edhe më të madh në implementimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve.

²⁷² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5.

²⁷³ Ligji për përdorimin e gjuhëve nr.02/L-37.

²⁷⁴ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre nr. 03/L-047.

²⁷⁵ Ligji për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040.

²⁷⁶ Mbledhja e komisionit për të drejta dhe interesa të komuniteteve dhe kthim, në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=3,128,5538> (01.11.2013).

Çështja e gjuhës është tërësisht çështje thelbësore në mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, për arsye se kjo ndikon në shumë lëmi tjera të rëndësishme të posaçme për komunitete, siç është arsimimi, veprimi politik, qasje e barabartë në mundësi për punësim dhe media.

2.31.1. Zyra e Komisionarit për gjuhët

Pas themelimit të Zyrës së Komisionarit për Gjuhë,²⁷⁷ brenda kabinetit të kryeministrit, e cila ka filluar punën në fund të vitit të shkuar pas emërimit të Komisionarit për Gjuhë, punësimi të personelit të Zyrës, sigurimi të hapësirës dhe resurseve, krijimi të dy mekanizmave mbështetës të Këshillit për Politikë Gjuhësore dhe Rrjeti për Politikë Gjuhësore, Qeveria ka siguruar përkrahje institucionale në jetësimin dhe forcimin e politikës gjuhësore dhe ka treguar gatishmëri dhe dëshirë politike në tejkalimin e problemeve ekzistuese drejtë aplikimit të tërësisht të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.²⁷⁸ Mandati i Komisionarit dhe funksioni të cilin ai e kryen në Kosovë është vlerësuar shumë i fuqishëm krahasuar me institucionet tjera me karakter të ngjashëm në botë.²⁷⁹

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, është themeluar Rrjeti për Politikë Gjuhësore që do të sigurojë që institucionet të emërojnë zyrtar përgjegjës me të cilët Zyra e Komisionarit për gjuhë do të mund të bashkëpunojë me synim të vetëm të jetësimi sa më të mirë të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.

Meqë është cekur në Raportin e vitit të shkuar të Avokatit të Popullit, se komunitetet në Kosovë kanë mundësi shumë të vogla, që pos gjuhës së vet amtare, të mësojnë ndonjë gjuhë zyrtare, është lansuar një nismë e caktuar në këtë aspekt dhe gjatë kohës raportuese Zyra e Komisionarit për Gjuhë në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI), nën përkrahjen e Zyrës së OSBE-së për të Drejta të Pakicave, ka iniciuar projektin në kuadër të së cilës këtë vit janë trajnuar diku rreth 270 zyrtar komunalë, në dhjetë komuna në tërë Kosovën.²⁸⁰ Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve dhe ofrimin e mundësive që zyrtarët komunal të kuptojnë më mirë gjuhën e komuniteteve tjera, si dhe të shtojnë mundësinë e komunikimit më të mirë në mes veti.

Komisionari për gjuhë, pas publikimit të raportit *ex-officio* të Avokatit të popullit vitin e shkuar për përdorim të gjuhëve zyrtare në faqet zyrtare të komunave të Republikës së Kosovës,²⁸¹ ka monitoruar faqet zyrtare të ministrive dhe ka ardhur në përfundim se në shumë ministri nuk publikohen informacionet në të dy gjuhët zyrtare, se ato nuk përditësohen rregullisht ose përditësohen vetëm në një gjuhë, kryesisht në gjuhën shqipe.

²⁷⁷ Rregullore nr. 07/2012.

²⁷⁸ Avokati i Popullit ka informuar hollësisht lidhur me këtë në Raportet vjetore të viteve 2011 dhe 2012, pjesa për Përdorimin e gjuhëve.

²⁷⁹ Deklarata e z. Astrid Tors, Komisionarit të lartë të OSCE-së për pakica kombëtare, në: <http://www.komisioneri-ks.org/?page=3,61> (23.12.2013).

²⁸⁰ Informatat e marra nga takimi i mbajtur në mes të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit me komisionarin për gjuhë, të mbajtur me datën 29.11. 2013.

²⁸¹ IAP, *rasti A. nr. 275/2012*.

Madje nuk janë tejkaluar edhe problemet rreth cilësisë së përkthimeve në gjuhën serbe të ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat i bëjnë institucionet e Kosovës në nivel qendror dhe lokal, por as edhe e problemeve rreth cilësisë së dokumenteve të përkthyer në gjuhën turke dhe boshnjake, gjuhë këto në përdorim zyrtar në shumë komuna të Kosovës. Ky është një problem kryekëput pasojë e mungesës së përkthyesve profesionalë nga këto komunitete, të cilët do të përkthenin dokumentet nga gjuha shqipe dhe ajo angleze, apo edhe nga gjuhët e tjera, në gjuhën e tyre amtare. Një përkthim kualitativ në gjuhën serbe, apo ndonjë gjuhë tjetër nuk mund të pritët nga personat që nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën në të cilën përkthejnë, përveç në raste të rralla. Numri i përkthyesve profesionalë në këto gjuhë në institucionet e Republikës së Kosovës është jashtëzakonisht i kufizuar.

2.31.2. Aktiviteti i IAP-së për mbrojtjen e të drejtës së përdorimit të gjuhës

Përfaqësuesit e Avokatit të popullit gjatë kohës për të cilën raportohet kanë mbajtur dy mbledhje me komisionarin për gjuhë në lidhje me ankesat të cilat qytetarët i kanë paraqitur Institucionit të Avokatit të Popullit, e të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe implementimin e Ligjit mbi Gjuhët, si dhe mundësinë për të bashkëpunuar në këtë drejtim. Komisionari gjatë këtyre takimeve ka theksuar që, në pajtueshmëri me rekomandimet e Avokatit të Popullit, do të ndikoj që cilësia e përkthimit të ligjeve dhe akteve nënligjore të përmirësohet dhe lidhur me këtë do të përpiqetqë nga fondet kadrovike të sigurohen mjete financiare shtesë për përkthyes dhe lektor cilësorë. Poashtu ka theksuar që në bashkëpunim me UNDP dhe ECMI, planifikon që në të ardhmen e afërt të standardizojë terminologjinë dhe hartojë një fjalor adekuat për përkthyes.²⁸²

Në kërkesë të Komisionit për të drejta dhe interesa të komuniteteve dhe kthim, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë marr pjesë në dëgjimin publik mbi monitorimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, ku kanë pasqyruar vërtetimet e tyre disa vjeçare në përcjelljen e jetësimit të këtij ligji në praktikë, prej ditës së ardhjes së saj në fuqi.

Në fund të këtij diskutimi, me qëllim të përmirësimit të implementimit të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, të pranishmit kanë shpreh mendimin se mësimi i gjuhës shqipe dhe serbe duhet nisur që në shkollimin fillor, që të organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme për përkthyes si dhe të bëhet standardizimi i gjuhës.²⁸³ Këto dhe rekomandimet tjera Avokati i Popullit i ka dhënë në Raportin vjetor të vitit 2012, madje edhe para këtij debati.

Gjatë kohës për të cilën raportohet IAP ka pranuar disa ankesa të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e përdorimit të gjuhëve zyrtare si në nivel lokal gjithashtu edhe atë qendror. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit në fazën e hetimit, ka konstatuar mosrespektim të ligjit dhe shkelje të së drejtës së përdorimit të gjuhës dhe bazuar në këtë u ka dërguar palëve përgjegjëse Raportin

²⁸² Përfaqësuesit e Avokatit të popullit kanë pasur takime me komisionarin për gjuhë më 21.03.2013 dhe 29.11.2013.

²⁸³ Dëgjim publik mbi implementimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve të mbajtur më 5.06.2013.

me rekomandime, të cilat e kanë njoftuar Avokatin e Popullit se kanë vepruar në përputhje me rekomandimet e ofruara.²⁸⁴

Rekomandime:

- *Qeveria e Kosovës në nivel qendror dhe lokal të sigurojë forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike në mënyrë që respektohet dhe në mënyrë cilësore të zbatohet Ligji mbi përdorimin e gjuhëve.*
- *Të gjitha institucionet në nivel qendror në Republikën e Kosovës dhe të gjithat komunat në Kosovë, të sigurojnë punësimin e përkthyesve profesionalë për gjuhën serbe dhe gjuhët tjera zyrtare, me qëllim të përmirësimit të përkthimit të dokumenteve në këto gjuhë.*
- *Qeveria e Kosovës së bashku me ministrinë e duhura të sigurojnë që sistemi arsimor i Kosovës të inkurajojë përafrinë gjuhësore dhe të ndërmerr masa me qëllim të sigurimit të orëve nga gjuha tjetër zyrtare.*
- *Të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të sigurojnë trajnimin e duhur për shërbyesit civil, në mënyrë që të sigurohet mësimi i të dy gjuhëve zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, sidomos në komunat me shumicë serbe, me qëllim të tejkalimit të barrierave gjuhësore.*

2.32. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre

Në Republikën e Kosovës jetojnë bashkësi të ndryshme pakicë, siç janë: serbët, boshnjakët, turqit, kroatët, malazezët, romët, ashkallitë dhe egjiptasit. Të drejtat e bashkësive pakicë garantohen me nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili ka të bëjë me mbrojtjen në fushën e kulturës, ruajtjen e identitetit, arsimimin, përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, qasje dhe përfaqësim në media. Përveç nenit 59, vlen të përmendet edhe neni 60 i cili ka të bëjë me formimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ për Bashkësitë, si dhe nenet 61 dhe 62 të cilat bashkësive pakicë në Kosovë ju garantojnë përfaqësim në organet shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Po ashtu, përveç neneve të lartpërmendura, të drejtat e pakicave në Kushtetutë mbrohen përmes Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave,²⁸⁵ e cila ka për qëllim të avancojë barazinë e plotë dhe efikase të bashkësive pakicë në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nuk ka pasur ndryshime të mëdha në kuptim të përmirësimit domethënës të situatës në të cilën ndodhen bashkësitë pakicë në Kosovë. Edhe në këtë raport, si edhe më herët do të bëhet fjalë për çështjet të cilat kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave themelore të qytetarëve, pjesëtarë të bashkësive pakicë, si dhe për të

²⁸⁴ IAP, rasti A. nr. 340/2013. Pala përgjegjëse Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Kadastër, Paluajtshmëri dhe Gjeodezi; IAP, rasti A. nr.499/2013. Pala përgjegjëse Ministria e Punëve të Brendshme; *ex-officio* A.nr.334/2013. Palët përgjegjëse: Ministria e Financave dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor ende nuk është përgjigjur në rekomandime.

²⁸⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, paragrafi 4.

drejtat e përcaktuara me nenet 59, 60, 61 dhe 62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në këtë pjesë të raportit vjetor do të vë theks të veçantë në sukseset dhe dështimet lidhur me kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Kosovë, për integrimin e tyre, mjete e informimit publik, arsimimin, punësimin, përfaqësimin e pakicave në organet e pushtetit, si dhe për të drejtën për gëzim të qetë dhe të papenguar të së drejtës në pronë dhe të drejtat tjera të cilat burojnë nga kjo e drejtë.²⁸⁶

2.32.1. Kthimi i personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Kosovë

Sikurse edhe gjatë periudhave të mëhershme, edhe gjatë vitit 2013, vazhdon trendi i cili reflektohet në numrin gjithnjë e më të vogël të të kthyerve, pjesëtarë të bashkësive pakica. Kjo situatë ka të bëjë me personat të cilët vullnetarisht kthehen në vendet në të cilat kanë jetuar deri në vitin 1999.²⁸⁷

Kthimi i personave të zhvendosur dhe refugjatëve gjatë vitit 2013 ka qenë dukshëm më i vogël krahasuar me vitin e kaluar (Në vitin 2012 në Kosovë janë kthyer 662 persona, kurse gjatë vitit 2011 u kthyen 1143 pjesëtarë të bashkësive pakica),²⁸⁸ gjë që tregon se me çështjen e kthimit, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, pushteti duhet të merret më seriozisht.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) edhe më tej u ofron ndihmë të kthyerve. Veçanërisht duhet të përmendet projekti i cili ka të bëjë me kthimin dhe ri-integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptasve,²⁸⁹ si dhe hartimin e strategjisë së MKK lidhur me kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve për periudhën kohore 2014-2018. Në strategjinë e lartpërmendur të MKK është paraparë edhe nisma për propozimin e hartimit të Ligjit për personat e zhvendosur,²⁹⁰ por, pavarësisht kësaj MKK ka edhe disa lëshime në punën e saj. Në fakt, përfaqësuesit e disa komunave të bashkësive pakica në Kosovë gjatë takimit me përfaqësuesit e IAP kanë shpërfaqur edhe ankesa të caktuara lidhur me punën e kësaj ministrie.

Në fakt, komuna e Ranillugut, qysh në mars të vitit 2013 i ka parashtruar kësaj ministrie 35 kërkesa për asistencë për të kthyerit në këtë komunë të cilat MKK në parim i ka pranuar, megjithatë deri në dhjetor 2013 asnjë nga kërkesat e lartpërmendura nuk është realizuar. Sipas shefit të Zyrës për Kthim dhe Komunitetet në komunën e Ranillugut, të vetmen asistencë të

²⁸⁶ Përfaqësuesit e IAP-së me qëllim të përgatitjes së këtij raporti kanë mbledhur informata në tërë Kosovën gjatë bisedave me bashkëbisedues të shumtë lokalë (qytetarët, përfaqësuesit e komunave të cilët janë pjesëtarë të bashkësive pakica, OJQ-të lokale etj.), si dhe me organizatat ndërkombëtare (OSBE, UNHCR, ECMI, etj).

²⁸⁷ Zyra e shefit të misionit të UNHCR në Prishtinë, pasqyra e të dhënave statistikore, të azhuruara në fund të nëntorit 2013. Në bazë të të dhënave të UNHCR nga janari deri në fund të nëntorit të vitit 2013 në Kosovë janë kthyer vetëm 402 persona, pjesëtarë të bashkësive pakicë, pra të bashkësisë serbe 19 romë, 112 ashkali/egjiptas, 39 boshnjakë, 2 goranë dhe një pjesëtarë i bashkësisë turke.

²⁸⁸ Zyra e shefit të misionit të UNHCR në Prishtinë, pasqyra e të dhënave statistikore për vitin 2011, 2012 dhe 2013.

²⁸⁹ MKK, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,630> (21.12.2013).

²⁹⁰ MKK, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,635> (21.12.2013).

cilën e kanë komuna dhe të kthyerit është nga organizatat ndërkombëtare (MercyCorps dhe Këshilli Danez për Refugjatë) të cilat ndihmojnë aq sa kanë mundësi.²⁹¹

MKK është njëra nga palët nënshkruese të planit të veprimit për kthim të zhvendosurve në qytete me përfaqësuesit e komunës së Prizrenit, Ferizajt dhe Shtërpçës.²⁹² Kjo gjë përbën një hap pozitiv në procesin e kthimit, por para nënshkrimit të marrëveshjeve të tilla organet e pushtetit para së gjithash duhet të mbrojnë të kthyerit dhe pronën e tyre, pasi që të njëjtit, si kategori e cenueshme e popullatës dhe më tej janë cak i sulmeve në disa vendbanime në të cilat kthehen..

Në fakt, në këtë kontekst, gjatë vitit 2013 ka ndodhur disa sulme ndaj të kthyerve, pjesëtarëve të bashkësive pakica dhe pronës së tyre në shatrat Grabac, Binçë dhe Bërkovë (komuna e Klinës), Bellopojë (komuna e Pejës), Bablak (komuna e Ferizajt), Lig dhe Kosh (komuna e Istogut).²⁹³

Ashtu si edhe viteve të mëparshme, në kthim ndikon fakti që një numër i madh i pronave të uzurpuara të personave të zhvendosur dhe refugjatëve edhe më tej evidentohen pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe gjykatave kompetente, të cilat edhe më tej i karakterizon vonesa në punën në lëndët e natyrës pronësore. IAP edhe më tej punon në lëndët dhe ankesat e pazgjidhura të cilat i kanë parashtruar qytetarët për shkak të kohëzgjatjes së procedurës pranë AKP-së dhe gjykatave në Kosovë, nga të cilat ankuesit kanë kërkuar që të lirohet prona e tyre nga mbajtësit ilegal dhe e njëjta t'u kthehet atyre si pronarë në posedim.²⁹⁴

Edhe në këtë raport, si edhe në gjitha raportet e mëparshme, IAP ka tërhequr vëmendjen institucioneve kompetente se edhe më tej një pjesë e bashkësive pakica jetojnë në kontejnerë në vendbanimet kolektive në tërë Kosovën dhe kanë status të personave të zhvendosur brenda vendit. Me këtë rast, IAP apelon për zgjidhje urgjente të personave të zhvendosur, si me përkujdesjen ndaj tyre duke u siguruar banim, ashtu edhe në punën e përkushtuar në kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre.

2.32.2. Arsimimi i pjesëtarëve të bashkësive pakica

Si edhe në raportet e mëhershme, ashtu edhe në këtë periudhë për të cilën po raportohet, gjendja në këtë fushë nuk ka ndryshime të mëdha. Situata edhe më tej është komplekse, pasi që si edhe më parë, edhe më tej funksionojnë dy sisteme paralele të arsimit, njëri sipas plan programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Republikës së

²⁹¹ Më 27 nëntor 2013, këshilltarja ligjore e IAP ka mbajtur takim me zyrtaren për të drejtat e njeriut dhe shefin e zyrës për kthim në komunën e Ranillugut. Në takim është marrë e dhëna se MKK në mars të vitit 2013 ka pranuar 35 kërkesa të zyrës për kthim dhe komunitete të komunës së Ranillugut, 5 kërkesa për ndërtimin e shtëpive dhe 30 për material ndërtimor, por deri në dhjetor të vitit 2013 asnjë kërkesë nuk është realizuar dhe MKK nuk ka dhënë asnjë sqarim përse po vonohet në realizimin e këtyre kërkesave. Po ashtu, në komunën e Klllokotit, zyrtarët e zyrës për bashkësi dhe kthim ankohen për shkak të mungesës së mjeteve dhe ndihmës e cija u dedikohet të kthyerve dhe të cilat i ndan MKK.

²⁹² MKK, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,623> (21.12.2013).

²⁹³ Po aty.

²⁹⁴ IAP, rastet: A.nr. 64/2010, A.nr. 338/2010, A.nr. 532/2012, A.nr. 513/2013; A.nr. 533/2012, A.nr. 226/2012, A.nr.507/2013, A.nr. 598/2013. Ankesat e qytetarëve të parashtruara në IAP për shkak të moszgjidhjes kërkesave të tyre pronësore nga AKP dhe organet gjyqësore.

Kosovës dhe tjetri sipas plan programit të Ministrisë së Arsimit të Serbisë, të cilët funksionojnë plotësisht ndaras që nga viti 1992 dhe sidomos pas vitit 1999.. Shkollat që zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe sipas planeve dhe programit të Serbisë nuk bashkëpunojnë fare me MASHT-in në asnjë fushë.

Bashkësia e turke, boshnjake, një numër i madh i pjesëtarëve të bashkësisë ashkali dhe egjiptas, si dhe një numër i pjesëtareve të bashkësisë rome, vijojnë mësimin sipas plan programit të MASHT. Pjesëtarët e bashkësisë serbe, kroate,²⁹⁵ malazeze, gorane (komuna e Dragashit) dhe një pjesë e madhe e bashkësisë rome, vijojnë mësimin në gjuhën serbe sipas plan programit të Republikës së Serbisë.

Pjesëtarët e bashkësisë rome, ashkali dhe egjiptas edhe më tej në përqindje më të vogël vijojnë mësimin në shkolla fillore dhe të mesme, që sipas të dhënave të MASHT është 14%. Kjo e dhënë përfshinë vetëm shkollat të cilat punojnë sipas plan programit të MASHT. Nuk ka të dhëna të tilla apo të ngjashme për Romët të cilët vijojnë mësimin në hapësirat ku shkollat punojnë sipas plan programit të Republikës së Serbisë.²⁹⁶

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, sektori civil ka bërë shumë në mënyrë që fëmijëve, pjesëtarë të bashkësisë rome, ashkali dhe egjiptas t'u afrohet shkolla në kuptim që atyre mësimi t'u prezantohet si obligim, por edhe si kënaqësi. Duke ju falënderuar OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare, janë hapur 30 qendra të arsimit për pjesëtarët e kësaj bashkësie të cilat aktivitetin primar e kanë në ndihmesën fëmijëve në parashkollor dhe nxënësve në hartimin e detyrave të shtëpisë, si dhe t'u ndihmojnë që më lehtë të zotërojnë me kurrikulën shkollore të cilën e kanë kaluar në shkollë. Programet e tilla në përgjithësi zbatohen pas përfundimit të mësimin, ndërsa një pjesë e programit mbahet në ndërtesa shkollore, kurse pjesa tjetër në shtëpitë private.²⁹⁷

Përveç ndihmës nxënësve në hartimin e detyrave të shtëpisë gjatë mësimin, OJQ-të rome kanë nisur programin e arsimit (aftësimin për të shkruar dhe lexuar) të personave pjesëtarë të këtyre bashkësive, si dhe dhënie e bursave nxënësve të shkollave të mesme dhe në këtë mënyrë i motivuan nxënësit e shkollave të mesme që të mos e braktisin shkollimin.

Programe të tilla të përkrahjes së arsimit janë realizuar vetëm duke iu falënderuar donacioneve të organizatave ndërkombëtare dhe ambasadave të vendeve të Evropës perëndimore në Kosovë. Por, qëndrueshmëria e programeve nga fusha e arsimit dhe motivimi i fëmijëve të bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase që të vazhdojnë shkollimin varet edhe nga bashkëpunimi me institucionet vendore, veçanërisht me MASHT, por edhe zyrën për çështje të komuniteteve në Qeverinë e Kosovës, por sipas fjalëve të përfaqësuesve të sektorit civil, një bashkëpunim i tillë është minimal dhe pothuajse nuk ekziston fare.²⁹⁸

Duke pasur parasysh çfarë u tha më lartë, është e domosdoshme që të angazhohen institucionet kompetente dhe të përkrahin iniciativa të tilla, në mënyrë që fëmijët, pjesëtarëve të bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase të inkurajohen për të vazhduar shkollimin, si dhe

²⁹⁵ Shkolla fillore "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, komuna e Lipjanit.

²⁹⁶ Të dhënat dhe informatat e marra nga OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve".

²⁹⁷ *Po aty*. Informatat e marra edhe nga përfaqësuesit e OSBE-së gjatë takimit të mbajtur më 5 dhjetor 2013 në Zyrën e OSBE-së në Graçanicë.

²⁹⁸ Të dhënat dhe informatat e marra nga OJQ „Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve“.

për ngritjen e vetëdijes tek prindërit dhe fëmijët për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e shkollimit.

Pjesëtarët e bashkësisë gorane të komunës së Dragashit mësimin e vijnë në gjuhën serbe, sipas plan programit të Republikës së Serbisë, ndërsa numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme është rreth 1'100. Mësimi zhvillohet në ndërtesat ekzistuese shkollore në fshatrat gorane dhe boshnjake, dhe kjo në dy ndërrime. Në njërin ndërrim, mësimin e vijnë fëmijët pjesëtarë të bashkësisë boshnjake sipas plan programit të Republikës së Kosovës, ndërsa në ndërrimin e dytë mësimin e vijnë fëmijë pjesëtarë të bashkësisë gorane, sipas plan programit të Republikës së Serbisë.

Pjesëtarët e bashkësive turke dhe boshnjake të cilët vijnë mësimin në gjuhën e tyre amtare sipas plan programit të MASHT, ashtu si edhe viteve të mëhershme ballafaqohen me problemin e teksteve shkollore në gjuhën e tyre. Lidhur me këtë problem, IAP ka raportuar edhe në vitet e mëparshme, por problemi edhe më tej nuk është zgjidhur.

Shumica e teksteve shkollore të cilat MASHT i ka hartuar në gjuhën turke dhe boshnjake janë kualitetit shumë të dobët, kështu që kuadri arsimor së bashku me nxënësit ia del disi në të gjitha mënyrat e mundshme në mënyrë që kjo mungesë të sadopak të kompensohet (për shembull, tekstet shkollore sigurohen në Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës). Për sa i përket këtij problemi, në rastin e bashkësisë turke deri diku është zgjidhur problemi i teksteve shkollore në shkollat e mesme, sepse ambasada turke ka siguruar tekste deri në vitin shkollor 2015/16.²⁹⁹

Pjesëtarët e bashkësisë turke dhe boshnjake nuk janë të kënaqur me numrin e institucioneve shtetërore të arsimit të lartë në gjuhët e këtyre bashkësive. Pjesëtarët e bashkësisë turke mund të vijnë shkollimin e lartë në gjuhën e tyre në fakultetin për edukim në Universitetin e Prizrenit dhe në katedrën për gjuhën dhe letërsinë turke në Universitetin "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Por, një numër i madh i studentëve të bashkësisë turke përcaktohen për shkuarjen në Turqi, ku vazhdojnë arsimimin e mëtejshëm. Pjesëtarët e bashkësisë boshnjake, arsimimin e lartë në gjuhë e tyre mund ta marrin në fakultetin e shkencave të aplikuara dhe biznesit në Pejë, si dhe në fakultetin e edukimit në Universitetin Publik të Prizrenit. Ashtu si edhe studentët e bashkësisë turke, edhe studentët boshnjak e vazhdojnë shkollimin në fakultetet e Bosnjës dhe Hercegovinës ose në Serbi.

Kur bëhet fjalë për mësimin i cili zhvillohet në gjuhën serbe, sipas plan programit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, arsimimi fillor dhe i mesëm vijnë në hapësirat me shumicë të pjesëtarëve të bashkësisë serbe, bashkësisë gorane dhe një pjesë të bashkësisë rome. Arsimi i lartë gjithashtu funksionon sipas plan programit të Republikës së Serbisë, ndërsa qendra universitare ndodhet në veri të Mitrovicës, ndërsa degët e disa fakulteteve janë të hapura edhe në Graçanicë.

Sa i përket arsimimit fillor dhe të mesëm, që në Kosovë në vendbanimet serbe funksionojnë sipas sistemit arsimor të financuar nga Republika e Serbisë, problemin më të madh e paraqet kualiteti i pamjaftueshëm i arsimimit. Në mesin e mësimdhënësve ka edhe një pjesë të kuadrove i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret në kuptim të përgatitjes shkollore, përvojës dhe

²⁹⁹ Raporti i OJQ "Qendra për integrim të bashkësive etnike" nga Prizreni e cila ka bërë raport lidhur me respektimin e të drejtave të qytetarëve në komunën e Prizrenit. Këshilltarja ligjore, informatat lidhur me bashkësinë turke dhe boshnjake i ka marrë nga sektori civil nga Prizreni.

ekspertizës. Përveç kësaj, problem të madh paraqet edhe mbipopullimi i shkollave, pra të objekteve në të cilat zhvillohet mësimi. Në një ndërtesë, përveç shkollës fillore janë të vendosura edhe disa shkolla të mesme, kështu që nxënësit vijnë në mësimin në 3 ndërtime, siç është rasti për shembull në Graçanicë, Llapnasellë, Shtërpce, etj.³⁰⁰

Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, duhet theksuar se nuk ekziston çfarëdo bashkëpunimi ndërmjet MASHT dhe shkollave të cilat punojnë në gjuhën serbe, të cilat nuk pranojnë asnjë kontakt me MASHT as institucionet e Republikës së Kosovës.

2.32.3. Këshilli konsultativ dhe Zyra për çështje të bashkësive

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 60 parasheh krijimin e Këshillit Konsultativ për Bashkësitë, i cili ka mandat të sigurojë mekanizmat për shkëmbim të rregullt të mendimit qeverisë dhe pjesëtarëve të bashkësive pakica, si dhe që në emër të bashkësive pakica në fazën fillestare të jap komentet e veta lidhur me iniciativat politike dhe legjislative dhe të jap propozimet e veta, por gjithashtu mund të kërkojë që qëndrimet e tij të përfshihen në projektet dhe programet relevante. Këshilli konsultativ për komunitete (KKK) funksionon në kuadër të kabinetit të Kryetarit të Kosovës dhe përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha bashkësive në Kosovë nga radhët e sektorit civil dhe shoqatat e bashkësive.³⁰¹

KKK përbën organin kryesor përmes së cilit bashkësitë ia paraqesin qeverisë qëndrimet dhe problemet e tyre. Po ashtu, KKK, në bazë të mandatit të tij, paraqet organin kyç për prani të bashkësive pakica në kuadër të procesit të nxjerrjes së ligjeve dhe vendim-marrjes në Republikën e Kosovës.

Problem të madh në punën e këtij Këshilli edhe më tej paraqet mungesa e buxhetit adekuat për çfarëdo pune në terren, hartim të raporteve, broshurave apo çfarëdo lloje iniciative tjetër, me qëllim të paraqitjes së problemeve me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e bashkësive në Kosovë.³⁰²

Duke pasur parasysh se vetëm në vitin 2013, Këshilli Konsultativ për bashkësitë ka filluar të punojë seriozisht për të bërë që problemet e bashkësive të dëgjohen edhe tek organet më të larta të pushtetit në Republikën e Kosovës.

Sa i përket Zyrës për Bashkësitë pranë kabinetit të Kryeministrit, kjo zyrë është krijuar me Vendimin e Qeverisë nr. 06/34 për krijimin e Zyrës nga 3 shtatori 2008. Kjo zyrë ka mandat për zgjidhjen e nevojave praktike të bashkësive.³⁰³

Pas një periudhe të heshtjes në punën e kësaj zyreje, mungesës së rezultateve dhe të transparencës në punë, përparimi gjatë viteve 2012 dhe 2013 është i dukshëm, ndërsa rezultatet pozitive janë të dukshme dhe kanë të bëjnë me iniciativa të ndryshme, raporte dhe ndihmën konkrete në terren duke iu falënderuar angazhimit të Zyrës tek organet kompetente në mënyrë që pjesëtarëve të bashkësive t'u dilet në ndihmë.

³⁰⁰ Po aty.

³⁰¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 60.

³⁰² European Council for Minority Issues, Kosovo (ECMI), <http://www.ecmikosovo.org/?p=3121> (22.12.2013).

³⁰³ Në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=3,134>, dhe <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,54> (22.12.2013).

Po ashtu, mund të vlerësohet pozitivisht edhe realizimi i planit të veprimit për vitin 2013, siç është bashkëpunimi me organet qendrore të pushtetit, bashkëpunimi me komunat, me sektorin civil, ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare dhe një lloj ndihme sociale banorëve të rrezikuar në aspektin social. Me këtë rast, IAP përshëndet hartimin e raportit të kësaj Zyre i cili ka të bëjë me vlerësimin e punësimit të pjesëtarëve të bashkësive pakicë në shërbimet dhe ndërmarrjet publike në Kosovë,³⁰⁴ si dhe fillimi i bashkëpunimit me Këshillin konsultativ për komunitetet.³⁰⁵

2.32.4. Gjendja e bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase

Bashkësitë rome, ashkali dhe egjiptase edhe gjatë kësaj periudhe raportuese përballen me probleme sa i përket gjendjes socio-ekonomike të arsimimit të fëmijëve dhe të rinjëve, kushteve të banimit në të cilat jetojnë dhe çështjen e integritetit të tyre në shoqëri. Projektet për mbylljen e kampeve të romëve dhe ashkalive të zhvendosur në veri të Kosovës në përgjithësi janë realizuar.

Strategjia për integrimin e bashkësive romë, ashkali dhe egjiptas (2009-2015) dhe plani i saj i veprimit për zbatim thekson masa konkrete në mënyrë që të integrohen më mirë pjesëtarët e këtyre bashkësive në kuadër të shoqërisë kosovare. Mirëpo zbatimi i kësaj strategjie vazhdon të çalojë dhe të mos ketë efektet e duhura.³⁰⁶

Për zbatimin e strategjisë së lartpërmendur dhe planit të veprimit, gjatë kësaj periudhe të raportimit ka pasur edhe lëvizje pozitive në kuptim të asaj që ekziston vullneti politik dhe se çështja e zbatimit të strategjisë është më shumë e pranishme në institucionet e pushtetit, në përgjithësi si temë, për dallim nga 5 vitet e kaluara kur nuk është bërë pothuajse asgjë.

2.32.5. Ripranimi dhe riatdhesimi

Kur flitet për ripranimin dhe riatdhesimin gjatë vitit 2013, nga vendet nikoqire, kryesisht nga vendet e Evropës perëndimore, janë kthyer gjithsej 2.061 persona.³⁰⁷ 64% janë kthyer me

³⁰⁴ Zyra për çështje të bashkësive pranë kabinetit të Kryeministrit, në: <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,4,164> (22.12.2013).

³⁰⁵ Zyra për çështje të bashkësive pranë kabinetit të Kryeministrit, në: <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=3,4,165> dhe në: http://kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Zajednicki_dokument_final.pdf (22.12.2013). Më 12 dhjetor 2013 Zyra e Kryeministrit për çështje të bashkësive organizoi promovimin e hulumtimit “Vlerësimi i punësimit të pjesëtarëve të bashkësive pakica në shërbimet dhe ndërmarrjet publike në Kosovë” të cilën e bëri në bashkëpunim me UNDP dhe kompaninë Novus e cila e kreu hulumtimin në terren.

³⁰⁶ Për nevojat e këtij raporti, IAP lidhur me strategjinë dhe planin e veprimit ka biseduar me përfaqësuesin e bashkësisë rome dhe drejtorin e OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve”. Komisioni ka theksuar si sfidë të veçantë mungesën e mbikëqyrjes dhe kapaciteteve për shkrimin e raporteve në kombinim me bashkëpunimin e dobët institucionale, mbledhjen e kufizuar të të dhënave dhe praktikën e përpunimit të të dhënave.

³⁰⁷ Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme – “Strategjia kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar”, pasqyra e të dhënave statistike e azhurnuar në fund të tetorit 2013, në: <http://mpb-ks.org> (02.12.2013.). Megjithatë, sipas pasqyrës së të dhënave statistikore të Zyrës së shefit të misionit të UNHCR në Prishtinë, i azhurnuar në fund të nëntorit 2013, numri i personave të riatdhesuar është 852.

forcë, ndërsa 36 % janë kthyer vullnetarisht. Duke shikuar sipas shteteve, më së shumti janë kthyer nga Gjermania, kryesisht pjesëtare të nacionalitetit shqiptar, mandej romë, ashkali, egjiptas, etj. Numri më i madh i personave të riatdhesuar (vullnetarisht ose me forcë) është në komunat Gjilan, Mitrovicë dhe Prishtinë.

Strategjia e reintegrimit dhe plani i veprimit (2013-2017) i bazuar në parimet e qëndrueshmërisë, identifikimin e mungesave dhe nevojave, qëllimeve të veçanta strategjike, harmonizimin e ndihmës dhe evitimit të diskriminimit pozitiv. Një numër i madh i të riatdhesuarve dhe të reintegruarve paraqesin sfidë të madhe për institucionet. Po ashtu, vetë procesi paraqet shpenzim të madh financiar, gjë që është sfidë shtesë për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ofrimi i ndihmës dhe përkrahjes, përveç shërbimeve themelore, përfshirë këtu edhe banimin, restaurimin/ndërtimin e shtëpive të cilat janë shkatërruar /dëmtuar, financimine projekteve në mënyrë që personat e riatdhesuar të vinë deri tek të ardhurat dhe përkrahje të llojeve tjera.

Personat e riatdhesuar të cilët kanë vështirësi që brenda periudhës së shkurtë të vijnë deri tek të ardhurat sjell deri tek rritja e numrit të njerëzve të cilët varen nga kategoritë sociale, edhe më shumë e ngarkojnë buxhetin e Kosovës. Për të pasur një proces të suksesshëm të reintegrimit të personave të riatdhesuar është shumë e rëndësishme që të krijohen mundësitë për aftësimin e tyre profesional, mundësi të punësimit apo të ofrohen mundësi për fillim të aktiviteteve fitimprurëse për të krijuar të ardhura përmes themelimit të bizneseve.

Edhe personat e riatdhesuar të nacionalitetit serb në komunën e Ranillugut ballafaqohen me të njëjtat sfida të cilat e pengojnë integrimin e tyre të qëndrueshëm. Nëntë familje serbe janë riatdhesuar në këtë komunë të cilat janë kthyer në shtëpitë e tyre dhe marrin pako ushqimore dhe higjienike, por kanë marrë edhe dokumentacionin e nevojshëm nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Problemi sërish paraqitet për të filluar aktivitetet përfituese përmes planeve biznesore. Një numër i qytetarëve i kanë regjistruar kompanitë etyre por presin për plane të biznesit për një kohë më të gjatë, gjoja se MPB e ka humbur të gjithë dokumentacionin e dorëzuar. Prandaj, qytetarëve u është dashur të përsërisin dokumentacionin, por pavarësisht kësaj, problemi i përgjithshëm është mungesa e efikasitetit të zbatimit të strategjisë si pasojë e mungesës së vullnetit politik në nivelin qendror, duke pasur parasysh që deri tek personat e riatdhesuar vjen vetëm një përqindje e vogël e mjeteve financiare.³⁰⁸

Shumë persona të riatdhesuar kanë kaluar kohë të gjatë jashtë vendit. Për të rinjtë, veçanërisht për fëmijët kjo do të thotë se shpesh ata nuk kanë dijeni për cilëndo nga gjuhët zyrtare në Kosovë, gjë që i sjell deri tek vështirësitë në qasje në arsim, trajnim, ndihma sociale dhe mjekësore, si dhe deri te ofrimi i ndihmave të cilat i ofrojnë zyrat publike.

³⁰⁸ Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në: <http://mpb-ks.org> (02.12.2013.), dhe informatat e grumbulluara me rastin e bisedimit të IAP me shefin e zyrës për bashkësi dhe kthim në komunën e Ranillugut.

2.32.6. Mediat

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton qasjen dhe përfaqësimin e bashkësive pakica në mediat publike,³⁰⁹ i cili ka të bëjë me krijimin dhe shfrytëzimin e mediave të tyre, ofrimin e informatave në gjuhën e tyre, përveç tjerash edhe përmes gazetave ditore dhe shërbimeve kabllore, dhe shfrytëzimit të një numri të frekuencave për mediat elektronike, të gjitha këto në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kur bëhet fjalë për mediat, gjatë periudhës raportuese për vitin 2013, IAP ka vërejtur ndryshime pozitive në raport me periudhat e mëhershme të raportimit. Në prill të vitit 2012 u miratua ligji i ri për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në të cilin është paraparë krijimi i kanalit të dytë të RTK vetëm në gjuhën serbe.³¹⁰ Më 3 qershor 2013, RTK 2 ka filluar emetimin e programit në këtë kanal televiziv. Më herët emitohej vetëm ditari në gjuhën serbe, kurse nga shtatori i vitit 2013 emitohet edhe programi i mëngjesit, lajmet, reportazhet nga tereni, dokumentarët dhe një emision politik në mbrëmje.

Po ashtu, bashkësitë ashkali dhe egjiptas kanë rastin që në televizionin publik të Kosovës të promovojnë bashkësitë e tyre edhe përmes mediave të paraqesin problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë pjesëtarët e këtyre bashkësive. Por, edhe më tej ekziston nevoja për zgjerim dhe përforsim me kuadro të programeve në gjuhët e bashkësive tjera, sidomos në gjuhën turke, boshnjake dhe rome.³¹¹

Televizioni publik i Kosovës, RTK1, bazuar në ligjin për RTK me përpikëri zbaton obligimin që së paku 15% të programit të tij të ia dedikojë bashkësive pakica në gjuhët e tyre amtare.³¹² Në pajtim me këtë, çdo ditë (nga e hëna deri të premten) emitojnë programe dhjetëminutëshe të lajmeve dhe një program në gjuhën rome i cili emitohet njëherë në javë.

2.32.7. Përfaqësimi në pushtetin qendror dhe lokal dhe punësimi

Kosova posedon kornizë legjislative të sofistikuar për mbrojtje të përgjithshme të pjesëtarëve të bashkësive pakicë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht mbulon përfaqësimin e bashkësive në institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike.³¹³ Përveç kësaj, një numër i akteve ligjore mbrojnë të drejtat e bashkësive pakica në Kosovë.³¹⁴ Ligji 03/L-149 për shërbimin civil të Kosovës parasheh standardet e zbatueshme për përfaqësim dhe punësim të pjesëtarëve të bashkësive pakica në shërbimin civil të Kosovës dhe kërkon që së paku 10 % të

³⁰⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59, pikat 10 dhe 11.

³¹⁰ Ligji për Radio Televizionin e Kosovës nr.04/L-046, prill 2012.

³¹¹ Bazuar në bisedën me redaktorët e programit në gjuhën turke, boshnjake dhe rome në RTK.

³¹² Ligji për Radio Televizionin e Kosovës nr.02/L-047, neni 6, paragrafi6, si dhe Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës nr.04/L-046.

³¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 61. "bashkësitë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë me rastin e punësimit në organet publike dhe ndërmarrjet publike."

³¹⁴ Ligji nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (2011);Ligji 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, Ligji për arsimimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Ligji për arsimin e lartë në Kosovë; Ligji për Trashëgiminë Kulturore.

pozitive në nivelin qendror të rezervohen për “personat të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Kosovë”, kurse përfaqësimi në nivel komunal duhet të jetë në proporcion me përbërjen demografike të popullsisë në komunën në fjalë.

Administrata shtetërore është skeleti i një shteti funksional pasi që udhëheq politikën e qeverisë dhe ofron shërbime publike për qytetarët, prandaj për këtë arsye në Kosovë duhet të ndërtohet administrata shtetërore gjithëpërfshirëse dhe multietnike. Në të vërtetë, Ligji për Shërbimin Civil obligon të gjitha institucionet shtetërore në Kosovë për një kuotë të caktuar (së paku 10 %) për punësim të zyrtarëve në administratën shtetërore nga radhët e bashkësive pakica, si dhe që të përmbush obligimet pozitive të zbatimit të disa masave aktive të punësimit.

Zyra për çështje të bashkësive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në prill të vitit 2013 ka publikuar raportin për vlerësimin e gjendjes së përfaqësimit të pjesëtarëve të bashkësive pakica.³¹⁵ Së pari, sa i përket përfaqësimit të bashkësive pakica, është konstatuar se 7,7 % të zyrtarëve të administratës shtetërore dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal (përfshirë këtu ndërmarrjet publike) vijnë nga bashkësitë pakica. Pjesëtarët e bashkësive ashkali, egjiptas, goran dhe romë janë jashtëzakonisht pak të përfaqësuar në raport me numrin e përgjithshëm të popullatës nga këto bashkësi, kurse bashkësia e boshnjakëve, turqve dhe serbëve është afër arritjes së pragut të përfaqësimit në institucionet shtetërore. Për sa i përket baraspeshës gjinore, zyrtarët shtetëror nga radhët e bashkësive pakica në përgjithësi janë të gjinisë femërore, gjë që nuk është rast tek zyrtarët tjerë shtetëror në tërësi.

Agjencitë e pavarura dhe komunat kanë normën më të lartë mesatare të përfaqësimit (8,9 % dhe 8,8 %, për secilën veç e veç), kurse ndërmarrjet publike më të ultë (2,2 %). Institucionet shtetërore (ministrinë dhe institucionet përfaqësuese) dhe agjencitë ekzekutive kanë normë relativisht të vogël të përfaqësimit të bashkësive pakica (6,6 % dhe 6,2 %, për secilën në veçanti). Bazuar në faktin se institucionet qendrore duhet të kenë së paku 10 % të zyrtarëve shtetëror nga radhët e bashkësive pakicë, kurse institucionet në nivel lokal duhet të kenë kuotën e zyrtarëve shtetëror nga radhët e bashkësive pakicë në proporcion me përbërjen etnike të secilës komunë në fjalë, mund të konstatojmë se pak institucione të nivelit qendror kanë arritur të plotësojnë prapësin e përfaqësimit 10 %. Duhet më shumë vullnet politik, mjete dhe koordinim ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale për integrim efektiv të bashkësive pakica në Kosovë.³¹⁶

Në pikëpamje të pozitive në punë, pjesëtarët e bashkësive tjera pakicë në përgjithësi janë të punësuar në pozita administrative dhe profesionale, por nuk janë mjaft të përfaqësuar në pozitën udhëheqëse në institucionet shtetërore. Pothuajse të gjithë zyrtarët shtetëror nga radhët e pjesëtarëve të bashkësive ashkali, egjiptas, goran dhe romë janë të punësuar në pozitën administrative.

Në kuptim të përgatitjes shkollërore, dy herë më pak zyrtarë shtetëror nga radhët e bashkësive pakica posedojnë diploma universitare. Por, siç theksohet në këtë raport, arsye për këtë mund të jetë mospranimi aktual i diplomave të arsimimit të lartë të marra në Universitetin në pjesën veriore të Mitrovicës, i cili punon me plan program të Republikës së Serbisë, si dhe për

³¹⁵ Raporti bazohet në anketat e bëra në 104 institucione shtetërore dhe tregon për mungesën e “përfaqësimit të sigurtë dhe të drejtë të të gjitha komuniteteve, përfshirë edhe femrat në udhëheqje në Kosovë”.

³¹⁶ Raporti i Zyrës për çështje të komuniteteve, maj 2013 dhe informata të cilat janë nxjerrë nga hulumtimi i IAP për nevojat e këtij Raporti.

shkak të problemeve të caktuara të ngadalësimit lidhur me nostrifikimin e diplomave, të marra jashtë vendit, nga ana e ministrisë përgjegjëse.

Shumica e institucioneve shpallin konkurse për punë në gjuhët e bashkësive pakicë, kurse me rastin e punësimit në shumicën e institucioneve publike zbatohen masat e diskriminimit pozitiv. Po ashtu, institucionet në mënyrë aktive punojnë në arritjen deri tek pjesëtarët e këtyre bashkësive duke ofruar trajnime për ngritje profesionale. Por, një përqindje shumë e vogël i institucioneve kanë programe të bursave, këshillime, trajnime në vend të punës, punëtori për ndalimin e diskriminimit, strategji të punësimit të përbashkët dhe listat e përhershme të kandidatëve nga radhët e bashkësive pakicë.

Shikuar në përgjithësi, institucionet në nivel qendror dhe lokal në Kosovë punësojnë diku rreth 5,6 % të zyrtarëve shtetëror nga radhët e bashkësive pakicë.³¹⁷ Nëse përjashtojmë ndërmarrjet publike, përfaqësimi i bashkësive pakicë rritet në 7,7 % që është vlerë mesatare e cila është e ngjashme me vlerësimin e OSBE 8,0 %, në të cilat po ashtu nuk janë përfshirë ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet publike punësojnë një numër të madh të njerëzve, por asnjë person i punësuar në ndërmarrjet publike nuk është zyrtarë shtetëror, kështu që ndërmarrjet publike nuk janë të obliguara të plotësojnë kuotën e përfaqësimit të zyrtarëve shtetëror të bashkësive pakicë në 10 %.

Me këtë rast Avokati i Popullit thekson se numri i të punësuarve në institucionet publike në mes të bashkësive të ndryshme, dallon shumë. Lirisht mund të thuhet se punësimi për pjesëtarët e bashkësisë rome, ashkali dhe egjiptas është shumë më i ultë se i bashkësive tjera pakicë.

Edhe pse është përcaktuar korniza ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e bashkësive pakica në Kosovë, nevojitet edhe shumëçka tjetër për t'u bërë, konkretisht, që kjo të bëhet dhe realizohet në praktikë. Vullneti i popullit nuk është vetëm vullneti i shumicës. Në mënyrë që pushteti të jetë përfaqësues ai duhet të respektojë të drejtat e garantuara të bashkësive pakicë, gjë që është në interes të përgjithshëm dhe ka për qëllim prosperitetin e shoqërisë kosovare në tërësi.

³¹⁷ Ai numër është më i vogël se 7,3% të cilin e ka publikuar Qendra Evropiane për çështje të pakicave (ECMI) e cila në kuadër të hulumtimeve të saj ka përfshirë edhe ndërmarrjet publike.

KAPITULLI III

BASHKËPUNIMI DHE AKTIVITETET E IAP-së

IAP veprimtarinë e vet e zhvillon në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm institucionalë e shoqërorë, sikurse në planin vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në këtë kapitull do të shpërfaqen aktivitetet e IAP-së, si dhe të grupeve të ndryshme të specializuara të IAP-së, të realizuara në kuadër të këtij bashkëpunimi.

3.1. Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për të mbrojtur dhe për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë, IAP angazhohet për të bashkëpunuar me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që synojnë promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

IAP gjatë vitit 2013 ka bashkëpunuar me institucionet vendore siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë e ndryshme, komunat, institucionet dhe agjencitë e pavarura, si dhe gjykatat.

IAP në vazhdimësi ka bashkëpunuar me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjatë tërë vitit janë realizuar shumë takime, gjithashtu janë dërguar raporte me rekomandime. Me theks të veçantë duhet përmendur bashkëpunimin shumë të mirë që IAP ka pasur me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, me të cilin janë realizuar takime, lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, me raportet me rekomandime të IAP, si dhe me shqyrtimin e raportit vjetor të IAP. Gjatë këtij viti Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka mbajtur takime trepalëshe midis IAP-së, institucioneve të Republikës së Kosovës me qëllim të verifikimit se a zbatohen dhe, nëse po, sa zbatohen rekomandimet e Avokatit të Popullit nga Raporti vjetor dhe raportet e tjera të IAP-së. Kjo praktikë është e re dhe meriton të vlerësohet shumë lart.

Gjatë këtij viti IAP ka bashkëpunuar edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Edhe gjatë këtij viti IAP ka dërguar raporte me rekomandime për raste të ndryshme. Gjithashtu, janë realizuar takime të shumta lidhur me to. Në të shumtën e rasteve IAP është ftuar në aktivitetet e organizuara nga ana e institucioneve të Qeverisë së Kosovës, lidhur me fushën e të drejtave e njeriut. Vlen të theksohet fakti i një përvoje të re, e cila duhet të intensifikohet edhe më tej, dërgimi i projektligjeve nga Qeveria e Kosovës për komente në IAP, lidhur me fushën e të drejtave të njeriut.

IAP, gjatë këtij viti, ka realizuar disa tryeza të rrumbullakëta, në të cilat janë diskutuar çështje të ndryshme rreth bashkëpunimit në mes të IAP dhe autoriteteve vendore, në lidhje me të drejtat e njeriut në Kosovë.

Më 18 tetor 2013, IAP organizoi tryezën me temën “Zhurma dhe ndikimi i saj në të drejtat e njeriut”. Tryeza ofroi mundësinë e diskutimit rreth bashkëpunimit të IAP-së dhe autoriteteve përgjegjëse për zhurmën.

Një bashkëpunim të ngushtë me komunat IAP e ka pasur edhe gjatë këtij viti. Ka një ngritje të përgjegjshmërisë sa i përket hetimit të ankesave të ndryshme. Gjatë këtij viti IAP ka realizuar takime të shumta dhe ka organizuar tryeza të rrumbullakëta në komuna të ndryshme.

Në muajin tetor 2013, IAP ka organizuar tryezat e rrumbullakëta në zyrat rajonale të IAP-së në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë dhe në Mitrovicë, në pjesën jugore dhe veriore, me temën: *“Përmbushja e misionit të Avokatit të Popullit”*. Këto tryeza ofruan mundësinë e diskutimit të përbashkët të përfaqësuesve të IAP-së, autoriteteve komunale, gjyqësorit, policisë, organizatave joqeveritare dhe mediave, për sfidat ekzistuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe për rolin e IAP-së në këtë aspekt.

Pas reformave në strukturimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe vlerësimit të nevojave për të qenë sa më afër qytetarit, Avokati i Popullit në fillim të këtij viti ka shtuar numrin e zyrave rajonale të IAP-së edhe me dy zyra të reja, në Ferizaj dhe në Gjakovë. Më 30 shtator dhe 1 tetor 2013, IAP me rastin e hapjes së Zyrave Regjionale në Ferizaj dhe në Gjakovë dhe në kuadër të promovimit të vazhdueshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut, ka mbajtur në këto dy qytete Tryeza të rrumbullakëta me temën: *“Përmbushja e misionit të Avokatit të Popullit”*.

Krahasuar me vitin e kaluar bashkëpunimi me gjyqësorin është përmirësuar. Sipas statistikave të IAP edhe gjatë vitit 2013 numri më i madh i ankesave nga qytetarët janë adresuar ndaj gjyqësorit, mirëpo, ka pasur një gatishmëri më të madhe të gjyqësorit për bashkëpunim me IAP. Këshilltarët ligjorë të IAP-së, gjatë këtij viti, në vazhdimësi kanë realizuar takime dhe kontakte të shumta me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatat, për trajtimin e temave të ndryshme me interes të përbashkët. Në vazhdimësi janë dërguar letra me rekomandime, lidhur me hetimin e ankesave dhe IAP-së i janë ofruar informatat e kërkuara lidhur me to.

Në muajin nëntor 2013, me mbështetjen e UNDP-së, është realizuar një tryezë pune në mes të IAP-së dhe kryetarëve të gjykatave në Kosovë, lidhur me numrin e lartë të rasteve të paraqitura në IAP kundër gjykatave.

Bashkëpunim të mirë IAP-së ka pasur edhe me Inspektoratin Policor të Kosovës, Policinë e Kosovës, Inspektorati i Shërbimit Korrektues, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Prokurorin Speciale, lidhur me hetimin e ankesave të personave të privuar nga liria.

3.2. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile

Bashkëpunimi i IAP-së me shoqërinë civile jo vetëm që kërkohet me ligj, por është i rëndësishëm për efektivitetin e punës së IAP-së. Gjatë vitit 2013, IAP ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me disa nga OJQ-të në Republikën e Kosovës.

Gjatë muajit prill të këtij viti, OJQ “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” (YIHR), gjatë implementimit të projektit të tyre të mbështetur nga Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, ka monitoruar punën e IAP, si rezultat i së cilës në muajin qershor të këtij viti ka publikuar raportin “Pasqyrë mbi punën e Institucionit të Avokatit të

Popullit”.³¹⁸ IAP ka ofruar të gjitha lehtësitë për një bashkëpunim të ngushtë në realizimin e këtij projekti. IAP e vlerëson lartë punën e YIHR, pasi kjo është e vetmja organizatë deri më tani që ka marrë një iniciativë të tillë lidhur me monitorimin e punës konkrete të IAP-së.

Në periudhën janar-qershor të vitit 2013, IAP në bashkëpunim me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) dhe Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), si një Grup Punues i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (NPM), ka monitoruar Qendrën Korrektuese në Dubravë, Qendrën Korrektuese dhe Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Në lidhje me këtë monitorim, më 1 korrik 2013 është mbajtur tryeza e rrumbullakët me temën “Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës - sfidat, mundësitë dhe hapat e bëra përpara”, në fokus të së cilës ishin raportet e publikuara të grupit punues për NPM-në, nga monitorimi i këtyre qendrave, si dhe aktivitetet e zbatuara në periudhën janar-qershor 2013.

Më 17 qershor 2013, Avokati i Popullit, me bashkëpunëtorët, ka mbajtur takim me qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunën e Lipjanit. Në këtë takim morën pjesë drejtori i Drejtoratit për Arsim në këtë komunë, si dhe përfaqësues nga forumi “Sud”, Klubi Rinor nga fshatrat Magure dhe Gadime, si dhe OJQ-të “Health for All” dhe “Zemra e Hapur”. Në këtë takim është diskutuar lidhur me edukimin, punësimin dhe zbatimin e ligjeve në jetën e përditshme.

Gjatë muajit dhjetor të këtij viti zyra rajonale e IAP-së në Gjakovë, në bashkëpunim me projektin “Child Protection and Child Right” të OJQ “Syri i Vizionit” në Pejë, i mbështetur nga OJQ “Save the Children”, ka vizituar nxënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta “Zekeria Rexha” dhe “Mustafa Bakija” në Gjakovë. Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i nxënësve, lidhur me mandatin e IAP-së, përkatësisht të Grupit për të Drejtat e Fëmijëve, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Kosovës.

Bashkëpunime të tjera IAP ka pasur edhe me OJQ-të e tjera, si: “Smile”, me të cilën janë realizuar dokumentar në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi i zyrës rajonale të IAP-së në Graçanicë me OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” dhe me OJQ “Komunikimi për Zhvillim Social dhe të Drejtat Civile”.

3.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

IAP përveç rolit të institucionit të ombudsmanit klasik, është i vetmi institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në Kosovë. Si i tillë, ai është i përkushtuar që të jetë një urë lidhëse për shkëmbimin e përvojave profesionale ndërkombëtare sa i përket të drejtave të njeriut, si dhe rrjetëzimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

³¹⁸*Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut*, Raporti “Pasqyrë mbi punën e Institucionit të Avokatit të Popullit” në: <http://ks.yihr.org/ks/article/149/YIHR-KS-published-the-report-An-Insight-Into-the-Work-of-the-Ombudsperson-Institution> (10.12.2013).

3.3.1. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Më qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimit të përvojave me institucionet e tjera simotra në fushën e të drejtave të njeriut, IAP mori pjesë në shumë takime të ndryshme gjatë vitit 2013.

Më 11-15 mars 2013, IAP mori pjesë në Këshillin për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, ku u diskutuan një sërë çështjesh më rëndësi vitale për gjendjen e të drejtave të njeriut në botë.

Më 6-8 maj 2013, IAP mori pjesë në Takimin e 26-të, të Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC – International Coordinating Committee for NHRIs), që është organizatë ndërkombëtare e institucioneve kombëtare që merren më të drejtat e njeriut. Ajo promovon dhe fuqizon këto institucione, në mënyrë që të jenë në pajtueshmëri me Parimet e Parisit dhe vepron si lider i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në kuadër të Takimit të Byrosë, një nga çështjet e parapara në agjendën e këtij takimi, në kuadër të diskutimit në Nënkomitetin për Akreditim, ishte edhe diskutimi për akreditimin e IAP-së në ICC dhe hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerren nga ICC, lidhur me kërkesat për anëtarësim të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) të vendeve që nuk janë anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Me këtë rast fjala iu dha edhe Avokatit të Popullit, z. Sami Kurteshi, i cili e paraqiti dhe arsyetoi kërkesën formale për anëtarësim të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në këtë organizatë, e cila vepron në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, me seli në Gjenevë. Pas diskutimeve u rekomandua që kjo çështje të diskutohet edhe njëherë në këtë nënkomitet dhe të krijohet një dokument i ri procedural që do të rregullojë qartë procedurat që duhet të ndërmerren për anëtarësimin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në ICC, të vendeve joanëtare të OKB, në këtë rast Kosovës.

Përveç kësaj, në takim raportoi edhe raportuesi special i Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut, ku raportua për implementimin e Deklaratës së Amanit, më tutje u diskutua edhe për *Post 2015 agjenda dhe roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*, të drejtën e pjesëmarrjes si dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme në nivel ndërkombëtar.

Më 20-21 shtator 2013, Avokati i Popullit mori pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të Institutit Evropian të Ombudsmanëve (EOI), në të cilën u zgjodh kryesuesi i ri dhe u shënuar 25-vjetori i themelimit të këtij rrjeti të Institucioneve të Ombudsmanëve Evropianë, që u përcoll me diskutime rreth të drejtave të njeriut në Evropë dhe prioritetet e së ardhmes.

Më 29 tetor - 1 nëntor 2013, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën ndërkombëtare “*Të zhdukurit - agjenda e së ardhmes*”, e cila u organizua nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.³¹⁹ Kjo konferencë mblodhi përfaqësues të vendeve nga rajoni, ku u diskutuan ndër të tjera edhe këto çështje: konfliktet e armatosura dhe shkeljet e të drejtave të njeriut; dhuna e organizuar dhe migrimi; sfidat dhe përpjekjet për të kërkuar llogari për të zhdukurit, si dhe çfarë mund të bëhet në të ardhmen për të trajtuar këtë çështje.

³¹⁹ Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur në: <http://www.ic-mp.org/>

Në Vjenë, më 7-8 tetor 2014, u organizua konferenca ndërkombëtare “*Fuqizimi i mbrojtjes së të drejtave themelore në një skenar në ndryshim për të drejtat e njeriut*”. Ndër objektivat kryesore të kësaj konference ishte të mbledh bashkë të gjitha KDNJ-të, Mekanizmat e Barazisë dhe Institucionet të Ombudsmanëve, për të diskutuar për ndikimin e situatës ekonomike në të drejtat e njeriut, rritjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit strategjik në nivel vendor dhe evropian dhe identifikimin e aktiviteteve konkrete të bashkëpunimit, si dhe krijimi i mundësive të rrjetëzimit për organizatat pjesëmarrëse. Kjo konferencë u organizua nga Agjencia për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian (FRA), Këshilli i Evropës dhe OSBE. Njërin nga grupet punuese të kësaj konference me temë “*Implementimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*” e udhëhoqi Avokati i Popullit të Kosovës, z. Sami Kurteshi dhe raportoi për të në panelin e konferencës.

Në Budapest, më 13- 15 nëntor 2013, u mbledh Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, në një takim të planifikimit strategjik ku u diskutua për punën dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij rrjeti. Edhe në këtë takim, Avokati i Popullit i Kosovës, z. Sami Kurteshi udhëhoqi njërin nga panelet e takimit, me temën “*Bashkëpunimi i ombudsmanëve me shoqërinë civile*”.

3.3.2. Projektet me mbështetje ndërkombëtare

Një nga projektet më frytdhënëse të ofruara deri më tani për IAP-në është projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “*Avancimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë*”. Ky projekt, përfitues kryesor i të cilit ishte IAP, e ku ishin të përfshira edhe organizatat e shoqërisë civile dhe Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ka filluar së zbatuari në qershor të vitit 2012 dhe ka përfunduar në shkurt 2014. Qëllimi kryesor i tij është përmirësimi i implementimit të standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet dhe të gjeturat e Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor apo Degradues dhe Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Në kuadër të këtij projekti u realizuan shumë aktivitete të cilat ishin shumë të dobishme për stafin e IAP-së, meqë ishin të bazuara në vlerësimin e nevojave konkrete. Vetëm gjatë vitit 2013 janë realizuar shumë trajnime lidhur me tematika të ndryshme. Përveç kësaj janë përgatitur opinione shumë profesionale për pakon e ligjeve më kryesore për të drejtat e njeriut në Kosovë, që janë në proces të amendamentimit, përkatësisht Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji kundër Diskriminimit dhe Ligji për Barazinë Gjinore. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti është bërë edhe një propozim profesional për reformën për dinamizmin e institucioneve jogjyqësore për të drejtat e njeriut në Kosovë. Kjo ishte një punë shumë e vlefshme që do të ndikojë që Kosova të ketë ligje lehtë të zbatueshme dhe në dobi të qytetarëve të Kosovës.

Përveç kësaj, në kuadër të këtij projekti u organizuan edhe katër vizita studimore jashtë vendit. *E para* në Strasburg të Francës, ku 5 persona nga IAP, patën rastin të njihen më punën e Këshillit të Evropës dhe komiteteve të ndryshme në kuadër të tij, e po ashtu edhe me punën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

E dyta, u organizua në Varshavë të Polonisë, ku gjithashtu morën pjesë 5 persona nga IAP. Gjatë kësaj vizite, ata vizituan disa institucione dhe organizata për të drejtat e njeriut që veprojnë atje siç janë: Institucionin e Ombudsmanit të Polonisë, Komitetin e Helsinkit, policinë etj.

E treta, u mbajt në Belfast të Irlandës së Veriut, ku morën pjesë 14 persona nga IAP. Gjatë kësaj vizite takime u organizuan me të gjitha strukturat për të drejtat e njeriut atje: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Ombudsmani Parlamentar i Irlandës së Veriut, Komisioni i Barazisë, Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, Komisioni për Persona të Moshuar, Ombudsmani i Burgjeve, Ombudsmani i Policisë etj. ku u shkëmbyen praktikat më të mira dhe informacione të dobishme.

E katërta, vizita studimore tek Ombudsmani Parlamentar i Danimarkës dhe në Institutin Kombëtar për të Drejtat e Njeriut të Danimarkës. Në këtë vizitë ishin 11 persona nga IAP. Vizita kishte për temë këmbimin e përvojave në trajtimin e rasteve të ankesave individuale në mënyrë të detajuar.

Në kuadër të këtij projekti u organizua edhe konferenca ndërkombëtare *“Përmbushja e qëllimit: Institucionet e Ombudsmanëve dhe gjyqësori për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - Praktikrat më të mira evropiane dhe përvojat regjionale”*, ku morën pjesë shumë ekspertë dhe homologë të Avokatit të Popullit nga rajoni dhe më gjerë, si dhe përfaqësues të Gjykatave Kushtetuese dhe të Larta të vendeve fqinje.

Një tjetër projekt në të cilin IAP ishte përfitues është edhe projekti *“Avancimi i drejtësisë gjinore”*, me fokus në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, i cili financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës, ndërsa implementohet nga UNDP-ja në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti u mbajtën disa trajnime, një tryezë, e gjithashtu u mbështet pjesëmarrja në një takim ndërkombëtar në Kroaci me temën *“Institucionet e Ombudsmanëve në Evropën Juglindore: Anëtarësimi në BE dhe Rishikimi Periodik i Përgjithshëm.”*

3.3.3. Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare

IAP i kushton një rëndësi të madhe edhe bashkëpunimit me institucionet homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, përmendim vizitën e Komisionares së Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, znj. Navi Pillay, e cila vizitoi IAP-në më 20 qershor 2013, ku u bisedua për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në deklaratën e saj për media ajo deklaroi se *“është impresionuar nga përkushtimi dhe kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit”*³²⁰ dhe e ripërsëriti mbështetjen e saj për IAP-në. Znj. Pillay gjatë kësaj vizite takoi edhe institucione të tjera në Kosovë, tek të cilat përcolli mesazhe të qarta për përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut.

³²⁰ Deklarata e Komisionares së Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, znj. Navi Pillay, në konferencën për shtyp me rastin e vizitës së saj në Kosovë, në: <http://www.unkt.org/opening-remarks-by-un-high-commissioner-for-human-rights-navi-pillay-at-a-press-conference/> (03.02.2014).

Përveç kësaj, me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Kosovë, më 11-13 dhjetor 2013, është realizuar një vizitë zyrtare e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës dhe zëvendësit të tij në Institucionin e Ombudsmanit në Francë. Vizita ishte me karakter pune, për t'u njoftuar me punën e ndërsjellë të dy institucioneve në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo vizitë ishte shumë e frytshme dhe përfundoi me synimet që bashkëpunimi të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit të Shqipërisë vizitoi Kosovën dhe pati një vizitë kthyesë të Avokatit të Popullit të Kosovës në Shqipëri. Gjatë këtyre vizitave u diskutuan shumë çështje konkrete për thellimin e bashkëpunimit dhe u ripërtëri memorandumit i bashkëpunimit i nënshkruar më herët. Gjatë vizitave pati edhe takime në institucione të ndryshme në nivel shteti.

IAP ka bashkëpunim shumë të mirë me të gjithë homologët nga rajoni, me të cilët bashkëpunon në fusha të ndryshme dhe ka pasur takime të tematikave të ndryshme.

3.3.4. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

IAP është i anëtarësuar në këto mekanizma ndërkombëtar:

- Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI),³²¹ në të cilin IAP është anëtar i barabartë me të drejta dhe obligime. IOI është organizatë botërore për bashkëpunimin e më shumë se 155 institucioneve të Ombudsmanëve nga më shumë se 90 vende të botës. Në përpjekjet e tij që fokusohen në të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë dhe ngritjen e kapaciteteve, IOI mbështet institucionet anëtare në tri forma, përmes:

- Trajnimeve,
- Hulumtimeve dhe
- Ndihmës në projekte rajonale.

- Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI),³²² ku IAP, gjithashtu është anëtar institucional me të drejta dhe obligime të barabarta. EOI është organizatë rajonale e ombudsmanëve Evropianë, e cila punon për të arritur këto objektiva:

- Promovimi i konceptit të ombudsmanit si institucion,
- Promovimi i shkëmbimit të përvojave në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar,
- Hulumtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtat e njeriut dhe aktivitetet e ombudsmanëve,

- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), në të cilin IAP është anëtarësuar në nëntor të vitit 2013, por njëkohësisht është edhe bashkëthemelues i Rrjetit. ENNHRI është organizatë që ka mision mbështetjen dhe fuqizimin e IKDNJ-ve, që të jenë në pajtueshmëri me Parimet e Parisit.³²³ Objektivat kryesore të këtij

³²¹ Instituti Evropian të Ombudsmanëve, në: www.theioi.org

³²² Instituti Evropian të Ombudsmanëve, në: www.eoi.at

³²³ Parimet e Parisit, në: <http://www2.ohchr.org/english/law/parisprinciples.htm> (30.01.2014).

rrjeti janë: krijimi i një sekretariati të fortë dhe të qëndrueshëm, fuqizimi i komunikimit në mes të anëtarëve të ENNHRI-it, ngritja e bashkëpunimeve në mes anëtarëve dhe mekanizmave të tjerë rajonal.

IAP ka bërë kërkesën formale për akreditim edhe nga Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC), në takimet e të cilit merr pjesë rregullisht që nga tetori i vitit 2010 në cilësinë e vëzhguesit. Po ashtu, IAP ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në Asociacionin e Ombudsmanëve Mesdhetar dhe është në pritje të përgjigjes nga ata e tyre.

3.3.5. Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar

IAP çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar pesë pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare

Data	Tema e raportit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
19 prill 2013	Biznesi dhe të drejtat e njeriut	Komitetin Koordinues Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
2 maj 2013	Implementimi i Deklaratës së Amanit dhe planit të saj për veprim	Komiteti Koordinues Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
22 tetor 2013	Të drejtat e njeriut në situatat post-konfliktuale	Komiteti Këshillues i Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara
5 nëntor 2013	Të drejtat e personave të privuar nga liria	Grupi punues për Ndalimet Arbitrare-Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara
2 dhjetor 2013	Ndikimi i politikave fiskale dhe atyre të taksave në të drejtat e njeriut	Raportuesi special i Kombeve të Bashkuara për varfërinë e skajshme dhe të drejtat e njeriut

3.4. Ngritja e kapaciteteve të IAP-së

Gjatë periudhës raportuese, IAP i ka kushtuar rëndësi të madhe ngritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve. Po ashtu, një rëndësi të veçantë, me gjithë kushtet aspak të volitshme infrastrukturore të zyrave të IAP-së në qendër dhe në qendrat rajonale, IAP i ka kushtuar ofrimin të trajnimeve të personave të ndryshëm dhe organizimin e mbajtjes së punës praktike në IAP.

IAP ka organizuar trajnim për punonjësit me temë *“Komunikimi dhe sjellja në situata të vështira në një mjedis pune – Ekspozimi i brendshëm dhe i jashtëm”*, pastaj trajnimi me temë *“Hartimi i raporteve analitike – Koncepti i proporcionalitetit në të Drejtën Kushtetuese”*.

Punonjësit e IAP-së kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), përkatësisht, trajnime në fushën e teknologjisë informative dhe trajnime, lidhur me hartimin e legjislacionit.

Në kuadër të projektit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian *“Avancimi i të Drejtave të Njeriut”*, janë organizuar trajnime në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut siç janë: *“Trajnim për trajner për të drejtat e njeriut”*, vazhdim i trajnimit nga vitit 2012, *“Monitorimin e qendrave ku mbahen personat e privuar nga liria”*, *“Marrëdhëniet me publikun dhe promovimi i të drejtave të njeriut përmes medieve”*, *“Metodologjia e komunikimit”* dhe *“Hartimi i raporteve sipas standardeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT)”*.

Në kuadër të këtij projekti, janë përfshirë edhe vizita studimore për punonjësit e IAP-së në Strasburg të Francës, Varshavë të Polonisë, Belfast të Irlandës Veriore dhe në Institucionin e Ombudsmanit të Danimarkës.

Edhe për vitin për të cilin raportohet vlen të përmendet mbështetja e OSBE-së në ngritjen e kapaciteteve. Ajo ka organizuar trajnim lidhur me monitorimin e qendrave të ndalimit të policisë.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve IAP, ka pasur mbështetje edhe nga UNDP, në organizimin e trajnimeve me temat: *“Hartimi dhe menaxhimi i projekteve”*, *“Të drejtat e personave të privuar nga liria”* dhe *“Ligji për mbrojtjen e ambientit”*.

Po ashtu, vlen të përmendet mbështetja nga Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), trajnimi me temë *“Referimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese”*.

Punonjësit e IAP-së kanë mbajtur trajnim lidhur me *“Planifikimin, ekzekutimin dhe auditimin e buxhetit”*, po ashtu trajnim lidhur me *“Evidentimin e lëndëve, organizimin dhe puna në shkrimore dhe procedurat e qasjes në dokumente publike”*.

Përveç trajnimeve të organizuara për punonjësit e vet, ka organizuar edhe mbajtjen e praktikës në IAP për studentë, absolventë apo edhe të interesuar të tjerë, kryesisht juristë. Praktika për personat e tillë mbahet në kohëzgjatje prej 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe, UNDP ka ofruar një donacion të vlefshëm për praktikantët në IAP. Të gjithë personat e tillë me admirim dhe kënaqësi të madhe kanë konstatuar për përfitimet profesionale nga mbajtja e praktikës në IAP.

Po ashtu, IAP që nga fillimi i vitit 2013 ka filluar edhe pranimin e studentëve nga vendet e ndryshme për mbajtjen e një praktike në IAP. Praktika e parë e tillë është bërë nga një student

i Universitetit të Yale të SHBA dhe Oxford të Mbretërisë së Bashkuar. Kjo mënyrë e zhvillimit të praktikës në IAP me studentë nga universitete të ndryshme të botës, është dëshmuar si një përvojë e shkëlqyeshme për këmbim të përvojave studimore.

IAP edhe në të ardhmen do t'i kushtojë rëndësi ngritjes së kapaciteteve, varësisht nga nevojat të punonjësve, por edhe nga kërkesat e jashtme, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e performancës së punonjësve të vet, por edhe personave të interesuar për përvojën e IAP-së. Por, po ashtu, me kënaqësi të madhe IAP, varësisht nga hapësirat fizike që do t'i sigurohen, mund të ofrojë një punë praktike shumë të vlefshme për një numër shumë më të madh të personave të interesuar për trajnime në IAP, lidhur me të drejtat e njeriut.

3.5. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF), në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) është themeluar me qëllim që me kujdes të veçantë t'i mbikëqyrë, t'i mbrojtë dhe t'i hetojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF gjatë vitit 2013 përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera në drejtim të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

IAP përkatësisht GDF mori pjesë në konferencën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të organizuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) e cila u mbajt në Prishtinë më 31 janar 2013. Në këtë konferencë përveç tjerash u prezantua raporti i KOMF-it "Kush flet për mua", i cili ofroi të dhëna për gjendjen aktuale të fëmijëve në fushën e strehimit familjar, adoptimit ndërshtetëror, varfërinë e fëmijëve, shfrytëzimin e fëmijëve në situatë rruge etj.

Në kuadër të projektit rajonal "Parandalimi i shfrytëzimit të fëmijëve në Evropën Juglindore", më 22-24 prill 2013, në Novi Sad (Serbi), GDF mori pjesë në konferencën përfundimtare, ku u prezantuan edhe rezultatet e hulumtimit "Si të përmirësohet komunikimi në mes të ombudsmanit dhe fëmijëve në Evropën Juglindore". Hulumtimi në fjalë ishte kryer nga Save the Children International në bashkëpunim me Rrjetin e Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore (CRONSEE).

Nga pjesëmarrësit u përmendën shembuj të ndryshëm nga praktikat e tyre të komunikimit me fëmijë. U theksua përveç të tjerash se takimet me nxënës, grupe nxënësish apo këshilla të nxënësve janë shumë të rëndësishme jo vetëm në bërjen e dukshme të institucionit të ombudsmanëve, edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre, por edhe të marrjes parasysh të pikëpamjeve dhe të mendimeve të fëmijëve si pjesëtarë të shoqërisë.

Më 26 prill 2013, në Prishtinë, IAP në bashkëpunim me Save the Children International organizoi konferencën në të cilën u promovua raporti "Eksplotimi seksual i fëmijëve në Kosovë" i cili ishte rezultat i hulumtimit të zhvilluar nga GDF. Pjesëmarrësit e kësaj konference u njoftuan për hulumtimin, të gjeturat dhe rekomandimet e bëra me qëllim të përmirësimit të punës në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e paraqitjes dhe fuqizimin e luftës kundër shfrytëzimit seksual, e në veçanti për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve viktimat të keqpërdorimit seksual dhe shfrytëzimit. Po të njëjtën ditë, përfaqësuesja e

IAP-së ka marrë pjesë në dy emisione televizive (në Rrokum TV dhe KTV), ku është diskutuar rreth këtij raporti.

Më rastin e shënimit të Ditës së Fëmijëve, më 1 qershor 2013, përfaqësues të IAP-së në Prishtinë dhe Graçanicë, nën tendat e vendosura në sheshet e këtyre lokale, kanë biseduar me fëmijë për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përkatësisht të fëmijëve.

Më 27-28 qershor 2013, në Bruksel u mbajt Konferenca për Drejtësinë për Fëmijë e organizuar nga Komisioni Evropian, Zyra Rajonale e UNICEF-it për Evropën Qendrore dhe Lindore, si dhe shtetet e pavarura të Komonweltit, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të qeverive të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe ombudsmanë, përfshirë këtu edhe Avokatin e Popullit të Kosovës. Në konferencë, në sesione të ndryshme, u mbajtën debate, lidhur me drejtësinë për fëmijë, përparimet e bëra, sfidat, pengesat dhe mundësitë për përmirësimin e drejtësisë për fëmijë në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu, në një nga sesionet e konferencës, u diskutua edhe për përvojën e Kosovës në fushën e drejtësisë për fëmijë.

Më 8 korrik 2013, GDF mori pjesë në konferencën e përrurimit të Raportit të tretë, lidhur me vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës, për vitin 2012. Si pjesë e panelit të konferencës Avokati i Popullit prezantoi temën “Përpjekjet e Institucionit të Avokatit të Popullit në promovimin dhe garantimin e interesit më të lartë të Fëmijëve”.

Më 30 shtator 2013 një grup i fëmijëve nga Shqipëria, të mbështetur nga Save the Children në Shqipëri, në kuadër të Programit për qeverisjen me të drejtat e fëmijëve u takuan me Avokatin e Popullit. Qëllimi i takimit, përveç të tjerash, ishte informimi për situatën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, rolin e IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, natyrën, mënyrën dhe ankesat e paraqitura, lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave të fëmijëve.

Më 17 tetor 2013 në Prishtinë u mbajt konferenca për përrurimin e raportit “Gjendja e fëmijëve në botë 2013 - fëmijët me aftësi të kufizuar”, i publikuar nga UNICEF, në të cilën mori pjesë edhe GDF. Në këtë konferencë u prezantuan të gjeturat e raportit, lidhur me gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në botë si dhe u theksua nevoja e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për përmirësimin e saj në të gjitha segmentet e jetës.

“Fëmijët në lëvizje” ishte temë diskutimi e CRONSEE, në konferencën e tetë vjetore, e cila u mbajt më 5 nëntor 2013 në Zagreb (Kroaci). Konkluzion i konferencës ishte se “Fëmijët në lëvizje”, përkatësisht fëmijët në migrimet e rrezikshme, përbëjnë një grup veçanërisht të cenueshëm, pavarësisht asaj nëse këta fëmijë janë të shoqëruar nga prindër apo udhëtojnë vetëm në kërkim të kushteve më të mira jetësore, ikin nga dhuna, abuzimi, lufta, katastrofat natyrore apo nga vështirësi të tjera që i detyrojnë ata të braktisin vatrat e tyre. Pjesëmarrësit në konferencë u pajtuan se për shkak të gjendjes së fëmijëve është e domosdoshme që të fuqizohet dhe përmirësohet sistemi i mbrojtjes në nivel kombëtar, si dhe të fuqizohet bashkëpunimi ndërkufitar në regjion. Gjithashtu u konkludua se shtetet pjesëmarrëse, përveç të tjerash do të duhej:

- Të krijojnë sisteme gjithëpërfshirëse dhe efektive për mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje, që garantojnë mbrojtjen dhe realizimin e plotë të të drejtave të tyre të

garantuara edhe me Konventën për të drejtat e fëmijës, pavarësisht statusit të tyre migrues.

- Të krijojnë mekanizma operativ për bashkëpunim ndërsektorial, si dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë procedura standarde për pranim miqësor.
- Të ofrojnë trajnime të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse për profesionistët që punojnë me “fëmijët në lëvizje”.
- Të sigurojnë që të gjitha masat mbrojtëse të ndërmerren në këshillim me fëmijët dhe të përfshijnë perspektivën fëmijës-përvojat e tyre, pikëpamjet dhe pritjet, duke pasur parasysh parimet e etikës dhe metodologjinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në të gjitha vendimet.

Të gjeturat nga rishikimi afatmesëm i programit të bashkëpunimit në mes të institucioneve të Kosovës dhe UNICEF-it 2011-2015, u prezantuan në punëtorinë e mbajtur më 14 nëntor 2013, në të cilën mori pjesë edhe GDF. Rishikimi afatmesëm i programit të bashkëpunimit ishte kryer gjatë periudhës shkurt - maj 2013, me qëllim që të përmirësohet puna dhe cilësia e zbatimit të këtij programi, si dhe për të vazhduar ciklin e programit të ri pas vitit 2015.

Edhe këtë vit, me rastin e shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, IAP ka realizuar shumë takime me nxënës të shkollave fillore në disa nga fshatrat e komunave të Mitrovicës, Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Deçanit, Graçanicës, Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës. Në këto takime ata kanë informuar nxënësit e këtyre shkollave lidhur me misionin e IAP-së gjegjësisht të GDF-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Në këto takime është diskutuar edhe për situatën e të drejtave të fëmijëve në shkollat përkatëse dhe mënyrën e adresimit të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve në shkolla.

Nga diskutimet e bëra rezultoi se në disa nga shkollat e vizituara nxënësit janë pak të informuar për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndërsa në disa shkolla të tjera mungojnë kushtet adekuate për mësim gjë që vështirësojnë realizimin përkatës të procesit mësimor.

Në Prishtinë, po me rastin e shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, fëmijë të shkollave fillore të komunës së Prishtinës dhe fëmijë të një kopshti fëmijësh kanë vizituar Zyrën Qendrore të IAP-së, janë takuar me Avokatin e Popullit dhe janë njohur për së afërmi me punën që bëhet në këtë institucion, me misionin dhe angazhimin e IAP në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Më 3 dhjetor 2013, në Prishtinë, u mbajt tryeza e rumbullakët me temën “Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, e organizuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë në bashkëpunim me USAID, në të cilën mori pjesë edhe përfaqësuesja e IAP-së. Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze ishte përmirësimi i njohurive të punonjësve të gjykatave themelore, prokurorive dhe të institucioneve të tjera për Ligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, nr.03/L-238, përkatësisht për juridiksionin ekskluziv të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së parë, për të vendosur lidhur me rastet që kanë të bëjnë me aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Përfaqësues të IAP në bashkëpunim me OJQ “Syri i Vizionit” nga Peja, në kuadër të projektit “Child Protection and Child Right Governance”, gjatë muajit dhjetor 2013 janë takuar me nxënës të disa shkollave fillore të mesme të ulëta të Mitrovicës, Pejës, Gjakovës dhe Ferizajt.

Në këto takime është diskutuar edhe për të drejtat e fëmijëve, procedurat e ankimit në rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, si dhe për rolin e IAP në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

3.6. Aktivitetet e Departamentit kundër Diskriminimit

Gjatë këtij viti raportues, Departamenti kundër Diskriminimit (DKD) në IAP, ka trajtuar ankesa individuale por edhe sipas detyrës zyrtare, në të cilat pretendohet se janë shkelur të drejta të cilat janë të mbrojtura me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, sidomos me ligjin kundër diskriminimit. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me diskriminim në sferën sociale, shëndetësore, pronësore, marrëdhënie pune.

Gjatë vizitave të rregullta me OJQ-të, të cilat i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar, IAP ka pranuar ankesa nga ta lidhur me kushtet për qasje të lirë nëpër institucione publike si dhe legjislacionin për persona me aftësi të kufizuar.

Ky departament gjatë periudhës raportuese ka realizuar vizita nëpër spitale, OJQ, vendbanime të banuara me komunitetet, nëpër shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje, është takuar me përfaqësues të personave me aftësi të kufizuar, komisararin për gjuhët në Zyrën e Kryeministrit, ka marrë pjesë në debate publike, konferenca dhe trajnime të ndryshme.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese DKD ka pasur takime me Zyrën për Qeverisje të mirë, koordinatorë për të drejta të njeriut në nivel lokal dhe qendror, si dhe ka marrë pjesë në debatin publik për plotësim ndryshimin e projektligjit kundër diskriminimit, projektligjit për sigurimin shëndetësor.

Në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut te personat e vendosur në shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje, gjatë këtij viti është vizituar disa herë shtëpia për të moshuar, Institucioni Special në Shtime, Klinika e Psikiatrisë në QKU, Qendrat e Shëndetit Mendor në Bashkësi në Prishtinë, Shtëpia Integruese në Bresje.

Gjatë kësaj vizite në fokus kanë qenë monitorimi i kushteve të jetesës së rezidentëve, hapësirat nëpër rezidenca, kushtet e punës së të punësuarve nëpër këto institucione, si dhe bashkëpunimi dhe funksionimi i harkut zinxhiror në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institucioneve të lartpërmendura.

Në shënim të ditës ndërkombëtare të ditës së personave të moshuar, më 1 tetor 2013 dhe ditës ndërkombëtare të shëndetit mendor, të shënuar më 10 tetor 2013, Avokati i Popullit më 21 tetor 2013, ka organizuar një tryezë, në të cilën ka publikuar raportin me rekomandime për institucionet përgjegjëse, gjetjet nga vizita në teren tek shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje.

Gjatë këtij viti DKD, ka hetuar çështjen problemeve në funksionimin e Këshillit Ekonomiko Social dhe mos nënshkrimin e Kontratës Kolektive, për të cilin ka hartuar një raport *ex-officio* me rekomandime.

Në vazhden e projektit të përbashkët në mes të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Avancimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, DKD gjatë vitit 2013, ka mbajtur trajnime dhe vizita studimore brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit raportues përfaqësues të DKD kanë qenë pjesëmarrës në debate publike në mediet audio-vizuele vendore, ku janë trajtuar tema lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, të drejtat e personave të moshuar në Kosovë, si dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, si dhe për të drejtat e njeriut.

3.7. Komentet dhe rekomandimet në projektligje dhe akte nënligjore

Një nga përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, të përcaktuara me ligj për Avokatin e Popullit, është edhe: *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës”*.³²⁴

Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash nga qytetarët e Kosovës për refuzimin e parashtrësive të tyre nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS) për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), për shkak të mosparashtrimit të tyre edhe në gjuhën angleze, me ç’rast barra e përkthimit, bie mbi palët që i drejtohen asaj. Pas analizimit të këtyre ankesave, Avokati i Popullit ka konstatuar se kjo praktikë e DHPGJS-së është diskriminuese për qytetarët, sepse faktikisht iu mohohet apo iu vështirësohet e drejta për qasje në DHPGJS.

Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit ka përgatitur Raportin me rekomandime, të cilin, më 2 nëntor 2012, ia ka dërguar kryetarit të DHPGJS-së dhe kryetarëve të komisioneve parlamentare përkatëse (Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe peticione, si dhe Komisionit për Legjislacion), duke kërkuar fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 25, paragrafit 8, 9 e 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe ndërprerjen e praktikave refuzuese dhe fuqizimin e shërbimeve të përkthimeve brenda gjykatës, ashtu që qytetarët të mos kushtëzohen që t’i drejtohen gjykatës edhe në gjuhën angleze.

Për këtë, më 29 janar 2013, është diskutuar edhe në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, ku njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit ka sqaruar se dispozitat e ligjit janë në kundërshtim me nenet 5 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6.1 dhe nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ). Anëtarët e Komisionit kanë përkrahur njëzëri rekomandimet e IAP-së dhe u pajtuan që Komisioni t’i drejtohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të kërkuar ndërprerjen e këtyre praktikave, si dhe të propozojë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Ndërkohë, IAP, gjatë vitit 2013, ka pranuar një sërë projektligjesh dhe draftesh të udhëzimeve administrative të ministrive për dhënien e komenteve. Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, organi propozues ka obligim që për projektligjet dhe aktet nënligjore, pos me ministritë përkatëse, të konsultohet edhe me IAP-në, për përputhshmërinë e tyre me *“standardet e pranueshme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut”*.³²⁵ Afati për dërgimin e komenteve është 15 ditë pune.³²⁶

³²⁴ Ligji për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, neni 16, paragrafi 1, paragrafi 1.6.

³²⁵ Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 2.

³²⁶ Po aty, neni 7, paragrafi 3.

Në vitin 2013, përveç që ka dhënë kontributin e vet në një varg aktesh të ndryshme normative nga institucione të ndryshme publike të nivelit qendror, Avokati i Popullit ka dërguar komente edhe për këto projektligje:

- Projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi
- Projektligji për pagat e funksionarëve publik
- Projektligji për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore
- Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve
- Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-19 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Është për t'u theksuar se gjatë vitit 2013, institucionet shtetërore në nivel qendror, në shumë raste, kanë dërguar projekt-propozimet e dokumenteve të ndryshme normative për konsultime me IAP në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo është një praktikë pozitive që vlen të theksohet, edhe pse shikuar realisht, përbën një ngarkesë të madhe profesionale dhe kohore për IAP-në.

Megjithëse, Avokati i Popullit është i gatshëm të ofrojë ndihmën dhe përkrahjen në të gjitha ato raste ku vlerëson se kjo është e mundur, për shkak të ngarkesës së jashtëzakonshme, sidomos në aspektin profesional, rekomandon të gjitha institucionet që IAP i dërgojnë aktet normative për komentim.

Rekomandime:

- *IAP t'i dërgojnë për këshillim vetëm ato akte normative, të cilat në ndonjë pjesë të tyre prekin të drejtat e njeriut, sidomos kur bëhet fjalë për përcaktimin apo edhe kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.*
- *Që periudha kohore për këshillime të mos jetë më e shkurtër se 15 ditë, nga dita e dërgimit të aktit për shqyrtim.*

3.8. Komunikimi me mediat

Identiteti publik është jashtëzakonisht i rëndësishëm për një institucion pa fuqi ekzekutive. Ky identitet vihet në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, duke luajtur rol të pazëvendësueshëm në përmbushjen e misionit kushtetues e ligjor të IAP-së.

Profili publik i IAP-së domosdoshmërisht ndërtohet nga prania në media, qoftë përmes plasimit të materialeve që paraqesin punën dhe aktivitetet e institucionit, qoftë përmes përgjigjeve në kërkesat e mediave për të marrë opinionet, qëndrimet ose edhe për të marrë të dhëna lidhur me raste apo fusha të caktuara të të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjithashtu, organizimet e aktiviteteve të hapura për mediat ofrojnë një mundësi më tepër që mediat dhe publiku përmes tyre, të dinë më tepër për misionin dhe mandatin e Avokatit të Popullit dhe për punën e rastet që trajton.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut dhe punës së IAP-së, gjatë 2013-tës janë mbajtur tryeza të rumbullakëta në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Prizren, Pejë, në jug dhe në veri të Mitrovicës, si dhe në Graçanicë, duke përfshirë kështu të gjitha qendrat ku ndodhen zyra regjionale të IAP-së. Tetë tryezat e rumbullakëta kanë ofruar mundësinë e diskutimit me strukturat udhëheqëse të komunave përkatëse, organizatat jo qeveritare dhe mediat lokale, lidhur me përmbushjen e misionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu mbajtja e katër tryezave tematike dhe shënimi i 13 vjetorit të themelimit të IAP-së kanë shërbyer për të reflektuar mbi punën dhe rolin e IAP-së, por gjithashtu për të avokuar lidhur me çështje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjatë vitit 2013 ka pasur edhe dy prezantime publike (prezantimi i Raportit “Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në Kosovë” dhe prezantimi i të dhënave preliminare dhe punës së IAP-së në fundvit) përmes konferencave për media.

Ndryshe nga vitet tjera, IAP në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, veç të tjerash, është paraqitur para qytetarëve në ambient të hapur (në sheshin “Nënë Tereza”), në standat e organizuara dhe të furnizuara me broshura dhe fletushka të ndryshme edhe me aktivitete dhe shpërndarje materiale të publikuara nga IAP.

Gjatë periudhës raportuese 1 janar - 31 dhjetor 2013, janë realizuar 128 paraqitje publike, kryesisht të Avokatit të Popullit, por edhe të zyrtarëve të IAP-së, si përgjigje në kërkesa të mediave dhe gazetarëve, për prononcime, intervista, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve, debate etj., përmes mediave tradicionale, portaleve elektronike dhe shtypit të shkruar.³²⁷ Në këtë numër paraqitjesh publike nuk janë të përfshira prononcimet për mediat lokale, të bëra gjatë aktiviteteve, vizitave apo monitorimeve nëpër qendrat regjionale.

Ndërkaq, gjatë po të njëjtës periudhë, në ueb faqen e IAP-së dhe përmes faqes së institucionit në facebook, si dhe për media, janë plasuar 50 deklaratat, njoftime, fotolajme, reagime, raporte etj.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, IAP ka publikuar në kopje fizike dhe në formë elektronike:

- Raportin vjetor (*në gjuhën shqipe, serbe, angleze*)
- Përmbledhjen ekzekutive të statistikave lidhur me rastet, mbulimin medial dhe financat (*në gjuhën shqipe, serbe, turke, angleze*)
- Përmbledhjen e rekomandimeve nga Raporti vjetor 2012 (*në gjuhën shqipe, serbe, turke, angleze*)
- Buletinin mbi të drejtat e fëmijës (*në gjuhën shqipe, serbe, turke, rome*)

³²⁷ Shifra prej 100 paraqitjeve mediale nuk përfshin shpërndarjen apo afishimin e të njëjtave.

- Broshurën për qasje në dokumente publike (në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe)
- Fletëpalosjen për mandatin e Avokatit të Popullit (në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe)

Tabela 2: Lista e paraqitjeve mediale sipas medimeve

PARAQITJET MEDIALE TË SHPËRNDARA SIPAS MEDIUMEVE <i>(pa përfshirë prononcimet për mediat lokale, gjatë aktiviteteve, vizitave apo monitorimeve nëpër qendrat rajonale)</i>	
BIRN / Jeta në Kosovë	9
Epoka e Re	1
MedijaCentar	1
Gazetarë të pavarur dhe projekte/dokumentarë	8
Telegraf	1
KIM Radio	1
KLAN Kosova	6
Koha Ditore	11
Portali KosovaLive	1
Kosova Sot	6
KTV	14
Lajmpress	2
Radio Dukagjini	1
Preportr	1
RROKUM	1
RTK 1	17
RTV 21	10
SETimes	2
Tribuna	5
TV Vali	1
Radio Puls	1
VoA	2

Zëri	6
Radio Kosova	7
RTK2	1
Bota sot	2
Infoglobi	1
Radio Evropa e Lirë	6
Top Chanel	2
Agjencia albinfo.ch.	1

KAPITULLI IV

BUXHETI DHE PERSONELI I IAP-së

IAP është institucion i pavarur publik, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.³²⁸ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm “Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera”.³²⁹

4.1. Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës

Mbështetur në legjislacionin për pavarësinë buxhetore dhe financiare të IAP-së dhe duke u bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit i ka parashtruar kërkesën e vetë buxhetore për vitin 2013, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2013, është bazuar në planin e punës dhe të aktiviteteve të planifikuara të IAP-së, kurse buxheti i aprovuar për vitin 2013, nga organet vendimmarrëse, është lejuar përafërsisht sipas Kërkesës Buxhetore të parashtruar nga IAP.

Pasqyrimi i gjendjes dhe rrjedhës së buxhetit të IAP-së për vitin 2013 është paraqitur në tabelën në vijim. Ndërsa pasqyrimi i detajuar i të gjitha rrjedhave në kuadër të buxhetit të IAP, me kategoritë e veçanta ekonomike, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas përmbajtjes së formularit të unifikuar për raportim financiar të hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.³³⁰

Tabela 3. Kërkesa buxhetore, buxheti i aprovuar dhe buxheti final IAP-së për vitin 2013

Nr.	Kategoritë ekonomike	Kërkesa buxhetore për vitin 2013	Buxheti i aprovuar për vitin 2013	Buxheti final 2013	Buxheti për vitin 2012
1.	Paga dhe mëditje	557,993.61€	526,050.00 €	513,050.00 €	383.778.00 €
2.	Mallra dhe shërbime	389,239.00 €	359,239.00 €	302,239.00 €	260.532.00 €
3.	Shpenzime komunale	30,000.00 €	30.000.00 €	23,000.00 €	30.000.00 €
4.	Shpenzime kapitale	52,750.00 €	52,750.00 €	52,000.00 €	7.000.00 €
Gjithsej		1,029,982.61 €	968,039.00 €	890,289.00 €	681.310.00 €

³²⁸ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 34, paragrafi 2.

³²⁹ Po aty.

³³⁰ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

Me rishikimin gjashtëmuor të buxhetit, IAP ka parashtruar kërkesë për rishikimin buxhetor, me datën 21 qershor 2013, ka bërë transferim të buxhetit në shumë prej 17,000.00 € nga kategoria ekonomike *mallra dhe shërbime* në kategorinë ekonomike *shpenzime kapitale*, për rritjen e masës monetare për furnizim me dy automjete.

Kurse, lidhur me kursimet buxhetore për vitin 2013, me rastin e përmbylljes së vitit fiskal 2013, IAP pas analizës financiare të gjendjes së buxhetit në raport me mjetet e shpenzuara dhe të planifikuara për shpenzim deri më 31 dhjetor 2013, është bërë kthimi i mjeteve financiare buxhetore në Buxhetin e Kosovës në shumë prej 77,750.00 €.

4.2. Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2013

Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2013.

Tabela 4: Buxheti i shpenzuar për vitin 2013

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final 2013	Buxheti shpenzuar	Të pa pashlyera	Mjete të lira	Realizim i në %
1.	Paga dhe mëditje	513,050.00 €	450,248.48 €	-	62,801.52 €	87.76%
2.	Mallra dhe shërbime	302,239.00 €	256,899.05 €	38,412.75 €	6,927.20 €	85.00%
3.	Shpenzime komunale	23,000.00 €	17,410.43 €	3,852.36 €	1,737.20 €	75.70%
4.	Shpenzime kapitale	52,000.00 €	14,430.00 €	37,570.00 €	-	27.75%
Gjithsej		890,289.00 €	738,987.96 €	79,835.11€	71,465.93 €	83.01%

4.3. Financimi i IAP-së nga donatorët

Gjatë vitit 2013, IAP është përkrahur me mjete financiare në mënyrë indirekte dhe direkte nga donatorët si në vijim: Këshilli i Evropës, Ambasada e Belgjikës, Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Turqisë, OSBE, UNDP dhe OJQ Save the Children. Donacionet për IAP-në, edhe për këtë periudhë raportuese, kanë qenë të rëndësishme dhe me interes lidhur me arritjen e objektivave të punës. Donacionet e vitit 2013 kryesisht kanë qenë të destinuara në ngritjen profesionale të personelit si dhe në promovimin e punës të IAP-së.

Meqenëse për ngritjen profesionale të personelit si dhe disa forma e aktivitete të promovimit të punës së IAP-së janë financuar direkt nga vet donatorët, IAP në shumë prej tyre nuk ka pasur qasje të drejtpërdrejtë në mjetet financiare të dedikuara për këto projekte, prandaj edhe paraqitja e gjendjes dhe shpenzimeve financiare si tërësi për donatorët dhe donacionet, në formën tabelare, nga ana e IAP-së, nuk është e mundur të paraqitet në këtë raport.

4.4. Personeli i IAP-së për vitin 2013

Për përmbushjen e misionit kushtetues, përbërja dhe numri i të punësuarve përbën faktorin themelor për funksionimin e IAP-së. Numri i lejuar i vendeve të punës për vitin 2013 ka qenë për 55 punonjës.

Numri i pozitive të miratuara prej 55 punonjës, sipas kategorisë së zyrtarëve, ndahet si në vijim: gjashtë (6) zyrtarë publikë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe dyzet e nëntë (49) zyrtarë - nëpunës civilë.

Rritja e numrit të ankesave për vitin 2013, obligimet shtesë që rrjedhin nga shumë ligje të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, si dhe miratimi i ligjeve të reja që caktojnë obligime dhe përgjegjësi ligjore për menaxhimin dhe funksionimin e administratës, përcaktojnë përgjegjësi të drejtpërdrejta shtesë për IAP, të cilat mund të kryhen vetëm me angazhim shtesë të burimeve njerëzore.

Buxheti i IAP-së për paga dhe mëditje ka qenë i mjaftueshëm për pozitat e vendeve të punës të miratuara për vitin 2013.

Një fakt pozitiv që vlen të theksohet është se tendenca e largimit të kuadrit profesional në vitin 2013 është dukshëm më e vogël se në vitet paraprake. Mirëpo, edhe gjatë vitit 2013 ka pasur lëvizje të personelit dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës në mënyrë vullnetare. Kjo ka ndikuar negativisht në funksionimin e disa sektorëve si dhe kualitetin e punës së IAP-së, sidomos kur kihet parasysh se bëhet fjalë për pozita kyçe dhe persona me përvojë dhe përgatitje shumëvjeçare në IAP. Shkaqet kryesore për shkëputjen vullnetare të marrëdhënies së punës, pas përgatitjes profesionale afatgjatë në IAP, janë: akomodimi në vende tjera të punës, ku të ardhurat personale janë më të larta dhe me kushte më të favorshme të punës se në IAP, apo edhe riorientimi profesional.

KAPITULLI V

PËRMBLEDHJA STATISTIKORE

5.1. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2013

Nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2013, janë paraqitur 2047 persona në selinë e IAP në Prishtinë dhe në zyrat rajonale, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. Prej tyre 302 persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit, gjatë *Ditëve të hapura*, të mbajtura së paku njëherë në muaj nëpër komuna dhe dy herë në muaj në Prishtinë.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht përkitazi me: mbrojtjen e pronës, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtat e të akuzuarit, etj.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme, paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2013. Në këto tabela janë të pasqyruara të gjitha llojet e veprimeve dhe të rasteve me shifra absolute. Po ashtu, këtu janë të pasqyruara edhe shifrat për numrin e raporteve dhe rekomandimeve të publikuara nga IAP, dështimet dhe vonesat e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së, implementimi i rekomandimeve të IAP-së nga autoritetet përgjegjëse, etj.

Tabela 5: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP (1 janar 2013 – 31 dhjetor 2013)

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	2047
<i>Përkatësia etnike e ankuesve</i>		
	Shqiptarë	1795
	Serbë	146
	Boshnjakë	31
	Turq	25
	Romë	21
	Ashkali	11
	Të tjerë	18
<i>Gjinia e ankuesve të paraqitur në IAP</i>		
	Meshkuj	1611
	Femra	436
<i>Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		

Gjykatat	577
Ministritë	433
Komunat	298
Ndërmarrjet publike	163
Agjencia Kosovare për Privatizim	125
Policia	92
Prokuroritë publike	41
Kompanitë private	41
Agjencia Kosovare e Pronës	28
Të tjera	312

Tabela 6: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2013

Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	1452
<i>Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin e Avokatit të Popullit</i>	
Mos shfrytëzim i mjeteve juridike - neni 20, pika 1.4	537
S'ka shkelje, keqadministrim - neni 20, pika 1.1	316
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 20, pika 1.3	277
Jashtë juridiksionit - neni 19, pika 1.3.1	248
Mosinteresim, dështim i palës - neni 20, pika 1.2	32
Ankesë e parashtruar pas afatit ligjor - neni 19, pika 1.3.2	31
Të tjera	11

Tabela 7: Rastet e hapura për hetim IAP (1 janar 2013 – 31 dhjetor 2013)

Rastet hapura për hetim nga ankesat e paraqitura nga qytetarët	595
Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (<i>ex officio</i>)	21
<i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i>	
Shqiptarë	474
Serbë	82
Boshnjakë	12
Turq	10
Romë	7

	Të tjerë	10
Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga IAP		
	Meshkuj	453
	Femra	142
Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Gjykatat	195
	Ministritë	133
	Komunat	90
	Ndërmarrjet publike	78
	Policia	35
	Prokuroritë publike	21
	Agjencia Kosovare për Privatizim	18
	Agjencia Kosovare e Pronës	11
	Kompanitë private	5
	Të tjera	51

Tabela 8: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë
(një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

	Mbrojtja e pronës	157
	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	143
	E drejta për mjete juridike	68
	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	63
	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	59
	Të drejtat e të akuzuarit	30
	Barazia para ligjit	23
	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues	23
	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	18
	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	17
	E drejta e qasjes në dokumente publike	14
	Liria e lëvizjes	11
	Raste për ndërmjetësim	10
	Të drejtat e fëmijës	10

	E drejta për arsimin	8
	E drejta e lirisë dhe sigurisë	8
	E drejta e martesës dhe familjes	7
	Dinjiteti i njeriut	6
	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	5
	E drejta e privatësisë	5
	E drejta për jetën	4
	Liria e shprehjes	3
	E drejta e integritetit personal	2
	Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar	1
	Liria e asociimit	1
	Liria e tubimit	1
	E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	1

Tabela 9: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2013
(jo vetëm rastet e vitit 2013, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

	Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	1309
Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin e Avokatit të Popullit		
	I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 19, pika 1.5.	587
	I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 20, pika 1.2	195
	I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 20, pika 1.3	178
	I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - neni 20, pika 1.1	131
	I mbyllur me raport	118
	I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 20, pika 1.4	80
	I papranueshëm, jashtë juridiksionit - neni 19, pika 1.3.1	10
	Të tjera	10

Tabela 10: Autoritetet përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara nga IAP
(një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Themelore në Prishtinë	52
	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	26
	Gjykata e Apelit në Prishtinë	21
	Gjykata Themelore në Gjilan	19
	Gjykata Themelore në Prizren	18
	Gjykata Themelore në Pejë	16
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	10
	Gjykata Themelore në Ferizaj	8
	Gjykata Themelore në Gjakovë	8
	Prokuroria Themelore në Prishtinë	8
	Prokuroria Themelore në Mitrovicë	6
	Gjykata Supreme e Kosovës	6
	Këshilli Gjyqsorë i Kosovës	5
	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	3
	Prokuroria Themelore në Prizren	3
	Paneli për Lirim me Kusht	3
	Prokuroria Themelore në Ferizaj	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	2
AUTORITETET QEVERTARE		
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	41
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	23
	Ministria e Punëve të Brendshme	22
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	11
	Ministria e Drejtësisë	7
	Ministria e Shëndetësisë	5
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	4
	Ministria e Infrastrukturës	3
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3

	Administrata Tatimore e Kosovës	3
	Zyra e Kryeministrit	2
	Ministria për Punë të Jashtme	2
	Qeveria e Kosovës	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	5
PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Prizrenit	12
	Komuna e Pejës	11
	Komuna e Prishtinës	9
	Komuna e Gjilanit	8
	Komuna e Mitrovicës	6
	Komuna e Suharekës	6
	Komuna e Graçanicës	5
	Komuna e Obiliqit	4
	Komuna e Vushtrrisë	4
	Komuna e Kamenicës	3
	Komuna e Kaçanikut	3
	Komuna e Skenderajt	3
	Komuna e Gjakovës	3
	Komuna e Ferizajt	2
	Komuna e Novobërdës	2
	Komuna e Shtërpcës	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	7
INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE		
	Korporata Energjetike e Kosovës	71
	Policia e Kosovës	35
	Agjencia Kosovare për Privatizim	19
	Universiteti i Prishtinës	12
	Agjencia Kosovare e Pronës	11
	Autoritetet e huaja	6
	Komisioni Qendror Zgjedhor	5

	Kuvendi i Kosovës	3
	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike	3
	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	2
	Oda e Avokatëve të Kosovës	2
	Agjencia Kosovare për Kadastër	2
	Galeria e Arteve të Kosovës	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	18
PALË PRIVATE		7

Tabela 11: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Themelore në Prishtinë	25
	Paneli për lirim me kusht	7
	Gjykata Themelore në Pejë	4
	Gjykata Themelore në Gjilan	3
	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	3
	Gjykata e Apelit	2
	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	1
	Prokuroria Themelore në Mitrovicë	1
	Prokuroria e Apelit në Prishtinë	1
AUTORITETET QEVERTARE		
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2
	Ministria e Infrastrukturës	2
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1
	Ministria e Punëve të Brendshme	1
	Qeveria e Kosovës	1
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Prishtinës	3
	Komuna e Parteshit	2

	Komuna e Vitisë	1
	Komuna e Vushtrrisë	1
	Komuna e Mitrovicës	1
	Komuna e Shtërpcës	1
INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE		
	Agjencia Kosovare për Privatizim	4
	KEK	4
	Universiteti i Prishtinës	2
	Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina	1
	KRUK "Hidrodrini" në Pejë	1

Tabela 12: Vonesat e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Themelore në Prishtinë	11
	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	3
	Gjykata e Apelit në Prishtinë	1
	Gjykata Themelore në Prizren	1
	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1
	Prokuroria e Shtetit	1
AUTORITETET QEVERTARE		
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
	Ministria e Infrastrukturës	1
	Ministria e Financave	1
PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Vushtrrisë	2
	Komuna e Ferizajit	1
	Komuna e Mitrovicës	1
INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE		
	Oda e Avokatëve të Kosovës	2
	Universiteti i Prishtinës	1
	Dogana e Kosovës	1

Tabela 13: Raportet dhe rekomandimet e nxjerra nga IAP

	Raporte mbi rastet	17
	Raporte <i>ex officio</i>	6
	Rekomandime në Raportet e nxjerra	55

Tabela 14: Zbatimi i rekomandimeve nga raportet për rastet e hetuara nga IAP

Autoriteti përgjegjës	<i>Rekomandime të implementuara</i>	<i>Rekomandime të paimplementuara</i>	<i>Në pritje për implementim</i>
Gjykata Themelore në Prishtinë	3	5	1
Komuna e Prishtinës		5	
MMPH		5	
Gjykata Themelore në Gjilan		3	
Qeveria e Kosovës		3	
Ministria e Financave			3
Zyra e Prokurorit Disiplinor	3		
KEK	1	2	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2		1
Prokuroria e Apelit në Prishtinë		2	
Komuna e Vitisë		2	
Zyra e Rregullatorit të Energjisë	1	1	
Agjencia Kosovare e Privatizimit		1	1
Ministria e Punëve të Brendshme	2		
Zyra e Kryeministrit	1		
MASHT		1	
Komuna e Mitrovicës		1	
Prokuroria Themelore në Prizren		1	
Gjykata Themelore në Prizren		1	
Gjykata e Apelit në Prishtinë	1		
Komuna e Prizrenit	1		
DHPGJS			1
Gjithsej	15	33	7

5.2. Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2013 - 31 dhjetor 2013

Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2013




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve sipas ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2013




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2013




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2013




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim gjatë vitit 2013




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP




Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë





Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2012

(jo vetëm rastet e vitit 2013, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)



SHKURTESAT

AMPEK	Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
CRONSEE	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKD	Departamenti kundër Diskriminimit
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
ENNHRI	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
EOI	Instituti Evropian i Ombudsmanëve
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
FRA	Agjencia për të Drejta Themelore e Bashkimit Evropian
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKDNJ	Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
IOI	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve
IPFK	Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës
ISHM	Instituti i Shëndetit Mendor
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për të Drejtat e Fëmijëve

KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Këshilli i Pavarur i Mediave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LAP	Ligji për Arsimin Parauniversitar
LESP	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
LFK	Ligji për Familjen i Kosovës
LGBT	Lesbian Gay Bisexuals Transsexuals
LKD	Ligji kundër Diskriminimit
LQDP	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
LTP	Ligji mbi Tubimet Publike
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIPK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OHCHR	Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PLK	Paneli për Lirim me Kusht
QKD	Qendra Korrektuese në Dubravë
QKL	Qendra Korrektuese në Lipjan
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKS	Qendra Korrektuese në Smrekovnicë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës

QPS	Qendra për Punë Sociale
QV	Qendra e Votimit
RCT	Qendra për Kërkime dhe Rehabilitim të Viktimave të Torturës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Vendvotim
YIHR	Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
ZQKM	Zyra e Qeverisë së Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës